

PLANI KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ENERGJINË DHE KLIMËN



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

VERSIONI DRAFT

Përgatitur nga:

Dr. Andrian VASO

Nëntor 2021

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

Për t'u plotësuar në raportin përfundimtar

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	9
1. TË PËRGJITHSHME	12
1.1. Çfarë është VSM	12
1.2. Kuadri ligjor për VSM-në	13
1.3. Fazat kryesore të procesit të VSM-së	13
1.4. Metoda e punës.....	14
1.4.1. Të dhënat për përgatitjen e raportit të VSM-së.....	15
1.4.2. Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së.....	15
1.5. Procesi i hartimit dhe struktura e raportit të VSM-së.....	16
2. INFORMACION MBI PLANIN KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ENERGJINË DHE KLIMËN	18
2.1. Përmbledhje e procesit për krijimin e planit	18
2.1.1. Të përgjithshme.....	18
2.1.1.1. Konteksti politik, ekonomik, mjedisor dhe social i planit.....	18
2.1.1.2. Strategjia në lidhje me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë	20
2.1.2. Pikësynimet, politikat dhe masat e planit	21
2.1.2.1. Pikësynimet	21
2.1.2.2. Politikat dhe masat.....	21
2.1.3. Marrëdhënia e PKEK-së me strategjitë, programet dhe planet përkatëse	24
2.1.3.1. Niveli ndërkombëtar	24
2.1.3.2. Niveli kombëtar	25
3. GJENDJA E MJEDISIT DHE REGJIMET E MBROJTJES	28
3.1. Informacionet bazë	28
3.1.1. Veçoritë e klimës dhe ndryshimet klimatike	28
3.1.2. Ndryshimet klimatike	28
3.1.3. Mjedisi	30
3.1.3.1. Cilësia e ajrit	30
3.1.3.2. Burimet ujore	31
3.1.3.3. Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës.....	32
3.1.3.4. Erozioni i tokës	40
3.1.3.5. Menaxhimi i mbetjeve	41
3.1.4. Turizmi	42
3.1.4.1. Trashëgimia kulturore	42
3.1.4.2. Peizazhi	43
3.1.5. Popullsia dhe shëndeti	45
3.1.5.1. Popullsia	45
3.1.5.2. Shëndetësia	46
3.1.6. Ekonomia	48
3.1.6.1. Bujqësia	50
3.1.6.2. Industria	50
3.1.6.3. Sektori i ndërtimit.....	52
3.1.6.4. Energjia	52
3.1.6.5. Transporti	57
3.2. Zhvillimi potencial i mjedisit në rast të moszbatimit të PKEK-së – Alternativa “0”	58
3.3. Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial	58
4. OBJEKTIVAT DHE NËNOBJEKTIVAT MJEDISORË LIDHUR ME ZBATIMIN E PKEK-SË	61
4.1. Vlerësimi i ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore.....	80
4.1.1. Objektivi mjedisor “Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj tyre” (OM1)	80
4.1.1.1. Nënobjektivi mjedisor “Rritja e përfitimeve të efikasitetit të energjisë, duke përfshirë ndërtesat me zero shkarkime deri në vitin 2030” (OM1-NoM1).....	80
4.1.1.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	80
4.1.1.2. Nënobjektivi mjedisor “Reduktimi i konsumit final të energjisë” (OM1-NoM2)	88
4.1.1.2.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	89

4.1.1.3.	Nënobjektivi mjedisor "Shfrytëzimi më intensiv i energjisë nga burime të rinovueshme dhe i energjisë elektrike për të dekarbonizuar plotësisht furnizimin me energji deri në vitin 2030" OM1-NoM3.....	97
4.1.1.3.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	97
4.1.1.4.	Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për të arritur vlerën 11.5% në vitin 2030" OM1-NoM4	103
4.1.1.4.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	103
4.1.1.5.	Nënobjektivi mjedisor "Shfrytëzimi i të gjitha përfitimeve të bioekonomisë dhe krijimi në masë të madhe i përthithësve të karbonit" OM1-NoM5.....	110
4.1.1.5.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	110
4.1.1.6.	Nënobjektivi mjedisor "Rritja e lëvizshmërisë ndërkohë që reduktohet konsumi i energjisë në sektorin e transportit" OM1-NoM6	112
4.1.1.6.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	113
4.1.1.7.	Nënobjektivi mjedisor "Reduktim i ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitet dhe përshtatshmëri më e madhe e shoqërisë" OM1-NoM7	114
4.1.1.7.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	114
4.1.2.	Objektivi mjedisor "Jetesa e shëndetshme" (OM2)	118
4.1.2.1.	Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i shkarkimeve të elementeve ndotëse të ajrit" (OM2-NoM1)	119
4.1.2.1.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	119
4.1.2.2.	Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i mbetjeve" OM2-NoM2	121
4.1.2.2.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	121
4.1.3.	Objektivi mjedisor "Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera" (OM3)	122
4.1.3.1.	Nënobjektivi mjedisor "Parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu dhe kufizimi i pasojave të tyre" OM3-NoM1.....	123
4.1.3.1.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	123
4.1.4.	Objektivi mjedisor "Mbrojtja e habitateve natyrore dhe llojeve" (OM4)	124
4.1.4.1.	Nënobjektivi mjedisor "Mbrojtja e biodiversitetit" OM4-NoM1	124
4.1.4.1.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	124
4.1.4.2.	Nënobjektivi mjedisor "Mbrojtja e zonave të ruajtjes së natyrës dhe e vlerave natyrore" OM4-NoM2.....	128
4.1.4.2.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	129
4.1.5.	Objektivi mjedisor "Qëndrueshmëria e mjedisit socio-ekonomik" (OM5).....	130
4.1.5.1.	Nënobjektivi mjedisor "Qëndrueshmëria mjedisore" OM5-NoM1	130
4.1.5.1.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	131
4.1.5.2.	Nënobjektivi mjedisor "Zhvillimi i një qasjeje për adresimin e problemit të varfërisë energjetike" OM5-NoM2	134
4.1.5.2.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	135
4.1.5.3.	Nënobjektivi mjedisor "Ekonomia qarkulluese si një faktor kyç në reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe në krijimin e një industrie konkurruese" OM5-NoM3	136
4.1.5.3.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	136
4.1.5.4.	Nënobjektivi mjedisor "Zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme të interkoneksioneve dhe rrjetit inteligjent" OM5-NoM4.....	138
4.1.5.4.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	138
4.1.5.5.	Nënobjektivi mjedisor "Edukimi lidhur me energjinë dhe klimën" OM5-NoM5.....	140
4.1.5.5.1.	Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së	140
4.1.6.	Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore.....	141
4.2.	Ndikimet ndërkufitare.....	149
5.	gjendja dhe masat zbutëse	153
5.1.	Gjendja.....	153
5.2.	Masa zbutëse.....	153
5.2.1.	Masat zbutëse në aspektin organizativ/administrativ.....	153
5.2.2.	Masat zbutëse për marrjen në konsideratë të shpërndarjes hapësinore të objekteve dhe infrastrukturës.....	154
5.2.3.	MZ-të për parandalimin, eliminimin, minimizimin dhe kompensimin e ndikimeve mjedisore dhe shëndetësore	155
5.2.4.	Masat zbutëse për plotësimin e PM-ve të PKEK-së	156

5.2.5.	Masat zbutëse lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.....	158
5.2.6.	Masat zbutëse lidhur me përdorimin e BRE-ve.....	158
6.	MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT	160
7.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	168
8.	PROCESET E KONSULTIMEVE.....	171
9.	BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT	172
10.	SHTOJCAT	175
10.1.	Shtojca 1 – Kuadri ligjor gjithëpërfshirës.....	176
10.2.	Shtojca 2 – Konsultimet me publikun	179
10.3.	Shtojca 3 – Përmbledhje e institucioneve të përfshira në sektorin e energjisë.....	180

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Fazat kryesore të procesit të VSM-së.....	13
Tabela 2: Lloji ose natyra e ndikimit të PKEK-së në mjedis.....	15
Tabela 3: Kategoritë e përmasave të ndikimeve të PKEK-së në arritjen e objektivave mjedisore	16
Tabela 4: Pikësynimet 2030 dhe kontributet në sektor	21
Tabela 5: Tabelë përmbledhëse e politikave kyçe që ndikojnë në objektivin kombëtar klimatik deri në vitin 2030	22
Tabela 6: Të dhënat vjetore mbi ndotjen e ajrit në disa prej stacioneve kryesore	30
Tabela 7: Të dhënat mbi burimet ujore	31
Tabela 8: Lista e zonave të mbrojtura.....	35
Tabela 9: Profili demografik dhe shëndetësor i Shqipërisë	47
Tabela 10: Gjenerimi i energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë.....	53
Tabela 11: Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial.....	59
Tabela 12: Objektivat dhe nënobjektivat mjedisore, si dhe politikat dhe masat përkatëse	62
Tabela 13: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM1	80
Tabela 14: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM2	88
Tabela 15: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM3	97
Tabela 16: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM4	103
Tabela 17: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM5	110
Tabela 18: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM6	112
Tabela 19: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM7	114
Tabela 20: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM2-NoM1	119
Tabela 21: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM2-NoM2	121

Tabela 22: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM3-NoM1	123
Tabela 23: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM4-NoM1	124
Tabela 24: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM4-NoM2	129
Tabela 25: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM1	131
Tabela 26: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM2	135
Tabela 27: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM3	136
Tabela 28: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM4	138
Tabela 29: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM5	140
Tabela 30: Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore.....	143
Tabela 31: Krahësimi i PM-ve specifike në varësi të pajtueshmërisë së tyre me OM-të/NM-të, përqindjet e ndikimeve të vlerësuara.....	147
Tabela 32: Interkonektorët ekzistues ndërkufitarë	150
Tabela 33: Modeli i programit të monitorimit të ndikimeve të konsiderueshme në mjedis nga PKEK-ja	164

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Marrëdhëniet ndërmjet VSM-së dhe VNM-së	12
Figura 2: Përmbledhje e dokumenteve politike kombëtare	26
Figura 3: Harta e zonave pyjore në Shqipëri	32
Figura 4: Harta e zonave të mbrojtura	34
Figura 5: Harta e trashëgimisë kulturore në Shqipëri	43
Figura 6: Harta fizike e Shqipërisë	44
Figura 7: PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren kombëtare (në mijë lekë)	50
Figura 8: Prodhimi industrial në Shqipëri në % (2002-2014)	51
Figura 9: Kuota relative e sektorëve të prodhimit mineral dhe shpërndarja e tyre gjeografike	52
Figura 10: Konsumi i brendshëm bruto (Ktoe)	54
Figura 11: Importet në raport me konsumin e brendshëm bruto për periudhën 2004-2019, shprehur në %	55
Figura 12: Konsumi final i energjisë sipas sektorëve (ktoe)	55
Figura 13: Konsumi final i energjisë për vitin 2019 sipas lëndës djegëse dhe sektorëve	56
Figura 14: Humbjet në transmetim dhe në shpërndarje në raport me energjinë elektrike të transmetuar dhe të shpërndarë në rrjete	56
Figura 15: Intensiteti i energjisë	57
Figura 16: Harta e linjave kryesore të transmetimit dhe e interkonektorëve	150
Figura 17: Kapacitetet e interkonektorëve	151
Figura 18: Organigrama e institucioneve qeveritare të përfshira në hartimin dhe zbatimin e PKEK-së ..	183

SHKURTIME

AK	Autoriteti i Konkurrencës
ACER	Agjencia për Bashkëpunim midis Rregullatorëve të Energjisë
AKEE	Agjencia Kombëtare për Efiçencën e Energjisë
AFD	<i>Agence Française de Développement</i>
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
ALKOGAP	Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë
APEX	Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
ASHRSN	Agjencia Shtetërore e Rezervave të Sigurisë së Naftës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BaU	Punë si zakonisht
BAT	Teknikat më të mira në dispozicion
MBB	Mbetjet Bashkiake të Biodegradueshme
PMB	Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore
BRE-E	Burimet e rinovueshme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike
BRE-N & F	Burimet e rinovueshme të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen
BRE-T	Burimet e rinovueshme të energjisë për transport
cap	Për frymë
CAPEX	Shpenzime kapitale
CCL	Grupi Lobues i Qytetarëve për Çështjet Klimatike
CDD	Gradë-ditët e ftohjes
CEC	Komuniteti i Energjisë për Qytetarët
CfD	Kontratë për Diferencë
CH ₄	Metan
CO ₂	Dyoksid karboni
CO ₂ eq	Ekuivalent i dyoksidit të karbonit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ECM	Masat për ruajtjen e energjisë
EE	Efiçenca e energjisë
PVEE	Plani i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
EED	Direktiva për Efiçencën e Energjisë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EPBD	Direktiva për Performancën e Energjisë së Ndërtesave
KE	Komuniteti i Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Sinkron Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
ESCO	Shoqëria e Shërbimeve Energjetike
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
ESO	Operatori i Sistemit të Transmetimit i Bullgarisë
ETS	Sistemi i tregtimit të shkarkimeve
EV	Automjet elektrik
KFE	Konsumi final i energjisë
FIT	Tarifë e stimuluar "feed-in"
GACMO	Modeli i Kostos së Pakësimit të Gazit me Efekt Serrë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto

GES	Gaze me Efekt Serrë
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
ha	Hektarë
HDD	Gradë-ditët e ngrohjes
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
ERAL	Ekspertët e reformës në arsimin e lartë
HEC	Hidrocentral
HVDC	Instalime me rrymë të vazhduar, me tension të lartë
IAP	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian
IECC	Komiteti Ndërmënor për Energjinë dhe Klimën
EEI	Efiçenca e Energjisë në Industri
INDC	Kontributet Kombëtare të Pikësnuara
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural
PIPP	Proceset Industriale dhe Përdorimi i Produkteve
SNZHRB	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
SIT	Sistemet inteligjente të transportit
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
SIT	Sistemet inteligjente të transportit
KESH	Korporata Elektroenergetike Shqiptare
KfW	<i>Kreditanstalt für Wiederaufbau</i>
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
PVZh	Plani Vendor i Zhvillimit
GNL	Gaz natyror i lëngëzuar
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEPSO	Operatori i sistemit të transmetimit i Maqedonisë së Veriut
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MZ	Masë Zbutëse
MMR	Rregullorja për mekanizmat e monitorimit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PMV	Programi i Monitorimit dhe Verifikimit
MW	Megavat
NAMA	Masa Zbutëse Kombëtare të Përshtatshme
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
PKKVBRE	Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
NDC	Kontributet Kombëtare të Përcaktuara
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
SKZHI II	Strategjia e Dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKE	Strategjia Kombëtare e Energjisë
nZEB	Ndërtesë me konsum energjie thuajse zero

OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
P + R	Park and Ride (stacione ku mund të parkohet mjeti personal dhe të merret një mjet i transportit publik)
PM	Politika dhe masa
PBL	Hua e bazuar në politika
PECI	Projekte me Interes për Komunitetin e Energjisë
PHEV	Mjet elektrik hibrid me karikim me prizë
PMU	Njësi matëse fazorësh
ERP	Elementet e Reformave Politike
TP	Transporti publik
PV	Fotovoltaik
QA/QC	Garancimi i Cilësisë / Kontrolli i Cilësisë
BRE	Burim i Rinovueshëm Energjie
RFNBO	Lëndë djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike
SCC	Qendra për Koordinimin e Sigurisë Energjetike
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
ED	Energjia Diellore
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
PVEQ	Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme
SEE CAO	Zyra e Koordinuar e Ankandëve për Evropën Juglindore në Mal të Zi
SET-Plan	Plani Strategjik për Teknologjitë Energjetike
HECv	Hidrocentral i vogël
SLED	Përkrahje për Zhvillimin me Shkarkime të Ulëta në Evropën Juglindore
TAP	Gazsjellësi Trans-Adriatik
TKPE	Totali i konsumit përfundimtar të energjisë
TEN-E	Rrjetet Transevropiane të Energjisë
TEN-T	Rrjetet Transevropiane të Transportit
toe	tonë ekuivalent naftë
ToR	Termet e referencës
TFEP	Totali i furnizimit me energji primare
TEC	Termocentral
SSTPV	Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020
TYNDP	Plani Dhjetëvjeçar i Zhvillimit të Rrjetit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
WAM	Me masa shtesë
BP	Ballkani Perëndimor
BB*	Banka Botërore
BP6	Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia
WBIF	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
MPEE	Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike
WEM	Me masa ekzistuese
ITUP	Impiant Trajtimi i Ujërave të Përdorura

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Çfarë është VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kryesore për integrimin e shqetësimeve për aspektet mjedisore dhe të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin dhe vendimmarrjen strategjike. Ai është një mjet i njohur në nivel ndërkombëtar për planifikimin me pjesëmarrje i cili përdoret për të analizuar dhe integruar shqetësimet për aspektet mjedisore dhe shëndetësore në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) mund të konsiderohet si “një proces sistematik dhe paraprak që ndërmerret me qëllim analizimin e efekteve mjedisore të planeve, programeve dhe masave të tjera strategjike të propozuara, si dhe integrimin e konkluzioneve në procesin e vendimmarrjes”.

Në përgjithësi, VSM zbatohet për planet, programet, politikat dhe dokumentet e tjera të një natyre strategjike (duke përfshirë mundësisht të gjitha dokumentet ligjore).




Figura 1: Marrëdhëniet ndërmjet VSM-së dhe VNM-së

Burimi: Sustainability 2020, 12, 4039; doi:10.3390/su12104039

Qëllimi i VSM-së mund të përcaktohet si garantimi i informimit të vendimmarrjes strategjike nga aspektet mjedisore dhe integrimi i këtyre të fundit në të për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të shëndoshë në aspektin mjedisor. Në veçanti, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendimmarrësit për të marrë në konsideratë:

- Tendencat, potencialin dhe kufizimet kryesore mjedisore me ndikim të ndërsjellë të plani apo programi
- Objektivat dhe treguesit mjedisorë me rëndësi për planin ose programin

- Efektet e mundshme mjedisore të një niveli të konsiderueshëm si rezultat i opsioneve të propozuara dhe i zbatimit të planit apo programit
- Masat për shmangien, reduktimin ose zbutjen e efekteve negative dhe ato për përforcimin e efekteve pozitive
- Pikëpamjet dhe informacionet nga autoritetet përkatëse, publiku dhe, sipas rastit, shtetet potencialisht të prekura

1.2. Kuadri ligjor për VSM-në

Kuadri ligjor për VSM-në përfshin në mënyrë të detyrueshme ligjin shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për qëllime koherence, nuk përjashtohet kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat ligjore përkatëse gjenden në vijim.

- ❖ **Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”**. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit dhe rishikimit të planeve a programeve me pasoja në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe detyrat e përgjegjësive të tyre, si dhe procedurat, sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Ky ligj është përafshuar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Detaje të mëtejshme mund të gjenden në http://www.legislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.
- ❖ **VKM nr. 219, datë 11.3.2015** “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.
- ❖ **VKM nr. 507, datë 10.6.2015**, “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.
- ❖ **Direktiva 2001/42/KE e Komisionit Evropian** “Mbi vlerësimin e efekteve të disa planeve e programeve në mjedis” (Direktiva për VSM-në). Informacione të mëtejshme mund të gjenden në <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.
- ❖ **Protokolli i VSM-së**, i miratuar në Kiev (Ukrainë) në vitin 2003, në një mbledhje të jashtëzakonshme të palëve të Konventës së ESPOO-s gjatë konferencës ministeriale “Mjedisi për Evropën” dhe i nënshkruar nga 36 shtete dhe nga Komuniteti Evropian. Informacione të mëtejshme mbi Protokollin e VSM-së mund të gjenden në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.

1.3. Fazat kryesore të procesit të VSM-së

Fazat kryesore të procesit të VSM-së përshkruhen në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Fazat kryesore të procesit të VSM-së

Fazat	Përshkrimi
Ekzaminimi	Ekzaminimi identifikon nëse nevojitet zbatimi i VSM-së për një plan, program apo projekt specifik. Kjo fazë fokuson burimet te planet, programet dhe projektet që mund të rezultojnë potencialisht në efekte të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore dhe përjashton nga sistemi i VSM-së ato me pasoja mjedisore dhe shëndetësore të pakonsiderueshme (ose pa pasoja). Synimi i fazës së ekzaminimit është të identifikojë nëse nevojitet zbatimi i VSM-së/VNM-së për një plan, program

	apo projekt specifik.
Përcaktimi i fushës së zbatimit	Çështjet e identifikuar gjatë kësaj faze do të udhëheqin vlerësimin e gjendjes mjedisore ekzistuese, vlerësimin real të ndikimeve të mundshme dhe marrjen në konsideratë të alternativave ose opsioneve të mundshme. VSM merr në konsideratë përfshirjen e çështjeve mjedisore ose sociale më gjithëpërfshirëse, p.sh. përshtatjet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë e punësimit etj. Synimi i fazës së përcaktimit të fushës së zbatimit është identifikimi i çështjeve kryesore që duhet të adresohen në raportin specifik të VSM-së.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese siguron një bazë për vlerësimin e ndikimit, hartimin e masave zbutëse dhe skemën e monitorimit. Për VSM-në është me rëndësi që të përmbledhë tendencat e ardhshme potenciale. Rrjedhimisht, me qëllim vlerësimin e zhvillimeve të mundshme në të ardhmen, nevojitet analizimi i tendencave të kaluara. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme nuk mund të kryhet pa kuptuar siç duhet gjendjen ekzistuese lidhur me çështjet kryesore të identifikuar gjatë përcaktimit të fushës së zbatimit. <i>Synimi i analizës së gjendjes ekzistuese është arritja e përmirësimit të specifikimit të çështjeve kryesore dhe e identifikimit të problemeve kryesore lidhur me planin, programin apo projektin përkatës.</i>
Analiza e ndikimit dhe masat zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe pozitive të planit, programit apo projektit të propozuar. Një nga përfitimet kryesore të VSM-së është mundësia të identifikimit të efekteve mjedisore për një sërë propozimesh të përfshira në dokumentin strategjik dhe, rrjedhimisht, mundësia të adresimit të efekteve të mundshme kumulative të cilat mund të rezultojnë nga masat që zbatohen përgjatë një periudhe të caktuar kohore pa ndonjë peshë të konsiderueshme të marra individualisht, por me shumë peshë në tërësinë e tyre. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuar, VSM sugjeron masa për trajtimin e efekteve të mundshme negative, si dhe për përf forcimin e ndikimeve pozitive që mund të rezultojnë nga plani, programi apo projekti. <i>Kjo fazë synon vlerësimin e efekteve të konsiderueshme negative e pozitive të një plani, programi apo projekti dhe, në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, marrjen në konsideratë të alternativave dhe opsioneve, si dhe hartimin e masave për parandalimin, reduktimin dhe, për aq sa është e mundur, kompensimin e efekteve të konsiderueshme negative si pasojë e zbatimit të planit, programit apo projektit.</i>
Përgatitja e raportit të VSM-së	Raporti i VSM-së/VNM-së duhet të përmbledhë të gjitha rezultatet dhe konkluzionet e arritura gjatë procesit të plotë të VSM-së/VNM-së, si dhe duhet të shërbejë si referencë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. <i>Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të thjeshtë e të kuptueshëm, që të sigurojë në mënyrë të qartë të gjitha informacionet, të dhënat, konkluzionet dhe rekomandimet e rëndësishme dhe që, rrjedhimisht, të mundësojë konsultime efikase me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.</i>
Miratimi	Dhënia e informacioneve mbi planin/programin e miratuar, mbi mënyrën se si janë marrë në konsideratë komentet e konsultimeve dhe mbi metodat për monitorimin e efekteve të konsiderueshme mjedisore të zbatimit të planit/programit.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe marrja e masave të përshtatshme korrigjuese për të gjitha efektet të konsiderueshme dhe të paparashikuara në mjedis.

1.4. Metoda e punës

1.4.1. Të dhënat për përgatitjen e raportit të VSM-së

Për përgatitjen e raportit të VSM-së, përdoren të dhënat publike dhe të dhënat e siguruar nga hartuesi i Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) të Republikës së Shqipërisë dhe nga institucionet kompetente.

1.4.2. Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së

Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së është në pajtueshmëri me ligjin nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" i harmonizuar plotësisht me direktivën e BE-së: 2001/42/EC "Për vlerësimin e ndikimit të disa planeve dhe programeve në mjedis".

Në bazë të të dhënave të përftuara, u krye një përmbledhje e politikave dhe masave (PM) të marra në konsideratë nga PKEK. U përcaktuan ndikimet potenciale (pozitive dhe negative) të zbatimit të planit në komponentë individuale të mjedisit dhe u vlerësua shkalla e rëndësisë së ndikimeve. U mor gjithashtu një vendim dhe u dhanë sqarime në lidhje me marrjen në konsideratë dhe vlerësimin e mëtejshëm të ndikimeve të PM-ve të përcaktuara në PKEK te komponentë individuale të mjedisit. Janë zhvilluar objektivat dhe nënobjektivat mjedisore, si dhe kriteret e vlerësimit.

Ndikimet e konsiderueshme të identifikuar gjatë fazës së vlerësimit u analizuan më në detaj gjatë përgatitjes së raportit të VSM-së, duke përcaktuar llojin ose natyrën e ndikimit.

Tabela 2: Lloji ose natyra e ndikimit të PKEK-së në mjedis

Lloji ose natyra e ndikimit	Përshkrimi
Ndikim i drejtpërdrejtë	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PKEK planifikon masa që ndikojnë drejtpërdrejtë në gjendjen e mjedisit.
Ndikim jo i drejtpërdrejtë	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PKEK planifikon masa që kanë ndikime në gjendjen e mjedisit, të cilat vijnë si rezultat i zbatimit të planit dhe shfaqen në distancë nga pika e ndërhyrjes në mjedis.
Ndikim kumulativ	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PKEK planifikon masa me ndikim të pakonsiderueshëm në gjendjen e mjedisit, por që së bashku me ndërhyrjet ekzistuese në mjedis dhe/ose ndërhyrjet e planifikuara dhe/ose të zbatuara në bazë të planeve/programeve të tjera kanë një ndikim të konsiderueshëm në mjedis; ose kur disa ndikime individuale, të pakonsiderueshme në aspektin mjedisor të lidhura me një ose disa masa të PKEK-së kanë një ndikim efektet e të cilit në pjesë të caktuara të mjedisit nuk janë të pakonsiderueshme.
Ndikim sinergjik	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PKEK planifikon masa me ndikime mjedisore që të kombinuara me njëra-tjetrën janë më të konsiderueshme në krahasim me shumën ndikimeve individuale.
Kohëzgjatja e ndikimit	Ndikim i përkohshëm: përbën një ndikim të një natyre të përkohshme. Ndikim afatshkurtër: është ndikimi efektet e të cilit në gjendjen e mjedisit përfundojnë pas (5) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PKEK-së. Ndikim afatmesëm: është ndikimi efektet e të cilit në gjendjen e mjedisit përfundojnë pas pesë (5) deri në dhjetë (10) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PKEK-së. Ndikim afatgjatë: është ndikimi efektet e të cilit në treguesit e caktuar të gjendjes së mjedisit përfundojnë pas (10) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PKEK-së. Ndikim i përhershëm: është një ndikim që lë pasojë afatgjatë në zbatimin e PKEK-së.

Ndikimet në arritjen e objektivave mjedisore u vlerësuan mandej në bazë të shtrirjes së ndryshimeve të treguesve individualë të gjendjes së mjedisit dhe rëndësisë së tyre, masës së pajtueshmërisë me objektivat e mbrojtjes ose në bazë të kriterëve të tjera të vlerësimit, në varësi të gjendjes së mjedisit ose komponentëve të tij, mbrojtjes së burimeve natyrore, mbrojtjes së vlerave natyrore, ruajtjes së biodiversitetit, karakteristikave të popullsisë dhe shëndetit të njeriut.

Metodologjia e vlerësimit dhe kategoritë e përmasave të ndikimeve të PKEK-së lidhur me arritjen e objektivave mjedisore përcaktohen në bazë të legjislacionit shqiptar mbi VSM-në dhe markohen sipas kategorive A deri në E dhe me X në rast të pamundësisë së vlerësimit të ndikimeve.

Tabela 3: Kategoritë e përmasave të ndikimeve të PKEK-së në arritjen e objektivave mjedisore

Kategori a	Përkufizimi i kategorisë
A	Zero ndikime ose ndikim pozitiv
B	Ndikim i pakonsiderueshëm
C	Ndikim i pakonsiderueshëm si rezultat i zbatimit të masave zbutëse
D	Ndikim i konsiderueshëm
E	Ndikim shkatërrues
X	Ndikim i papërcaktueshëm

Nëse vlerësimet e ndonjë prej pasojave të zbatimit të PKEK-së klasifikohen në kategoritë e përmasave A ose B, ndikimet e planit në fjalë janë të pranueshme. Nëse vlerësimet e ndonjë prej pasojave të zbatimit të PKEK-së klasifikohen në kategorinë e përmasave C, ndikimet e planit në fjalë janë të pranueshme si rezultat i masave zbutëse. Nëse vlerësimet e ndonjë prej ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore klasifikohen në kategoritë e përmasave D ose E ose nëse ndikimi është i papërcaktueshëm, ndikimet si rezultat i zbatimit të ndërhyrjeve të planifikuara në arritjen e objektivave mjedisore janë të papranueshme.

Masat e caktuara zbutëse shpjegohen si dhe përcaktohen në raport me kohën dhe vendin e zbatimit. Gjithashtu përcaktohet edhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës zbutëse.

1.5. Procesi i hartimit dhe struktura e raportit të VSM-së

Raporti tematik u përgatit në bazë të dokumentit Albania_NECP_draft_19_Jul_sg_clean, të datës 19 korrik 2021. Ai konsiston në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin:

- Metodologjinë e ndjekur për përgatitjen e raportit të VSM-së;
- Informacionin mbi Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës;
- Gjendjen e mjedisit dhe përcaktimin e çështjeve kryesore mjedisore.

Pjesa e dytë lidh dhe kombinon këto përmbajtje në kuadrin e:

- Përcaktimit të objektivave mjedisore (OM) dhe nënobjektivave mjedisore (NoM) lidhur me VSM-në për PKEK-në;
- Identifikimit të politikave dhe masave të PKEK-së në lidhje me secilën prej OM-ve/NoM-ve;
- Përcaktimit të kriterëve dhe metodave për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve;
- Identifikimit të ndikimeve për secilën prej politikave dhe masave në lidhje me OM-të/NoM-të;
- Vlerësimit të ndikimeve si rezultat i zbatimit të politikave dhe masave të PKEK-së tek OM-të/NoM-të (duke përfshirë ndikimet ndërkufitare, nëse ka);

- Përcaktimit të masave zbutëse dhe monitorimit lidhur me zbatimin e PKEK-së.

Ndikimet e masave të renditura nga PKEK merren në konsideratë në tërësinë e tyre në përputhje me secilën prej objektivave ose nënobjektivave të veçanta mjedisore. Paraqiten vlerësimet lidhur me pranueshmërinë e ndikimeve dhe cilësohen masat zbutëse, si dhe rekomandimet dhe ndikimet ndërkufitare.

Objektivat e përcaktuara mjedisore konsiderohen në raport me sektorët përkatës të prekur nga zbatimi i PKEK-së. Arsyeja është përcaktimi i objektivave në raportin e VSM-së, detyra e të cilit është verifikimi i shtrirjes së efektit, negativ ose pozitiv, të zbatimit të PKEK-së në arritjen e objektivave të politikave sektoriale (p.sh. mbrojtja e natyrës, shëndeti i njeriut, furnizimi dhe konsumi i energjisë, zbatimi i EE-së dhe BRE-së etj.). Duhet theksuar gjithashtu se raporti i VSM-së përdor terminologjinë e marrë nga legjislacioni për mbrojtjen mjedisore.

2. INFORMACION MBI PLANIN KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ENERGJINË DHE KLIMËN

Tabela e mëposhtme bën një përmbledhje të përmbajtjes së PKEK-së:

Kategoria e të dhënave	Përshkrimi
Emri:	Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën (version draft i 19 korrikut 2021, i dorëzuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Shqipërisë)
Përgatitur nga:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë
Periudha e parashikuar e zbatimit:	2021–2030
Zona e zbatimit:	Territori i Republikës së Shqipërisë
Përdorimi i synuar i hapësirës:	Në disa vende, plani përfshin vendndodhje të veçanta për ndërhyrjet në mjedis, por nuk përcakton përdorimin e synuar të hapësirës.

Deklarata:

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Politikën e Klimës në Vendet e Evropës Juglindore dhe Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, faza III”. Projekti është pjesë e Nismës Ndërkombëtare për Klimën (NNK). Ministria Federale Gjermane për Mjedisin, Mbrojtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMU) mbështet këtë nismë në bazë të një vendimi të miratuar nga Bundestagu gjerman.

2.1. Përmbledhje e procesit për krijimin e planit

2.1.1. Të përgjithshme

Shqipëria është angazhuar në përgatitjen e Planit të saj të parë Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2021-2030, gjatë vitit 2020. Periudha e zhvillimit u desh të zgjatej për shkak të pandemisë së COVID-19.

Ky PKEK bazohet në Strategjinë Kombëtare për Energjinë (SKE) dhe në Kontributet e para Kombëtare të Përcaktuara (NDC), si dhe është harmonizuar me draftin e rishikuar të NDC-së. Diferencat në raport me dokumentet politike ekzistuese janë analizuar dhe mund t’u atribuohen, ndër të tjera, nevojës për përshtatje me evoluimin e bazës së njohurive.

Hartimi i PKEK-së sjell nevojën për një gamë të gjerë të dhënash të besueshme dhe konsistente. Të dhënat më të rëndësishme mbi ndryshimet klimatike janë mbledhur dhe përpunuar nga projektet e asistencës teknike të UNDP-së gjatë përgatitjes së komunikimeve kombëtare për KKKBNK. Për sa i përket procesit të hartimit të PKEK-së, aksesueshmëria e të dhënave dhe niveli i detajimit nuk kanë qenë gjithnjë në nivele optimale, për shkak të procedurave dhe afateve të ndryshme. Pavarësisht këtyre sfidave, ecuria me përafrimin e PKEK-së dhe NDC-së për progres-raportet dhe përditësimet e ardhshme ka qenë e kënaqshme. Megjithatë, nevojiten masa zyrtare për të garantuar mbledhjen e të dhënave të ndara sipas kategorive, konsistencën e të dhënave dhe transparencën e tyre për aktivitetet e ardhshme.

2.1.1.1. Konteksti politik, ekonomik, mjedisor dhe social i planit

Konteksti politik:

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se ekzistojnë politika dhe ligje për secilin prej pesë dimensioneve të Unionit të Energjisë.

Shqipëria është përfshirë në procesin e krijimit të një tregu të brendshëm mbështetës në fushën e energjisë dhe në garantimin e sigurisë së energjisë, efikasitetit të energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit, përfshirë këtu edhe reduktimin e shkarkimeve të GES-ve të përshkuara dhe të prezantuara në një sërë masash dhe investimesh të planifikuara që identifikohen në dokumente politike të ndryshme. Strategjia Kombëtare e Energjisë, Plani i Dytë dhe i Tretë i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe Strategjia e Transportit kanë përcaktuar objektiva dhe pikësynime për rritjen e sigurisë së furnizimit me anë të investimeve në sektorin e energjisë elektrike, penetrimit të gazit në tregun shqiptar dhe rritjes së përqindjes së BRE-ve dhe EE-së, pasuar nga një reduktim i shkarkimit të GES-ve.

Ligji nr.155/2020 “Për ndryshimet klimatike” ka krijuar një bazë për transpozimin e rregullores për qeverisjen dhe legjislacionit përkatës të BE-së për ndryshimet klimatike.

Për implementimin dhe zbatimin e plotë të politikave për energjinë dhe klimën, gjatë vitit 2020 është miratuar plotësisht legjislacioni dytësor për efikasitetin e energjisë, përfshirë këtu edhe performancën e energjisë në ndërtesa, ndërsa legjislacioni dytësor për burimet e rinovueshme të energjisë është ende në hartim e sipër ose nuk ka filluar ende të hartohet.

Struktura institucionale për planifikimin dhe raportimin e politikave dhe masave në lidhje me energjinë dhe klimën është në zhvillim e sipër. Krijimi i institucioneve dhe profesioneve në vijim, i cili është miratuar me ligj, mbetet ende për t’u konkretizuar në praktikë: Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë¹, Operatori i Energjisë së Rinovueshme, shoqëritë e shërbimeve energjetike, Instituti Shkencor i Hidrokarbureve, operatorët e gazit natyror.

Konteksti ekonomik:

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave kombëtare të energjisë dhe hartimi i PKEK-së do të ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Shumë prej investimeve që janë parashikuar të realizohen në mbarë sektorin e energjisë do të kenë një ndikim të madh në rritjen e PPB-ve sektoriale, gjenerimin e të ardhurave dhe shtimin e forcave punëtore në fusha të ndryshme.

Politikat dhe masat që lidhen me ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave, si dhe me ndërtimin e sistemeve fotovoltaike, do të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e punëve ekologjike. Reduktimi i varësisë nga energjia e importuar do të kontribuojë jo vetëm në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, por edhe në rritjen e sigurisë makroekonomike dhe politike të vendit në sajë të zvogëlimit të deficitit në buxhetin e brendshëm.

Konteksti mjedisor:

Politikat energjetike të Shqipërisë ndjekin tri objektiva:

- i) mbështetja për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë,
- ii) rritja e sigurisë së furnizimit me energji,
- iii) mbrojtja e mjedisit.

¹Deri tani, ky rol është kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN). Ende nuk është përcaktuar agjencia që do të marrë përsipër në mënyrë të përhershme përgjegjësitë e saj.

Burimet e rinovueshme të energjisë, sidomos ato të ndryshme nga burimet hidrike, janë një zgjidhje e mundshme për reduktimin e varësisë strategjike nga energjia e importuar dhe për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike, të cilat shkaktojnë pasiguri të prodhimit hidroenergetik. Megjithatë, ka disa konflikte interesi me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, të cilat duhet të trajtohen siç duhet.

Konteksti social:

Rritja e nivelit të punësimit, kryesisht përmes investimeve në sektorin e energjisë dhe të ndërtimit, ka sjellë rritje të të ardhurave personale/familjare, gjë që është shoqëruar me një rritje të standardit të jetesës të shoqërisë. Ekziston një lidhje e fortë midis mirëqenies personale dhe asaj sociale, çka nënkupton se investimet jo vetëm që krijojnë vende pune, por edhe ndikojnë te të ardhurat e bashkive dhe ato të qeverisë qendrore përmes taksave, tarifave etj. dhe përdorimit të tyre si buxhet për t'u shpenzuar në shëndetësi, arsim etj.

Në mënyrë të veçantë, pikësynimet lidhur me Efiçencën e Energjisë kanë për qëllim reduktimin e konsumit të energjisë për njësi, duke kontribuar kështu në furnizimin me energji të përballueshme dhe reduktimin e varfërisë.

2.1.1.2. Strategjia në lidhje me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë

Pesë dimensionet e Unionit të Energjisë janë: I. siguria e energjisë; II. tregu i brendshëm i energjisë; III. efiçenca e energjisë IV. dekarbonizimi; dhe V. kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca.

Strategjia lidhur me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë bazohet mbi katër shtylla:

- (1) Të diskutojë pikësynimet, politikat dhe masat sektoriale me qëllim identifikimin e mangësive dhe sinergjive, veçanërisht për sa i përket eliminimit të varfërisë energjetike dhe sigurimit të energjisë elektrike të përballueshme për individët, si dhe krijimit të vendeve të punës. Për rrjedhojë, një fokus i rëndësishëm janë edhe masat e financimit.
- (2) Të vërë në dispozicion, për aq sa është e mundur, të dhëna sasiore të një cilësie të lartë. Ato duhet të ofrohen me një nivel sa më të madh detajimi, për të mbështetur procesin e analizimit dhe arritjes së rezultateve të nevojshme për analizat, planifikimin dhe monitorimin e thelluar në sektorë të ndryshëm të lidhur me energjinë.
- (3) Të racionalizojë proceset e mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave, me qëllim kufizimin e barrës mbi administratën publike përgjegjëse për këto detyra. Kjo përbën një shqetësim të përgjithshëm i cili, rrjedhimisht, lidhet ndër të tjera edhe me hartimin e PKEK-së.
- (4) Të rrisë ndërgjegjësimin dhe pranimin e PKEK-së në radhët e të gjitha grupeve të interesit, duke organizuar procedura të informimit dhe konsultimit publik.

Baza për këtë është ngritja e një strukture dhe procedure koordinimi mes ministrive dhe drejtorive të ndryshme që luajnë një rol në pesë dimensionet e Unionit të Energjisë.

Komiteti Ndërmintor për Energjinë dhe Klimën (IECC) është ngritur për të garantuar që pikësynimet, politikat dhe masat e hartuara të jenë të arritshme dhe realiste për sa i përket zbatimit dhe ndikimit të tyre të mundshëm në nivel kombëtar.

Hartimi i PKEK-së konsiderohet si një proces menaxhimi gjithnjë i hapur, i cili bazohet në përmirësimet e vazhdueshme. Situata në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave paraqitet veçanërisht sfiduese dhe është identifikuar si një fushë veprimi me prioritet të lartë, me synim përmirësimin e versioneve të ardhshme të PKEK-së.

2.1.2. Pikësytimet, politikat dhe masat e planit

2.1.2.1. Pikësytimet

Pikësytimet që duhet të arrihen brenda vitit 2030 paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela 4: Pikësytimet 2030 dhe kontributet në sektor

Pikësytimet (2030) dhe referenca		Kontributi në sektor	
Reduktimi i shkarkimeve të GES-ve (Reduktimi në raport me WEM)	-18,7%		
		Shkarkimet e GES-ve [kt CO ₂ eq] sipas parashikimit me masa shtesë për vitin 2030	
		Kërkesa	4833,0
		Transformimi	250,8
		Sektorët joenergjetikë	5139,0
Efiçenca e energjisë (Reduktimi i Konsumit Final të Energjisë në raport me WEM)	-8,4%		
		Konsumi final i energjisë [ktoe] sipas parashikimit me masa shtesë për vitin 2030	
		Sektori i banesave	348,9
		Shërbimet	195,2
		Industria	542,4
		Transporti	1003,4
		Bujqësia Pylltaria	110,5
		Peshkimi	56,0
		Sektorët joenergjetikë	70,6
Përqindja e energjisë së rinovueshme në kërkesën finale për energji	54,4%		
		Përqindja e BRE-ve në kërkesën finale për energji [%] sipas parashikimit me masa shtesë për vitin 2030 <i>* Vlerat mbi 100% janë për shkak të eksporteve të energjisë elektrike.</i>	
		BRE- Energjia elektrike	178,1 %*
		BRE-Transporti	34,6%
		BRE-Ngrohje dhe ftohje	16,6%

2.1.2.2. Politikat dhe masat

Politikat dhe masat (PM) e paraqitura në PKEK identifikohen në bazë të përkufizimeve në nenin 2 të rregullores për qeverisjen:

PM-të caktohen në skenarët me PM ekzistuese (skenari WEM) dhe me PM shtesë (skenari WAM), ku ky i fundit u referohet politikave e masave të planifikuara dhe politikave e masave të reja të cilat kanë realisht gjasa të zbatohen.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të politikave dhe masave kryesore të përshkruara në dokumentin e PKEK-së.

Tabela 5: Tabelë përmbledhëse e politikave kyçe që ndikojnë në objektivin kombëtar klimatik deri në vitin 2030

Dimensioni	Nr.	Kodi i PM-së	Emri i PM	Lloji i PM	Caktuar në skenarin
Dekarbonizim/shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	1 (1)	G-T1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë	Rregullatore	WAM
	2 (2)	G-T2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave	Rregullatore	WAM
	3 (3)	G-T3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës	Rregullatore; Fiskale	WEM
	4 (4)	G-B1	Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen	Rregullatore; Financiare; Edukative	WEM
	5 (5)	G-I1	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	Rregullatore; Edukative	WAM
	6 (6)	G-I2	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së	Rregullatore	WAM
	7 (7)	G-A1	Promovimi i bujqësisë organike	Rregullatore; Financiare	WEM
	8 (8)	G-A2	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri	Rregullatore	WAM
	9 (9)	G-A3	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi	Rregullatore	WEM
	10 (10)	G-W1	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet	Rregullatore; Financiare	WEM
	11 (11)	G-W2	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri	Rregullatore; Financiare	WEM
	12 (12)	G-W3	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	Rregullatore; Financiare	WEM
	13 (13)	G-LF1	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave	Rregullatore; Financiare	WAM
	14 (14)	G-LF2	Menaxhimi ekologjik i pyjeve	Rregullatore; Financiare	WAM
Energjitë e rinovueshme	1 (15)	R-E1	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla të rinovueshme	Rregullatore; Financiare	WEM dhe WAM
	2 (16)	R-E2	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë	Rregullatore; Financiare	WEM dhe WAM
	3 (17)	R-E3	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW	Rregullatore	WEM
	4 (18)	R-E4	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme	Financiare	WEM
	5 (19)	R-E5	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.	Rregullatore	WEM
	6 (20)	R-E6	Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik	Rregullatore	WAM
	7 (21)	R-E7	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë	Rregullatore	WEM
	8 (22)	R-T1	Elektrifikimi i sektorit të transportit	Rregullatore	WAM
	9 (23)	R-T2	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	Rregullatore; Fiskale	WAM
	10 (24)	R-I1	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor	Investuese; Financiare; Informative; Edukative	WAM
Eficienca e energjisë	1 (25)	EE-O1	Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Rregullatore	WAM
	2 (26)	EE-L1	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së	Rregullatore	WAM

			energjisë në ndërtesa		
	3 (27)	EE-L2	Strategjia afatgjatë e rinovimit (<i>për ndërtesat publike dhe private</i>)	Rregullatore; Financiare; Informative	WAM
	4 (28)	EE-L3	Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (<i>me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.</i>)	Investuese; Rregullatore	WAM
	5 (29)	EE-L4	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)	Investuese; Rregullatore	WAM
	6 (30)	EE-L5	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa (sektori privat)	Financiare; Fiskale	WAM
	7 (31)	EE-S1	Zbatimi i modeleve të ESCO	Rregullatore; Financiare	WAM
	8 (32)	EE-P1	Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	Rregullatore	WAM
	9 (33)	EE-P2	Planet bashkëpërmirësimi të veprimit për efikasitetin e energjisë, zbatimi dhe raportimi	Rregullatore, Edukative	WAM
	10 (34)	EE-E1	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	Rregullatore; Organizative	WAM
	11 (35)	EE-E2	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të	Rregullatore; Organizative	WAM
	12 (36)	EE-C1	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	Rregullatore; Informative	WAM
	13 (37)	EE-T1	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	Informative; Edukative	WAM
	14 (38)	EE-T2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të automjeteve.	Rregullatore; Financiare; Fiskale	WAM
	15 (39)	EE-T3	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	Rregullatore; Financiare; Fiskale	WEM
	16 (40)	EE-T4	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)	Rregullatore	WEM
Siguria energjetike	1 (41)	ES-P1	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	Rregullatore	WEM
	2 (42)	ES-P2	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica	Rregullatore; Financiare	WEM dhe WAM
	3 (43)	ES-O1	Kuadri ligjor plotësisht funksional për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët	Rregullatore	WAM
	4 (44)	ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit	Rregullatore; Financiare	WAM
	5 (45)	ES-O3	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit	Rregullatore	WEM
	6 (46)	ES-O4	Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	Rregullatore; Financiare	WEM
	7 (47)	ES-O5	Plani i emergjencës për gazin natyror	Rregullatore; Financiare	WEM
	8 (48)	ES-O6	Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”	Rregullatore; Financiare	WEM
	9 (49)	ES-R1	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë	Rregullatore; Financiare	WEM
Tregu i energjisë	1 (50)	EM-I1	Ndërlidhësit elektrikë	Rregullatore; Financiare	WEM
	2 (51)	EM-I2	Reforma në sektorin e energjisë elektrike	Rregullatore	WEM
	3 (52)	EM-I3	Caktimi i një operatori BRE dhe transformimi i tarifave “feed-in”	Rregullatore	WAM
	4 (53)	EM-P1	Eliminimi i varfërisë energjetike	Rregullatore	WAM

Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca	1 (54)	RIC-E1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë	Rregullatore; Informative; Edukative; Financiare	WEM
	2 (55)	RIC-E2	Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit	Financiare	WEM
	3 (56)	RIC-E3	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS)	Rregullatore	WAM
	4 (57)	RIC-E4	Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës	Financiare	WAM

2.1.3. Marrëdhënia e PKEK-së me strategjitë, programet dhe planet përkatëse

2.1.3.1. Niveli ndërkombëtar

PKEK-ja hartohet në përputhje me:

- Strategjinë e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), e cila është përafuar me **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara**;
- Detyrimet që burojnë nga nënshkrimi i **Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike** (KKKBNK);
- **Tërësinë e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën.**

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara

Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II) prezanton vizionin kombëtar për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë përgjatë periudhës 2014-2020, si dokumenti kryesor vizionar dhe planifikues për vendin, dhe është përafuar shprehimisht me OZhQ-të. Teksa qëllimi është të maksimizohet përdorimi i treguesve të miratuar në nivel global, vizioni është gjithashtu maksimizimi i treguesve që do të ishin më të përshtatshëm për Shqipërinë².

Për sa u përket Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ 7 - Energji e përbalueshme dhe e pastër, bën thirrje për akses universal në shërbimet energjetike moderne, përmirësim të efikasitetit të energjisë dhe rritje të përqindjes së energjisë së rinovueshme.

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe ndryshimeve klimatike në veçanti. Vetë Kushtetuta e Shqipërisë ka përfshirë “një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin e tanishëm dhe atë të ardhshëm” si një prej objektivave sociale që duhet të merren në konsideratë nga të gjitha institucionet shtetërore.

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), të miratuar në “Samitin e Tokës në Rio” më 1992 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar më 1994, e cila ka përcaktuar objektivin për luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stabilizimit të përqendrimeve të GES-ve në atmosferë dhe kufizimit të rritjes së temperaturave mesatare globale për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm. Në kuadrin e KKKBNK-së, Shqipëria ka nisur procesin e ndryshimit të statusit të saj nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar.

Tërësia e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën

Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar disa dokumente politike, strategji dhe plane veprimi të harmonizuara me tërësinë e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën. Ndonëse

²Rishikimi 3 i Performancës Mjedisore, UNECE

Shqipëria po bën progres për sa i përket transpozimit dhe zbatimit të tërësisë së legjislacionit, mbeten ende disa pika kyçe:

- besueshmëria e bazës së të dhënave për energjinë dhe nevoja për të dhëna makroekonomike shumë më të detajuara me qëllim përmirësimin e analizave, rishikimeve të thelluara dhe monitorimeve të planeve të veprimit dhe strategjive lidhur me energjinë;
- shkalla e ulët e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike;
- nevoja për një kuadër financiar për zbatimin e masave politike.

2.1.3.2. Niveli kombëtar

Në figurën e mëposhtme jepet një përmbledhje e dokumenteve politike kombëtare në lidhje me PKEK-në.




Figura 2: Përmbledhje e dokumenteve politike kombëtare

Strategjia Kombëtare e Energjisë për Shqipërinë

Strategjia e Energjisë për Shqipërinë 2018-2030, si dokumenti strategjik thelbësor për sektorin kombëtar të energjisë, është në koherencë të plotë me politikat dhe strategjitë e tjera kombëtare dhe me objektivat e Paktit të Gjellbër Evropian: Furnizimin me energji të pastër, të përballueshme dhe të sigurt; Ndërtimi dhe rinovimiNdërtimin dhe rinovimin, duke promovuar një sektor ndërtimi më të pastër; Përshejtimin e kalimit drejt lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe inteligjente; Eliminimi i ndotjes Eliminimin e ndotjes përmes masave për reduktimin e shpejtë dhe efikas të ndotjes.

Pesë dimensionet që mbështet strategjia për energjinë janë:

1. Siguria e energjisë, bazuar në diversifikimin e burimeve të energjisë;
2. Integrimi i plotë në tregun rajonal dhe më pas në atë evropian;
3. Efiçenca e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës;
4. Dekarbonizimi i ekonomisë;
5. Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca

Strategjia e Energjisë trajton ligjet, rregulloret dhe reformat e reja institucionale që po zhvillohen aktualisht në Shqipëri, duke përfshirë nxitjet për EE-në dhe BRE-në, reformën e tarifës së energjisë elektrike, zhvillimin e tregut dhe integrimin me tregun e BE-së dhe tregjet rajonale.

INDC (Kontributet Kombëtare të Pikësnuara)

Ndonëse Shqipëria ka një ekonomi me karbon të ulët, INDC-të (Kontributet Kombëtare të Pikësnuara) të Shqipërisë synojnë reduktimin e shkarkimeve të saj të CO₂ me 11,5% krahasuar me skenarin bazë për periudhën 2016 deri në 2030. Ky reduktim është i barasvlershëm me një reduktim të shkarkimeve të CO₂ me 708 Gg brenda vitit 2030. Trajektorja e shkarkimeve për Shqipërinë mundëson një tendencë të lehtë drejt arritjes së 2 tonëve shkarkime të GES-ve për frymë brenda vitit 2050, çka mund të merret si pikësynim për tkurrjen dhe bashkërendimin global të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

Mekanizmat kryesorë për arritjen e këtij objektiivi lidhen me ruajtjen e niveleve të ulëta të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga sektori i prodhimit të energjisë dhe zhvillimin e politikave me karbon të ulët me qëllim parandalimin e rritjes së shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga sektorë të tjerë të ekonomisë.

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2019-2030)

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2019-2030) është përafëruar me dokumentet kryesore në vijim:

- Detyrimet në kuadër të Komunitetit të Energjisë
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim – 2015-2020 (Këshilli Shqiptar i Ministrave, 2017)
- Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë (2020-2022)
- Draft Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKVBRE) i vitit 2019
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Tiranë, qershor 2016)
- Dokumenti i parë për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC) kundrejt arritjes së objektiivit të KKKBNK-së, miratuar me VKM Nr. 762, datë 16.9.2015
- Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKKBRE 2019 – 2020) (VKM Nr. 580, datë 31.7.2018)

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin

Objektivat kombëtare:

- Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor
- Rritja e investimeve në kërkim dhe inovacion me fonde publike dhe burime të tjera alternative, në nivelin 1% të PBB në 2022
- Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në shkencë, teknologji dhe inovacion
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit shkencor dhe bizneseve 2017-2022
- Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor

Në vitin 2014, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje me BE-në për të marrë pjesë në programin kuadër për kërkimin dhe inovacionin Horizon 2020 (2014-2020).

Shqipëria merr pjesë në aktivitete të lidhura me Planin Strategjik për Teknologjitë Energjetike (SET) mbi bazën ligjore në vijim: Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, raporti “Shqipëria 2019”, Raporti që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social.

Dokumente të tjera

Dokumentet e PKEK-së u referohen një sërë ligjeve, VKM-ve, urdhrave etj. lidhur me vetë PKEK-në dhe, në mënyrë specifike, me dimensionet përkatëse. Këto paraqiten, në funksion të referencës, në shtojcën 1.

3. GJENDJA E MJEDISIT DHE REGJIMET E MBROJTJES

3.1. Informacionet bazë

3.1.1. Veçoritë e klimës dhe ndryshimet klimatike

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë është përgjegjës për klimën e saj mesdhetare të karakterizuar nga një dimër i butë dhe i lagësht, i pasuar nga një verë e nxehtë dhe e thatë. Reshjet e shiut janë kryesisht të pranishme gjatë gjysmës së dytë të vitit. Kushtet specifike klimatike ndryshojnë ndjeshëm në varësi të rajoneve. Planet për bregdetin ndikohen në masë të konsiderueshme nga deti. Ky ndikim dobësohet në drejtim të lindjes dhe në drejtim të tokës, duke shkaktuar temperatura më të ulëta dhe reduktim të reshjeve.

Temperaturat mesatare vjetore variojnë nga 17,6°C (në Sarandë, në jug) deri në 7°C (në Vermosh, në veri). Zonat e ulëta karakterizohen nga një shpërndarje pothuajse e qëndrueshme e temperaturave mesatare vjetore prej 14–16°C. Mesatarja vjetore e temperaturave maksimale të ajrit varion nga 11,3 °C në zonat malore deri në 21,8 °C në zonat e ulëta dhe ato bregdetare, ndërsa mesatarja vjetore e temperaturave minimale varion nga – 0,1°C deri në 14,6 °C, përkatësisht.

Temperaturat më të ulëta janë regjistruar në Sheqeras (-25,8°C), Voskopojë (-25,6°C) dhe në Bizë (-34,7°C), ndërsa ato më të larta janë vënë re në Kuçovë (43,9°C), Roskovec (42,8°C) dhe Çiflig (42,4°C).

Disa rajone të përqendruara kryesisht në veri, perëndim dhe jugperëndim të Shqipërisë karakterizohen nga reshje të dendura shiu, me një mesatare vjetore prej 1430 mm. Megjithatë, shpërndarja hapësinore dhe stinore e reshjeve është e variueshme; kryesisht reshjet janë të pranishme gjatë gjysmës së ftohtë të vitit (70%). Zonat më të lagështa janë Alpet e Shqipërisë në veri (Kodër Shëngjergj me sasi të reshjeve vjetore prej 2935 mm dhe Boga me sasi të reshjeve vjetore prej 2883 mm) dhe Kurveleshi në jug (Nivica me sasi të reshjeve vjetore prej 2204 mm). Muaji me regjimin më të dendur të reshjeve në të gjithë Shqipërinë është nëntori, ndërsa periudha me sasinë më të ulët të reshjeve është ajo korrik-gusht.

Reshjet e dëborës janë të pranishme në rajonet malore, pra në Alpe dhe në rajonet malore qendrore dhe jugore. Lartësia mesatare e dëborës në zonat malore është 60-120 cm, me një maksimum prej 2-3 m në Vermosh, Bogë, Theth, Valbonë, Curraj dhe Lurë. Reshjet e dëborës janë një fenomen i rrallë në terrenet e ulëta fushore në perëndim, në veçanti në pjesën jugperëndimore të bregdetit të Shqipërisë. Regjimi i reshjeve është një faktor kyç për prodhimin e energjisë elektrike në nivel kombëtar, duke qenë se pjesa dërrmuese e kësaj energjie në vend prodhohet nga hidrocentralet. Reshjet janë gjithashtu një faktor tepër i rëndësishëm për bujqësinë, e cila është një ndër aktivitetet ekonomike kryesore.

3.1.2. Ndryshimet klimatike

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe ndryshimeve klimatike në veçanti. Vetë Kushtetuta e Shqipërisë ka përfshirë “një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin e tanishëm dhe atë të ardhshëm” si një prej objektivave sociale që duhet të merren në konsideratë nga të gjitha institucionet shtetërore.

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), të miratuar në “Samitin e Tokës në Rio” më 1992 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar më 1994, e cila ka përcaktuar objektivin për luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stabilizimit të përqendrimeve të GES-ve në atmosferë dhe kufizimit të rritjes së temperaturave mesatare globale për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm. Në kuadrin e KKKBNK-së, Shqipëria ka nisur procesin

e ndryshimit të statusit të saj nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar. Ky proces është pjesë thelbësore e procesit të integritetit në BE dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të Gazeve me Efekt Serrë (GES-ve), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, si dhe transpozimin dhe zbatimin e tërësisë së legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike. Me qëllim arritjen e objektivave të reduktimit të shkarkimeve, Marrëveshja e Parisit e miratuar në dhjetor 2015 dhe e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me anë të Ligjit nr. 75/2016, datë 14.7.2016, ka ngritur një “sistem nga poshtë-lart” ku Palëve u duhet të përgatisin dhe të komunikojnë kontribute kombëtare të përcaktuara (NDC) të njëpasnjëshme çdo pesë vite, me synimin për të përmirësuar në mënyrë progresive përpjekjet e tyre. Krahas NDC-ve të tyre, Palët duhet të formulojnë gjithashtu strategji afatgjata zhvillimi për arritjen e niveleve të ulëta të GES-ve brenda mesit të shekullit dhe t’i paraqesin ato brenda vitit 2020, duke demonstruar sesi përpjekjet e tyre do të kontribuojnë në arritjen e objektivit “zero shkarkime” brenda gjysmës së dytë të këtij shekulli.

Përditësimi i radhës i NDC-ve pritët brenda vitit 2020 dhe procesi i hartimit të PKEK-së duhet të jetë në një linjë me procesin e përditësimit të NDC-ve.

Në vitin 2014, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014, u ngrit një grup pune ndërministror për koordinimin e detyrave të ministrive sipas detyrimeve të vendit në bazë të KKKBNK-së. Grupi, i kryesuar nga zëvendës ministri i mjedisit, përfshin përfaqësues të 12 ministrive shqiptare. Ndër të tjera, grupi ka tagrin për të hartuar politika dhe strategji dhe për të garantuar koordinim ndërinstitutional për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me ndryshimet klimatike.

Tërësia e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën

Ndonëse Shqipëria po bën progres për sa i përket transpozimit dhe zbatimit të tërësisë së legjislacionit, mbeten ende disa pika kyçe:

- besueshmëria e bazës së të dhënave për energjinë dhe nevoja për të dhëna makroekonomike shumë më të detajuara me qëllim përmirësimin e analizave, rishikimeve të thelluara dhe monitorimeve të planeve të veprimit dhe strategjive lidhur me energjinë;
- shkalla e ulët e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike;
- nevoja për një kuadër financiar për zbatimin e masave politike.

Një nga shkaqet për moszbatimin e PKVM-ve të mëparshme apo legjislacionit për EE-në ka qenë edhe mungesa e një kuadri financiar për zbatimin e tyre (në formën e një fondi për EE-në apo në formën e një financimi të posaçëm nga shteti). Për të shmangur këtë rrezik, ngritja e mekanizmave të financimit për zbatimin e PKEK-së është çelësi drejt suksesit. Për shkak të kostove mjaft të larta të investimit dhe kohës së gjatë që duhet për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë, investimet strategjike në BRE dhe BR po kthehen në problematika kyçe për sa i përket rritjes së sigurisë së furnizimit, reduktimit të shkarkimeve dhe përshtatjes së kërkesës për energji mbi bazën e planifikimit me kosto sa më të ulët.

Transpozimi i direktivave të BE-së në kuadër të tërësisë së legjislacionit të Komunitetit të Energjisë

Informacionet lidhur me statusin e transpozimit dhe zbatimit të direktivave janë dhënë në kërkesën për dimensionin përkatës. Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar disa dokumente politike, strategji dhe plane veprimi të harmonizuara me tërësinë e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën.

Në vijim përshkruhen dokumentet kryesore politike në lidhje me energjinë:

- Strategjia Kombëtare Sektoriale për Energjinë 2018-2030, e miratuar me VKM nr. 480, datë

31.7.2018, përbën dokumentin strategjik thelbësor për sektorin kombëtar të energjisë, i cili përcakton qartë pikësynimet kombëtare për energjinë për vitin 2030.

- Plani Strategjik për Reformimin e Sektorit të Energjisë në Shqipëri (2018-2020), miratuar me VKM nr. 742, datë 12.12.2018, është një udhërrëfyes për reformimin tërësor të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ai përbën bazën për Huanë e Bazuar në Politika (PBL) për zbatimin e Elementeve të caktuara të Reformave Politike (18 ERP) të renditura në këtë plan strategjik.
- Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë (2020-2022) përfshin pikat në vijim në lidhje me reformat në sektorin e energjisë: (i) Liberalizimin efektiv të tregut të energjisë, me pavarësi të plotë dhe me një bursë funksionale energjie; (ii) Zbatimin e ligjit për burimet e rinovueshme të energjisë; (iii) Miratimin e legjislacionit dytësor për ligjet mbi efikasitetin e energjisë dhe performancën e energjisë së ndërtesave.
- PKVEE-ja e 2-të dhe e 3-të ka përcaktuar disa objektiva dhe pikësynime për t'u arritur brenda vitit 2020, si dhe masat për EE-në, investimet dhe institucionet përgjegjëse.
- Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKKVBRE 2019 – 2020), i miratuar me anë të VKM nr. 580, datë 31.7.2018, parashikon një rritje mesatare të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme me 738 MW, prej të cilave 490 MW nga burimet e energjisë fotovoltaike (PV) dhe 150 MW nga burimet e energjisë eolike.

3.1.3. Mjedisi

3.1.3.1. Cilësia e ajrit

Ndotja e ajrit njihet tashmë si një problem serioz në aspektin shëndetësor në qytetet e mëdha të Shqipërisë. Urbanizimi i shpejtë dhe shtimi i rrjedhojës në ndërtesave rezidenciale dhe atyre tregtare, kombinuar me gjendjen aktualisht të keqe të rrugëve në zonat urbane kanë kontribuar ndjeshëm në ndotjen e ajrit. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe numrit të makinave të vjetra në qarkullim, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.³

Ndotësit kryesorë që ndikojnë në cilësinë e ajrit janë NO₂, O₃, SO₂, CO, PM₁₀, PM_{2.5} dhe benzeni, të cilët shkarkohen nga djegia e materialeve fosile për prodhimin e energjisë dhe transportin. Burimet e ndotjes së ajrit kanë origjinë natyrore dhe antropogjenike.⁴ Të dhënat mbi nivelet e elementeve ndotëse të ajrit në qytetet kryesore tregohen në tabelën 6.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve kombëtare të veprimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e ajrit në zonat urbane nga ndotja, si dhe për përpilimin e masave lidhur me reduktimin e nivelit të ndotjes së ajrit. Kjo ministri është gjithashtu përgjegjëse për garantimin e organizimit dhe funksioneve të proceseve të monitorimit të cilësisë së ajrit. Ministria e Shëndetësisë (MSH) është përgjegjëse për problematikat shëndetësore që lidhen me cilësinë e ajrit, ndërkohë që Instituti i Shëndetit Publik është i angazhuar në monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit në zonat urbane. MSH ka nën varësi Drejtorinë e Shëndetit Publik e cila është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ajrit në nivel rajonal.⁵

Tabela 6: Të dhënat vjetore mbi ndotjen e ajrit në disa prej stacioneve kryesore

Kategoria e të dhënave	PM ₁₀ (µg/m ³)	PM _{2.5} (µg/m ³)	NO (µg/m ³)	O ₃ (µg/m ³)	SO ₂ (µg/m ³)
------------------------	--	---	----------------------------	--	---

³ UNECE, 2012

⁴ MTM, 2014

⁵ Këshilli i Ministrave, 2010

Tiranë	33,5	17,8	41,61	49,4	-
PHI	31,8	15,3	13	52,66	-
Vlora	34,37	16,11	7,25	75,25	-
Korça	27,52	-	5,06	66,2	5,83
Standardi kombëtar	60	15	60	65	60
Standardi evropian	40	25	40	-	-

Burimi: MTM, 2014

3.1.3.2. Burimet ujore

Shqipëria është e pasur në burime ujore. Shtatë lumenj së bashku me degët e tyre derdhen në detin Adriatik. Një total prej 250 liqenesh zënë 4% të territorit shqiptar. Baseni hidrografik që ushqen rrjedhat ujore të Shqipërisë ka një sipërfaqe totale prej 43 305 km², pra rreth 50% më e madhe se territori i vendit.⁶ Tabela 7 paraqet disa të dhëna mbi burimet ujore të Shqipërisë. Lumenjtë e Shqipërisë janë një burim i rëndësishëm për hidrocentralet. Liqenet ndahen në akullnajore, tektonike ose artificiale. Gjithsej ka rreth 56 liqene me origjinë akullnajore, duke përfshirë ato që ndodhen në Alpe, Lurë, Balgjaj, Martanesh, Shebenik dhe Valamar. Liqenet karstike (82 liqene) ndodhen në zonën e Dumresë. Liqenet e krijuara nga veprimtaria tektonike përfshijnë Liqenin e Shkodrës (370 km²), Liqenin e Ohrit (367 km², me një thellësi maksimale prej 300 m), liqenet e Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël (285 km² dhe 44 km² përkatësisht, me nivelin më të lartë ndër liqenet tektonike në Ballkan - 800 m mbi nivelin e detit) dhe Liqeni i Butrintit (16,3 km²). Disa nga liqenet e Shqipërisë kanë origjinë të dyfishtë. Disa prej liqeneve artificiale janë ndërtuar për prodhimin e energjisë elektrike, duke përfshirë ato të ndërtuara në lumin Drin (Fierza, Vau i Dejës, Komani) dhe në lumin Mat (Ulza dhe Shkopeti). Liqenet artificiale përdoren për ujitjen e tokave bujqësore, duke përfshirë ato që ndodhen në Gjanç, Thanë, Kurjan dhe Bezhan. Përgjatë zonës bregdetare të Adriatikut dhe Jonit ka një seri lagunash, ndër të cilat Viluni, Kunë-Vaini, Patoku, Bishtaraka, Karavastaja, Narta, Orikumi. Liqenet në zonat kodrinore dhe ato malore janë të rëndësishme për sa i përket turizmit, mbrojtjes së ekosistemit dhe prodhimit të peshkut.

Tabela 7: Të dhënat mbi burimet ujore

Treguesit	Vlera
Prurjet totale vjetore	39,22 miliardë m ³ /vit
Burimet e rinovueshme ujore	13 300 m ³ për frymë
Burimet e rinovueshme nëntokësore	1 250 milionë m ³ /vit
Lumenjtë kryesorë	Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa
Liqenet kryesore	Prespa, Ohri dhe Shkodra
Përdorimi kryesor i burimeve ujore	Për qëllime urbane, industriale, bujqësore dhe për energjinë hidrike
Humbjet e sasisë së ujit	>60 % në të gjitha qytetet
Furnizimi me ujë nga sistemi publik	Mbulim i 85% të popullsisë
Përdorimet bujqësore	Mbulim me sistem ujitjeje i 43% të territorit
Prodhimi i energjisë	90%

Burimi: Përshtatur nga UNECE, 2012 dhe Banka Botërore, 2010

Shumë prej problemeve lidhen me menaxhimin aktual të burimeve ujore, duke përfshirë:

- Sistemin e dobët të monitorimit, si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore;

⁶ UNECE, 2012

- Mangësitë në infrastrukturën hidrike, veçanërisht në furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të përdorura;
- Mirëmbajtjen e pamjaftueshme të infrastrukturës hidrike;

Kuadrin e dobët rregullator dhe financiar në sektorin e ujit, kombinuar me mungesën e një strategjie afatgjatë, e cila duhet të shërbente si një program për të gjitha aktivitetet dhe projektet në këtë sektor.

Të gjitha problematikat e mësipërme kanë rezultuar në një nivel të lartë ndotjeje të burimeve ujore në zonat e populluara. Këto probleme lidhur me cilësinë përkeqësohen më tej nga rritja e kërkesës për burime ujore në disa zona të vendit ku ujërat e brendshme janë tepër të pakta. Zbatimi i tërësisë së legjislacionit të BE-së lidhur me cilësinë e ujit në zonë mbetet një sfidë madhore. Kapaciteti i ndërmarrjeve publike të ujësjellësit lidhur me menaxhimin e shërbimeve bazë të furnizimit me ujë të pijshëm dhe me trajtimin e ujërave të përdorura është i ulët. Planet për menaxhimin e basenit të lumenjve janë ende në fazë zhvillimi.


Menaxhimi i burimeve ujore në nivel kombëtar është përgjegjësi e Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU), i cili është një organ ndërinstitucional i kryesuar nga Kryeministri, me anëtarësi nga ministri të ndryshme. Në nivel rajonal përgjegjësi i takon Këshillave të Baseneve Ujore (KBU) të kryesuara nga Perfekti.

3.1.3.3. Mbrojtja e biodiversitetit dhe natyrës

Shqipëria njihet për diversitetin e lartë të ekosistemeve dhe habitateve të saj. Në brendësi të territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurre me gjelbërim të përhershëm e gjethegjera, pyje gjethegjera, pyje me pisha, kullota dhe livadhe alpine e nënalpine, si dhe ekosisteme të larta malore.

Sipërfaqja e përgjithshme e Shqipërisë ndahet në tri zona ekologjike kryesore (zona bregdetare fushore, zona kodrinore nënmalore e tranzicionit dhe zona malore) dhe 13 në nënzona, të cilat kontribuojnë në biodiversitetin e pasur të vendit.

Pyjet



Shqipëria është e pasur në pyje dhe kullota. Në Shqipëri ka 4 zona fitoklimatike si rezultat i disa faktorëve si toka, klima dhe bimësia, përkatësisht: zona e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare, zona me dru lisi, zona me dru ah dhe dru halorë, si dhe kullotat alpine. Pyjet mbulojnë 1 030 000 ha ose 36% të territorit të vendit, ndërsa kullotat rreth 400 000 ha ose 15% të territorit. Përafërsisht 60% (244 000 ha) e kullotave janë kullota alpine, nënalpine dhe livadhe.

Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimë dhe shtazore. Përafërsisht 60% e kullotave janë kullota alpine, nënalpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kanë një diversitet të lartë të shkurreve mesdhetare, pyjeve me lis, pyjeve me ah, pishave malore, etj. dhe komuniteteve të kafshëve.

Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme me rëndësi në rajonin e Mesdheut si për shembull laguna, ligatina, duna ranore, delta lumenjsh, pyje

Figura 3: Harta e zonave pyjore në Shqipëri
Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

hidrofile dhe higrofile. Liqenet dhe lumenjtë janë gjithashtu të rëndësishëm për larminë biologjike dhe larminë e peizazhit në vend. Bukuria e peizazhit e bën Shqipërinë tërheqëse për aktivitete rekreative në natyrë.

Biodiversiteti

Duke marrë parasysh informacionin ekzistues, Shqipëria ka një diversitet të pasur të florës dhe faunës me rreth 3 200 lloje bimësh vaskulare, 2 350 lloje bimësh jo vaskulare dhe 15 600 lloje jovertebrorësh dhe vertebrorësh. Shqipëria është një rrugë e rëndësishme shtegtimi për zogjtë.

Në Shqipëri gjenden afërsisht 30% e florës evropiane dhe 42% e gjitarëve evropianë. Relievi ka krijuar kushtet për ekzistencën dhe mbrojtjen e disa llojeve endemike dhe nënendemike. Ka 32 lloje bimore me 150 nënlloje që janë endemike në Shqipëri dhe 160 lloje të tjera bimore që janë nënendemike në rajonin e Ballkanit.

Shqipëria ka 91 lloje ornitofauna të rrezikuara globalisht dhe disa prej tyre kanë rëndësi kritike (p.sh. *Pelecanus crispus*, *Phalacrocorax pygmeus* dhe *Acipenser sturio*). Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdha janë zona të rëndësishme, veçanërisht për zogjtë që migrojnë në dimër. Në to, çdo vit hasen 70 lloje të shpendëve të ujit dhe zogjve të ujit me një popullsi të përgjithshme prej 180 000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. Shqipëria ka një numër racash autoktone të bagëtive dhe të lashtave. Rreth 30 lloje të lashtash janë autoktone të Shqipërisë. Ka 9 raca autoktone dhish dhe 5 delesh. Ka një trashëgimi të rëndësishme për mbrojtjen dhe përmirësimin e prodhimit dhe cilësisë së bujqësisë dhe blegtorisë.

Në zonat malore ka më shumë se 52 00 ha pyje natyrore me pemë më shumë se 200 vjeçare me vlerë të lartë për biodiversitetin e kafshëve dhe shpendëve të egra dhe për qëllime argëtimi. Kjo zonë është më e rëndësishmja për kërkime dhe burime gjenetike.

Flora

Flora e shumëllojshme e Shqipërisë përbën rreth 30% të të gjitha llojeve bimore evropiane në vend, ku rreth 3 200 lloje të florës dhe rreth 250 lloje mund të përdoren si mjekim, erëza apo aromatizues. Elementet kryesore të florës shqiptare janë mesdhetare (24%), ballkanike (22%), evropiane (18%) dhe euroaziatike (14%).

Fauna

Për sa i përket spektrit të faunës në vend ai mbizotërohet nga elemente euroaziatike, holarktike, mesdhetare dhe ballkanike. Pyjet e lartë të Shqipërisë mbajnë komunitete gjitarësh të mëdhenj si ujku, ariu kaf, rrëqebulli, dhia e egër, derri i egër, kaprolli etj. Rreth 756 lloje vertebrorësh raportohen deri më sot në Shqipëri dhe prej tyre 70 lloje gjitarësh, 323 lloje shpendësh, 36 lloje reptilësh dhe 15 lloje amfibësh. Shumë prej tyre janë lloje të rrezikuara ose të kërcënuara. Terreni malor në brendësi siguron habitat për gjitarët e mëdhenj si ariu.

Shpendët

Shqipëria ka një klimë të butë mesdhetare e cila është përshtatshme për një grup unik të llojeve të shpendëve, duke përfshirë pelikanin kaçurrel që është një lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Në Shqipëri gjenden 277 lloje shpendësh që bëjnë pjesë në 48 familje të ndryshme. Gjithashtu këtu gjenden edhe 2 nga 9 llojet endemike evropiane.

Mbrojtja e llojeve dhe habitateve

Pas zbatimit të dispozitave ligjore hartohen aktet nënligjore, të cilat plotësojnë bazën ligjore për elemente të veçanta të natyrës. Në mesin e dokumenteve të tilla është edhe lista e llojeve të florës dhe faunës që janë nën mbrojtje dhe janë materializuar me botimin e Librit të Kuq të Florës Shqiptare dhe Librit të Kuq të Faunës Shqiptare.

Mbrojtja e llojeve me interes për t'u ruajtur realizohet përmes dispozitave të veçanta të ligjit për biodiversitetin dhe ligjit për mbrojtjen e faunës së egër. Ligji për biodiversitetin në të njëjtën kohë përmban dispozita për llojet invazive dhe masa mbrojtëse për ruajtjen e llojeve. Arritja e statusit të favorshëm të ruajtjes për llojet synohet nëpërmjet ligjit për biodiversitetin dhe ligjit për zonat e mbrojtura që përmbajnë dispozita për mbrojtjen e biodiversitetit brenda zonave të mbrojtura dhe jashtë tyre.



Mbrojtja e habitatit bëhet nëpërmjet dispozitave të ligjit për zonat e mbrojtura, bazuar mbi të cilat është shfaqur rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura që do të shërbejnë për të identifikuar dhe krijuar rrjetin ekologjik NATURA 2000. Ligji për mbrojtjen e faunës së egër parashikon dispozita mbrojtëse për habitatet e rëndësishme për shpendët në përgjithësi dhe shpendët shtegtarë në veçanti.

Bazuar në dispozitat ligjore kombëtare, të gjitha llojet e renditura në Listën e Kuqe të florës dhe faunës së egër të Shqipërisë, sipas kategorive të ndryshme në rrezik të IUCN-së, gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe nuk mund të përfshihen në listën e llojeve për gjueti në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, në Listën e Kuqe janë të përfshira 405 lloje të florës së egër dhe 575 lloje të faunës së egër (Urdhri i MTM-së nr. 1280, i datës 20.11.2013).

Disa nga llojet më të rëndësishme të shpendëve që gjenden në vend, përfshijnë shqiponjën e artë - e njohur si simboli kombëtar i Shqipërisë – llojet e grabitqarëve, gjelin e egër dhe shpendët e ujit. Pyjet e Shqipërisë ende ruajnë komunitete të konsiderueshme të

Figura 4: Harta e zonave të mbrojtura
Burimi: MTM

gjitareve të mëdhenj, siç janë ariu kaf, ujku gri, dhia e egër dhe derri i egër. Malet në veri dhe në lindje të vendit janë habitat i fundit i mbetur i rrëqebullit ballkanik - një popullatë tepër e rrezikuar e rrëqebullit euroaziatik.

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka ecur përpara dhe ka bërë investime të mëdha për mbrojtjen e ardhme të aseteve natyrore unike dhe të peizazhit. Në përputhje me fushat kryesore të punës që janë identifikuar nga NBSAP 2000 si dhe si rezultat i Programit Kombëtar të Punës mbi Zonat e Mbrojtura (PKPZM) për periudhën 2006-2009, rrjeti i zonave të mbrojtura ka pësuar zgjerim.

Që nga viti 1996, sipërfaqet e deklaruara ligjërisht si zona të mbrojtura në Shqipëri janë më se trefishuar nga 108 475 ha në 378 748 ha, duke e çuar përqindjen totale të zonave të mbrojtura në kategori të ndryshme të menaxhimit në 13,17% në vitin 2011, krahasuar me vetëm 5,7% në 2002.

Tendenca pozitive është veçanërisht e dukshme për përcaktimin ligjor të zonave të mbrojtura që përkon me kategorinë IUCN:

- IUCN I: Rezervat strikt natyror/rezervat shkencor
- IUCN II: Park kombëtar
- IUCN III: Monument natyre
- IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar
- IUCN V: Peizazh i mbrojtur tokësor/ujor
- IUCN VI: Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara

Tabela 8: Lista e zonave të mbrojtura

Nr	Zona	Kategoria	Zona (ha)	Nr. i ZM-ve
Zonat e mbrojtura të shpërndara në rajone të ndryshme				
01	Divjakë-Karavasta	IUCN II: Park kombëtar	22230,2	1
02	Shebenik-Jabllanicë	IUCN II: Park kombëtar	33927,7	1
03	Bredhi i Hotovës-Dangëlli	IUCN II: Park kombëtar	34361,1	1
04	Mali i Dajtit	IUCN II: Park kombëtar	29216,9	1
05	Mali i Tomorit	IUCN II: Park kombëtar	26106,1	1
06	Korab-Koritnik	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	55550,2	1
07	M. Gropa-Bizë-Martanesh	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	25266,4	1
08	Biomonumente	IUCN III: Monument natyre	0,0	348
09	Monumente gjeografike	IUCN III: Monument natyre	0,0	398
Rajoni i Vlorës				
10	Vjosë – Nartë	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	19738,0	1
11	Rrëzoma	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	1400,0	1
12	Butrinti	IUCN II: Park kombëtar	9424,4	1
13	Syri i Kaltër	IUCN III: Monument natyre	180,0	1
14	Llogara	IUCN II: Park kombëtar	1010,0	1
15	Karaburun	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	20000,0	1

16	Karaburun – Sazan	IUCN II: Park kombëtar	12428,0	1
Rajoni i Gjirokastrës				
17	Kardhiq	IUCN I: Rezervat strikt natyror/rezervat shkencor	1800,0	1
18	Zhej	IUCN III: Monument natyre	1500,0	1
19	Bredhi i Sotirës	IUCN III: Monument natyre	1740,0	1
20	Zagori	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	24590,0	
Rajoni i Korçës				
21	Guri i Nikës	IUCN VI: Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara	2200,0	1
22	Liqeni i Pogradecit	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	27323,0	1
23	Prespa	IUCN II: Park kombëtar	27750,0	1
24	Cangonji	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	250,0	1
25	Bredhi i Drenovës	IUCN II: Park kombëtar	1380,0	1
26	Krastafillak	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	250,0	1
27	Nikolicë	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	510,0	1
28	Gërmenj-Shelegur	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	430,0	1
29	Piskal – Shqeri	IUCN VI: Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara	5400,0	1
Rajoni i Durrësit				
30	Qafe Shtamë	IUCN II: Park kombëtar	2000,0	1
31	Rrushkull	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	650,0	1
Rajoni i Fierit				
32	Pishë-Poro	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	1500,0	1
33	Levan	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	200,0	1
Rajoni i Elbasanit				
34	Kuturman	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	3600,0	1
35	Qafë Bushi	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	500,0	1
36	Polis	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	45,0	1
37	Stravaj	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	400,0	1
38	Sopot	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	300,0	1
39	Dardhë-Xhyrë	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	400,0	1
Rajoni i Shkodrës				
40	Thethi	IUCN II: Park kombëtar	4782,0	1

41	Liqeni i Shkodrës	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	26535,0	1
42	Lumi i Bunës - Velipojë	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	23027,0	1
Rajoni i Lezhës				
43	Berzanë	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	880,0	1
44	Kunë-Vain-Tale	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	4393,2	1
45	Patok-Fushëkuqe-Ishëm	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	5000,7	1
46	Bjeshka e Oroshit	IUCN VI: Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara	4745,0	1
Rajoni i Kukësit				
47	Lumi i Gashit	IUCN I: Rezervat strikt natyror/rezervat shkencor	10263,33	1
48	Lugina e lumit të Valbonës	IUCN II: Park kombëtar	21390,0	1
49	Tej Drini i Bardhë	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	30,0	1
50	Nikaj-Mërtur	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	17505	1
Rajoni i Dibrës				
51	Lura - Mali i Dejës	IUCN II: Park kombëtar	20242,0	1
52	Zall Gjogaj	IUCN II: Park kombëtar	140,0	1
53	Vlashaj	IUCN III: Monument natyre	50,0	1
54	Liqeni i Ulzës dhe zona përreth	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	4206,0	1
55	Luzni-Buiac	IUCN VI: Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara	5900,0	1
Rajoni i Beratit				
56	Bogoni	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	330,0	1
57	Balloll	IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror	330,0	1
Totali		16% e territorit te vendit	526334,4	800

Burimi: MTM/AKM

Habitatet natyrore si dhe flora e fauna janë nën presion të vazhdueshëm dhe kanë pësuar reduktim të ndjeshëm si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor. Llojet dhe habitatet nën kërcënim, në shkallë të ndryshme, janë gjithnjë në rritje. Ndryshimet e mëdha negative ndodhin në fermat bujqësore , pyjet dhe zonat bregdetare. Shumica e presionit ushtrohet mbi biodiversitetin, veçanërisht në zonat ku përdorimi i tokës për aktivitete nga njerëzit është intensiv.

Llojet endemike/nënendemike

Relievi i Shqipërisë ka krijuar kushtet për ekzistencën dhe mbrojtjen e disa llojeve endemike, relikte dhe nënendemike. Në Shqipëri ka 27 lloje bimësh endemike dhe 150 nënlloje bimësh. Një total prej 160 llojesh bimësh janë nënendemike në Shqipëri, Greqi dhe ish-Republikat Jugosllave.

Midis paleoendemikëve hasen relikte me origjinë shumë të hershme si *Wulfenia baldaccii*, *Forsythia europea*, *Gymnospermium*, *shqipetorum*, ndërsa prej neoendemikëve mund të përmenden *Lunaria telekiana*, *Crepis bertscea*, *Petasites doerfleri*, *Leucojum valentinum* subsp. *Vlorense*, *Aster albanicus* subsp. *Paparistoi* dhe të tjera. Në krahasim me florën, fauna shqiptare është më pak e njohur dhe e studiuar. Ajo ka një numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte. Liqeni i Ohrit shquhet si ekosistemi më i rëndësishëm në vend për sa i përket veçorisë endemike të faunës: mbi 50 lloje molusqesh dhe 2 lloje peshqish (*korani* dhe *mrena* e Prespës) janë endemike.

Insektet janë të përfaqësuara nga 16 lloje (11 lloje të Hemiptera dhe 5 lloje të fluturave). Studime të mëtejshme të faunës së vendit, në mënyrë të veçantë studimet biospeleologjike, që janë vetëm në hapat e para në vendin tonë, do të ndihmojnë në zbulimin e endemizmeve të reja në vend.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet e kërcënuara globalisht

Shqipëria strehon lloje që janë të rrezikuara në nivel evropian dhe global. Në territorin e saj gjenden disa lloje globalisht të kërcënuara, duke përfshirë të paktën 73 lloje vertebrorësh dhe 18 lloje jovertebrorësh që kanë një pjesë të habitatit dhe popullatave të tyre në vend. Për disa nga to (*Pelecanus crispus*, *Phalacrocorax pygmeus*, *Salmo letnica* dhe *Acipenser sturio*) Shqipëria ka një rëndësi tepër të madhe, deri në kritike.

Breshka e detit e llojit "*Caretta caretta*" është gjetur përgjatë bregdetit Jon ku plazhet e ngushta dhe të virgjëra janë të përshtatshme për lëshimin e vezëve. Pelikani kaçurrel është një lloj i kërcënuar i cili e ka vendndodhjen e vetme të folezimit në Shqipëri, në lagunën e Karavastasë. Foka e detit e cila është zhdukur praktikisht në Mesdhe, me përjashtim të zonave të veçanta të Egjeut dhe Adriatikut, gjendet gjithashtu edhe në Shqipëri.

Flora

Flora e Shqipërisë përfaqësohet nga 165 familje me rreth 910 gjini. Rreth 15% janë lloje me elemente ballkanike dhe pjesa tjetër janë nënballkanike. Elementi floristik mesdhetar përbën rreth 24% të diversitetit të llojeve, prej të cilave 8% janë euromesdhetare, 7% stenomesdhetare, 25% mesdhetare-atlantike, etj. Elementi floristik evropian përbën 18 %, ku vendin kryesor e zënë llojet e Evropës Jugore (5,5%) dhe ato të Evropës Juglindore (4,5%). Elemente të tjera floristike janë dhe ato euroaziatike (14%) dhe eurosiberiane me (4%). Në këtë numër afro 350 njësi taksonomike e varietete janë drurë e shkurre pyjore, 85% e të cilëve rriten e zhvillohen spontanisht në natyrë, kurse 15% janë të sjellë nga jashtë për qëllime ekonomike e dekorative.

Në Librin e Kuq, 320 njësi taksonomike bimore konsiderohen të kërcënuara ose të rralla. Nga pikëpamja e elementit floristik, llojet endemike zënë rreth 11%, llojet nënendemike rreth 39%, llojet ballkanike rreth 11% dhe ato nënballkanike rreth 4%. Pjesën tjetër, rreth 35%, e zë lloji joballkanik. Në këtë libër përmenden tri lloje që mund të zhduken: gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), tisi (*Taxus baccata*) dhe ylli i Alpeve (*Leontopodium alpinum*). Dy të parat konsiderohen si bimë relikte të periudhës së Terciarit.

Fauna

Fauna e egër e Shqipërisë përfaqësohet kryesisht nga elementi euroaziatik, por edhe nga elementet holarktike, mesdhetare si dhe endemizmat e subendemizmat ballkanike. Vendi përbën gjithashtu një biokorridor të lëvizjes së faunës nga veriu në jug të Evropës, e më tej në Afrikën Veriore e Azinë e Vogël dhe e anasjella.

Në ujërat e detit Adriatik, të Jonit dhe ato të brendshme gjendet një faunë e pasur jovertebrorësh dhe vertebrorësh, që nga celenteratët e deri te gjitarët e mëdhenj. Nga jovertebrorët hasen rreth 46 lloje ekinodermatesh, 115 lloje krustacesh dhe 520 lloje molusqesh bikapakore dhe gasteropode të tokës, të ujërave detare dhe ujërave të ëmbla, nga një total prej 720 llojesh të pritshme në këtë grup.

Numërohen afro 4000 lloje insektesh, nga 14 000 lloje te pritshëm. Grupin më të madh e përbën rendi Lepidoptera me rreth 1700 lloje, i pasuar nga rendi i flatramembranorëve me 850 lloje, i flatrafortëve me 600 lloje dhe gjysmëflatrafortëve me 320 lloje.

Iktiofauna e Shqipërisë përfshin 313 lloje e nënlloje, nga 350 lloje të pritshme në këtë grup. Në ujërat e ëmbla gjenden 64 lloje dhe në ujërat detare 249 lloje, nga të cilat 4 lloje janë endemike.

Amfibët dhe reptilët përfaqësojnë një herpetofaunë të pasur me 15 lloje amfibësh, nga 16 te pritshëm, dhe 37 lloje reptilësh, nga 38 te pritshëm. Në pyje jetojnë një numër i konsiderueshëm nga ky grup, që përfaqësojnë afro 10-12 lloje amfibësh dhe 8-10 lloje reptilësh. Nga amfibët lloji *Rana epeirotica* është lloj subendemik.

Shpendët përbëhen nga 323 lloje, nga 335 lloje të pritshme, e janë të shpërndarë në 19 rende dhe 54 familje. Rreth 118 lloje shpendësh ose 46% e avifaunës janë të përhershëm, 72 lloje janë veronjës, 45 lloje janë dimëronjës, 22 lloje janë kalimtare, 26 lloje janë rastësore dhe 22 lloje të tjera citohen nga literatura. Nga shpendët rreth 62 lloje gjenden në pyje, nga të cilët 42 lloje janë të përhershëm. Pjesa më e madhe e zogjve gjenden në zonat ligatinore dhe veçanërisht në lagunat bregdetare dhe në liqenet ndërkufitare (Shkodra, Ohri dhe Prespa).

Gjitarët përfaqësohen me 69 lloje (64 janë tokësore dhe 5 detare), nga 84 lloje të pritshme, dhe përbëjnë afro 42% të mamalofaunës evropiane (200 lloje). Rendi i lakuriqeve të natës (Chiroptera) përbëhet nga 26 lloje, rendi i brejtësve (Rodentia) nga 23 lloje, rendi i mishngrënësve (Carnivora) nga 13 lloje dhe rendi i insektengrënësve (Insectivora) nga 11 lloje. Afro 60 lloje të këtij grupi janë të lidhur me jetën e pyllit, veçanërisht për 13 lloje gjitarësh, jeta e të cilëve është e lidhur tepër ngushtë me ekosistemin pyjor, siç janë ariu (*Ursus arctos*), rrëqebulli (*Lynx lynx*), ujku (*Canis lupus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*) dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*). Një lloj i veçantë lepuri, i njohur si lepuri i gropës (*Oryctolagus cuniculus*), jeton në ishullin e Sazanit. Nga gjitarët në Shqipëri 3 lloje janë cilësuar subendemike, *Pitymys thomasi*, *Pitymys felteni* dhe *Talpa stankovic*.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për shtegtimin e shpendëve, lakuriqëve të natës dhe insekteve. Çdo vit gjatë dimrit në Shqipëri hasen rreth 70 lloje te shpendëve të ujit dhe zogjve të ujit me një popullatë të përgjithshme prej 180 000 individësh. Gjithashtu në Shqipëri janë regjistruar 5 lloje të rrezikuara shpendësh. Ato janë pelikani kaçurrel, skifteri kthetraverdhë, mbreti i shkurtës, pata ballëbardhë dhe kryekuqja e vogël.

Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brendësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë. Së paku katër prej tyre (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si zona të një rëndësie ndërkombëtare për shpendët, të njohura si ZRSH (Zona me Rëndësi për Shpendët), dhe plotësojnë kushtet për të qenë zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20 000 mijë shpendë uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron një varietet habitatesh për lakuriqet e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tunelet e ndërtuara gjatë dekadave të kaluara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, mund të shërbejnë si strofulla për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës. Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të liqenit të Prespës së Vogël dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vite e fundit. Meqenëse kjo shpellë është zvogëluar dhe është tharë, ajo ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjlish për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii*, *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

Llojet me rëndësi ekonomike

Vlerat mjekësore, industriale dhe ushqimore të shumë bimëve dhe kafshëve janë tashmë të njohura. Deri më sot njihen rreth 300 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike ose afro 10% e florës së vendit. Në të ardhmen, numri i bimëve që mund të kenë veti kuruese apo aromatike mund të jetë edhe më i lartë. Rreth 40 lloje bimësh mund të përdoren si foragjere, ndërsa 35 lloje bimësh kanë veti regjëse apo ngjyruese. Numri i bimëve mjaltëse të njohura deri më sot arrin në afro 50 lloje, ndërsa numri i bimëve që përdoren si ushqim arrin në 70 lloje. Të gjithë llojet e peshqve të ujërave të detit dhe ujërave të ëmbla, një pjesë e konsiderueshme e molusqeve (sepiet, kallamarët, oktapodët) dhe lloje të tjera si karkalecat sot përdoren gjerësisht si ushqim për njeriun. Kohët e fundit ka filluar dhe konsumi i disa lloje bretkosash. Molusqet janë një burim i rëndësishëm për përgatitjen e produkteve farmaceutike dhe produkteve të tjera kozmetike. Guaskat e tyre shërbejnë për të prodhuar objekte artistike, pulla, pjesë të veglave muzikore dhe objekte të tjera. Insektet kanë rëndësi të madhe për pjalmim dhe një pjesë e tyre ka vlera ushqimore dhe industriale, si bleta dhe krimbat e mëndafshit. Gëzofët e disa gjitarëve si kunadhet, dhelpra, ketri etj., kanë pasur dhe kanë ende rëndësi për industrinë e gëzofëve.

3.1.3.4. Erozioni i tokës

Në Shqipëri erozioni i tokës vazhdon të jetë një problem i përhershëm për sa i përket përdorimit të tokës dhe një problem mjedisor i vazhdueshëm për bujqësinë. Për më shumë se dy dekada, ka pasur kushte favorizuese të erozionit, të cilat e intensifikojnë dhe përkeqësojnë atë. Disa nga faktorët që ndikojnë në erozion janë kushtet klimatike, si reshjet e shiut (sasia, intensiteti dhe shpeshtësia), temperatura, karakteristikat fizike të tokës; relievi (pjerrësia) dhe përdorimi i tokës; degradimi i mbulesës bimore (shpyllëzimi, zjarret, mbikullotja etj.); ndryshimet topografike (ndërtimi i rrugëve, qendrave urbane etj.); politikat e administrimit të ujërave (kanalizimet, veprat hidrike, pritrat etj.).

Erozioni i tokës vlerësohet të jetë në nivele të larta në të gjitha basenet e lumenjve dhe veçanërisht përgjatë lumenjve Seman dhe Shkumbin. Përgjithësisht masat për parandalimin e erozionit mungojnë ose janë të papërshtatshme për kushtet lokale. Investimet e ndërmarra kanë qenë sporadike, vetëm përgjatë disa prej rrjedhave në afërsi të zonave të banimit ose pranë akseve rrugore. Praktikrat bujqësore në këto zona janë të orientuara drejt bimësisë së kullotave (jonxhë), duke kontribuar kështu në përforcimin e mbrojtjes së tokave nga erozioni. Rreziku i tokave bujqësore nga erozioni konsiderohet mesatar deri në i lartë. Të dhënat zyrtare tregojnë se në rreth 167 646 ha ose 25% të tokave bujqësore rreziku potencial është mesatar, ndërsa në rreth 442 200 ha ose 75% të tokave rreziku është i lartë. Kultivimi i arrave dhe ullinjve ka sjellë një kontribut pozitiv në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Praktikrat e menaxhimit të pyjeve afër zonave të banuara kanë sjellë përmirësim të gjendjes së pyjeve të ulëta (me dru lisi), duke ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e burimeve tokësore. Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Zonat bregdetare janë më të rrezikuara nga gërryerja në krahasim me zonat malore në qendër apo në lindje. Krahas erozionit të tokës, një tjetër fenomen është edhe

rrëshqitja e dheut që transporton sasi të konsiderueshme azoti, i cili është tepër i dëmshëm për pjellorinë e tokave. Aktivitetet njerëzore të cilat sjellin ndryshim të përdorimit të tokës (ndërtimi, turizmi etj.) shkaktojnë rritje të niveleve të erozionit.

3.1.3.5. Menaxhimi i mbetjeve

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat, në vitin 2014, Shqipëria është në rrugën drejt integritit evropian dhe është angazhuar në mënyrë aktive për harmonizimin e standardeve mjedisore me ato të BE-së. Në kuadër të progresit drejt këtij objekti, që prej vitit 2020, Shqipëria ka arritur të realizojë pothuajse gjysmën e punës (48%) lidhur me transpozimin e kreut 27 “Mjedisi” të tërësisë së legjislacionit të BE-së.

Pavarësisht progresit thelbësor lidhur me transpozimin, zbatimin real i standardeve dhe legjislacionit është mbrapa në raport me kapacitetet përkatëse të cilat janë në rrugën e duhur. Fuqizimi i kapaciteteve administrative përbën një masë kyçe të nevojshme për mundësimin gradual të transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Ndërkohë që në nivel kombëtar po avancohet ndjeshëm drejt transpozimit të tërësisë së legjislacionit të BE-së, nevoja për kapacitete dhe burime lidhur me zbatimin dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët është më e madhe në nivelin vendor.

Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Shqipëri është sfidues dhe bie në sy pamjaftueshmëria e kontrollit të efektshëm të asgjësimit të mbetjeve. Me qëllim kapërcimin e kësaj sfide, nevojitet përmirësimi i aftësive administrative; qartësimi i roleve, përgjegjësi dhe llogaridhënies; si dhe përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizës së sasisë dhe përbërjes së mbetjeve çka shërben për përmirësimin e planifikimit dhe informimin e vendimmarrjes. Kjo përfshin gjithashtu nevojën për kapacitete rregullatore dhe administrative, burime financiare dhe infrastrukturë fizike.

Sipas INSTAT, në vitin 2019 Shqipëria arriti të menaxhonte rreth 1 milion tonë mbetje shtëpiake. Rreth 78% e tyre u trajtuan në vendgrumbullimet e mbetjeve dhe u asgjësuan duke iu nënshtruar niveleve të ndryshme të kontrollit mjedisor, ndërsa 19% u veçuan për riciklim. Për sa u përket ndryshimeve klimatike, mbetjet organike të cilat përbëjnë rreth 50% të totalit të mbetjeve të asgjësuar, kontribuojnë në mënyrë thelbësore në prodhimin e metanit, një gaz i fuqishëm me efekt serrë. Gazet nga dekompozimi i mbetjeve dhe lëngjet që kullojnë prej tyre ndotin ujin dhe tokat, duke dëmtuar kështu bujqësinë, burimet e ujit të pijshëm si dhe klimën.

Praktika aktuale e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri vazhdon të mbizotërohet nga një qasje lineare e grumbullimit dhe asgjësimit dhe jo nga qasje të menaxhimit të integruar e të qëndrueshëm të mbetjeve. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve (2020 – 2035) e miratuar së fundi, përcakton një udhërrëfyes drejt integritit të parimeve të ekonomisë qarkulluese dhe përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Koncepti i parimit "kush ndot paguan" është aktualisht në fillesat e tij dhe rikuperimi i kostos së shërbimeve me standarde minimale nëpërmjet gjatësisë së shërbimeve të ndotjes zbatohet në shumë pak qytete. Për shkak të mungesës së burimeve dhe kërkesave konkurruese, shumë prej bashkive raportojnë një ngarkesë tejet të madhe si rezultat i nevojës për modernizimin e shërbimeve. Normat e ulëta të riciklimit dhe mungesa e rregullave të përshtatshme për ambalazhimin dhe produktet njëpërdorimëse sjellin gjithashtu konsum të tepruar të lëndës së parë të papërpunuar të shoqëruar me çlirim të ndotësve, përgjegjës për ndryshimet klimatike, gjatë cikleve të prodhimit.

3.1.4. Turizmi

Turizmi është një prej aktiviteteve kryesore ekonomike në vend, i cili siguron vende pune dhe të ardhura dhe kontribuon ndjeshëm në të ardhurat e qeverisë. Kontributi i drejtpërdrejtë në PBB nga shpenzimet për turizëm në Shqipëri në vitin 2009 është në normën 7,6%.³³ Ky sektor është i kërcënuar nga një sërë faktorësh, duke përfshirë rrezikun nga përmbytjet, gjendjen e plazheve, erozionin bregdetar dhe menaxhimin e mbetjeve. Pavarësisht mungesës së menaxhimit të planifikuar të sektorit të turizmit, sektori privat ka reaguar pozitivisht ndaj kërkesave të tregut të turizmit. Zhvillim në veçanti njih turizmi bregdetar, i cili përfshin turizmin veror, me fokus kryesisht te aktivitetet pranë zonave të plazhit dhe te vizitat e shkurtra në zonat e mbrojtura bregdetare. Shumica e turistëve në destinacionet bregdetare janë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Turistët e huaj, si ata skandinavë, polakë, italianë, austriakë, britanikë dhe gjermanë, janë të paktë në numër dhe vizitojnë kryesisht Sarandën, pasi ky qytet ofron jo vetëm turizëm bregdetar, por edhe mundësinë për të vizituar atraksionet turistike përreth. Shpërndarja e turistëve në zonat bregdetare është e pabarabartë: Velipoja dhe Shëngjini varen së tepërmi nga tregu i Kosovës, ndërsa zonat bregdetare të jugut preferohen më së shumti nga turistët që jetojnë në Shqipëri dhe nga vizitorët e huaj. Në Shqipëri, turizmi bregdetar ka një karakter të theksuar sezonal, Ai nis në periudhën qershor-korrik dhe arrin numrin maksimal të turistëve në gusht, duke u pasuar nga një rënie e menjëhershme e tyre pas 1 shtatorit.

Megjithëse nuk përbëjnë qëllimin kryesor të vizitave në Shqipëri, arkeologjia, trashëgimia dhe kultura identifikohen si pikat e forta më kryesore të saj në studime të ndryshme mbi sektorin turistik. Janë të njohura parqet arkeologjike të Butrintit, Beratit dhe Gjirokastrës, të cilat bëjnë pjesë në Sitet e Trashëgimisë Botërore, të ndjekura nga një sërë atraksionesh e monumentesh historike dhe kulturore. Destinacionet kryesore që vizitohen me anë të ekskursioneve të organizuara në sitet kulturore dhe turistike janë: Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora. Megjithatë, numri i vizitorëve të huaj që vizitojnë atraksionet turistike është mjaft i ulët.

Shqipëria vlerësohet nga shumë operatorë dhe vizitorë ndërkombëtarë për peizazhin dhe natyrën e saj, të cilat konsiderohen gjithashtu si pikat e forta të sektorit turistik. Klima, veçoritë gjeografike dhe larmia fizike e territorit, përfaqësuar nga vargmalet, liqenet, lumenjtë dhe lagunat, të shoqëruara nga një biodiversitet i pasur i florës dhe faunës i pranishëm në shumë parqe dhe rezervate natyrore të vendit, konsiderohen me potencial të paçmueshëm për zhvillimin e turizmit natyror dhe atij rural në Shqipëri. Komunitetet lokale që banojnë në afërsi të një pjese të madhe të burimeve natyrore ruajnë një stil jetese tradicional dhe një trashëgimi të pasur kulturore, çka perceptohet si vlerë e shtuar. Zonat natyrore dhe rurale ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, ekoturizmit dhe aktiviteteve në ambiente të hapura (rafting, hedhje me parashutë, çiklizëm malor, peshkim, shëtitje, ngjitje në mal, ecje në natyrë (hiking), shëtitje me kalë, ekskursione studimore etj.).

3.1.4.1. Trashëgimia kulturore

Shqipëria ka një larmi vlerash, si të ndërtuara nga njeriu ashtu dhe historike, kulturore dhe natyrore. Në kategorinë e siteve arkeologjike dhe historike, vendi është shumë i pasur në aspektin e trashëgimisë kulturore e historike të të gjithë epokave, duke përfshirë atë parahistorike, antike, kristiane dhe mesjetare përfaqësuar nga kështjellat e hershme, si dhe bizantine përfaqësuar nga një sërë manastiresh e kishash etj. Në të gjitha zonat përfituese ka muze të rëndësishëm dhe vepra të tjera infrastrukturore kulturore që pasurojnë produktin turistik. Mbrojtja e monumenteve, siteve arkeologjike dhe atyre historike është përfshirë në objektivat e çdo niveli planifikimi hapësinor, zhvillimor, mjedisor dhe urban.

Mikpritja është një shenjë dalluese e kulturës shqiptare që daton qindra vite më parë. Për shkak të vendndodhjes së tij në udhëkryq të Perandorisë së lashtë Romake dhe Bizantine, në rajon kanë kaluar shumë pushtues, duke lënë gjurmë të kulturave të tyre. Sot janë ende të dukshme veprat e çmuara dhe rrënojat e disa prej qytetërimeve të mëdha botërore, duke përfshirë qytetërimin helen, romak, bizantin, osman, venedikas dhe atë modern italian.

Në Shqipëri mund të gjendet një shumëllojshmëri kishash bizantine e postbizantine, xhamish, manastirësh me afreske dhe ikona të çmuara, urash otoman dhe monumentesh të tjera.

Në të gjenden gjithashtu kështjella që datojnë në epokën ilire dhe atë mesjetare dhe qytete të rëndësishme si Gjirokastra me arkitekturën tradicionale, sitet arkeologjike dhe muzetë e saj.

Gjithashtu, Shqipëria është vlerësuar nga UNESCO me përfshirjen e tri siteve të saj në listën prestigjioze të Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në kulturën shqiptare bën pjesë edhe iso-polifonia, nën mbrojtjen e UNESCO-s, e cilësuar si unike në mbarë botën.



Figura 5: Harta e trashëgimisë kulturore në Shqipëri

Burimi: <http://turizmishqipetar.weebly.com/harta-turistike-e-shqipeumlriseuml.html>

3.1.4.2. Peizazhi

Shqipëria është kryesisht një vend malor; 28% është e përbërë prej maleve, 47% prej kodrave dhe 25% prej fushave, me një lartësi deri në 300 m mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e vendit është 708 m mbi nivelin e detit, dy herë më e madhe sesa lartësia mesatare e Evropës.

Peizazhi malor i Shqipërisë është i mrekullueshëm dhe i mahnitshëm, me pyje lisi, ahu, pishe dhe pemësh halore, me lumenj me ujë të pastër dhe të ftohtë. Rajonet më të larta, ku majat arrijnë deri në rreth 2700 m, janë Alpet e jashtëzakonshme shqiptare në veri dhe një sërë malesh të pyllëzuara, që shtrihen në gjatësinë e vendit dhe deri në kufirin lindor. Në pjesën qendrore ka male të gjelbëruara, të cilat u lënë vendin kullotave në drejtim të jugut.

Bazuar mbi veçantitë territoriale dhe strukturat e relievit, dallohen katër rajone natyrore: Alpet e veriut të Shqipërisë; rajoni malor qendror; rajoni malor jugor; ultësira perëndimore.



Figura 6: Harta fizike e Shqipërisë
Burimi: Gjeografia e Shqipërisë

Vargmali jugor

Këto male ndodhen në jug të rajonit qendror dhe ofrojnë një strukturë tektonike edhe më të rregullt, të karakterizuar nga prania e një numri malesh me shkëmbinj gëlqerorë dhe luginash që janë paralel me njëra-tjetrën, nga verilindja në jugperëndim. Shumica e majave të maleve janë 2000 m mbi nivelin e detit, megjithatë ka disa luginë që zbresin deri në nivelin e detit. Malet më të larta të rajonit janë Tomorri (2417 m) dhe Papingji (2486 m). Malet e rajonit jugor janë kryesisht të zhveshura ose me pyje të rralla.

Alpet e veriut të Shqipërisë

Këto male gjenden përgjatë anës së djathtë të luginës së Drinit. Në përgjithësi, lartësia mesatare është 1500 m mbi nivelin e detit. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre është mbi 2000 m dhe maja më e lartë është Jezerca, e cila arrin 2603 m mbi nivelin e detit. Rajoni është shumë i thepisur, me male si piramida plot me gryka dhe luginë të thella, që i bëjnë të duken më të larta se ç'janë në realitet. Luginat e Bogës, Thethit dhe Jezercës lënë një përshtypje të jashtëzakonshme të vizitorët.

Rajoni malor qendror

Këto male ndodhen ndërmjet luginës së Drinit dhe luginave dhe lumenjve të Devollit të poshtëm dhe Osumit të sipërm. Ato ndryshojnë nga rajoni i Alpeve të Veriut pasi nuk janë të thepisura. Tri male kryesore, me shtrirje veriperëndim - jugperëndim, kanë tiparet e përgjithshme strukturore të relievit. Maja më e lartë e këtij vargmali është Korabi (2751 m mbi nivelin e detit). Midis tyre shtrihen edhe dy ultësira të gjata, zona e Matit dhe e Shkumbinit të sipërm dhe ultësira e Drinit të Zi. Liqenet e Lurës, që konsiderohen si “perlat e peizazhit shqiptar”, janë pjesa më mahnitëse e rajonit. Në pjesën fundore të lindjes së rajonit ka një zonë me një ultësi mjaft të thellë ndërmjet maleve, nga ku formohen liqenet e mrekullueshme të Ohrit dhe Prespës.

Ultësira perëndimore

Ultësira perëndimore ndodhet në pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe shtrihet përgjatë vijës bregdetare të detit Adriatik. Ajo përbëhet nga rrafshina me lartësi të ulët. Kjo ultësirë shtrihet përgjatë 200 km nga liqeni i Hotit në veri deri në Vlorë në jug. Në lindje shtrihet deri në shpatet perëndimore të Alpeve të Veriut, të vargmalit qendror dhe vargmalit jugor që depërton deri në 50 km nga brigjet e detit. Një varg kodrash e ndan ultësirën në rrafshnaltat te veçanta. Në tërësi rrafshnaltat kanë një pjerrësi të papërfillshme dhe kryesisht nuk ngrihen më lartë se 20 metra mbi nivelin e detit. Ultësira shtrihet nga veriu në jug dhe depërtohet nga lumenj me pellgje të mëdha ujëmbledhëse si Shkumbini, Semani dhe Mati. Rrafshnaltat e ultësirës karakterizohen nga një reliev i sheshtë. Disa pjesë të rrafshnaltës në afërsi të zonës bregdetare, si Talë (Lezhë), Velipojë (Shkodër), Fushë-Kuqe (Laç) dhe Divjakë - (Lushnje) ndodhen në nivelin e detit. Përgjatë bregdetit ka shumë laguna dhe pjesë me rërë. Këto të fundit formojnë plazhe të shkëlqyera për banjë dielli, si për shembull ato në Shëngjin, Velipojë, Durrës, Karavasta, Godullat, Vain, Kënallë, Divjakë etj.

Vlerat argëtuese

Shqipëria ka karakteristika unike ekologjike që ofrojnë potencial të konsiderueshëm, por të nënshfrytëzuar të turizmit, duke përfshirë zonat bregdetare, terrenin malor, lumenjtë, parqet, zonat e mbrojtura, etj. Industria e turizmit në Shqipëri aktualisht përqendrohet në zonat bregdetare dhe jo në karakteristikat unike që e bëjnë këtë vend të veçantë nga fqinjët e tij. Veçoritë natyrore të Shqipërisë kanë potencial për të tërhequr turistë që kërkojnë përvoja ekologjike dhe kulturore. Zhvillimi i mirëmbëdruar dhe i qëndrueshëm i këtyre burimeve mund të përmirësojë jetesën e fshatrave dhe komuniteteve rurale në të gjithë Shqipërinë.

Vlerat rekreative të larmisë biologjike dhe të peizazhit janë një pasuri, e cila mund të përdoret për të nxitur zhvillimin e turizmit. Nëse nuk bëhen investime të afërta për mbrojtjen dhe ruajtjen e larmisë biologjike dhe të peizazhit, ekziston rreziku i humbjes së vlerave të tyre rekreative që ndihmojnë në nxitjen e turizmit si një mjet për të promovuar zhvillimin dhe prosperitetin në Shqipëri. Shëtitja në natyrë, ecja nëpër shtigje në zona të mbrojtura, zhytja, banjat e diellit, ngjitja në male, sporti i gjuetisë dhe peshkimit dhe aktivitete të tjera që janë pjesë e këtij zhvillimi të turizmit, kërkojnë që Shqipëria të marrë masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

Është pranuar se, veçanërisht, infrastruktura e re e transportit ka potencialin të ndikojë në përdorimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore.

3.1.5. Popullsia dhe shëndeti

3.1.5.1. Popullsia

Profili demografik i Shqipërisë ka ndryshuar ndjeshëm që prej viteve 1960 dhe veçanërisht gjatë viteve pas rënies së regjimit komunist, periudhë që përfshiu reforma të thella sociale dhe ekonomike. Në bazë të anketës Census 2011 (tetor 2011), Shqipëria kishte 2 821 977 banorë. Kjo përbën një rënie të popullsisë prej rreth 8,0 për qind; censusi i vitit 2001 numëronte një total prej 3 069 275 banorësh.

Dinamika e popullsisë përcaktohet nga katër faktorë: lindjet, vdekjet, emigrimi dhe imigrimi. Gjatë pesë dekadave të fundit, norma e përgjithshme e fertilitetit ka rënë nga më shumë se gjashtë në rreth 1,6 fëmijë për grua. Gjatë periudhës ndërmjet censuseve, 2001-2011, norma vjetore e lindshmërisë ka pësuar një rënie të ndjeshme, nga 53 000 në vitin 2001 në rreth 34 000 në vitin 2011, ndërsa numri i vdekjeve ka mbetur i qëndrueshëm me një shifër prej rreth 20 000 në vit. Në këto kushte, rënia e lindshmërisë supozohet të jetë një nga faktorët e reduktimit të numrit të popullsisë. Gjithashtu,

popullsia e Shqipërisë ka filluar të reduktohet që prej vitit 1990, si pasojë e emigrimit masiv. Në periudhën 2001-2011, numri i emigrantëve vlerësohet të ketë qenë rreth 500 000. Lëvizjet e konsiderueshme brenda dhe jashtë vendit kanë krijuar sfida për politikat ekonomike dhe sociale të qeverisë. Që prej vitit 2000, situata e emigrimit në Shqipëri është stabilizuar dhe, në veçanti, nuk ka pasur më episode emigrimi masiv. Pritet që në të ardhmen emigrimi të mos përbëjë më një çështje problematike dhe aderimi në BE parashikohet të mos ketë ndikim të konsiderueshëm.

Emigrimi nga zonat rurale në ato urbane dhe emigrimi nga zonat e thella dhe ato malore drejt zonave bregdetare kanë qenë karakteristikat kryesore të rishpërndarjes së popullsisë gjatë viteve të tranzicionit dhe pritet të karakterizojnë emigrimin drejt zonave urbane të paktën edhe gjatë dekadës së ardhshme. Censusi i vitit 2011 tregoi për herë të parë se numri i popullsisë që jetonte në zonat urbane ishte më i lartë se ai në zonat rurale (53,5 për qind përkundrajt 46,5 për qind, përkatësisht).

Raporti gjinor në lindje (numri i meshkujve për 100 femra) në mbarë botën është 105. Megjithatë, për Shqipërinë kjo shifër është 107,8. Ka një rënie të konsiderueshme të raportit gjinor pas moshës 80-vjeçare, gjë që është një fenomen i zakonshëm pasi gratë kanë një jetëgjatësi mesatare më të madhe se burrat. Mosha mesatare e popullsisë është rritur nga 30,6 vjeç në vitin 2001 në 35,3 në vitin 2011. Dendësia mesatare e popullsisë në mbarë vendin është reduktuar nga 107 persona për kilometër katror në vitin 2001 në 97 persona për kilometër katror në vitin 2011. Dendësia e popullsisë në prefekturat e Tiranës dhe Durrësit është më e lartë në krahasim me prefekturat e tjera, përkatësisht 454 dhe 343 persona për kilometër katror, për shkak të një rritjeje të popullsisë si pasojë e intensitetit të lëvizjeve të brendshme drejt këtyre prefekturave.

Numri i njësive ekonomike familjare është 722 262. Kjo përfaqëson një rënie të numrit absolut të njësive ekonomike familjare me 4633 njësi ose me 0,6 për qind në raport me censusin e mëparshëm. Madhësia mesatare e NjEF-ve pësoi rënie nga 4,2 anëtarë në vitin 2001 në 3,9 anëtarë në vitin 2011. Në zonat urbane treguesi është 3,6, ndërsa në zonat rurale është 4,2 anëtarë për NjEF.

3.1.5.2. Shëndetësia

Në tabelën 9 tregohet një përmbledhje e profilit demografik dhe shëndetësor të Shqipërisë për vitin 2014.

Në vitin 2011, shpenzimet totale shëndetësore në Shqipëri përbënin 6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Megjithëse shpenzimet shëndetësore për frymë kanë pësuar rritje të ndjeshme gjatë dekadës së kaluar, sektori shëndetësor në Shqipëri vazhdon të mos ketë financim të mjaftueshëm. Numri i përgjithshëm i mjekëve në Shqipëri është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat shëndetësore. Numri i spitaleve dhe shtretërve në to është reduktuar vitet e fundit në Shqipëri. Ekziston nevoja për një sistem solid të shëndetit publik me qëllim mbrojtjen nga rreziqet shëndetësore dhe promovimin e sjelljeve të shëndetshme në popullsinë e Shqipërisë. Duhet të ofrohet akses i barabartë dhe i përshtatshëm në shërbimet e kujdesit shëndetësor nëpërmjet një sistemi solid dhe një personeli të mirëtrajnuar e të mjaftueshëm në numër. Vitet e fundit në Shqipëri ka pasur investime të rëndësishme në teknologjinë shëndetësore, duke përfshirë pajisjet për njësinë CAT dhe ato të radioterapisë e mamografisë.

Barra e sëmundjeve si kanceri, sëmundjet kardiovaskulare, diabeti dhe bronkopneumopatia kronike obstruktive përbëjnë disa nga shqetësimet kryesore shëndetësore në Shqipëri, me potencial për t'u intensifikuar në dekadat e ardhshme nëse nuk merren masat e duhura parandaluese. Gjatë njëzetë viteve të kaluara, jetëgjatësia mesatare në Shqipëri është rritur në mënyrë konstante për të dyja gjinitë

(te meshkujt, nga 67 vjeç në vitin 1990 në 73 vjeç në vitin 2012; te femrat, nga 71 vjeç në vitin 1990 në 75 vjeç në vitin 2012). Ndryshime të shumta, duke përfshirë tranzicionin demografik, kanë sjellë një tranzicion të qartë epidemiologjik gjatë dy dekadave të kaluara me një reduktim të ndjeshëm të sëmundjeve infektive, në kontrast me rritjen e ndjeshme të sëmundjeve kronike. Nëse nuk merren masa të reja, përhapja e duhanpirjes mund të rritet dhe kjo mund të frenojë ndjeshëm rritjen e jetëgjatësisë mesatare dhe mund të shtojë barrën potenciale të sëmundjeve kronike. Në vitin 2010, faktorët lidhur me mënyrën e jetesës ishin përgjegjës për mbi 70% të barrës së sëmundjeve në Shqipëri.

Politikat shëndetësore në Shqipëri përcaktohen, koordinohen dhe drejtohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS). Instituti i Shëndetit Publik është institucioni që mbështet MShMS-në dhe strukturat rajonale të shëndetit publik në përmbushjen e funksioneve dhe shërbimeve përkatëse. Objektivi kryesor i reformës në shërbimet spitalore ka qenë ofrimi i shërbimeve cilësore, të sigurta, të aksesueshme dhe me kosto efektive. Progresraporti i KE-së për Shqipërinë gjatë vitit 2013 vë gjithashtu në dukje se mungesa e kapaciteteve në administrimin e shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i shpenzimeve publike dhe korrupsioni kanë ngadalësuar progresin në fushën e përmirësimit të shëndetit publik. Shërbimet shëndetësore parësore vuajnë nga mungesa e financimit dhe e burimeve njerëzore. Mbulimi i shërbimeve të kujdesit që bazohen te sigurimet është ende shumë i ulët. Sektori i shëndetësisë publike vazhdon të jetë pazhvilluar, ndërsa ai privat po zhvillohet në mungesë të një rregullimi të përshtatshëm.

Gjithashtu, sistemet e informacioneve shëndetësore në Shqipëri duhet të reformohen për të mundësuar administrimin dhe vlerësimin e përshtatshëm të sistemit shëndetësor shqiptar. Këtu përfshihet monitorimi i ndërhyrjeve parandaluese dhe hapat kyçe në reformën e kujdesit shëndetësor. Të dhënat më të sakta statistikore, sondazhet shëndetësore periodike dhe të dhënat administrative për përmirësimin e kujdesit shëndetësor do të mundësojnë krijimin e programeve për rritjen e cilësisë së sistemit shëndetësor shqiptar, si dhe do të ndihmojnë në caktimin e prioriteteve dhe politikave shëndetësore bazuar në fakte (prova).

Tabela 9: Profili demografik dhe shëndetësor i Shqipërisë

Kategoria e të dhënave	Të dhënat
Popullsia	3 020 209 (përcaktuar në korrik 2014)
Mosha mediane	Totali: 31,6 vjeç; meshkujt: 30,3 vjeç; femrat: 32,9 vjeç (përcaktuar në 2014)
Norma e rritjes së popullsisë	0,3% (përcaktuar në 2014)
Norma e lindshmërisë	12,73 lindje/1000 banorë (përcaktuar në 2014)
Norma e vdekshmërisë	6,47 vdekje/1000 banorë (përcaktuar në 2014)
Norma neto e emigrimit	3,31 emigrantë/1000 banorë (përcaktuar në 2014)
Urbanizimi	Popullsia urbane: 53,4% e popullsisë totale (2011) Norma e urbanizimit: 2,27% normë vjetore ndryshimi (përcaktuar në 2010-15)
Qytetet kryesore - popullsia	TIRANA (kryeqyteti) 419 000 (2011)
Norma e vdekshmërisë foshnjore	Totali: 13,19 vdekje/1000 lindje të gjalla meshkujt: 14,68 vdekje/1000 lindje të gjalla femrat: 11,54 vdekje/1000 lindje të gjalla (përcaktuar në 2014)
Jetëgjatësia mesatare	Popullsia totale: 77,96 vjeç meshkujt: 75,33 vjeç femrat: 80,86 vjeç (përcaktuar në 2014)
Norma totale e fertilitetit	1,5 fëmijë/grua (përcaktuar në 2014)

Kombësia	shqiptar
Grupet etnike	Shqiptarë 82,6%, grekë 0,9%, të tjerë 1% (duke përfshirë vllahët, romët (ciganët), maqedonasit, malazezët dhe egjiptianët), të paspecifikuar 15,5% (përcaktuar në 2011)
Feja	Myslimanë 56,7%, katolikë 10%, ortodoksë 6,8%, ateistë 2,5%, bektashi (të sektit Sufi) 2,1%, të tjerë 5,7%, të paspecifikuar 16,2% (përcaktuar në 2011)
Gjuhët	Shqip 98,8% (zyrtare - toskërisht), greqisht 0,5%, të tjera 0,6% (duke përfshirë maqedonishten, gjuhën rome, gjuhën vllahë, turqishten, italishten, serbo-kroatishten), të paspecifikuara 0,1% (përcaktuar në 2011)
Aftësia e shkrim-këndimit	Popullsia totale: 96,8%; meshkujt: 98%; femrat: 95,7% (përcaktuar në 2011)
Mesatarja e viteve të shkollimit (përpara arsimit të lartë)	Totali: 10 vite meshkujt: 10 vite femrat: 10 vite (2001)
Shkalla e punësimit të fëmijëve të moshave 5-14 vjeç	Numri total: 72 818 Përqindja: 12% (përcaktuar në 2005)
Shpenzimet për arsimin	3,3% e PBB-së (2007)
Norma e vdekshmërisë amtare	27 vdekje/100 000 lindje të gjalla (2010)
Shkalla e fëmijëve nënprerë tek ata nën moshën 5 vjeç	6,3% (2009)
Shpenzimet për shëndetësinë	6,3% e PBB-së (2011)
Numri i mjekëve	1,11 mjekë/1000 banorë (2011)
Numri i shtretërve në spitale	2,4 shtretër/1000 banorë (2011)
Obeziteti - norma e prevalencës tek të rriturit	21,3% (2008)

Burimi: Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë në kuadër të KKKBNK-së

3.1.6. Ekonomia

Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare që, gjatë dy dekadave të fundit, ka bërë hapa shumë të mëdha në vendosjen e një demokracie të besueshme e shumëpartiake dhe të ekonomisë së tregut. Përpara krizës financiare globale, Shqipëria ishte një nga ekonomitë në zhvillim më të vullshëm në Evropë, me norma mesatare të rritjes reale vjetore prej 6%, shoqëruar nga norma të shpejta të uljes së varfërisë. Megjithatë, pas vitit 2008 rritja mesatare vjetore pësoi përgjysmim dhe në sektorët publikë dhe ata të jashtëm dolën në pah çekuilibre makroekonomike. Ritmi i rritjes u pasqyrua gjithashtu te varfëria dhe te papunësia: nga 2002 deri në 2008, varfëria në vend u përgjysmua (deri në rreth 12,4%), por në 2012 ajo u rrit përsëri deri në 14,3%. Papunësia u rrit nga 2008 deri në 2013, duke arritur një shkallë të papunësisë tek të rinjtë prej 26,9%.⁷

Pas kualifikimit nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) në vitin 2008, Shqipëria ka arritur përgjithësisht të ruajë një ritëm pozitiv zhvillimi

⁷ Banka Botërore, 2014

dhe qëndrueshmëri financiare, pavarësisht krizës së vazhdueshme ekonomike. Situata ekonomike e Shqipërisë gjatë viteve të kaluara, e ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, ka pësuar tendencë zhvillimi në ndryshim. Duke qenë se Shqipëria ka pasur një ndikim më të ulët nga kushtet jo të favorshme ekonomike në rajon dhe në mbarë botën, është arritur ruajtja e qëndrueshmërisë makroekonomike.⁸ PBB-ja është e lidhur ngushtë me sektorin e shërbimeve dhe bujqësinë. Ndërkohë, zhvillim po merr edhe sektori industrial – përfshirë degën e prodhimit të energjisë. Pas vitit 2002, ekonomia e Shqipërisë përjetoi një periudhë rritjeje të vazhdueshme ekonomike, e cila kulmoi në vitin 2008 (7,5%). Pas vitit 2008, ekonomia pësoi rënie të rritjes ekonomike, me nivelin më të ulët të regjistruar në vitin 2013 (0,4%). Shkaqet i janë atribuar jo vetëm krizës ekonomike globale, por gjithashtu edhe politikave dhe zhvillimit të brendshëm. Megjithatë, kjo tendencë pritet të jetë drejt fundit pasi në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook) të FMN-së është parashikuar një normë rritjeje prej 2,7%, 2,9% dhe 3,4% për vitin 2014, 2015 dhe 2019 përkatësisht.⁹

Sektori i ndërtimit vijoi të kontraktohet gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2010, ndërsa sektori i bujqësisë vlerësohet të ketë regjistruar rritje të kënaqshme. Normat e ngadalta të rritjes ekonomike vijuan edhe në vitet në vazhdim, me përkatësisht: 2,8% në vitin 2011, 1,3% në vitin 2012 dhe 0.4% në vitin 2013. Ritmet e ngadalta të veprimtarisë ekonomike ishin kryesisht shkak i performancës së dobët të investimeve dhe konsumit privat, të cilat vazhduan të vuanin mungesën e besimit nga agjentët ekonomikë dhe kufizimet financiare. Konsumi privat dhe investimet private nuk u favorizuan nga politikat konservative të bankave për huadhënien. Këto politika janë rezultat i vështirësive që kanë karakterizuar tregjet financiare të eurozonës dhe i perceptimit të rrezikut të lartë të mospagimit të kredive. Nga ana tjetër, stimujt fiskalë dhe kërkesa e huaj patën një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike.

Institucionet kryesore përgjegjëse për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë financiare dhe ekonomike janë Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Ministria e Financave është autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e financave dhe buxhetit në Shqipëri.²¹ Banka e Shqipërisë është një institucion kushtetues i pavarur. Objektivat kryesore të bankës janë arritja dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimit; promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të një regjimi dhe sistemi valutor, të një tregu të brendshëm financiar dhe të një sistemi pagesash; nxitja e kushteve monetare dhe të kreditimit favorizuese për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik në vend; promovimi dhe ruajtja e likuiditetit, aftësisë paguese dhe e funksionimit normal të një sistemi bankar të bazuar në treg.

Në vitin 1992, autoritetet zhvilluan një program të orientuar drejt krijimit të një sistemi bankar modern. Reformat rezultuan efikase dhe sollën rritje të kreditimit në sektorin privat formal dhe shtim të numrit të bankave private. Sektori bankar po zhvillohet vazhdimisht për shkak të procesit të privatizimit të plotë dhe po integron brenda tij banka private ndërkombëtare. Në vitin 2017, sipas rajoneve statistikore niveli 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente është 1 551,3 miliardë Lekë, duke shënuar një rritje prej 3,82% krahasuar me vitin 2016. Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (Qark), vlera më e lartë në PBB paraqitet në qarkun e Tiranës me rreth 652,1 miliardë lekë ose 42,03 % të totalit të PBB-së.

Në vitin 2017, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor niveli 1 (Republika e Shqipërisë) ishte rreth 540 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2016, PBB për frymë pësoi rritje me 5,45%. Në vitin 2016, niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas qarqeve ishte në qarkun e Tiranës me rreth 747 mijë lekë ose 38,33% mbi mesataren kombëtare, një rritje prej 7,99% krahasuar me vitin 2016.

⁸ EC, 2012

⁹ IMF, 2014




Figura 7: PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren kombëtare (në mijë lekë)
Burimi: Të dhënat e INSTAT 2017

3.1.6.1. Bujqësia

Spektori i bujqësisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, i cili kontribuon në rreth 20% të vlerës së shtuar në ekonomi.

Shqipëria është e ndarë në katër zona kryesore agro-ekologjike. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore dhe ajo më cilësore shtrihet në dy zonat e para agro-ekologjike. Gjatë dekadës së fundit, sektori ka përjetuar rritje të moderuar duke nisur që prej vitit 2006. Megjithatë, zhvillimi i sektorit është tejte i kufizuar nga probleme të ndryshme strukturore. Infrastruktura relativisht e prapambetur në zonat rurale frenon depërtimin e produkteve bujqësore në treg. Fragmentimi i tokave bujqësore pengon organizimin efikas të prodhimit, redukton prodhimtarinë dhe rrit koston e përdorimit të mekanikës bujqësore. Në të njëjtën kohë, toka bujqësore nuk shfrytëzohet plotësisht si rezultat i fenomenit të emigrimit brenda dhe jashtë vendit të popullsisë. Ky fenomen, së bashku me çështjet e pronësisë së tokave, ka kufizuar vazhdimin e investimeve në sektorin e bujqësisë. Pavarësisht zgjerimit të përgjithshëm të kreditimit të ekonomisë gjatë periudhës 2000-2008, kreditimi për veprimtaritë bujqësore ka mbetur në nivele të ulëta. Megjithatë, zgjerimi i sektorit gjatë periudhës 2005-2013 besohet të ketë kontribuar në rritjen e përgjithshme ekonomike në vend. Gjithashtu, rritja e çmimeve të produkteve bujqësore në tregjet botërore stimulon pozitivisht rritjen afatgjatë të prodhimit në këtë sektor të ekonomisë shqiptare. Kjo është mbështetur nga reformat zhvillimore dhe strukturore (të cilat synojnë rritjen e efikasitetit në prodhimin bujqësor, lehtësimin e aksesit të produkteve bujqësore lokale në tregjet vendase dhe ato të huaja, si dhe mbështetjen financiare të bizneseve dhe fermave në këtë sektor) që konsiderohen si prioritet për politikat e ardhshme ekonomike.

3.1.6.2. Industria

Spektori industrial ka shënuar zhvillime mjaft pozitive gjatë dekadës së fundit. Shqipëria njihet për rezervat e saj të kromit, hekurit, nikelit dhe bakrit. Shfrytëzimi dhe përpunimi i tyre përbëjnë një aktivitet të rëndësishëm ekonomik. Historikisht, pas vitit 1944, industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve të kromit, bakrit, hekurit dhe qymyrit kanë siguruar një nivel thelbësor të ardhurash. Sektori ka qenë plotësisht i mbizotëruar nga ndërmarrjet shtetërore. Në vitin 1994, me miratimin e ligjit të ri për minierat, sektori nisi të hapet ndaj investimeve private. Gjatë kohës së regjimit komunist, degët kryesore

të industrisë (industria e rëndë, industria e lehtë dhe industritë ushqimore) gjeneronin 58% të PBB-së në Shqipëri.

Që prej vitit 1990, profili ekonomik i vendit ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore. Nënsektorët e rëndësishëm të industrisë, si industria kimike, metalurgjike dhe ajo mekanike, dhe degë të tjera të lidhura me to, kanë pësuar rënie me mbi trefish krahasuar me shifrat e vitit 1990.

Megjithatë, vitet e fundit sektori industrial është karakterizuar nga tendenca pozitive. Shitjet e këtij sektori në vitin 2006 përbënin pothuajse çerekun e shitjeve totale të ndërmarrjeve ekonomike, duke e bërë atë sektorin e dytë më të rëndësishëm pas atij të shërbimeve.

Për shumë vite, një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e shitjeve të industrisë në përgjithësi e ka sjellë nëndega e industrisë së përpunimit. Kuota e vogël e industrisë nxjerrëse i atribuohet mungesës së investimeve vendase dhe të huaja. Gjatë treçerekut të parë të vitit 2008, indeksi i xhiros në vëllimin industrial u rrit mesatarisht me rreth 7,4 për qind në plan vjetor; kjo vlerë ishte më e lartë se mesatarja vjetore e katër viteve të kaluara (5,4 për qind). Përmirësimi i konsiderueshëm i aktivitetit ekonomik të këtij sektori në vitin 2010 u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës së huaj për produkte shqiptare dhe rritja e çmimeve në tregjet botërore. Ky zhvillim u pasqyrua në rritjen e eksporteve dhe shitjeve industriale në vend, siç tregohet nga vëllimi i xhiros.

Në vitin 2011, sektori minerar përbënte rreth 16% të vlerës së prodhimit industrial dhe rreth 2% të PBB-së. Prodhimi industrial u rrit me 6,10% në tremujorin e dytë të vitit 2014 në raport me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, dhe mesatarisht me 2,59% nga viti 2002 deri në vitin 2014 (Figura 6). Në figurën 7 paraqiten disa shifra lidhur me kuotën relative të nënsektorëve të prodhimit minerar dhe shpërndarja e tyre në vend në vitin 2011. Performanca e mirë e sektorit industrial i është atribuar rritjes së numrit të punonjësve në këtë sektor.




Figura 8: Prodhimi industrial në Shqipëri në % (2002-2014)

Burimi: www.tradingeconomics.com, INSTAT




Figura 9: Kuota relative e sektorëve të prodhimit mineral dhe shpërndarja e tyre gjeografike
 Burimi: EITI (2011): <http://www.albeiti.org/industria-nxjerrese/sektori-minerar/>

3.1.6.3. Sektori i ndërtimit

Gjatë periudhës 2003 – 2008, ndërtimi njohu një rritje dyshifrore në terma të vlerës së shtuar, e mbështetur nga prirja në rritje e lejeve të miratuara për ndërtime private, nga kërkesa e lartë për banesa, nga lëvizjet dinamike demografike, si dhe nga mbështetja e favorshme me financim. Rritja vjetore e këtij sektori gjatë kësaj periudhe varionte midis 10-15%, duke e bërë atë sektorin kryesor në aspektin zhvillimor.

Pas vitit 2008, kufizimi i lejeve të ndërtimit solli një ngadalësim të sektorit. Në vitin 2008, investimet në projektet e infrastrukturës rrugore u vlerësuan se patën nxitur rritjen e aktivitetit ndërtimor. Duke nisur nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2009, aktiviteti i sektorit të ndërtimit ka rënë ndjeshëm (22,5% mesatarisht gjatë vitit 2010), reflektuar në tendencat në rënie të çmimeve të banesave, si dhe në rënien e vlerave të ndërtimeve inxhinierike (20,3% rënie mesatare vjetore gjatë vitit 2010).

Rënia e vlerës së shtuar në sektorin e ndërtimit në vitin 2009 është ndikuar nga rënia e kërkesës për ndërtesa rezidenciale, e investimeve publike ose e kapaciteteve prodhuese të bizneseve, si dhe nga mbështetja më e ulët me kredi dhënë këtij sektori në krahasim me vitet e mëparshme. Në veçanti, kërkesa për banesa është ngadalësuar si kundërpërgjigje ndaj pasigurisë së konsumatorit. Pas një tkurrjeje të fortë gjatë vitit 2012, sektori i ndërtimit ka shënuar një rritje të përkohshme në tremujorin e dytë të vitit 2013, të lidhur kryesisht me investimet publike. Përtej luhatjeve afatshkurtra, aktiviteti i ndërtimit vazhdoi të vuante pamjaftueshmërinë e investimeve private në ekonomi.

Pavarësisht rritjes fillestare të këtij sektori, përqendrimi i skajshëm i ndërtesave në disa territore të caktuara konfirmoi mungesën e vazhdueshme të vizionit në zhvillimin urban, duke bërë kështu të pamundur garantimin e qëndrueshmërisë në këtë degë. Gjithashtu, ndërtimi vazhdon të mbizotërohet nga ndërtesat rezidenciale, duke anashkaluar aspekte të tjera strategjike, si investimet në infrastrukturën rrugore, ndërtesat industriale, përmirësimin e tokës dhe infrastrukturën bujqësore, si dhe investime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës në komunitetet e vogla dhe zonat rurale.

3.1.6.4. Energjia

Sektori shqiptar i energjisë¹⁰ mbulon nënsektorët në vijim¹¹:

¹⁰ Referuar Strategjisë Kombëtare Sektoriale për Energjinë (NSSE) 2018-2030

- Sigurinë e furnizimit dhe infrastrukturën (e energjisë)
- Rregullimin e tregut të energjisë
- Eficiencën e energjisë
- Hidrokarburet
- Energjinë e rinovueshme

Sistemi kombëtar i energjisë nga pikëpamja e kërkesës dhe ofertës, si dhe sfidat kryesore me të cilat ai përballet, janë paraqitur në mënyrë të përmblodhur në vijim.

Me pak fjalë, varësia nga importet dhe humbjet e mëdha në shpërndarje në rrjetin elektrik janë sfida që duhen trajtuar. Planet për të rritur përdorimin e gazit natyror duhet të zhvillohen në mënyrë të kujdesshme dhe të harmonizohen me plane të tjera, për të garantuar arritjen e pikësnyimeve lidhur me reduktimin e GES-ve dhe reduktimin final të energjisë, si dhe arritjen e pikësnyimeve për përmirësimin e EE-së (eficiencës së energjisë).

Shqipëria varet thuajse ekskluzivisht nga hidroenergjetika për prodhimin e energjisë elektrike (98% e energjisë elektrike të gjeneruar prej saj vjen nga burimet hidrike), gjë që e bën atë gjithmonë e më të rrezikuar nga kushtet hidrologjike të pafavorshme gjatë verës, veçanërisht për sa u përket efekteve të parashikuara të ndryshimeve klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përveç faktit që nuk ka prodhim konstant, energjia elektrike nga burimet hidrike është gjithashtu e pamjaftueshme për të përbushur nevojat. Shqipëria është një importues neto i energjisë elektrike dhe garantimi i sigurisë së furnizimit të saj me energji paraqet një sfidë. Kësisoj, Shqipëria ka filluar planifikimin e masave të duhura për të rritur investimet në projektet e energjisë së rinovueshme nga burime johidrike. Si pasojë e rënies së kostove të teknologjisë dhe potencialit të konsiderueshëm të vendit për energji të rinovueshme, burimet eolike dhe ato diellore fotovoltaike mund të shfrytëzohen me kosto efektive për të zbutur ndikimin mbi çmimin e energjisë elektrike për konsumatorin fundor. Në fund të vitit 2018, u konstatua një rritje e energjisë fotovoltaike diellore të instaluar më 10 MW.

Gjatë viteve 2019-2020, Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë parashikon rritjen e prodhimit të energjisë së instaluar me bazë burimet e rinovueshme me 738 MW, si vijon: 57 MW energji hidrike; 490 MW energji fotovoltaike; 150 MW energji eolike; 41 MW MNU (energji e rikuperuar nga mbetjet). Sipas përlllogaritjeve, potenciali përkatës shtesë për gjenerimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri është 1761 GWh. (Burimi: Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019 - 2020).

Megjithatë, për sa u përket veçanërisht kontratave të koncesionit për ndërtimin dhe operimin e HEC-eve, janë shprehur dyshime lidhur me cilësinë e VSM-ve dhe VNM-ve të kryera në lidhje me projektet energjetike. Në përgjithësi, zbatimi i projekteve energjetike ka ecur më ngadalë seç ishte parashikuar, gjë që duhet të trajtohet në planifikimin strategjik. Tabela 10 tregon zhvillimin e ngadaltë të energjisë johidrike ndër kapacitetet e energjisë së rinovueshme.

Tabela 10: Gjenerimi i energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë

Viti	2017	2018	2019
Fuqia totale e instaluar	2145 MW	2204 MW	2275 MW

¹¹ Referuar ligjit "Për sektorin e energjisë", ligjeve për nënsektorë të tjerë dhe NSSE-së 2018-2030

Energjia hidrike	100%		
Energjia fotovoltaike	1 MW	11 MW	15 MW
Prodhiimi vjetor	4525 GWh	8552 GWh	5200 GWh
Energjia hidrike	100%		
Energjia fotovoltaike		1334 MWh	22190 MWh
Komente	1MW energji fotovoltaike në Korçë, por jashtë sistemit	1MW energji fotovoltaike në Korçë, por jashtë sistemit	

Burimi: Plani i Konsoliduar i Veprimet për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019 - 2020

Termocentrali i Vlorës (i ndërtuar me financim nga BERZH-i në vlerën 40 milionë euro, financim nga BEI në vlerën 40 milionë euro dhe financim nga BB* në vlerën 20,5 milionë euro) nuk është vënë kurrë në funksionim që prej përfundimit të tij në vitin 2011. Kjo për shkak të një defekti në sistemin e ftohjes së impiantit, i cili nuk është riparuar ende. Pas lidhjes së termocentralit të Vlorës me TAP-in, inkurajohet kalimi i tij nga përdorimi i naftës në përdorimin e gazit. Kjo do të kontribuonte në stabilizimin e gjenerimit të energjisë elektrike gjatë periudhave të thatësirës në pjesën jugore të Shqipërisë. Megjithatë, kjo do të rrisë konsumin e gazit, e për rrjedhojë edhe shkarkimet e CO₂, ndaj duhet marrë në konsideratë përkatësisht në planifikimin strategjik.

Struktura e sistemit shqiptar të energjisë

Më poshtë jepet një paraqitje në formë grafike e strukturës së sistemit shqiptar të energjisë. Për sa i përket Konsumit të brendshëm bruto për vitin 2019, në sistemin shqiptar të energjisë kanë mbizotëruar dhe vazhdojnë të mbizotërojnë nënproduktet e naftës për përdorim në transport (rreth 53,3%), të pasuara nga energjia elektrike e prodhuar nga burime hidrike (rreth 28,17%), ndërsa vendin e tretë e mban biomasa (lënda drusore si lëndë djegëse, rreth 6,8%) e cila gjen përdorim për ngrohje, gatim dhe ujë të ngrohtë në banesa. Lënda drusore si lëndë djegëse përdoret kryesisht në banesa (në zonat rurale) dhe në sektorin e shërbimeve (Figura 10).




Figura 10: Konsumi i brendshëm bruto (Ktoe)

Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë

Varësia nga importet është një nga arsyet kryesore pse sistemi shqiptar i energjisë duhet të zhvillohet për t'u transformuar në një sistem energjie të diversifikuar që përdor burime alternative të energjisë, të

tilla si gazi dhe burimet e rinovueshme me shkarkime më të ulëta të GES-ve, dhe që zbaton masa të efikasitetit të energjisë të bazuara në efikasitetin e kostos. Sistemi duhet të mbështetet te prodhimi i brendshëm dhe të jetë i përballueshëm për konsumatorët, duke kontribuar në reduktimin e varfërisë.

Figura 11 tregon varësinë e sistemit të energjisë nga importet. Përqindja e importeve në konsumin e brendshëm bruto është e lartë dhe kjo ndikon në sigurinë e furnizimit. Sistemi i energjisë duhet të jetë më i diversifikuar dhe më eficient, si pasojë edhe e rritjes së kërkesës për vetëplotësim të nevojave për energji.




Figura 11: Importet në raport me konsumin e brendshëm bruto për periudhën 2004-2019, shprehur në %

Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë




Figura 12: Konsumi final i energjisë sipas sektorëve (ktoe)

Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë

Zhvillimi i konsumit final të energjisë gjatë viteve 2004-2019 mbizotërohet nga transporti, pasuar nga sektori i banesave dhe ai i tregtisë. Specifikisht, në vitin 2019 ka mbizotëruar sektori i transportit me 41,6%, me në vend të dytë sektorin e banesave dhe atë të tregtisë me 34,7%. Industria mban vendin e tretë me 18%, ndërsa pjesa e mbetur i atribuohet bujqësisë dhe sektorëve të tjerë.

Figura 11 tregon se pjesa më e madhe e burimeve të energjisë mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e naftës, veçanërisht në sektorin e transportit, pasuar nga burimet e energjisë hidrike dhe elektrike dhe biomasa.




Figura 13: Konsumi final i energjisë për vitin 2019 sipas lëndës djegëse dhe sektorëve
Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë

Bazuar në dokumentet e politikave të energjisë, sektorët që konsiderohet se kanë një potencial të lartë për kursim energjie janë sektori i transportit, ndërtesat publike dhe private dhe industria.

Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike

Një çështje thelbësore për performancën e shoqërive të transmetimit dhe shpërndarjes, si një aspekt mjaft i rëndësishëm i furnizimit me energji, është fenomeni i humbjeve në transmetim dhe në shpërndarje.




Figura 14: Humbjet në transmetim dhe në shpërndarje në raport me energjinë elektrike të transmetuar dhe të shpërndarë në rrjete

Burimi: raportet vjetore të ERE-s (vija e kuqe: humbjet në transmetim, vija blu: humbjet në shpërndarje)

Bazuar në raportet vjetore të ERE, falë investimeve në funksion të efijencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike, ka pasur disa arritje lidhur me reduktimin e humbjeve teknike në transmetim dhe në shpërndarje. Humbjet në transmetim u reduktuan nga 2,46% në vitin 2018 në 2,12% në vitin 2019. Niveli i humbjeve në shpërndarje për vitin 2019 ka pësuar një ulje me 2,17%, krahasuar me nivelin 23,96% në vitin 2018. Sipas ERE, humbjet totale në transmetim dhe në shpërndarje arrinin përafërsisht 23,91% në vitin 2019. (Burimi: raportet vjetore të ERE)

Intensiteti i energjisë

Siç mund të shihet nga Figura 15, për vitin 2014 intensiteti i energjisë ka qenë 0,219067 ktoe/miliardë euro PBB, teksa parashikohet të jetë 0,209423 për vitin 2020 dhe 0,175174 ktoe/miliardë euro PBB për vitin 2030. (Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë).

Sistemi shqiptar i energjisë mund të arrijë reduktimin e pikësnyuar të intensitetit të energjisë nëse zbatohen masat e PKVEE-së së 2-të dhe të 3-të.



Figura 15: Intensiteti i energjisë

Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë

3.1.6.5. Transporti

Sektori i transportit në Shqipëri ka pësuar zhvillim që nga viti 1990. Si rezultat i rritjes së numrit të automjeteve dhe i përmirësimeve të infrastrukturës, ngarkesa e përgjithshme e trafikut ka qenë në rritje të vazhdueshme. Po ashtu janë rritur edhe investimet publike për t'iu përgjigjur nevojave të sektorit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sektorit të transportit. Kreu i sektorit të transportit në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (2014 - 2020) përcakton politikën e transportit dhe prioritetet për çdo mënyrë transporti. Më konkretisht, disa nga objektivat dhe prioritetet janë:

- Transporti rrugor:
 - Përafrimi i legjislacionit shqiptar me tërësinë e legjislacionit të BE-së;
 - Rritja e sigurisë rrugore;
 - Promovimi i një sistemi të integruar të transportit intermodal, i cili përfshin infrastrukturën/transportin tokësor dhe detar;
 - Mirëmbajtja e rrugëve përmes bashkëpunimit të sektorit publik dhe atij privat;
- Transporti hekurudhor:
 - Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së;
 - Ristrukturimi i mëtejshëm i sistemit hekurudhor, krijimi i Autoritetit Hekurudhor Shqiptar, riorganizimi i hekurudhave shqiptare, nëpërmjet ndarjes së plotë të aktiviteteve operative nga aktivitetet e menaxhimit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës;
 - Intensifikimi i punës për krijimin e një sistemi të integruar të transportit, i fokusuar në lidhjen e porteve të Durrësit, Vlorës dhe Shëngjinit me linjë hekurudhore;
- Transporti detar:
 - Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së;
 - Ndërtimi i një porti intermodal në Shëngjin, i cili do të jetë një nga portet më të mëdha në rajon dhe do të shërbejë gjithashtu si pikë lidhëse midis detit Adriatik dhe vendeve të tjera në Ballkanin qendror dhe lindor;

- Ndërtimi i porteve të reja turistike, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe logjistikën moderne për këtë qëllim;
- Transporti ajror:
 - Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së;
 - Hapja e tregut dhe ulja e kostonë së tarifave të udhëtimit për udhëtarët, me qëllim rritjen e lëvizjes së udhëtarëve dhe mallrave;
 - Promovimi i investimeve të bazuara në partneritetin publik-privat për qëllime të turizmit vendës;
 - Ndërtimi i një aeroporti të ri në jug të vendit;
 - Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e transportit ajror;
 - Mundësimi i një performancë më të mirë të funksioneve të sigurisë ajrore, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike në këtë sektor.

3.2. Zhvillimi potencial i mjedisit në rast të moszbatimit të PKEK-së – Alternativa “0”

Në bazë të informacionit të siguruar nga krerët përkatës të dokumentit të PKEK-së, si dhe nga burimet e tjera të informacionit, mund të deduktohen kërcënimet/pikat e dobëta/sfidat me të cilat është duke u përballur sektori i energjisë në Shqipëri, si më poshtë:

- Ekonomia me intensitet relativisht të lartë të karbonit ;
- Numri i madh i ndërtesave (rezidenciale dhe jorezidenciale) dhe teknologjive të vjetra me konsum të lartë energjie;
- Çmimet e larta të blerjes së energjisë elektrike nga BRE-të;
- Çmimet e larta finale të energjisë elektrike;
- Mungesa e fondeve për kompletimin e infrastrukturës së energjisë;
- Mungesa e investimeve dhe burimeve vetjake për inovacion, kërkim, shkencë dhe edukim;
- Varësia e lartë nga importet e burimeve të energjisë primare dhe cenueshmëria derivative;
- Efektet negative në mjedis nga përdorimi i disa prej burimeve të energjisë;
- Përqindja e lartë e shpenzimeve familjare për energjinë elektrike, rreziku i varfërisë energjetike;
- Kushtet kufizuese natyrore në kuadër të një numri të madh zonash të mbrojtura, të cilat reduktojnë mundësitë e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, veçanërisht të diellit dhe erës.
- Rënia e kuotës së transportit publik dhe rritja e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e transportit.

Politikat dhe masat e propozuara dhe të përshkruara në dokumentin e PKEK-së pasqyrojnë nevojën për përmirësimin e situatës aktuale lidhur me pjesën më të madhe të kërcënimeve/pikave të dobëta/sfidave të sipërpërmendura. Shumë prej tyre lidhen gjithashtu me mjedisin dhe shëndetin, veçanërisht për sa u përket marrëdhënieve socio-ekonomike me ndikim në cilësinë e jetës dhe shëndetin e banorëve të të gjithë territorit të Shqipërisë dhe, në veçanti, të banorëve të zonave rurale dhe atyre më pak të zhvilluara të vendit, si dhe të grupeve të marginalizuara të popullsisë.

Zbatimi i PKEK-së do të sjellë përfitime në sektor, duke përfshirë edhe në aspektet mjedisore.

3.3. Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial

Ligjet dhe rregulloret kryesore në fuqi dhe sektorët përkatës mjedisorë dhe socialë renditen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11: Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial

Nr.	NËNFUSHA E ZBATIMIT	AKTI LIGJOR	FAZA		LLOJI DHE NR. I AKTIT	
			Faza e ndërtimit	Faza operacionale	konsumatori	Numri
1	Ekologjia	“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	41/2013
		“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”	X	X	LIGJ	43/2013
		“Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”				61/2016
		“Për mbrojtjen e biodiversitetit”	X	X	LIGJ	68/2014
2	Vlerësimi i ndikimit në mjedis	“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”	X	X	LIGJ	12/2015
3	VSM	“Për vlerësimin strategjik mjedisor”	ne	ne	LIGJ	91/2013
4	Mjedisi	“Për mbrojtjen e mjedisit”	X	X	LIGJ	10431/11
		“Për lejet e mjedisit”	X	ne	LIGJ	60/2014
		“Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, kreu 6, seksioni, 2, referencat për karrierat	X	ne	VKM	533/2005
		“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”	X	ne	VKM	42/2008
		“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”	X	ne	VKM	410/2012
5	Zonat e mbrojtura	Ligji “Për zonat e mbrojtura” VKM “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”	X	X	LIGJ VKM	81/2017 67/2002
6	Mbetjet	“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	X		LIGJ	10463/2011
		“Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; i ndryshuar me ligjin 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”	X	X	LIGJ	10137/2009
		“Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”	X		VKM	229/2014
		“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”	X		VKM	371/2014
		“Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009; dhe Ligji Nr. 9890, datë 20.03.2008;	X	X	LIGJ	9537/06
		“Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori”	X	X	VKM	742/2015
		“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	X	X	LIGJ	32/2013
		“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”	X		VKM	575/2015
7	Trashëgimia kulturore	Ligji “Për trashëgiminë kulturore”	X	X	LIGJ	27/2018

8	Ajri	Ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” VKM “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe kërkesat për disa ndotës të caktuar që lidhen me të”	X	X	LIGJ VKM	162/2014 352/2015
		“Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”	X	X	VKM	435/2002
9	Uji	“Për menaxhimin e ujërave të përdorura”, i ndryshuar me ligjin Nr. 60/2014 “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	60/2014
		“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”			LIGJ	6/2018
10	Zhurmat	“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”	X	X	LIGJ	39/2013
11	Pyjet	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”	X	X	LIGJ	36/2013
12	Përdorimi i tokës	“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	38/2013
		“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”	X	X	LIGJ	10257/10
13	Bujqësia	“Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar VKM “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”	X	X	LIGJ VKM	131/2014 373/2018
		“Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”	X	X	LIGJ	24/2017
14	Shpronësimet	“Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”	X	X	LIGJ	20/2016
15	Planifikimi territorial	“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	X	X	LIGJ	107/2014
16	Lejet	“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”	X	X	LIGJ	6/2015
17	Çështjet sociale	“Për ratifikimin e “Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”	X	X	LIGJ VKM	8672/2000 16/2012
18	Puna	“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”	X	X	LIGJ	135/2016
19	Shëndetësia	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoratin sanitar shtetëror”	X	X	LIGJ	45/2013
20	Çështjet gjinore	“Për barazinë gjinore në shoqëri”	X	X	LIGJ	9970/2008

4. OBJEKTIVAT DHE NËNOBJEKTIVAT MJEDISORE LIDHUR ME ZBATIMIN E PKEK-SË

Në tabelën e mëposhtme paraqiten objektivat (OM) dhe nënobjektivat mjedisore (NoM) në bazë të të cilave është kryer një vlerësim i ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në draft VSM. Përcaktimi i këtyre objektivave u bë në bazë të ndikimeve të pritshme të PKEK-së në sektorët përkatës mjedisorë.

Direktivat përkatëse të BE-së (Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis”), kuadri legjislativ kombëtar, si dhe praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare, përcaktojnë kërkesat minimale për vlerësimin e efekteve të zbatimit të planeve në sektorët përkatës mjedisorë, si te faktorët klimatikë, burimet natyrore, biodiversiteti, shëndeti i njeriut etj. dhe raportet e ndërsjella ndërmjet tyre. Duke marrë në konsideratë Strategjinë për Klimën 2050 të BE-së dhe qëllimin e saj për të kontribuar në Zhvillimin e Gjelbër, ekzistojnë gjithashtu objektiva dhe nënobjektiva të tjera lidhur me qëndrueshmërinë ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat lidhen tërthorazi me sektorët mjedisorë.

Për çdo objektiv/nënobjektiv mjedisor renditen politikat dhe masat (PM) që gjenden në dokumentin e PKEK-së dhe që konsiderohen me rëndësi për OM/NoM përkatëse. Për çdo PM jepet informacioni përkatës i marrë nga PKEK dhe që ka të bëjë me: dimensionin të cilit i përket kjo PM, kodin përkatës, skenarin (WEM/WAM) në bazë të të cilit paraqitet kjo PM dhe rezultatet e pritshme.

Në vijim, kryhet analiza e ndikimeve të pritshme të PM-ve në mjedis dhe përcaktimi i shkallës së ndikimit për çdo PM, lidhur me OM/NoM përkatëse, duke marrë në konsideratë informacionet e sipërpërmendura, si dhe masat që duhet të zbatohen (siç përshkruhet në dokumentin e PKEK-së).

Tabela 12: Objektivat dhe nënobjektivat mjedisore, si dhe politikat dhe masat përkatëse

OM1: Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj tyre					
OM1-NoM1: Rritja e përfitimeve të efikasitetit të energjisë, duke përfshirë ndërtesat me zero shkarkime deri në vitin 2030					
Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Dimensioni	Kodi	Skenari	Rezultatet që duhet të arrihen
1	Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Eficienca e energjisë	EE-O1	WAM	- Përdorimi racional i burimeve energjetike në nivel kombëtar - Arritja e objektivave të kursimeve kumulative të energjisë në totalin e kërkesës finale për energji, deri më 31 dhjetor 2030 - Arritja e pikësnyimit nga palët e përfshira në detyrim (OP), prej rreth 1,5% shitje vjetore të energjisë të konsumatorët fundorë nga të gjithë shpërndarësit e energjisë ose shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, vlerë kjo e mesatarizuar përgjatë një periudhe trevjeçare; (EED, neni 7) - Kuadri rregullator për krijimin e skemës detyruese
2	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa		EE-L1	WAM	Caktimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë për: - Vlerësimi i kursimeve të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe jorezidenciale të sapondërtuara, me anë të përdorimit të zarfit termik - Vlerësimi i kursimit të energjisë në ndërtesat (ekzistuese) rezidenciale dhe jorezidenciale të restauruara (të rikonstruktura), me anë të përdorimit të zarfit termik, pa ndryshim të sistemit të ngrohjes - Rikonstruksioni i përgjithshëm i zarfit termik të ndërtesave ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale dhe rikonstruksioni i sistemit të ngrohjes - Përmirësimi i efikasitetit termik përmes ndërhyrjeve specifike në elemente të veçanta të ndërtesës - Lëshimi i certifikatës së performancës së energjisë
3	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)		EE-L2	WAM	- Përgatitja e strategjisë afatgjatë të rinovimit (LTRS) dhe masave për nxitjen e rinovimit rrënjësor me kosto efektive - Përmes zbatimit të LTRS-së - Rinovim i 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit. - Rinovim i 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit. - Përmbushja e kërkesave të nZEB nga të gjitha ndërtesat e reja. - Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë. - Inkurajimi i investimeve që lidhen me EE-në dhe BRE-të për rinovimin e ndërtesave publike, bazuar në kosto optimale për arritjen e reduktimit të konsumit të energjisë, reduktimit të shkarkimeve, rritjes së komfortit dhe reduktimit të faturave të energjisë.
4	Rikonstruksioni i ndërtesës ekzistuese të qeverisjes qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)		EE-L3	WAM	- Rinovim i 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit - Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë.
5	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)		EE-L4	WAM	- Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave në Shqipëri - Rinovim i 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit. - Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë. - Inkurajimi i investimeve lidhur me EE-në dhe BRE-në për rinovimin e ndërtesave publike bazuar në kosto optimale për arritjen e reduktimit të konsumit të energjisë, reduktimit të shkarkimeve, rritjes së komfortit dhe reduktimit të

					<i>faturave të energjisë</i>
6	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa (sektori privat)		EE-L5	WAM	- Krijimi i skemave të mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë së ndërtesave në Shqipëri
7	Zbatimi i modeleve të ESCO		EE-S1	WAM	- Prezantimi dhe ngritja e ESCO-ve do të mundësojë shërbime cilësore lidhur me investimet në EE dhe mund të shërbejë gjithashtu për financim, duke marrë përsipër arritjen e objektivave të kursimit të energjisë dhe reduktimit të kostove të energjisë e të shkarkimeve
8	Masat për efijencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike		EE-P1	WAM	- Një VKM që do të përfshijë në rregullat e prokurimit publik dispozita që detyrojnë autoritetet kontraktore publike që t'u japin përparësi, gjatë prokurimit, produkteve dhe shërbimeve me efijencë të lartë energjie. - Katalogë, udhëzues ose faqe interneti për specifikimet teknike/standardet e EE për produktet e blera bashkërisht - Trajnimi dhe udhëzimi i autoriteteve publike - Udhëzimi i autoriteteve publike lidhur me prokurimin publik me në fokus EE-në
9	Planet bashkiake të veprimit për efijencën e energjisë, zbatimi dhe raportimi		EE-P2	WAM	- Intensifikimi i ngritjes së kapaciteteve për punonjësit e bashkive në fushën e EE-së - Një plan i detajuar mbi masat e EE-së për bashkitë, në përputhje me planin kombëtar të veprimit për EE-në në sektorë të ndryshëm - Sigurimi i burimeve të financimit për investimet në EE - Monitorimi i zbatimit të masave për EE-në - Mbledhja e të dhënave mbi konsumin e energjisë dhe monitorimi i kursimeve të arritura.
10	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale		EE-E1	WAM	- Parashikimi me anë të akteve ligjore i detyrimit për kryerjen e auditimeve të energjisë në industri, me qëllim përdorimin më eficient të energjisë. - Audituesit energjetikë do të angazhohen në aktivitete industriale që lidhen me 2 elemente kyçe: proceset e prodhimit dhe proceset mbështetëse (shërbimet energjetike), duke përcaktuar konsumin e energjisë, duke përgatitur raporte dhe duke bërë propozime për industrinë lidhur me masat që duhet të merren në të ardhmen për reduktimin e konsumit të energjisë. - Bizneset e industrisë janë të detyruara të përgatisin planet e tyre të veprimit lidhur me EE-në, me qëllim investimin në masat për EE-në (sipas nevojës) brenda 2 muajve pas auditimit të energjisë. - Brenda 2 viteve, bazuar në raportet e auditimit të energjisë, ato janë të detyruara të bëjnë investime për reduktimin e konsumit të energjisë dhe të raportojnë pranë AEE-së. - Reduktimi i kostove të larta të shërbimeve energjetike dhe prodhimit të energjisë në rastet kur nuk janë konkurruese. - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit energjetik në sektorin e industrisë. - Pas dorëzimit të auditimeve të energjisë, konsumatorët e mëdhenj duhet të ndërmarrin investime për të arritur objektivin e kursimit të energjisë në masën 4% nga totali i energjisë ekuivalente të konsumuar prej tyre.
11	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të		EE-E2	WAM	- Përmirësimi i mbështetjes politike, rregullatore dhe institucionale për miratimin e standardeve të sistemeve të menaxhimit të energjisë - Rritja progresive e depërtimit të standardeve të sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe efijencës së energjisë në NVM-të industriale në Shqipëri - Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e energjisë - Zhvillimi i mekanizmave novatorë të financimit (duke përfshirë financimin e reduktimit të shkarkimeve të karbonit) për investime në teknologji industriale me efijencë të lartë energjie dhe nivele të ulëta karboni - Përmirësimi i zbatimit të Ligjit të rishikuar 124/2015 në lidhje me një pjesë të skemave të auditimit të energjisë
12	Prezantimi i kërkesave të		EE-C1	WAM	- Pritet që deri në vitin 2030, përqindja e teknologjive me efijencë të lartë energjetike të jetë 5% e rezervës së

	etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik				përgjithshme. - Një kursim i parashikuar energjie në masën 3 ktoe deri në vitin 2020.
13	Etiketimi i energjisë për makinat e reja		EE-T1	WAM	- Lejimi i konsumatorëve për të bërë zgjedhjet e tyre dhe për të ndikuar në reduktimin e konsumit të energjisë dhe të shkarkimeve.
14	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike		EE-T3	WEM	- Përqindja e planifikuar e burimeve të rinovueshme të energjisë në transport është 10% në vitin 2020 dhe çdo vit në vazhdim, deri në vitin 2030. - Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit prej 14% për burimet e rinovueshme në transport - o Arritja deri në vitin 2030 e objektivit të masës prej 13,4% për biokarburantet e lëngshme me origjinë bujqësore në transportin rrugor, lëndët djegëse të lëngshme nga lëndët e para të shtojcës IX, pjesa B dhe biokarburantet e lëngshme të avancuara nga lëndët e para të shtojcës IX, pjesa A në transportin rrugor, me kontribut në BRE-T: në sasinë 98,4 ktoe deri në vitin 2030 - o Transporti publik elektrik do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,014% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura - o Automjetet rrugore elektrike (automjetet për transportin e udhëtarëve, kamionët) do të kontribuojnë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,49% dhe 1,2 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura - o Hidrogjeni në transportin hekurudhor do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,005% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura - o Hidrogjeni (për urbanët dhe autobusët ndërqytetës) do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,005% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura - o Automjetet rrugore që punojnë me hidrogjen (automjetet për transportin e udhëtarëve dhe kamionët) do të kontribuojnë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,12% dhe 1,2 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura - Asnjë "tarifë regjistrimi fillestar" për automjetet e reja - Asnjë taksë automjeti për 5 vitet e para - Përrjashtimi nga TVSH (20%) për automjetet elektrike - Përrjashtimi nga TVSH vetëm për automjetet e reja me motor elektrik, me qëllim inkurajimin e individëve dhe bizneseve për të blerë automjete të tilla - Asnjë taksë rrugore - Zëvendësimi i autobusëve me autobusë me nivele të ulëta shkarkimi (Bashkia e Tiranës)
OM1-NoM2: Reduktimi i konsumit final të energjisë					
1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-T1	WAM	- Rritja e efikasitetit ekonomiko-financiar të operatorëve me 30-40% (brenda vitit) - Reduktimi i bllokimit të trafikut si rezultat i reduktimit të numrit të autobusëve që qarkullojnë në rrjetin rrugor kombëtar. - o Reduktimi i nisjeve dhe mbërritjeve të autobusëve me 15-20% (brenda një viti) - o Reduktimi i shkarkimeve të CO2 me 15-20%, me reduktimin e autobusëve në qarkullim - Promovimi i transportit multimodal - Rritja e efikasitetit financiar të operatorëve të rrjetit ndërqytetës. - Rritja e sigurisë së transportit ndërqytetës - Reduktimi i intensitetit të energjisë në sektorin e transportit me 10%, si rezultat i menaxhimit të mirë - Përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së shërbimit në linjat ndërqytetëse - Reduktimi i nevojave për lëvizshmërinë dhe distancave me anë të planifikimit të integruar

					- Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut - Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme - Mundësia e multimodalitetit dhe intermodalitetit midis modaliteteve të transportit - Krijimi i terminaleve të udhëtarëve
2	Elektrifikimi i sektorit të transportit	Energjitë e rinovueshme	R-T1	WAM	- 10% automjete elektrike (nga e gjithë flota), deri në vitin 2030
3	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara		R-T2	WAM	- Alternativat për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme përtej objektivit të vitit 2030 mund të ofrojnë mundësi për eksporte, p.sh. me anë të prodhimit dhe eksportimit të biokarburanteve me bazë vajrat e përdorura të gatimit dhe dhjamërat shtazore ose me anë të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme nga energjia elektrike e rinovueshme (RFNBO). - Biokarburantet, duke përfshirë ato me origjinë bujqësore, me origjinë nga mbetjet dhe ato të avancuara, parashikohet të japin kontributin më të madh drejt arritjes së objektivit. - Pikësynimi i masës 10% të biokarburanteve deri në vitin 2025.
4	Skema detyruese e efijencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Efijenca e energjisë	EE-O1	WAM	- Përdorimi racional i burimeve energjetike në nivel kombëtar - Arritja e objektivave të kursimeve kumulative të energjisë në totalin e kërkesës finale për energji, deri më 31 dhjetor 2030 - Arritja e pikësynimit nga palët e përfshira në detyrim (OP), prej rreth 1,5% shitje vjetore të energjisë të konsumatorët fundorë nga të gjithë shpërndarësit e energjisë ose shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, vlerë kjo e mesatarizuar përgjatë një periudhe trevjeçare; (EED, neni 7) - Kuadri rregullator për krijimin e skemës detyruese
5	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa		EE-L1	WAM	<i>Caktimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë për:</i> - Vlerësimi i kursimeve të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe jorezidenciale të sapondërtuara, me anë të përdorimit të zarfit termik - Vlerësimi i kursimit të energjisë në ndërtesat (ekzistuese) rezidenciale dhe jorezidenciale të restauruara (të rikonstruktura), me anë të përdorimit të zarfit termik, pa ndryshim të sistemit të ngrohjes - Rikonstruksioni i përgjithshëm i zarfit termik të ndërtesave ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale dhe rikonstruksioni i sistemit të ngrohjes - Përmirësimi i efijencës termike përmes ndërhyrjeve specifike në elemente të veçanta të ndërtesës - Lëshimi i certifikatës së performancës së energjisë
6	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)		EE-L2	WAM	- Përgatitja e strategjisë afatgjatë të rinovimit (LTRS) dhe masave për nxitjen e rinovimit rrënjësor me kosto efektive - Përmes zbatimit të LTRS-së - o Rinovim i 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit. - o Rinovim i 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit. - o Përmeshja e kërkesave të nZEB nga të gjitha ndërtesat e reja. - Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë. - Inkurajimi i investimeve që lidhen me EE-në dhe BRE-të për rinovimin e ndërtesave publike, bazuar në kosto optimale për arritjen e reduktimit të konsumit të energjisë, reduktimit të shkarkimeve, rritjes së komfortit dhe reduktimit të faturave të energjisë.
7	Rikonstruksioni i ndërtesës		EE-L3	WAM	- Rinovim i 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit

	ekzistuese të qeverisjes qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)				- <i>Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë.</i>
8	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)		EE-L4	WAM	- <i>Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave në Shqipëri</i> - <i>Rinovim i 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit.</i> - <i>Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë.</i> - <i>Inkurajimi i investimeve lidhur me EE-në dhe BRE-në për rinovimin e ndërtesave publike bazuar në kosto optimale për arritjen e reduktimit të konsumit të energjisë, reduktimit të shkarkimeve, rritjes së komfortit dhe reduktimit të faturave të energjisë</i>
9	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa (sektori privat)		EE-L5	WAM	- <i>Krijimi i skemave të mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë së ndërtesave në Shqipëri</i>
10	Zbatimi i modeleve të ESCO		EE-S1	WAM	- <i>Prezantimi dhe ngritja e ESCO-ve do të mundësojë shërbime cilësore lidhur me investimet në EE dhe mund të shërbejë gjithashtu për financim, duke marrë përsipër arritjen e objektivave të kursimit të energjisë dhe reduktimit të kostove të energjisë e të shkarkimeve</i>
11	Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike		EE-P1	WAM	- <i>Një VKM që do të përfshijë në rregullat e prokurimit publik dispozita që detyrojnë autoritetet kontraktore publike që t'u japin përparësi, gjatë prokurimit, produkteve dhe shërbimeve me efikasitet të lartë energjie.</i> - <i>Katalogë, udhëzues ose faqe interneti për specifikimet teknike/standardet e EE për produktet e blera bashkërisht</i> - <i>Trajnimi dhe udhëzimi i autoriteteve publike</i> - <i>Udhëzimi i autoriteteve publike lidhur me prokurimin publik me në fokus EE-në</i>
12	Planet bashkiake të veprimit për efikasitetin e energjisë, zbatimi dhe raportimi		EE-P2	WAM	- <i>Intensifikimi i ngritjes së kapaciteteve për punonjësit e bashkive në fushën e EE-së</i> - <i>Një plan i detajuar mbi masat e EE-së për bashkitë, në përputhje me planin kombëtar të veprimit për EE-në në sektorë të ndryshëm</i> - <i>Sigurimi i burimeve të financimit për investimet në EE</i> - <i>Monitorimi i zbatimit të masave për EE-në</i> - <i>Mbledhja e të dhënave mbi konsumin e energjisë dhe monitorimi i kursimeve të arritura.</i>
13	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale		EE-E1	WAM	- <i>Parashikimi me anë të akteve ligjore i detyrimit për kryerjen e auditimeve të energjisë në industri, me qëllim përdorimin më efikas të energjisë.</i> - <i>Audituesit energjetikë do të angazhohen në aktivitete industriale që lidhen me 2 elemente kyçe: proceset e prodhimit dhe proceset mbështetëse (shërbimet energjetike), duke përcaktuar konsumin e energjisë, duke përgatitur raporte dhe duke bërë propozime për industrinë lidhur me masat që duhet të merren në të ardhmen për reduktimin e konsumit të energjisë.</i> - <i>Bizneset e industrisë janë të detyruara të përgatisin planet e tyre të veprimit lidhur me EE-në, me qëllim investimin në masat për EE-në (sipas nevojës) brenda 2 muajve pas auditimit të energjisë.</i> - <i>Brenda 2 viteve, bazuar në raportet e auditimit të energjisë, ato janë të detyruara të bëjnë investime për reduktimin e konsumit të energjisë dhe të raportojnë pranë AEE-së.</i> - <i>Reduktimi i kostove të larta të shërbimeve energjetike dhe prodhimit të energjisë në rastet kur nuk janë konkurruese.</i> - <i>Përmirësimi i sistemit të menaxhimit energjetik në sektorin e industrisë.</i> - <i>Pas dorëzimit të auditimeve të energjisë, konsumatorët e mëdhenj duhet të ndërmarrin investime për të arritur</i>

					<i>objektivin e kursimit të energjisë në masën 4% nga totali i energjisë ekuivalente të konsumuar prej tyre.</i>
OM1-NoM3: Shfrytëzimi më intensiv i energjisë nga burimet e rinovueshme dhe i energjisë elektrike për të dekarbonizuar plotësisht furnizimin me energji deri në vitin 2030					
1	Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-B1	WEM	- Rritja e kapacitetit të instaluar të BRE-ve në ndërtesa
2	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla të rinovueshme	Energjitë e rinovueshme	R-E1	WEM dhe WAM	- Objektivi është nxitja e rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. - Kjo masë kontribuon gjithashtu në pikësynimin kombëtar për BRE-të deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë dhe, në mënyrë specifike, në arritjen e pikësynimit lidhur me energjinë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (BRE-E- 239 ktoe). <i>Për WEM:</i> - Do të ndërtohen të tjera hidrocentrale të vogla në kuadër të lejeve të dhëna më parë. Pritet që gjatë periudhës 2021-2028 të shtohen 40 MW në vit ose 320 MW në total. <i>Për WAM:</i> - Pritet që gjatë periudhës 2021-2030 në rrjet të shtohen 30 MW energji fotovoltaike në vit ose 300 MW në total deri në 2030. Për teknologjitë e tjera nuk parashikohet ndonjë rritje e ndjeshme.
3	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë		R-E2	WEM dhe WAM	- Objektivi është nxitja e rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. - Kjo masë kontribuon gjithashtu në pikësynimin kombëtar për BRE-të deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë. <i>Për WEM:</i> - Ndërtimi i parqeve fotovoltaike të Karavastasë dhe Spitallës deri në 2023 (240 MW energji fotovoltaike në total) - Shtimi i kapacitetit eolik me 150 MW deri në 2024 <i>Për WAM:</i> - Shtim i energjisë fotovoltaike me 70 MW në vit nga 2024 deri në 2030 (një total prej 490 MW) - Shtim i kapacitetit eolik me 60 MW nga 2026 deri në 2030 (një total prej 300 MW)
4	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW		R-E3	WEM	- Rritja e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë - Kjo masë kontribuon gjithashtu në pikësynimin kombëtar për BRE-të deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë dhe, në mënyrë specifike, në arritjen e pikësynimit lidhur me energjinë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (BRE-E- 239 ktoe). - Rritja e kapacitetit të rinovueshëm, kryesisht atij të energjisë fotovoltaike, nuk paraqitet veçmas për këtë masë, por kapaciteti total supozohet të pasqyrohet në R-E1.
5	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme		R-E4	WEM	- Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FiT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.
6	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.		R-E5	WEM	- Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me kërkesë të një prodhuesi të energjisë nga burime të rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, do të propozojnë si pikë lidhjeje me

					<i>rrjetin e tyre pikën që përmbush kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme për nga pikëpamja e koston dhe distancës me rrjetin.</i>
7	Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik		R-E6	WAM	- Studime paraprake për të vlerësuar potencialin për menaxhimin e krahut të kërkesës dhe rezervat - Lidhja me skemën e matjes së energjisë neto - Lidhja me instalimin e matësve inteligjentë (strategjia e matjes)
8	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë		R-E7	WEM	- Krijimi i një strategjie matjeje - Instalimi i matësve inteligjentë sipas strategjisë së matjes - Sigurimi i një menaxhimi proaktiv të rrjetit të shpërndarjes me anë të përdorimit të mjeteve të përshtatshme informatike dhe të dhënave të matësve inteligjentë (dixhitalizimi)
9	Elektrifikimi i sektorit të transportit		R-T1	WAM	- 10% automjete elektrike (nga e gjithë flota), deri në vitin 2030
10	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara		R-T2	WAM	- Alternativat për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme përtej objektivit të vitit 2030 mund të ofrojnë mundësi për eksporte, p.sh. me anë të prodhimit dhe eksportimit të biokarburanteve me bazë vajrat e përdorura të gatimit dhe dhjamërat shtazore ose me anë të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme nga energjia elektrike e rinovueshme (RFNBO). - Biokarburantet, duke përfshirë ato me origjinë bujqësore, me origjinë nga mbetjet dhe ato të avancuara, parashikohet të japin kontributin më të madh drejt arritjes së objektivit. - Pikësynimi i masës 10% të biokarburanteve deri në vitin 2025.
11	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor		R-I1	WAM	- Përmirësimi i kapaciteteve të NVM-ve prodhuese vendase me qëllim përshpejtimin e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Kuadro politike dhe rregullatore që nxisin zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Përmirësimi i mekanizmave financiare
OM1-NoM4: Reduktimi i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për të arritur vlerën 11.5% në vitin 2030					
1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-T1	WAM	- Rritja e efikasitetit ekonomiko-financiar të operatorëve me 30-40% (brenda vitit) - Reduktimi i bllokimit të trafikut si rezultat i reduktimit të numrit të autobusëve që qarkullojnë në rrjetin rrugor kombëtar. - o Reduktimi i nisjeve dhe mbërritjeve të autobusëve me 15-20% (brenda një viti) - o Reduktimi i shkarkimeve të CO2 me 15-20%, me reduktimin e autobusëve në qarkullim - Promovimi i transportit multimodal - Rritja e efikasitetit financiar të operatorëve të rrjetit ndërqytetës. - Rritja e sigurisë së transportit ndërqytetës - Reduktimi i intensitetit të energjisë në sektorin e transportit me 10%, si rezultat i menaxhimit të mirë - Përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së shërbimit në linjat ndërqytetëse - Reduktimi i nevojave për lëvizshmërinë dhe distancave me anë të planifikimit të integruar - Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut - Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme - Mundësia e multimodalitetit dhe intermodalitetit midis modaliteteve të transportit

					- <i>Krijimi i terminaleve të udhëtarëve</i>
2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave		G-T2	WAM	- <i>Integrimi i transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror në transportin e mallrave (plani afatmesëm 5-8 vite)</i> - <i>Rritja e efikasitetit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i kohës së transitit dhe kostove të transportit përgjatë zinxhirit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i bllokimit të trafikut në rrjetin rrugor kombëtar</i> - <i>Reduktimi i konsumit të energjisë (ton/km)</i> - <i>Reduktimi i shkarkimeve të CO2</i> - <i>Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut</i> - <i>Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme</i> - <i>Rritja e investimeve në sektorin e menaxhimit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i koston të transportit nga origjina deri në destinacionin e mallrave (gjatë zinxhirit të transportit)</i>
3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës		G-T3	WEM	- <i>Reduktimi i importeve të automjeteve të përdorura</i> - <i>Rritja e përdorimit të automjeteve të reja</i> - <i>Rritja e përdorimit të automjeteve elektrike</i>
4	Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen		G-B1	WEM	- <i>Rritja e kapacitetit të instaluar të BRE-ve në ndërtesa</i>
5	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri		G-I1	WAM	- <i>Reduktimi i synuar me 50% i shkarkimeve të GES-ve nga sektori i industrisë, deri në vitin 2030</i> - <i>Duke nisur nga viti 2025, prezantimi nga Shqipëria i tregtimit në nivel kombëtar të kuotave pa pagesë, me pjesëmarrjen e industrisë së çimentos, plehëruesve, hekurit dhe çelikut</i> - <i>Ngritja e një sistemi të përshtatshëm monitorimi, raportimi dhe verifikimi (MRV) për monitorimin e shkarkimeve, siç është parashikuar në ligjin “Për ndryshimet klimatike” e miratuar së fundmi</i> - <i>Aftësimi, deri në vitin 2027, i 20 operatorëve industrialë në shtojcën II të ligjit 155/2020, për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të GES-ve në pajtueshmëri me udhëzimet e BE-së.</i>
6	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së		G-I2	WAM	<i>Në përputhje me NDC-në e vitit 2015, duhet të raportohet progresi drejt synimeve të mëposhtme:</i> - <i>Në sektorin e ndërtimit (izolimi) do të arrihet një reduktim i CO2 prej 50 kt (ose reduktim me 7% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030</i> - <i>Në sektorin e industrisë (kalaja më efikase) do të arrihet një reduktim i CO2 prej 225 kt (ose reduktim me 32% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030</i> - <i>Në sektorin e industrisë (ndryshimi i lëndëve djegëse të përdorura) do të arrihet një reduktim i CO2 prej 52 kt (ose reduktim me 7% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030</i> - <i>Në sektorin e transportit (masa me kosto efektive) do të arrihet një reduktim i CO2 prej 116 kt (ose reduktim me 16% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030</i> - <i>Në sektorin e transportit (kalimi të biokarburantet në masën 10%) do të arrihet një reduktim i CO2 prej 265 kt (ose reduktim me 38% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030</i>
7	Promovimi i bujqësisë organike		G-A1	WEM	- <i>Rritja e numrit të fermave organike nga 123 (në vitin 2012) deri në 1000 (objektivi 2020)</i> - <i>Rritja e sipërfaqes së fermave organike nga 5848 ha (në vitin 2012) deri në 20 000 ha (sipas objektivit, në vitin 2020)</i> - <i>Ulja e normës mesatare të plehërimit me 10% nga 2019 deri në 2030 dhe një reduktim me 50% i uresë së shpërndarë nga 2019 deri në 2030</i>
8	Përmirësimi i monitorimit		G-A2	WAM	- <i>Krijimi i një regjistri kombëtar me mbështetjen e INSTAT në periudhën 2025-2030</i>

	bujqësor në Shqipëri				- <i>Trajnimi i personelit të bashkive, fermerëve etj.</i>																
9	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi		G-A3	WEM	- <i>Reduktim i shkarkimeve si rezultat i djegies së mbetjeve bujqësore</i> - <i>Trajnimi i fermerëve etj.</i>																
10	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet		G-W1	WEM	- <i>Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të disponojnë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Deri në vitin 2035, do të riciklohet 40% e totalit të rrymave të mbetjeve dhe do të grumbullohet në nivel bashkiak jo më pak se 70% e mbetjeve të ambalazheve.</i> - <i>Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të kenë mbyllur vendgrumbullimet e papajtueshme.</i> - <i>Deri në vitin 2035, do të grumbullohet dhe trajtohet si duhet 80% e baterive dhe akumulatorëve, 80% e llumrave të ujërave të ndotura dhe 80% e mbetjeve inerte.</i> - <i>Fillimi i përthithjes së CH₄ në vitin 2025, ndjekur nga një progres linear, derisa të arrihet një përthithje prej 10% nga 1,34 milionë tonë CH₄ në vitin 2030 (vlerësuar me anë të analizës së të dhënave të mjetit GACMO të skenarit të Komunikimit të Tretë Kombëtar dhe NDC-së).</i>																
11	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri		G-W2	WEM	- <i>Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e tyre në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet (WtE) do të shkojë nga 6 në vitin 2019 në 12 në vitin 2025.</i> - <i>Të gjitha bashkitë që bëjnë pjesë në diapazonin e shërbimit të impianteve WtE pritet të dërgojnë mbetjet e tyre brenda vitit 2030 (duke mbuluar rreth 58% të popullsisë shqiptare).</i>																
12	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës		G-W3	WEM	- <i>Objektivi për mbulimin me trajtim të ujërave të përdorura nga ITUP është si më poshtë:</i> <table><tr><td>Viti</td><td>Përqindja</td></tr><tr><td>2021</td><td>14</td></tr><tr><td>2022</td><td>17</td></tr><tr><td>2023</td><td>20</td></tr><tr><td>2024</td><td>24</td></tr><tr><td>2025</td><td>28</td></tr><tr><td>2026</td><td>32</td></tr><tr><td>2027</td><td>39</td></tr></table> - <i>Në 2024 pritet të miratohet strategjia e menaxhimit të llumrave.</i> - <i>Në 2025 pritet të miratohet ngritja e një laboratorit për analizën e llumrave në Shqipëri.</i>	Viti	Përqindja	2021	14	2022	17	2023	20	2024	24	2025	28	2026	32	2027	39
Viti	Përqindja																				
2021	14																				
2022	17																				
2023	20																				
2024	24																				
2025	28																				
2026	32																				
2027	39																				
13	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave		G-LF1	WAM	- <i>Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD)</i> - <i>Përmirësimi i kuadrit legjislativ në lidhje me ferment organikë</i> - <i>Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (PMB)</i> - <i>Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së</i>																
14	Menaxhimi ekologjik i pyjeve		G-LF2	WAM	- <i>Në bazë të një prej llogaritjeve të bëra, përmirësimi i menaxhimit të pyjeve, nëse arrihet të zbatohet në mënyrë progresive në një sipërfaqe prej 5000 ha në vit, do të lejojë një normë më të lartë të rritjes së biomasës së pemëve në këto zona.</i> - <i>Në vitin 2030, zbatimi i kësaj mase do të lejojë reduktimin e shkarkimeve vjetore në një masë të parashikuar prej -18 kt CO₂e, krahasuar me skenarin BAU. (Burimi: Kontributi Kombëtar i Përcaktuar 2021 (versioni draft), tabela 4)</i>																
OM1-NoM5: Shfrytëzimi i të gjitha përfitimeve të bioekonomisë dhe krijimi i përthithësve të konsiderueshëm të karbonit																					
1	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-LF1	WAM	- <i>Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD)</i> - <i>Përmirësimi i kuadrit legjislativ në lidhje me ferment organikë</i> - <i>Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (PMB)</i> - <i>Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së</i>																

2	Menaxhimi ekologjik i pyjeve		G-LF2	WAM	- Në bazë të një prej llogaritjeve të bëra, përmirësimi i menaxhimit të pyjeve, nëse arrihet të zbatohet në mënyrë progresive në një sipërfaqe prej 5000 ha në vit, do të lejojë një normë më të lartë të rritjes së biomasës së pemëve në kështojë. - Në vitin 2030, zbatimi i kësaj mase do të lejojë reduktimin e shkarkimeve vjetore në një masë të parashikuar prej -18 kt CO₂e, krahasuar me skenarin BAU. (Burimi: Kontributi Kombëtar i Përcaktuar 2021 (versioni draft), tabela 4)
3	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	Energjitë e rinovueshme	R-T2	WAM	- Alternativat për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme përtej objektivit të vitit 2030 mund të ofrojnë mundësi për eksporte, p.sh. me anë të prodhimit dhe eksportimit të biokarburanteve me bazë vajrat e përdorura të gatimit dhe dhjamërat shtazore ose me anë të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme nga energjia elektrike e rinovueshme (RFNBO). - Biokarburantet, duke përfshirë ato me origjinë bujqësore, me origjinë nga mbetjet dhe ato të avancuara, parashikohet të japin kontributin më të madh drejt arritjes së objektivit. - Pikësnyimi i masës 10% të biokarburanteve deri në vitin 2025.
OM1-NoM6 Rritja e lëvizshmërisë ndërkohë që reduktohet konsumi i energjisë në sektorin e transportit					
1	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)	Efienca e energjisë	EE-T4	WEM	- Shtimi i numrit të autobusëve, shpeshësisë, cilësisë dhe aksesit të rrugëve, korsive të dedikuara, sistemeve inteligjente të transportit, infrastrukturës hekurudhore, kryqëzimeve të transitit, rritja e faktorit të ngarkesës, çmime konkurruese në raport me transportin privat, përmirësimi i koordinimit ndërmjet mënyrave të transportit - autobusë, trena, anije. - Intensifikimi i kalimit drejt transportit publik dhe atij aktiv: Arritja e një ndarjeje modale prej 70% për transportin publik dhe atë aktiv për bashkinë e Tiranës. - Reformimi i sistemit hekurudhor duke krijuar një treg të hapur për investitorët publikë dhe privatë, për sa i përket rregullimit të tregut, menaxhimit të infrastrukturës ose shfrytëzimit të hekurudhave. - Modernizimi i infrastrukturës portuale përmes investimeve. - Fuqizimi i Administratës Detare në përputhje me standardet e BE-së. - Rritja e specializimit të funksioneve portuale me qëllim përfundim të veçorisë së tyre intermodale, veçanërisht për lidhjen port-hekurudhë.
2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të automjeteve.		EE-T2	WAM	- Reduktimi i konsumit të energjisë fosile dhe garantimi i qëndrueshmërisë së transportit publik/privat, përmes zhvillimit të infrastrukturës që konsiston në stacione karikimi të automjeteve elektrike - Ngritja e 200-300 stacionesh karikimi elektrik në të gjithë Shqipërinë, deri në vitin 2025 - Përmbytja e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Direktivës “Për Lëvizshmërinë e Qëndrueshme” - Reduktimi i ndotjes së ajrit me anë të promovimit të makinave elektrike, sipas standardeve evropiane - Për sa i përket ndikimit të pritshëm në transport të shkarkimeve të CO₂, një reduktim i përgjithshëm prej rreth 2,5-3% të shkarkimeve totale të CO₂ deri në vitin 2025 (duke marrë parasysh pikësnyimin prej 5% në konsumin total të energjisë dhe reduktimin e pritshëm prej 50-60% në shkarkimet e CO₂ për km të përshkruar nga automjeti, krahasuar me lëndët djegëse fosile) dhe prej 5-6% në vitin 2030 (duke marrë parasysh pikësnyimin prej 10% në konsumin total të energjisë), sipas propozimit të NDC-ve.
OM1-NoM7: Reduktimi i ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cënueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitet dhe përshtatshmëri më e madhe e shoqërisë					
1	Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)	Efienca e energjisë	EE-L4	WAM	- Përmirësimi i efiençës së energjisë së ndërtesave në Shqipëri - Rinovim i 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit. - Dhënia e një shembulli të mirë nga ana e qeverisë për EE-në, i cili të mund të përdoret për të motivuar publikun e gjerë. - Inkurajimi i investimeve lidhur me EE-në dhe BRE-në për rinovimin e ndërtesave publike bazuar në kosto optimale për arritjen e reduktimit të konsumit të energjisë, reduktimit të shkarkimeve, rritjes së komfortit dhe reduktimit të

					<i>faturave të energjisë</i>
2	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)		EE-L5	WAM	- <i>Krijimi i skemave të mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë së ndërtesave në Shqipëri</i>
3	Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike		EE-P1	WAM	- <i>Një VKM që do të përfshijë në rregullat e prokurimit publik dispozita që detyrojnë autoritetet kontraktore publike që t'u japin përparësi, gjatë prokurimit, produkteve dhe shërbimeve me efikasitet të lartë energjie.</i> - <i>Katalogë, udhëzues ose faqe interneti për specifikimet teknike/standardet e EE për produktet e blera bashkërisht</i> - <i>Trajnime dhe udhëzime i autoriteteve publike</i> - <i>Udhëzimi i autoriteteve publike lidhur me prokurimin publik me në fokus EE-në</i>
4	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik		EE-C1	WAM	- <i>Pritet që deri në vitin 2030, përqindja e teknologjive me efikasitet të lartë energjetike të jetë 5% e rezervës së përgjithshme.</i> - <i>Një kursim i parashikuar energjie në masën 3 ktoe deri në vitin 2020.</i>
5	Etiketimi i energjisë për makinat e reja		EE-T1	WAM	- <i>Lejimi i konsumatorëve për të bërë zgjedhjet e tyre dhe për të ndikuar në reduktimin e konsumit të energjisë dhe të shkarkimeve.</i>
6	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike		EE-T3	WEM	- <i>Përqindja e planifikuar e burimeve të rinovueshme të energjisë në transport është 10% në vitin 2020 dhe çdo vit në vazhdim, deri në vitin 2030.</i> - <i>Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit prej 14% për burimet e rinovueshme në transport</i> o <i>Arritja deri në vitin 2030 e objektivit të masës prej 13,4% për biokarburantet e lëngshme me origjinë bujqësore në transportin rrugor, lëndët djegëse të lëngshme nga lëndët e para të shtojcës IX, pjesa B dhe biokarburantet e lëngshme të avancuara nga lëndët e para të shtojcës IX, pjesa A në transportin rrugor, me kontribut në BRE-T: në sasinë 98,4 ktoe deri në vitin 2030</i> o <i>Transporti publik elektrik do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,014% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura</i> o <i>Automjetet rrugore elektrike (automjetet për transportin e udhëtarëve, kamionët) do të kontribuojnë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,49% dhe 1,2 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura</i> o <i>Hidrogjeni në transportin hekurudhor do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,005% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura</i> o <i>Hidrogjeni (për urbanët dhe autobusët ndërqytetas) do të kontribuojë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,005% dhe 0,1 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura</i> o <i>Automjetet rrugore që punojnë me hidrogjen (automjetet për transportin e udhëtarëve dhe kamionët) do të kontribuojnë në arritjen e objektivit të BRE-T Arritja deri në vitin 2030 e pikësnyimit të masës prej 0,12% dhe 1,2 ktoe për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura</i> - <i>Asnjë "tarifë regjistrimi fillestar" për automjetet e reja</i> - <i>Asnjë taksë automjeti për 5 vitet e para</i> - <i>Përjashtimi nga TVSH (20%) për automjetet elektrike</i> - <i>Përjashtimi nga TVSH vetëm për automjetet e reja me motor elektrik, me qëllim inkurajimin e individëve dhe bizneseve për të blerë automjete të tilla</i> - <i>Asnjë taksë rrugore</i> - <i>Zëvendësimi i autobusëve me autobusë me nivele të ulëta shkarkimi (Bashkia e Tiranës)</i>

7	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë	Energjitë e rinovueshme	R-E2	WEM dhe WAM	- <i>Objektivi është nxitja e rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.</i> - <i>Kjo masë kontribuon gjithashtu në pikësynimin kombëtar për BRE-të deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë.</i> <i>Për WEM:</i> - <i>Ndërtimi i parqeve fotovoltaike të Karavastasë dhe Spitallës deri në 2023 (240 MW energji fotovoltaike në total)</i> - <i>Shtimi i kapacitetit eolik me 150 MW deri në 2024</i> <i>Për WAM:</i> - <i>Shtim i energjisë fotovoltaike me 70 MW në vit nga 2024 deri në 2030 (një total prej 490 MW)</i> - <i>Shtim i kapacitetit eolik me 60 MW nga 2026 deri në 2030 (një total prej 300 MW)</i>
OM2: Jetesa e shëndetshme					
OM2-NoM1: Reduktimi i shkarkimeve të elementeve ndotëse të ajrit					
1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-T1	WAM	- <i>Rritja e efikasitetit ekonomiko-financiar të operatorëve me 30-40% (brenda vitit)</i> - <i>Reduktimi i bllokimit të trafikut si rezultat i reduktimit të numrit të autobusëve që qarkullojnë në rrjetin rrugor kombëtar.</i> - o <i>Reduktimi i nisjeve dhe mbërritjeve të autobusëve me 15-20% (brenda një viti)</i> - o <i>Reduktimi i shkarkimeve të CO2 me 15-20%, me reduktimin e autobusëve në qarkullim</i> - <i>Promovimi i transportit multimodal</i> - <i>Rritja e efikasitetit financiar të operatorëve të rrjetit ndërqytetës.</i> - <i>Rritja e sigurisë së transportit ndërqytetës</i> - <i>Reduktimi i intensitetit të energjisë në sektorin e transportit me 10%, si rezultat i menaxhimit të mirë</i> - <i>Përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së shërbimit në linjat ndërqytetëse</i> - <i>Reduktimi i nevojave për lëvizshmërinë dhe distancave me anë të planifikimit të integruar</i> - <i>Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut</i> - <i>Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme</i> - <i>Mundësia e multimodalitetit dhe intermodalitetit midis modaliteteve të transportit</i> - <i>Krijimi i terminaleve të udhëtarëve</i>
2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave		G-T2	WAM	- <i>Integrimi i transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror në transportin e mallrave (plani afatmesëm 5-8 vite)</i> - <i>Rritja e efikasitetit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i kohës së transitit dhe kostove të transportit përgjatë zinxhirit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i bllokimit të trafikut në rrjetin rrugor kombëtar</i> - <i>Reduktimi i konsumit të energjisë (ton/km)</i> - <i>Reduktimi i shkarkimeve të CO2</i> - <i>Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut</i> - <i>Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme</i> - <i>Rritja e investimeve në sektorin e menaxhimit të transportit të mallrave</i> - <i>Reduktimi i koston të transportit nga origjina deri në destinacionin e mallrave (gjatë zinxhirit të transportit)</i>

3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës		G-T3	WEM	- Reduktimi i importeve të automjeteve të përdorura - Rritja e përdorimit të automjeteve të reja - Rritja e përdorimit të automjeteve elektrike
OM2-NoM2: Reduktimi i mbetjeve					
1	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES- ve	G-W1	WEM	- Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të disponojnë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Deri në vitin 2035, do të riciklohet 40% e totalit të rrymave të mbetjeve dhe do të grumbullohet në nivel bashkiak jo më pak se 70% e mbetjeve të ambalazheve. - Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të kenë mbyllur vendgrumbullimet e papajtueshme. - Deri në vitin 2035, do të grumbullohet dhe trajtohet si duhet 80% e baterive dhe akumulatorëve, 80% e llumrave të ujërave të ndotura dhe 80% e mbetjeve inerte. - Fillimi i përhithjes së CH4 në vitin 2025, ndjekur nga një progres linear, derisa të arrihet një përhithje prej 10% nga 1,34 milionë tonë CH4 në vitin 2030 (vlerësuar me anë të analizës së të dhënave të mjetit GACMO të skenarit të Komunikimit të Tretë Kombëtar dhe NDC-së).
2	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri		G-W2	WEM	- Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e tyre në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet (WtE) do të shkojë nga 6 në vitin 2019 në 12 në vitin 2025. - Të gjitha bashkitë që bëjnë pjesë në diapazonin e shërbimit të impianteve WtE pritet të dërgojnë mbetjet e tyre brenda vitit 2030 (duke mbuluar rreth 58% të popullsisë shqiptare).
OM3: Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera					
OM3-NoM1: Parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu, si dhe kufizimi i pasojave të tyre					
1	Plani i emergjencës për gazin natyror	Siguria energjetike	ES-O5	WEM	- Përcaktimi i standardeve lidhur me kërkesat minimale për sigurinë e furnizimit. - Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përmbyshur standardet e sigurisë së furnizimit; - Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to; - Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Kriteret në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përmbyshjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian; - Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme të krizës.
OM4: MBROJTJA E HABITATEVE NATYRORE DHE LLOJEVE					
OM4-NoM1: Mbrojtja e biodiversitetit					
1	Plani i emergjencës për gazin natyror	Siguria energjetike	ES-O5	WEM	- Përcaktimi i standardeve lidhur me kërkesat minimale për sigurinë e furnizimit. - Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përmbyshur standardet e sigurisë së furnizimit; - Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to; - Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të

					<i>një situatë krize në sektorin e gazit natyror;</i> - Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Krite në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përmbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian; - Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme të krizës.																
2	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës		ES-P1	WEM	- Reduktimi i importit të energjisë elektrike - Mbulimi i 20% të deficitit të energjisë elektrike nga TEC-i i Vlorës																
3	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit		ES-O2	WAM	- Penetrim i gazit natyror (ktoe) në raport me furnizimin nga totali i burimeve primare energjetike: 0,37% në 2020, 5,1% në 2025 dhe 8,5% në 2030, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Energjinë. - Në vitin 2040, konsumi potencial i gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të arrijë rreth 770 milionë m ³ , ndërsa konsumi i parashikuar në rafineritë e vendit mund të jetë rreth 89,2 milionë m ³ . - Nga 376 njësi administrative vendore janë zgjedhur 85 prej tyre që kanë potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes të gazit.																
4	Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve		ES-O4	WEM	- Përafrimi i Direktivës së Këshillit 2009/119/KE, datë 14 shtator 2009, duke u imponuar shteteve anëtare detyrimin e ruajtjes së rezervave minimale të produkteve të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të saj. - Ngritja e një organi për ruajtjen e rezervave, përgatitja e planeve për vënien në dispozicion të rezervave në rast emergjence, përcaktimi i kapacitetit të ruajtjes dhe blerja e rezervave me miratimin e ligjit dhe në bazë të dispozitave të tij. - Ngritja dhe parashikimi me ligj i një sistemi për kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse. - Garantimi i monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse nëpërmjet programeve vjetore të monitorimit.																
5	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë		ES-R1	WEM	- Përgatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor për një treg të hapur e të liberalizuar, si dhe e kodeve teknike dhe normave rregullatore - Përsheptimi i miratimit të Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit - Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara etj.																
6	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica		ES-P2	WEM dhe WAM	- Rritja e pavarësisë energjetike me anë të shtimit të kapacitetit dhe një rezervuari më të madh.																
7	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	Dekarbonizimi/s hkarkimet dhe eliminimi i GES-ve	G-W3	WEM	- Objektivi për mbulimin me trajtim të ujërave të përdorura nga ITUP është si më poshtë: <table><tr><td>Viti</td><td>Përqindja</td></tr><tr><td>2021</td><td>14</td></tr><tr><td>2022</td><td>17</td></tr><tr><td>2023</td><td>20</td></tr><tr><td>2024</td><td>24</td></tr><tr><td>2025</td><td>28</td></tr><tr><td>2026</td><td>32</td></tr><tr><td>2027</td><td>39</td></tr></table> - Në 2024 pritet të miratohet strategjia e menaxhimit të llumrave. - Në 2025 pritet të miratohet ngritja e një laboratorit për analizën e llumrave në Shqipëri.	Viti	Përqindja	2021	14	2022	17	2023	20	2024	24	2025	28	2026	32	2027	39
Viti	Përqindja																				
2021	14																				
2022	17																				
2023	20																				
2024	24																				
2025	28																				
2026	32																				
2027	39																				
8	Përdorimi i impianteve të		G-W2	WEM	- Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e tyre në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet (WtE) do të shkojë																

	incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri				nga 6 në vitin 2019 në 12 në vitin 2025. - Të gjitha bashkitë që bëjnë pjesë në diapazonin e shërbimit të impianteve WtE pritët të dërgojnë mbetjet e tyre brenda vitit 2030 (duke mbuluar rreth 58% të popullsisë shqiptare).
9	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)	Efiçenca e energjisë	EE-T4	WEM	- Shtimi i numrit të autobusëve, shpeshëtësisë, cilësisë dhe aksesit të rrugëve, korsive të dedikuara, sistemeve inteligjente të transportit, infrastrukturës hekurudhore, kryqëzimeve të transitit, rritja e faktorit të ngarkesës, çmime konkurruese në raport me transportin privat, përmirësimi i koordinimit ndërmjet mënyrave të transportit - autobusë, trena, anije. - Intensifikimi i kalimit drejt transportit publik dhe atij aktiv: Arritja e një ndarjeje modale prej 70% për transportin publik dhe atë aktiv për bashkinë e Tiranës. - Reformimi i sistemit hekurudhor duke krijuar një treg të hapur për investitorët publikë dhe privatë, për sa i përket rregullimit të tregut, menaxhimit të infrastrukturës ose shfrytëzimit të hekurudhave. - Modernizimi i infrastrukturës portuale përmes investimeve. - Fuqizimi i Administratës Detare në përputhje me standardet e BE-së. - Rritja e specializimit të funksioneve portuale me qëllim përforcimin e veçorisë së tyre intermodale, veçanërisht për lidhjen port-hekurudhë.
10	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme	Energjia e rinovueshme	R-E4	WEM	- Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FiT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.
OM4-NoM2: Mbrojtja e zonave të ruajtjes së natyrës dhe e vlerave natyrore					
	Plani i emergjencës për gazin natyror	Siguria energjetike	ES-O5	WEM	- Përcaktimi i standardeve lidhur me kërkesat minimale për sigurinë e furnizimit. - Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përmblusur standardet e sigurisë së furnizimit; - Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to; - Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësisë të sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Krite në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përmblusjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian; - Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme të krizës.
	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë		ES-R1	WEM	- Përgatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor për një treg të hapur e të liberalizuar, si dhe e kodeve teknike dhe normave rregullatore - Përsheptimi i miratimit të Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit - Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara etj.
	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së	Energjia e rinovueshme	R-E4	WEM	- Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FiT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.

	rinovueshme				
OM5: QËNDRUESHMËRIA E MJEDISIT SOCIO-EKONOMIK					
OM5-NoM1: Qëndrueshmëria ekonomike					
1	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	Siguria energjetike	ES-P1	WEM	- Reduktimi i importit të energjisë elektrike - Mbulimi i 20% të deficitit të energjisë elektrike nga TEC-i i Vlorës
2	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica		ES-P2	WEM dhe WAM	- Rritja e pavarësisë energjetike me anë të shtimit të kapacitetit dhe një rezervuari më të madh.
3	Kuadri ligjor plotësisht funksional për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët		ES-O1	WAM	- Miratimi i një grupi aktesh nënligjore për zbatimin e kërkesave ligjore dhe teknike të ligjit, me qëllim ngritjen e një kuadri ligjor funksional për furnizimin e sigurt të gazit dhe krijimin e një tregu shumice për gazin natyror - Identifikimi dhe paraqitja e akteve nënligjore.
4	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit		ES-O2	WAM	- Penetrim i gazit natyror (ktoe) në raport me furnizimin nga totali i burimeve primare energjetike: 0,37% në 2020, 5,1% në 2025 dhe 8,5% në 2030, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Energjinë. - Në vitin 2040, konsumi potencial i gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të arrijë rreth 770 milionë m ³ , ndërsa konsumi i parashikuar në rafineritë e vendit mund të jetë rreth 89,2 milionë m ³ . - Nga 376 njësi administrative vendore janë zgjedhur 85 prej tyre që kanë potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes të gazit.
5	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit		ES-O3	WEM	- Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit sipas opsionit më të mirë për zhvillimin e tregut rajonal të gazit dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me gaz.
6	Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve		ES-O4	WEM	- Përafrimi i Direktivës së Këshillit 2009/119/KE, datë 14 shtator 2009, duke u imponuar shteteve anëtare detyrimin e ruajtjes së rezervave minimale të produkteve të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të saj. - Ngritja e një organi për ruajtjen e rezervave, përgatitja e planeve për vënien në dispozicion të rezervave në rast emergjence, përcaktimi i kapacitetit të ruajtjes dhe blerja e rezervave me miratimin e ligjit dhe në bazë të dispozitave të tij. - Ngritja dhe parashikimi me ligj i një sistemi për kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse. - Garantimi i monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse nëpërmjet programeve vjetore të monitorimit.
7	Plani i emergjencës për gazin natyror		ES-O5	WEM	- Përcaktimi i standardeve lidhur me kërkesat minimale për sigurinë e furnizimit. - Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përbushur standardet e sigurisë së furnizimit; - Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to; - Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror; - Krite në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian; - Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme të krizës.
8	Miratimi i ligjit “Për krijimin,		ES-O6	WEM	- Ligji i ri “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve

	mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”				<i>të saj”, i cili transponon Direktivën e Këshillit 2009/119 në legjislacionin shqiptar.</i>
9	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë		ES-R1	WEM	- Përgatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor për një treg të hapur e të liberalizuar, si dhe e kodeve teknike dhe normave rregullatore - Përshpejtimi i miratimit të Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit - Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara etj.
OM5-NoM2: Zhvillimi i një qasjeje për adresimin e problemit të varfërisë energjetike					
1	Eliminimi i varfërisë energjetike		EM-P1		- Përbushja e kërkesës për përcaktimin e konceptit të varfërisë energjetike dhe mbrojtja e konsumatorëve të energjisë.
OM5-NoM3: Ekonomia qarkulluese si një faktor kyç në reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe në krijimin e një industrie konkurruese					
1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë	Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca	RIC-E1	WEM	- Rritja e numrit të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor deri në vitin 2022 (p.sh. me pjesëmarrjen e EERA dhe ETIP) - Rritje me 20% (krahasuar me vitin 2018) e financimit për projektet rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit deri në vitin 2022 - Krijimi i një Komiteti Koordinimi për programet vijuese të H2020, Erasmus dhe Programet BE-së për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe NVM-ve (COSME) (programet Horizon Europe, Erasmus plus, EISMEA) deri në vitin 2022 - Rritje me 20% në projektet fituese të këtyre iniciativave deri në vitin 2027 - Zbatimi i aktiviteteve në lidhje me Shkencën e Hapur: publikim i të gjitha projekteve kërkimore kombëtare të financuara nga fondet publike (akses i lirë në rezultatet e projekteve)
2	Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit		RIC-E2	WEM	- Rritja e përvitshme e shpenzimeve publike për kërkim shkencor që i jepen Institucioneve të Arsimit të Lartë - Objektivi final është që shpenzimet për kërkim shkencor dhe novacion të arrijnë 2% të PBB-së deri në vitin 2022.
3	Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës		RIC-E4	WAM	- Studim fizibiliteti për projektin demonstrues, i disponueshëm brenda vitit 2022 - Projekt demonstrues që përfshin ngritjen e infrastrukturës për inovacion dhe trajnim në qarqe (seminare të përbashkëta, laboratorë testimi, hapësira kreative, etj.) brenda vitit 2025
OM5-NoM4: Zhvillimi i infrastrukturës dhe interkoneksioneve të përshtatshme të rrjetit inteligjent					
1	Ndërlidhësit elektrikë	Tregu i energjisë	EM-I1	WEM	- Zhvillimi i rrjetit për të përballuar rritjen e kërkesës për kapacitetin e transmetimit - Mbështetja e transaksioneve tregtare brenda vendit dhe në rajon, në mënyrë që rrjeti i transmetimit të mos paraqesë pengesa ndaj konkurrencës - Përfundimi brenda afatit i planeve të investimeve, veçanërisht atyre për investime kapitale - Përshpejtimi i integritetit të BRE-ve të larmishme në sistemin e energjisë dhe rritja e disponueshmërisë për të balancuar prodhimin e tyre
2	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme	Energjitë e rinovueshme	R-E4	WEM	- Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FiT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.
3	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.		R-E5	WEM	- Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me kërkesë të një prodhuesi të energjisë nga burime të rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, do të propozojnë si pikë lidhjeje me rrjetin e tyre pikën që përmbush kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme për nga pikëpamja e koston dhe distancës me rrjetin.

4	Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik		R-E6	WAM	- Studime paraprake për të vlerësuar potencialin për menaxhimin e krahut të kërkesës dhe rezervat - Lidhja me skemën e matjes së energjisë neto - Lidhja me instalimin e matësve inteligjentë (strategjia e matjes)
5	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë		R-E7	WEM	- Krijimi i një strategjie matjeje - Instalimi i matësve inteligjentë sipas strategjisë së matjes - Sigurimi i një menaxhimi proaktiv të rrjetit të shpërndarjes me anë të përdorimit të mjeteve të përshtatshme informatike dhe të dhënave të matësve inteligjentë (dixhitalizimi)
OM5-NoM5: Konkurrueshmëria dhe përgjegjshmëria sociale e sektorit të biznesit dhe të kërkimit					
1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë	Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca	RIC-E1	WEM	- Rritja e numrit të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor deri në vitin 2022 (p.sh. me pjesëmarrjen e EERA dhe ETIP) - Rritje me 20% (krahasuar me vitin 2018) e financimit për projektet rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit deri në vitin 2022 - Krijimi i një Komiteti Koordinimi për programet vijuese të H2020, Erasmus dhe Programet BE-së për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe NVM-ve (COSME) (programet Horizon Europe, Erasmus plus, EISMEA) deri në vitin 2022 - Rritje me 20% në projektet fituese të këtyre iniciativave deri në vitin 2027 - Zbatimi i aktiviteteve në lidhje me Shkencën e Hapur: publikim i të gjitha projekteve kërkimore kombëtare të financuara nga fondet publike (akses i lirë në rezultatet e projekteve)
2	Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit		RIC-E2	WEM	- Rritja e përvitshme e shpenzimeve publike për kërkim shkencor që i jepen Institucioneve të Arsimit të Lartë - Objektivi final është që shpenzimet për kërkim shkencor dhe novacion të arrijnë 2% të PBB-së deri në vitin 2022.
3	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS)		RIC-E3	WAM	- Programe specifike trajnimi të disponueshme deri në vitin 2023 - Një pikë e vetme plotësisht funksionale për NVM-të deri në vitin 2023
4	Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës		RIC-E4	WAM	- Studim fizibiliteti për projektin demonstrues, i disponueshëm brenda vitit 2022 - Projekt demonstrues që përfshin ngritjen e infrastrukturës për inovacion dhe trajnim në qarqe (seminare të përbashkëta, laboratorë testimi, hapësira kreative, etj.) brenda vitit 2025
OM5-NoM6: Edukimi lidhur me energjinë dhe klimën					
1	Dokumenti i PKEK-së parashikon një sërë veprimesh/masash në fushën e trajnimit, edukimit, informimit dhe promovimit. Ndikimi i tyre analizohet bashkërisht, ashtu si dhe rezultatet e nxjerra lidhur me to		Sipas PM-ve përkatëse		

4.1. Vlerësimi i ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore

4.1.1. Objektivi mjedisor “Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj tyre” (OM1)

4.1.1.1. Nënobjektivi mjedisor “Rritja e përfitimeve të efikasitetit të energjisë, duke përfshirë ndërtesat me zero shkarkime deri në vitin 2030” (OM1-NoM1)

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM1-NoM1 është kryer në bazë të pritshmërisë se zbatimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së nuk do të ndikojë në efikasitetin e energjisë ose do ta përmirësojë atë duke arritur kështu pikësynimet e përcaktuara në PKEK, SKE dhe NDC për vitin 2030.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthorë	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi ka këtë veçori, ? ndikimi nuk ka këtë veçori

Tabela 13: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM1

1. Përmirësimi i mjaftueshëm i efikasitetit të energjisë përmes prezantimit të masave të përdorimit eficient
2. Përmirësimi i pamjaftueshëm i efikasitetit të energjisë si rezultat i prezantimit të masave të përdorimit eficient
3. Ruajtja ose reduktimi i efikasitetit të energjisë në nivelin ekzistues

4.1.1.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Caktimi i objektivave për kursimet në konsumin fundor të energjisë, që operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë*. Sipas një përlllogaritjeje bruto të bazuar në një vlerë referencë, në vitin 2030 kursimet e parashikuara do të jenë 37 ktoe.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi nga qeveria i një VKM-je për krijimin e një skeme detyruese të efikasitetit të energjisë (deri në fund të 2022), e cila do të caktojë objektiva për kursimet në konsumin final të energjisë, të cilat operatorët e sistemit shpërndarës dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë
- Një metodologji e detajuar për caktimin e skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
- Masa të miratuara për EE-në, të cilat duhet të zbatohen nga përdoruesit fundorë me mbështetjen e operatorëve të sistemit shpërndarës dhe/ose të furnizuesve të tregjeve të energjisë

Të tria masat/veprimet janë masa të buta dhe nga pikëpamja mjedisore kanë një ndikim pozitiv. Tri masat e kësaj PM-je janë në sinergji me njëra-tjetrën (dy të parat përfshijnë aktorët publikë dhe e treta që përfshin gjithashtu konsumatorët fundorë). PM do të ishte më e plotë nëse do të ishte parashikuar/përfshirë pjesa informuese dhe ndërgjegjësuere për konsumatorët fundorë, si dhe

elementet e pjesëmarrjes publike.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria B).

2. Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e niveleve optimale (të realizueshme në aspektin teknik, funksional dhe ekonomik) të konsumit të energjisë në ndërtesa dhe në njësitë e tyre.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Zbatimi i VKM nr.1049, datë 24.12.2020, “Për metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa” me anë të softuerëve të miratuar.
- Zbatimi i VKM nr. 958, datë 02.12.2020, “Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të “certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave”:
 - o Lëshimi i certifikatave të performancës së energjisë së ndërtesave (CPE) për: (i) të gjitha ndërtesat apo njësitë e ndërtesave që do të shiten ose do të lëshohen me qira; (ii) të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen ose do të jenë objekt i një rinovimi të konsiderueshëm; (iii) të gjitha ndërtesat në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucione që ofrojnë shërbime publike dhe që vizitohen shpesh nga publiku, me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 250 m²; (iv) Kur një ndërtesë ose njësi ndërtese shitet apo lëshohet me qira përpara përfundimit të ndërtimit, pronari i saj duhet t’i pajisë këto ndërtesa apo njësi ndërtesash me certifikata të përkohshme të performancës së energjisë që gjatë fazës së projektimit.
 - o Zbatimi i VKM nr. 934, datë 25.11.2020 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa” (sistemi i pavarur i kontrollit)
 - o Ngritja e kapaciteteve për autoritetin kompetent dhe audituesit energjetikë lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe përdorimin e softuerëve për lëshimin e CPE-së

Të gjitha masat/veprimet janë masa të buta (të llojit rregullator ose për ngritjen e kapaciteteve) dhe nga pikëpamja mjedisore kanë një ndikim pozitiv. Masat e parashikuara sjellin fuqizimin e zbatimit të EE-së në ndërtesa, por ka mungesë të përfshirjes së qytetarëve si zbatues dhe nxitës të këtyre masave, që duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e procesit në tërësi.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

3. Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Strategjia afatgjatë e rinovimit do të jetë dokumenti kryesor politik për rinovimin e stokut të ndërtesave private dhe publike:*

- *arritja e pikësnyimit të përcaktuar në masën 3% të stokut të ndërtesave të pushtetit qendror që do të rinovohen çdo vit*
- *arritja e pikësnyimit të përcaktuar në masën 2% të stokut të ndërtesave publike që do të rinovohen çdo vit*

- *pas datës 31.12.2028, përmbushja e kërkesave të nZEB nga të gjitha ndërtesat e reja.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Një plan veprimi afatgjatë (LTRS) për mobilizimin e investimeve për rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale, publike dhe tregtare, si publike ashtu dhe private, i cili duhet të përfshijë: (i) një përmbledhje të stokut kombëtar të ndërtesave bazuar, sipas rastit, në kampionimin statistikor; (ii) identifikimin e qasjeve me kosto efektive ndaj rinovimeve, sipas llojit të ndërtesës dhe zonës klimatike; (iii) politikat dhe masat për nxitjen e rinovimeve me kosto efektive të ndërtesave; (iv) një perspektivë avangardë për të orientuar vendimet e investimit të individëve, industrisë së ndërtimit dhe institucioneve financiare; dhe (v) një vlerësim të bazuar në prova të kursimeve të parashikuara të energjisë dhe përfitimeve në shkallë më të gjerë.
- Një legjislacion dytësor që përcakton: (i) një metodologji specifike që do të përdoret për caktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e normës përkatëse për ndërtesat publike; dhe (ii) sipërfaqen totale të ndërtesave publike
- Vlerësimi i stokut kombëtar të ndërtesave
- Vlerësimi i kërkesës për energji për stokun e ndërtesave bazuar në kërkesat minimale energjetike
- Përcaktimi dhe sigurimi i mekanizmave financiare për investimet në kuadër të EE-së për rinovimin e stokut të ndërtesave
- Përcaktimi i objektivave për sektorin e ndërtimit sipas tipologjisë
- Përcaktimi i afateve
- Përcaktimi i treguesve të matshëm të progresit

Të gjitha masat/veprimet janë masa të buta (të llojit rregullator ose për ndërtimin e kapaciteteve) dhe nga pikëpamja mjedisore kanë një ndikim pozitiv. Masat e parashikuara sjellin fuqizimin e zbatimit të EE-së në ndërtesa, por ka mungesë të përfshirjes së qytetarëve si zbatues dhe nxitës të këtyre masave, që duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e procesit në tërësi.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4. Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - o Buxheti i shtetit
 - o Zbatimi i skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
 - o Institucionet financiare/donatorët ndërkombëtarë

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

5. Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - Buxheti i shtetit: Çdo vit, shteti i alokon qeverisë vendore një buxhet të caktuar për përmbushjen e objektivave të saj. Krahas kësaj, duke mbledhur një lloj të ndryshëm taksash, qeveria vendore përcakton objektivat dhe qëllimet dhe e shpërndan/investon një pjesë të buxhetit të saj total për investime lidhur me efikasitetin e energjisë në rinovimin e ndërtesave.
 - Kontributi i sektorit privat në atë publik
 - Zbatimi i skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
 - Kombinimi i investimeve në EE dhe BRE për ndërtesat që përfitojnë nga fondet “e gjelbra” lidhur me reduktimin e konsumit të energjisë dhe GES-ve
 - Linjat e kreditit dhe grantet për ndërtesat rezidenciale
 - Zbritjet fiskale/tatimore, reduktimi i TVSH-së; taksa e karbonit dhe krijimi i një fondi të dedikuar për financimin e investimeve në EE dhe promovimi i këtyre të fundit
 - Institucionet financiare/donatorët ndërkombëtarë
 - Subvencionet publike - ato përbëjnë vetëm një pjesë të përgjigjes ndaj nevojave të zhvilluesve të projekteve, të cilat variojnë nga asistencë teknike e deri te strukturimi financiar i projektit

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

6. Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa (sektori privat)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Kombinimi i financimeve, incentivave fiskale, ESCO-ve dhe skemave detyruese me një kuadër rregullator me qëllim mundësinë e ofrimit të alternativave për financimin e investimeve në kursimin e energjisë për stokun e ndërtesave.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa skema financiare:
 - Buxheti i shtetit: Çdo vit, shteti i alokon qeverisë vendore një buxhet të caktuar për përmbushjen e objektivave të saj. Krahas kësaj, duke mbledhur një lloj të ndryshëm taksash, qeveria vendore përcakton objektivat dhe qëllimet dhe e shpërndan/investon një pjesë të buxhetit të saj total për investime lidhur me efikasitetin e energjisë në rinovimin e ndërtesave.
 - Kontributi i sektorit privat në atë publik
 - Zbatimi i skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
 - Investimet private nëpërmjet ESCO-ve
 - Kombinimi i investimeve në EE dhe BRE për ndërtesat që përfitojnë nga fondet “e gjelbra” lidhur me reduktimin e konsumit të energjisë dhe GES-ve
 - Programet e KfW-së dhe skemat e kredive të buta për financimin publik reduktojnë koston e huave të cilat jepen zakonisht nga bankat private.
 - Linjat e kreditit dhe grantet për ndërtesat rezidenciale
 - Zbritjet fiskale/tatimore, reduktimi i TVSH-së; taksa e karbonit dhe krijimi i një fondi të

- dedikuar për financimin e investimeve në EE dhe promovimi i këtyre të fundit
- Institucionet financuese/donatorët ndërkombëtarë
- Subvencionet publike - ato përbëjnë vetëm një pjesë të përgjigjes ndaj nevojave të zhvilluesve të projekteve, të cilat variojnë nga asistenca teknike e deri te strukturimi financiar i projektit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

7. Zbatimi i modeleve të ESCO

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e investimeve në funksion të EE-së në sektorin privat dhe publik përmes mekanizmit ESCO Me anë të një kontrate të performancës së energjisë, ESCO-të marrin përsipër një projekt për realizimin e përmirësimeve të efikasitetit të energjisë në ambientet e klientit dhe përdor fluksin e të ardhurave nga shkurtimet e kostove për mbulimin e kostove të projektit. Për arsye ekonomike, duhet të bëhet i mundur kombinimi i masave për EE-në me ato për BRE-të.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përgatitja e kontratës tip në bazë të urdhrat të ministrit
- Subjekti i kontratës është zbatimi i masave për ruajtjen e energjisë (ECM) me qëllim përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë dhe reduktimin si rrjedhojë të shkarkimeve të CO2 dhe të kostove operacionale në objektin e kontraktuar.
- Kontraktori merr përsipër zbatimin e këtyre ECM-ve, nëpërmjet të cilave ai do të sigurojë shkurtimin e kostove operacionale në objektin e kontraktuar gjatë periudhës së garancisë, në përputhje me këtë kontratë (duke përfshirë shtojcat).
- Të gjitha ECM-të e zbatuara sipas kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me rregulloret e zbatueshme dhe standardet e kërkuara në Republikën e Shqipërisë.
- Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë publikon në faqen e saj të internetit: (i) praktikën më të mirë për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat tip, duke përfshirë dispozitat që do të jenë pjesë e këtyre kontratave për të garantuar kursimin e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë; (ii) listën e ofruesve të kualifikuar/të regjistruar të shërbimeve energjetike; dhe (iii) informacionet mbi të gjitha instrumentet financiare, incentivat, grantet dhe huatë e mundshme për mbështetjen e projekteve në sektorin e shërbimeve të efikasitetit të energjisë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

8. Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shpenzimi në mënyrë më efektive të fondeve publike nga ana e autoriteteve duke përfutur në këtë mënyrë rritjen e performancës energjetike të produkteve dhe shërbimeve, duke promovuar një konsum eficient të energjisë, konkurrues dhe me nivele të ulëta karboni.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i (projekt)ligjit të ndryshuar për efikasitetin e energjisë dhe
- Përgatitja e legjislacionit detyësor

Në hartimin e dokumenteve ligjore në përputhje me masat/veprimet e parashikuara, është e rekomandueshme përfshirja e procesit të trajnimit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria B).

9. Planet bashkiae të veprimit për efikasitetin e energjisë, zbatimi dhe raportimi

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përfshirja e bashkive me anë të përgatitjes së planeve të veta të veprimit lidhur me EE-në, si faktor nxitës, duke monitoruar zbatimin e masave për reduktimin e konsumit të energjisë, reduktimin e shkarkimeve dhe rritjen e cilësisë së jetës.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përfshirja e bashkive në proceset e përgatitjes së PVEE-ve, në përputhje me planin kombëtar të EE-së, marrja përsipër e të gjitha përgjegjësisë për zbatimin e masave për EE-në dhe sigurimi i fondeve të investimeve.
- Angazhimi i bashkive në monitorimin e zbatimit të masave për EE-në, me synim arritjet e objektivave.

Në hartimin e dokumenteve ligjore në përputhje me masat/veprimet e parashikuara, është e rekomandueshme përfshirja e procesit të trajnimit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria B).

10. Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Zbatimi i auditimeve të energjisë për operatorët industrialë, me qëllim vlerësimin e konsumit të energjisë, humbjeve dhe potencialit të EE-së, lëshimin e certifikatave të energjisë dhe detyrimin e industrive për të marrë masa për EE-në dhe për të përmbushur objektivat në lidhje me kursimin e energjisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Identifikimi i bizneseve të industrisë (konsumatorët e energjisë me një konsum vjetor energjie prej më shumë se 1 MWh do t'u nënshtrohen auditimeve të energjisë), krijimi i një baze të dhënash për to me anë të regjistrimit, planet për nisjen e auditimeve të energjisë dhe të gjitha hapat e parashikuara për auditimet e energjisë të përshkruara në ligj dhe VKM.
- Nisja e përgatitjes së planit të veprimit për EE-në nga bizneset e industrisë, bazuar në raportet e auditimit.

Në mënyrë që kjo PM të jetë e suksesshme, ajo duhet të parashikojë masa shtesë lidhur me zbatimin e ligjit (detyrimet e raportimit të inspektoratit dhe industrisë).

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

11. Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Detyrimi i konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, në përputhje me ligjin për EE-në, për caktimin e menaxherëve të energjisë, si dhe promovimi i standardit ISO 50001, do të rezultojnë në një përdorim racional të energjisë, duke shmangur kështu humbjet dhe duke rritur performancën e industrisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Promovimi i ISO 50001 si një standard kombëtar vullnetar për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë (EnMS)
- Zbatimi pilot i auditimit të energjisë për 10 konsumatorët më të mëdhenj të energjisë
- Manual pune për zbatimin e auditimit të energjisë
- Zbatimi pilot i EnMS-së nga NVM-të industriale pilot, në pajtueshmëri me standardin ISO 50001
- Promovimi i politikave të praktikave më të mira për Eficiencën e Energjisë në Industri (IEE) dhe promovimi i teknologjive novatore me efikasitet të lartë energjie specifike për sektorin
- Krijimi i një programi kombëtar për EEI-në me reduktim të kuantifikuar të shkarkimeve
- Ofrimi i trajnimeve cilësore dhe shërbimeve eksperte të konsulencës nga institucionet kombëtare kompetente dhe sektori i shërbimeve të efikasitetit të energjisë
- Hartimi i një mekanizmi novator financimi për EEI-në
- Rritja e njohurive të institucioneve financuese vendase lidhur me praktika të ndryshme të EEI-së dhe rritja e kapaciteteve për të vlerësuar propozimet për investime në EEI dhe përfitimet nga programet e kreditimit të institucioneve financuese ndërkombëtare.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

12. Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit për etiketat e energjisë dhe/ose eko-dizajnit për produktet: Vendosja mbi produktet e fabrikuara e etiketave informuese ku tregohet performanca energjetike, e cila u siguron konsumatorëve informacionin e nevojshëm për marrjen e vendimeve të informuara të blerjes në pikën e shitjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Transpozimi dhe miratimi i etiketave të energjisë dhe/ose eko-dizajnit për produktet
- Përshtatja (dhe përditësimi) i legjislacionit mbi produktet individuale, për shembull për të siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin evropian dhe ndryshimet e tij, për prezantimin e etiketave të energjisë për kategoritë e reja të produkteve ose për të pasqyruar zhvillimet e tregut
- Kontrolli i dokumentacionit teknik të produkteve të rregulluara
- Testimi i produkteve për sa i përket pajtueshmërisë me rregulloret
- Monitorimi i përdorimit të etiketave të energjisë nëpër pikat e shitjes
- Rritja e kapaciteteve teknike të personelit të dedikuar për mbikëqyrjen e tregut lidhur me legjislacionin për etiketat e energjisë dhe eko-dizajnin
- Përgatitja e udhëzimeve lidhur me kërkesat për profesionistët ose e udhëzuesve për konsumatorët, mbështetja në përgatitjen e udhëzuesve dhe procedurave të brendshme
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet informimit lidhur me çështjet shqetësuese nga qeveria, bashkitë dhe shoqëria civile
- Nxjerrja e njoftimeve në format të shtypur, video apo audio për fushatat e konsumatorëve, duke përfshirë monitorimin e aktiviteteve lidhur me faqet e internetit të fushatave dhe rrjetet sociale

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi lidhur me masat që duhen marrë, por në planin afat-mesëm, ajo duhet të ketë si pikësynim procesin e auditimit dhe certifikimit të etiketimit të energjisë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM1 (kategoria A).

13. Etiketimi i energjisë për makinat e reja

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Ngritja e një kuadri rregullator që siguron informacione transparente në lidhje me efikasitetin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ të automjeteve të reja të transportit të udhëtarëve në shitje ose për qira.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Transpozimi dhe miratimi i Direktivës 1999/94/BE, Direktivës 2003/73/BE, Rekomandimit të Komisionit 2003/217/KE dhe Rekomandimit të Komisionit (BE) 2017/948.
- Ofrimi i asistencës teknike për transpozimin e direktivave dhe rekomandimeve të sipërpërmendura.
- Ofrimi i trajnimit për autoritetet kompetente dhe grupet e interesit mbi zbatimin e kërkesave të garantimit të disponueshmërisë së informacionit për konsumatorin lidhur me efikasitetin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi për sa u përket masave që duhen marrë, por ajo duhet të përcaktojë dhe të jetë pjesë e pikësynimit numerik (sasior) në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria B).

14. Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të lëndëve djegëse alternative/të pastra dhe automjeteve me efikasitet energjie si mënyra për gjenerimin e ndikimeve më të konsiderueshme, me anë të reduktimit të konsumit të energjisë dhe, kryesisht, me anë të reduktimit të shkarkimeve të GES-ve përmes skemave mbështetëse të automjeteve efikente dhe atyre ekologjike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Kuadri ligjor për caktimin e qëllimeve, objektivave, detyrimeve, afateve, grupeve të interesit etj.
 - o Caktimi në bazë të kuadrit ligjor i objektivave të BRE-së për biokarburantet dhe hidrogjenin që do të përdoren në sektorin e transportit, si dhe përfshirja e dispozitës për elektricitetin që përdoret posaçërisht në transport.
 - o Caktimi në bazë të kuadrit ligjor i detyrimit të prodhuesve/importuesve/shitësve me pakicë në lidhje me sasinë dhe cilësinë (certifikimin) e BRE-ve specifike për tregun e transportit, si dhe i detyrimit të importuesve/shitësve me pakicë dhe përdoruesve të automjeteve në lidhje me efikasitetin e energjisë.
 - o Përditësimi i planit të veprimit në lidhje me EE-në në sektorin e transportit, i cili përcakton objektivat, duke përfshirë mënyrat e zhvillimit të tregut të EE-së dhe automjeteve me lëndë djegëse të pastra.
 - o Adresimi i prokurimit ekologjik për sektorin publik, në favor të shtimit të flotës së automjeteve me lëndë djegëse të pastra, krahas kritereve të efikasitetit të energjisë

- (përcaktuar nga ligji i ndryshuar për EE-në), me synim rritjen e numrit të automjeteve ekologjike në raport me ato që përdorin lëndë djegëse konvencionale.
- Ndhimat/incentivat financiare për prodhuesit e automjeteve, shitësit me pakicë dhe konsumatorët
 - Grantet dhe kreditë e buta për blerjen e automjeteve ekologjike
 - Zbritje tregtare (rabate)/subvencionime të çmimit të blerjes së automjeteve: përfitim financiar që merret me blerjen e një automjeti të kualifikueshëm
 - Sistemi i tarifimit dhe zbritjeve tregtare (feebate): një masë financiare sipas së cilës automjetet e kualifikueshme janë objekt i zbritjes tregtare mbi çmimin e blerjes, ndërsa lloje të tjera automjesh me nivele të larta të shkarkimit të CO₂ janë objekt i tarifimeve ose mbitarifimeve
 - Skema e incentivave për zëvendësimin e automjeteve: një masë e cila nxit zëvendësimin e automjeteve të vjetra me modele më të reja, më efikente dhe me nivele më të ulëta ndotjeje
 - Tarifat, penalitetet ose ndalimet për automjetet me nivelet më të larta të ndotjes
 - Reduktimi i taksave vjetore për automjetet ose përjashtimi nga to (për disa vite)
 - Reduktimi i taksave të lëndës djegëse të motorëve ose përjashtimi nga to
 - Reduktimi i taksave të rrugës
 - Reduktimi ose heqja e tarifës së parkimit
 - Përjashtime tatimore dhe zbritje për automjetet e importit, taksën e blerjes ose të regjistrimit
 - Një incentivë e planifikuar që varion nga 5% deri në 10% të kostos së blerjes për makinat e reja elektrike; mirëmbajtje dhe shërbime ndihmëse pa pagesë për pronarët e makinave elektrike; ofrim i incentivave dhe zbritjeve edhe për pronarët e makinave hibride.
 - Parkim pa pagesë në të gjitha hapësirat e parkimit publik.
 - Masat teknike
 - Pasurim i flotës së taksive me modele hibride apo elektrike

Kjo PM ka natyrë ekologjike, por arritja e saj kërkon investime në infrastrukturë, për të mbështetur dhe nxitur konsumatorët në këtë drejtim.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM1 (kategoria B).

4.1.1.2. Nënobjektivi mjedisor "Reduktim i konsumit final të energjisë" (OM1-NoM2)

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM1-NoM2 është kryer në bazë të pritshmërisë që zbatimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së do të garantojë reduktimin e konsumit final të energjisë me 8,4% në vitin 2030.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthortë	I largët	Afatshkurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi ka këtë veçori, ?? ndikimi nuk ka këtë veçori

Tabela 14: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM2

1. *Reduktimi i konsumit final të energjisë për shkak të prezantimit të masave të përdorimit eficient*
2. *Mbajtja e konsumit final të energjisë në nivelin ekzistues përmes prezantimit të masave të përdorimit eficient*
3. *Rritja e konsumit final të energjisë përmes masave të përdorimit eficient*

4.1.1.2.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je:

- (i) *përmirësimi i infrastrukturës së terminaleve të udhëtarëve;*
- (ii) *rritja e efikasitetit të rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë; dhe*
- (iii) *reduktimi i shkarkimeve të CO₂ të shkaktuara nga rrjeti i autobusëve ekstra-urbanë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Eliminimi i mbivendosjeve të linjave në itineraret e tyre
- Përdorimi i teknologjive të reja si “Sistemet e Transportit Inteligjent” dhe “Logjistika Inteligjente” për të ndihmuar në menaxhimin efikas të sistemeve të transportit
- Përmirësimi i cilësisë së rrugëve
- Përdorimi i automjeteve me efikasitet energjie, duke reduktuar nevojat për lëvizshmërinë dhe distancat me anë të planifikimit të integruar
- Promovimi i transportit publik të udhëtarëve
- Rritja e aksesit në përdorimin e biçikletave
- Fushatat e ndërgjegjësimit publik
- Taksa e karbonit
- Taksa e rrugës
- Caktimi i taksave të qarkullimit dhe kufizimi i përdorimit të automjeteve (përdorimi i tyre në ditë të caktuara të javës, p.sh. sipas targës së makinës)
- Përmirësimi i koeficientit të ngarkesës së automjetit në transportin e mallrave
- Përgatitja e një plani optimal parkimi dhe caktimi i tarifave optimale të parkimit, veçanërisht në nyjat kryesore të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave
- Reduktimi i përdorimit të burimeve të energjisë

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi lidhur me masat që duhen marrë dhe natyrën e saj ekologjike. Megjithatë, për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

2. Elektrifikimi i sektorit të transportit

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Intensifikimi i elektrifikimit në sektorin e transportit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Caktimi i objektivave ligjore ndaj operatorëve ekonomikë, duke përfshirë zbatimin e tyre. Një tjetër është certifikimi i cili garanton pajtueshmërinë e operatorëve ekonomikë me kërkesat e qëndrueshmërisë.

- Përcaktimi i elementeve të tjera kyçe të politikave, me qëllim arritjen e objektivit të vitit 2030 për BRE-T:
 - (i) strategji dhe mekanizma mbështetjeje për energjinë elektrike në sektorin e transportit
 - (ii) përcaktimi i detyrimeve të subjekteve të caktuara, siç janë parkimet publike ose garazhet publike, për të qenë të pajisur me stacione për karikimin e automjeteve elektrike;
 - (iii) incentiva ose procedura të thjeshtuara për ndërtimin/licencimin e stacioneve të karikimit me energji elektrike për automjetet rrugore ose për ndërtimin/licencimin e stacioneve të rimbushjes me lëndë djegëse hidrogjen;
 - (iv) përjashtim i plotë nga TVSH për automjetet e reja me motor elektrik me zero km, të paregjistruara më parë në ndonjë vend tjetër;
 - (v) reduktimi i importeve të lëndës djegëse fosile, krijimi i vendeve të punës, etj.
 - (vi) rishikimi i politikave dhe, sipas mundësive, përshtatja e tyre rreth vitit 2025, bazuar në një vlerësim të politikave dhe rezultateve.

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi lidhur me masat që duhen marrë dhe natyrën e saj ekologjike. Megjithatë, për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Po ashtu, masat/veprimet e detajuara imtësisht do të jenë më të vlefshme nëse plotësohen edhe nga aspektet e pjesëmarrjes publike, konkretisht të bizneseve private (tregtarët) dhe qytetarëve, si dhe nëse shoqërohen nga një fushatë promovionale.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM2 (kategoria B).

3. Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme që përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përcaktimi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për tregtim në sektorin e transportit
- Promovimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, me anë të zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë
- Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Marrja e masave nga çdo shoqëri që zotëron një licencë për “Tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, përshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, me kodin VIII.1.A” për tregtinë me shumicë, për të garantuar vendosjen në treg të sasisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Këto sasi duhet të përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë.
- Përcaktimi i kërkesave lidhur me verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve
- Detyrimi i përzierjes
- Caktimi i tarifave për certifikatat dhe lejet e nevojshme
- Kryerja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës
- Vendosja e gjobave për shitësit me pakicë të lëndëve djegëse, nëse nuk parashikohet që biokarburantet e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, si dhe nafta ose hidrokarburet, të përzihen me bionaftë dhe bioetanol në masën 5%
- Penalitete për furnitorët e lëndëve djegëse që nuk përmbushin detyrimet e tyre

- Përcaktimi i masave mbështetëse në dispozicion të blerësve të automjeteve me lëndë djegëse alternative, si dhe i dispozitave në lidhje me përshtatshmërinë e automjeteve me llojet e ndryshme të lëndëve djegëse alternative

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi lidhur me masat që duhen marrë dhe natyrën e saj ekologjike. Megjithatë, për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Masat/veprimet në formatin e paraqitur nuk bëjnë një ndarje të qartë të nënsektorit specifik të pikësnyuar të cilit i adresohen (transportit publik me autobus, ose nënsektorëve të tjerë)

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM2 (kategoria B).

4. Skema detyruese e efijencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Caktimi i objektivave për kursimet në konsumin fundor të energjisë, që operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë.* Sipas një përlllogaritjeje bruto të bazuar në një vlerë referencë, në vitin 2030 kursimet e parashikuara do të jenë 37 ktoe.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi nga qeveria i një VKM-je për krijimin e një skeme detyruese të efijencës së energjisë (deri në fund të 2022), e cila do të caktojë objektiva për kursimet në konsumin final të energjisë, të cilat operatorët e sistemit shpërndarës dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë
- Një metodologji e detajuar për caktimin e skemave detyruese të efijencës së energjisë
- Masa të miratuara për EE-në, të cilat duhet të zbatohen nga përdoruesit fundorë me mbështetjen e operatorëve të sistemit shpërndarës dhe/ose të furnizuesve të tregjeve të energjisë

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

5. Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e niveleve optimale (të realizueshme në aspektin teknik, funksional dhe ekonomik) të konsumit të energjisë në ndërtesa dhe në njësitë e tyre.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Zbatimi i VKM nr.1049, datë 24.12.2020, "Për metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa" me anë të softuerëve të miratuar.
- Zbatimi i VKM nr. 958, datë 02.12.2020, "Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të "certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave":

- Lëshimi i certifikatave të performancës së energjisë së ndërtesave (CPE) për: (i) të gjitha ndërtesat apo njësitë e ndërtesave që do të shiten ose do të lëshohen me qira; (ii) të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen ose do të jenë objekt i një rinovimi të konsiderueshëm; (iii) të gjitha ndërtesat në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucione që ofrojnë shërbime publike dhe që vizitohen shpesh nga publiku, me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 250 m²; (iv) Kur një ndërtesë ose njësi ndërtese shitet apo lëshohet me qira përpara përfundimit të ndërtimit, pronari i saj duhet t'i pajisë këto ndërtesa apo njësi ndërtesash me certifikata të përkohshme të performancës së energjisë që gjatë fazës së projektimit.
- Zbatimi i VKM nr. 934, datë 25.11.2020 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa” (sistemi i pavarur i kontrollit)
- Ngritja e kapaciteteve për autoritetin kompetent dhe audituesit energjetikë lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe përdorimin e softuerëve për lëshimin e CPE-së

Kjo PM është shqyrtuar me hollësi lidhur me masat që duhen marrë dhe natyrën e saj ekologjike. Megjithatë, për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Për më tepër, do të ishte e dobishme që këto masa të shoqëroheshin me mekanizma për reduktimin e taksave (p.sh. për ndërtesat e pajisura me certifikata që vërtetojnë natyrën ekologjike të tyre).

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM2 (kategoria B).

6. Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Strategjia afatgjatë e rinovimit do të jetë dokumenti kryesor politik për rinovimin e stokut të ndërtesave private dhe publike:*

- *arritja e pikësnyimit të përcaktuar në masën 3% të stokut të ndërtesave të pushtetit qendror që do të rinovohen çdo vit*
- *arritja e pikësnyimit të përcaktuar në masën 2% të stokut të ndërtesave publike që do të rinovohen çdo vit*
- *pas datës 31.12.2028, përmbushja e kërkesave të nZEB nga të gjitha ndërtesat e reja.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Një plan veprimi afatgjatë (LTRS) për mobilizimin e investimeve për rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale, publike dhe tregtare, si publike ashtu dhe private, i cili duhet të përfshijë: (i) një përmbledhje të stokut kombëtar të ndërtesave bazuar, sipas rastit, në kampionimin statistikor; (ii) identifikimin e qasjeve me kosto efektive ndaj rinovimeve, sipas llojit të ndërtesës dhe zonës klimatike; (iii) politikat dhe masat për nxitjen e rinovimeve me kosto efektive të ndërtesave; (iv) një perspektivë avangardë për të orientuar vendimet e investimit të individëve, industrisë së ndërtimit dhe institucioneve financiare; dhe (v) një vlerësim të bazuar në prova të kursimeve të parashikuara të energjisë dhe përfitimeve në shkallë më të gjerë.
- Një legjislacion dytësor që përcakton: (i) një metodologji specifike që do të përdoret për caktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e normës përkatëse për ndërtesat publike; dhe (ii) sipërfaqen totale të ndërtesave publike
- Vlerësimi i stokut kombëtar të ndërtesave

- Vlerësimi i kërkesës për energji për stokun e ndërtesave bazuar në kërkesat minimale energjetike
- Përcaktimi dhe sigurimi i mekanizmave financiarë për investimet në kuadër të EE-së për rinovimin e stokut të ndërtesave
- Përcaktimi i objektivave për sektorin e ndërtimit sipas tipologjisë
- Përcaktimi i afateve
- Përcaktimi i treguesve të matshëm të progresit

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Për më tepër, do të ishte e dobishme që këto masa të shoqëroheshin me mekanizma për reduktimin e taksave (p.sh. për ndërtesat e pajisura me certifikata që vërtetojnë natyrën ekologjike të tyre).

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të pakonsiderueshëm mbi OM1-NoM2 (kategoria B).

7. Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - o Buxheti i shtetit
 - o Zbatimi i skemave detyruese të efijencës së energjisë
 - o Institucionet financuese/donatorët ndërkombëtarë

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

8. Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - o Buxheti i shtetit: Çdo vit, shteti i alokon qeverisë vendore një buxhet të caktuar për përmbushjen e objektivave të saj. Krahas kësaj, duke mbledhur një lloj të ndryshëm taksash, qeveria vendore përcakton objektivat dhe qëllimet dhe e shpërndan/investon një pjesë të buxhetit të saj total për investime lidhur me efijencën e energjisë në rinovimin e ndërtesave.

- Kontributi i sektorit privat në atë publik
- Zbatimi i skemave detyruese të efijencës së energjisë
- Kombinimi i investimeve në EE dhe BRE për ndërtesat që përfitojnë nga fondet “e gjelbra” lidhur me reduktimin e konsumit të energjisë dhe GES-ve
- Linjat e kreditit dhe grantet për ndërtesat rezidenciale
- Zbritjet fiskale/tatimore, reduktimi i TVSH-së; taksa e karbonit dhe krijimi i një fondi të dedikuar për financimin e investimeve në EE dhe promovimi i këtyre të fundit
- Institucionet financuese/donatorët ndërkombëtarë
- Subvencionet publike - ato përbëjnë vetëm një pjesë të përgjigjes ndaj nevojave të zhvilluesve të projekteve, të cilat variojnë nga asistenca teknike e deri te strukturimi financiar i projektit

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

9. Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa (sektori privat)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Kombinimi i financimeve, incentivave fiskale, ESCO-ve dhe skemave detyruese me një kuadër rregullator me qëllim mundësinë e ofrimit të alternativave për financimin e investimeve në kursimin e energjisë për stokun e ndërtesave.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa skema financiare:
 - Buxheti i shtetit: Çdo vit, shteti i alokon qeverisë vendore një buxhet të caktuar për përmbushjen e objektivave të saj. Krahas kësaj, duke mbledhur një lloj të ndryshëm taksash, qeveria vendore përcakton objektivat dhe qëllimet dhe e shpërndan/investon një pjesë të buxhetit të saj total për investime lidhur me efijencën e energjisë në rinovimin e ndërtesave.
 - Kontributi i sektorit privat në atë publik
 - Zbatimi i skemave detyruese të efijencës së energjisë
 - Investimet private nëpërmjet ESCO-ve
 - Kombinimi i investimeve në EE dhe BRE për ndërtesat që përfitojnë nga fondet “e gjelbra” lidhur me reduktimin e konsumit të energjisë dhe GES-ve
 - Programet e KfW-së dhe skemat e kredive të buta për financimin publik reduktojnë koston e huave të cilat jepen zakonisht nga bankat private.
 - Linjat e kreditit dhe grantet për ndërtesat rezidenciale
 - Zbritjet fiskale/tatimore, reduktimi i TVSH-së; taksa e karbonit dhe krijimi i një fondi të dedikuar për financimin e investimeve në EE dhe promovimi i këtyre të fundit
 - Institucionet financuese/donatorët ndërkombëtarë
 - Subvencionet publike - ato përbëjnë vetëm një pjesë të përgjigjes ndaj nevojave të zhvilluesve të projekteve, të cilat variojnë nga asistenca teknike e deri te strukturimi financiar i projektit.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të

ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

10. Zbatimi i modeleve të ESCO

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e investimeve në funksion të EE-së në sektorin privat dhe publik përmes mekanizmit ESCO Me anë të një kontrate të performancës së energjisë, ESCO-të marrin përsipër një projekt për realizimin e përmirësimeve të efikasitetit të energjisë në ambientet e klientit dhe përdor fluksin e të ardhurave nga shkurtimet e kostove për mbulimin e kostove të projektit. Për arsye ekonomike, duhet të bëhet i mundur kombinimi i masave për EE-në me ato për BRE-të.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përgatitja e kontratës tip në bazë të urdhrit të ministrit
- Subjekti i kontratës është zbatimi i masave për ruajtjen e energjisë (ECM) me qëllim përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë dhe, për rrjedhojë, reduktimin e shkarkimeve të CO2 dhe të kostove operacionale në objektin e kontraktuar.
- Kontraktori merr përsipër zbatimin e këtyre ECM-ve, nëpërmjet të cilave ai do të sigurojë shkurtimin e kostove operacionale në objektin e kontraktuar gjatë periudhës së garancisë, në përputhje me këtë kontratë (duke përfshirë shtojcat).
- Të gjitha ECM-të e zbatuara sipas kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me rregulloret e zbatueshme dhe standardet e kërkuara në Republikën e Shqipërisë.
- Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë publikon në faqen e saj të internetit: (i) praktikat më të mira për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat tip, duke përfshirë dispozitat që do të jenë pjesë e këtyre kontratave për të garantuar kursimin e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë; (ii) listën e ofruesve të kualifikuar/të regjistruar të shërbimeve energjetike; dhe (iii) informacionet mbi të gjitha instrumentet financiare, incentivat, grantet dhe huatë e mundshme për mbështetjen e projekteve në sektorin e shërbimeve të efikasitetit të energjisë.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

11. Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shpenzimi në mënyrë më efektive të fondeve publike nga ana e autoriteteve duke përfutur në këtë mënyrë rritjen e performancës energjetike të produkteve dhe shërbimeve, duke promovuar një konsum eficient të energjisë, konkurrues dhe me nivele të ulëta karboni.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i (projekt)ligjit të ndryshuar për efikasitetin e energjisë dhe

- Përgatitja e legjislacionit dytësor

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

12. Planet bashkiake të veprimit për efikasitetin e energjisë, zbatimi dhe raportimi

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përfshirja e bashkive me anë të përgatitjes së planeve të veta të veprimit lidhur me EE-në, si faktor nxitës, duke monitoruar zbatimin e masave për reduktimin e konsumit të energjisë, reduktimin e shkarkimeve dhe rritjen e cilësisë së jetës.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përfshirja e bashkive në proceset e përgatitjes së PVEE-ve, në përputhje me planin kombëtar të EE-së, marrja përsipër e të gjitha përgjegjësisë për zbatimin e masave për EE-në dhe sigurimi i fondeve të investimeve.
- Angazhimi i bashkive në monitorimin e zbatimit të masave për EE-në, me synim arritjet e objektivave.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Në vijim, që në fillim të hartimit të këtyre planeve, duhet të merret parasysh se pikësnyimet duhet të përkojnë me burimet vendore (klime, ekonomia, profili etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

13. Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Zbatimi i auditimeve të energjisë për operatorët industrialë, me qëllim vlerësimin e konsumit të energjisë, humbjeve dhe potencialit të EE-së, lëshimin e certifikatave të energjisë dhe detyrimin e industrive për të marrë masa për EE-në dhe për të përmbushur objektivat në lidhje me kursimin e energjisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Identifikimi i bizneseve të industrisë (konsumatorët e energjisë me një konsum vjetor energjie prej më shumë se 1 MWh do t'u nënshtrohen auditimeve të energjisë), krijimi i një baze të dhënash për to me anë të regjistrimit, planet për nisjen e auditimeve të energjisë dhe të gjitha hapat e parashikuara për auditimet e energjisë të përshkruara në ligj dhe VKM.
- Nisja e përgatitjes së planit të veprimit për EE-në nga bizneset e industrisë, bazuar në raportet e auditimit.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Në mënyrë që kjo PM të jetë e suksesshme, ajo duhet të parashikojë masa shtesë lidhur me zbatimin e ligjit (detyrimet e raportimit të inspektoratit dhe industrisë).

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM2 (kategoria A).

4.1.1.3. Nënobjektivi mjedisor "Shfrytëzimi më intensiv i energjisë nga burime të rinovueshme dhe i energjisë elektrike për të dekarbonizuar plotësisht furnizimin me energji deri në vitin 2030" OM1-NoM3

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM1-NoM3 është kryer në bazë të pritshmërisë që, si rezultat i zbatimit të politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së, Shqipëria do të arrijë një përdorim të BRE-ve prej mbi 45% në konsumin final të energjisë deri në vitin 2030, ose do ta tejkalojë këtë përqindje.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afats hkurter	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi ka këtë veçori, ? ndikimi nuk ka këtë veçori

Tabela 15: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM3

1. Rritje intensive e përqindjes së shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në përdorimin e energjisë finale bruto
2. Rritje e moderuar e përqindjes së shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në përdorimin e energjisë finale bruto
3. Ruajtja e përqindjes së shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në përdorimin e energjisë finale bruto

4.1.1.3.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e përdorimit në shkallë të gjerë të energjive të rinovueshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Skemat e incentivave financiare
- Skemat rregullatore
- Udhëzime ose skema me bazë edukative

Që në ndërmarrjen e nismës së strategjisë kombëtare për BRE-të dhe skemat financiare, do të kishte qenë më e mundshme përfshirja e hartimit të një masterplani kombëtar, i cili do të përcaktonte fushat parësore për zbatimin e kësaj mase. Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit; megjithatë do të jetë më mirë nga ana sasiore që përqindja e kësaj PM-je të matet përmes përgatitjes dhe zbatimit të masterplanit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

2. Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla të rinovueshme

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shtimi i kapacitetit të energjisë së rinovueshme përmes një skeme mbështetjeje (FiT) për kapacitetet e vogla të energjisë së rinovueshme.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Të gjitha kapacitetet e energjisë së rinovueshme nën 2 MW (ose 3 MW për energjinë eolike) dhe projektet demonstruese dhe ato pilot mund të përfitojnë nga tarifa FiT.
- Tarifat llogariten nga ERE në mënyrë që të garantohet një normë e mjaftueshme e kthimit të investimit për të gjithë operatorët e energjisë së rinovueshme.
- Enti Rregullator i Energjisë miraton çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, sipas çmimit mesatar për vitin 2017, në përputhje me parashikimet e metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 369.
- Duke nisur nga viti 2019, çmimi i ERE i përfshirë në strategji është 100 €/MWh për energjinë e prodhuar nga dielli dhe 76 €/MWh për atë të prodhuar nga era.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Gjatë procesit të miratimit, duhet të bëhet kujdes që të mos cenohet përdorimi i tokës dhe peizazhi (cenimi i tokave bujqësore dhe ekosistemeve me vlerë natyrore).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM3 (kategoria B).

3. Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shtimi i kapacitetit të energjisë së rinovueshme (diellore dhe fotovoltaike) përmes organizimit të ankandëve dhe propozimit të skemave të mbështetjes të kontratave për diferencë (CfD).*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Ankandet do të zhvillohen me anë të një procedure konkurruese (bazuar në treg).
- Ofertuesit të zgjedhur nga ankandet do t'i akordohet një kontratë CfD. Me anë të kësaj kontrate CfD, ofertuesi do të marrë një prim progresiv (shuma e energjisë elektrike të shitur në treg dhe primi do të mbeten në vlera konstante).
- Pagesa e primit progresiv për ofertuesit e zgjedhur do të paguhet nga një subjekt i veçantë, i quajtur Operatori i Energjisë së Rinovueshme. Financimi i këtij subjekti do të bëhet me anë të tarifimit të të gjithë furnizuesve të energjisë elektrike.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Gjatë procesit të miratimit, duhet të bëhet kujdes që të mos cenohet përdorimi i tokës dhe peizazhi (cenimi i tokave bujqësore dhe ekosistemeve me vlerë natyrore).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM3 (kategoria B).

4. Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e familjeve dhe konsumatorëve (një*

instalim me kapacitet deri në 500 kW) që të instalojnë kapacitete të rinovueshme dhe të promovojnë konsumin vetjak.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Një procedurë transparente dhe e thjeshtë për regjistrimin e një impianti pranë OSHEE-së, aksesimi i thjeshtë i informacionit.
- Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme apo një konsumator familjar mund të instalojë një kapacitet të përgjithshëm prej maksimumi 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli, me qëllim mbulimin e plotë ose të pjesshëm të nevojave të tij për energji, dhe ta injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.
- Konsumatorët, sipas skemës së matjes neto të energjisë, duhet të instalojnë me shpenzimet e tyre një matës me dy drejtime.
- Bilanci neto dhe faturimi bëhen në baza mujore për secilën pikë matëse. Teprica e energjisë elektrike mbi konsumin mujor shitet te furnizuesi i shërbimit universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, sipas çmimit të caktuar nga ERE, bazuar në metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësynimit të përcaktuar. Pjesëmarrja e publikut dhe njohja e Komuniteteve të Energjisë për Qytetarët (CEC-et) në aspektet me përparësi (rregullatore) do të forcojë PM-në. Kjo masë kërkon edhe zbatimin e një fushate promociionale në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM3 (kategoria B).

5. Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FIT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Rikonstruktimi dhe rehabilitimi i nënstacioneve elektrike
- Rikonstruktimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike
- Implementimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit nëpërmjet PMU-së (Njësi matëse fazorësh).
- Krijimi i nyjave të reja të konjeksionit
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit, kontrollit dhe matjes
- Aksesimi dhe garantimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në rrjetin e transmetimit

Për sa i përket kësaj PM-je, ajo do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasimore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të

papërfillshëm mbi OM1-NoM3 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

6. Lehtësimi i marrëdhënies rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lehtësimi i shtimit të kapacitetit të ri të energjisë së rinovueshme.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Të gjitha masat rregullatore të nevojshme për arritjen e objektivit.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Duke qenë një masë rregullatore, është vlerësuar se komponenti i ndikimit mjedisor është gjithnjë një pjesë e qenësishme e rregullave, dhe si i tillë konsiderohet pozitiv.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

7. Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e operueshmërisë së rrjetit shpërndarës për të përballuar shpërndarjen e një kapaciteti më të lartë të energjisë së rinovueshme*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Operatori i shpërndarjes, së bashku me ministrinë dhe entin rregullator, do të marrin përsipër kryerjen e studimeve për të vlerësuar potencialin real të menaxhimit të krahut të kërkesës dhe rezervave në Shqipëri. Në bazë të këtyre studimeve, duhet të ndërmerren disa masa zbatuese.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Kjo është një masë menaxhuese dhe miqësore ndaj mjedisit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

8. Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i një strategjie për matjen dhe avancimi drejt një sektori më të digjitalizuar të energjisë elektrike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Hartimi i një strategjie matjeje
- Zbatimi i strategjisë së matjes dhe instalimi i matësve inteligjentë
- Ndërtimi i kapaciteteve të operatorëve për administrimin e matësve inteligjentë, si dhe pajisjeve dhe të dhënave përkatëse

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

9. Elektrifikimi i sektorit të transportit

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Intensifikimi i elektrifikimit në sektorin e transportit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Caktimi i objektivave ligjore ndaj operatorëve ekonomikë, duke përfshirë zbatimin e tyre. Një tjetër është certifikimi i cili garanton pajtueshmërinë e operatorëve ekonomikë me kërkesat e qëndrueshmërisë.
- Përcaktimi i elementeve të tjera kyçe të politikave, me qëllim arritjen e objektivit të vitit 2030 për BRE-T:
 - (i) strategji dhe mekanizma mbështetjeje për energjinë elektrike në sektorin e transportit
 - (ii) vendosja e detyrimeve për subjekte të caktuara, si p.sh., parkingjet publike ose garazhet publike, që të kenë stacione karikimi për automjetet elektrike;
 - (iii) incentivat ose procedurat e thjeshtuara për ndërtimin/licencimin e stacioneve të karkimit për automjetet rrugore elektrike ose për ndërtimin/licencimin e stacioneve të furnizimit me hidrogjen;
 - (iv) automjetet e reja me motor elektrik me kilometrazh zero, që nuk janë regjistruar më parë në asnjë shtet, përjashtohen plotësisht nga TVSH-ja;
 - (v) reduktim i importit të lëndës djegëse fosile, krijim i vendeve të punës, etj.
 - (vi) politikat duhet të rishikohen dhe mundësisht të rregullohen deri rreth vitit 2025, në bazë të një politike dhe vlerësimit të rezultateve.

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar. Kjo masë hyn në fuqi nëse do të pasohet nga investime në infrastrukturë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM3 (kategoria B).

10. Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Promovimi i prodhimit dhe përdorimit të biokarburanteve, si dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, të cilat përmbushin kriterin e qëndrueshmërisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përcaktimi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për tregtim në sektorin e transportit
- Promovimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, me anë të zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë
- Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Marrja e masave nga çdo shoqëri që zotëron një licencë për "Tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, me kodin VIII.1.A" për tregtinë me shumicë, për të garantuar vendosjen në treg të sasisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Këto sasi duhet të përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë.
- Përcaktimi i kërkesave lidhur me verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve
- Detyrimi i përzierjes
- Caktimi i tarifave për certifikatat dhe lejet e nevojshme

- Kryerja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës
- Vendorsja e gjobave për shitësit me pakicë të lëndëve djegëse, nëse nuk parashikohet që biokarburantet e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, si dhe nafta ose hidrokarburet, të përzihen me bionaftë dhe bioetanol në masën 5%
- Penalitete për furnitorët e lëndëve djegëse që nuk përmbushin detyrimet e tyre
- Përcaktimi i masave mbështetëse në dispozicion të blerësve të automjeteve me lëndë djegëse alternative, si dhe i dispozitave në lidhje me përshtatshmërinë e automjeteve me llojet e ndryshme të lëndëve djegëse alternative

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

11. Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Zhvillimi i konceptit të “Industrië ekologjike” përmes promovimit dhe mbështetjes së aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe tregtare për të nxitur sipërmarrjen.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- NVM pilot për zbatimin e projekteve demonstruese në shkallë të vogël të energjisë së rinovueshme
- Zgjerimi i kapacitetit të zinxhirit lokal të furnizimit dhe tregut të shërbimeve për demonstrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme (transferimi i teknologjisë, zhvilluesit e projekteve, instalimi, operimi dhe mirëmbajtja, ofruesit e shërbimeve etj.)
- Zhvillimi i materialeve të trajnimit nga NVM-të
- Zhvillimi i platformave të pjesëmarrjes për promovimin (ndërgjegjësimin), zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për mbështetjen e teknologjive të përzgjedhura të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël
- Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve
- Informimi më i mirë institucioneve financiare vendase lidhur me energjinë e rinovueshme

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM3 (kategoria A).

4.1.1.4. Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për të arritur vlerën 11.5% në vitin 2030" OM1-NoM4

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM1-NoM4 është kryer në bazë të pritshmërisë që zbatimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së do të reduktojë shkarkimet e GES-ve me më shumë se 11,5% deri në vitin 2030.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 16: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM4

1. Reduktimi i konsiderueshëm i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë
2. Reduktimi i vogël i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë
3. Ruajtja ose shtimi i nivelit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë

4.1.1.4.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je:

- (i) përmirësimi i infrastrukturës së terminaleve të udhëtarëve;
- (ii) shtimi i efikasitetit të rrjetit të autobusëve ekstraurbanë; dhe
- (iii) reduktimi i shkarkimeve të CO₂ të lëshuara nga rrjeti i autobusëve ekstraurbanë.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Eliminimi i mbivendosjeve të linjave në itineraret e tyre
- Përdorimi i teknologjive të reja si "Sistemet e Transportit Inteligjent" dhe "Logjistika Inteligjente" për të ndihmuar në menaxhimin efikas të sistemeve të transportit
- Përmirësimi i cilësisë së rrugëve
- Përdorimi i automjeteve me efikasitet energjie, duke reduktuar nevojat për lëvizshmërinë dhe distancat me anë të planifikimit të integruar
- Promovimi i transportit publik të udhëtarëve
- Rritja e aksesit në përdorimin e biçikletave
- Fushatat e ndërgjegjësimit publik
- Taksa e karbonit
- Taksa e rrugës
- Caktimi i taksave të qarkullimit dhe kufizimi i përdorimit të automjeteve (përdorimi i tyre në ditë të caktuara të javës, p.sh. sipas targës së makinës)
- Përmirësimi i koeficientit të ngarkesës së automjetit në transportin e mallrave
- Përgatitja e një plani optimal parkimi dhe caktimi i tarifave optimale të parkimit, veçanërisht në nyjat kryesore të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave
- Reduktimi i përdorimit të burimeve të energjisë

Kjo PM është e një natyre ekologjike, megjithatë për një vlerësim më të mirë në aspektin sasior, do të ishte më mirë nëse do të përcaktohej edhe masa e kontributit të kësaj PM-je në arritjen e pikësnyimit të përcaktuar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

2. Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je:

- (i) *një skenar të transportit aktiv që synon të reduktojë me 10% intensitetin e energjisë në sektorin e transportit*
- (ii) *reduktimi i kostos logjistike*
- (iii) *reduktimi i trafikut rrugor dhe i bllokimeve të trafikut*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Integrimi i transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror në transportin e mallrave (plani afatmesëm 5-8 vite)
- Rritja e efikasitetit të transportit të mallrave
- Reduktimi i kohës së transitit dhe kostove të transportit përgjatë zinxhirit të transportit të mallrave
- Reduktimi i bllokimit të trafikut në rrjetin rrugor kombëtar
- Reduktimi i konsumit të energjisë (ton/km)
- Reduktimi i shkarkimeve të CO₂
- Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut
- Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme
- Rritja e investimeve në sektorin e menaxhimit të transportit të mallrave
- Reduktimi i kostos së transportit nga origjina deri në destinacionin e mallrave (gjatë zinxhirit të transportit)

Për sa i përket kësaj PM-je, ajo do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasimore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

3. Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Reduktimi i vjetërsisë mesatare të makinave dhe rritja e standardit të kërkuar. Masa është konsistente me skenarin zbutës të INDC-së. Ajo përfshin ndalimin e regjistrimit dhe rritjen e taksave për automjetet e dorës së dytë, me qëllim reduktimin në maksimum të hyrjes së tyre në tregun shqiptar.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Masat e përshkruara në seksionin e masave të marra deri më tani

- Rritja e taksave vjetore në bazë të vjetërsisë së automjetit dhe llojit të lëndës djegëse të përdorur

Për sa i përket kësaj PM-je, ajo do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasiore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Për më tepër, është e nevojshme që PM-ja të përfshijë pjesëmarrjen e publikut dhe fushatën promovionale.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria B).

4. Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e përdorimit në shkallë të gjerë të energjive të rinovueshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Skemat e incentivave financiare
- Skemat rregullatore
- Udhëzime ose skema me bazë edukative

Që në ndërmarrjen e nismës së strategjisë kombëtare për BRE-të dhe skemat financiare, do të kishte qenë më e mundshme përfshirja e hartimit të një masterplani kombëtar, i cili do të përcaktonte fushat parësore për zbatimin e kësaj mase. Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit; megjithatë do të jetë më mirë nga ana sasiore që përqindja e kësaj PM-je të matet përmes përgatitjes dhe zbatimit të masterplanit.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

5. Zbatimi i ETS-së në Shqipëri

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i ETS-së në Shqipëri do të kontribuojë në arritjen e objektivit të NDC-së për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve nga sektori i industrisë, si dhe në arritjen e objektivit të PKEK-së për dekarbonizimin e ekonomisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Projektimi i ETS-së së ardhshme në përputhje me standardet e BE-së, me qëllim lehtësimin e procesit të çdo ndërlidhjeje të mundshme në të ardhmen me ETS-në e BE-së.
 - o Përmirësimi i kuadrit legjislativ (legjisacionit dytësor për procedurat e nxjerrjes së lejeve për shkarkimin e GES-ve dhe udhëzimet teknike)
 - o Krijimi i një sporteli shërbimi për operatorët industrialë
 - o Caktimi i çmimit të karbonit
 - o Trajnimi i operatorëve industrialë lidhur me:
 - Krijimin e planit të monitorimit (kategorizimi, sistemi me nivele, qasja e bazuar në llogaritje, pasiguria, kërkesa të tjera)
 - Ngritjen e një kuadri verifikimi dhe raportimi (raport vjetor mbi shkarkimet, shoqëruar me të dhëna të verifikuara lidhur me këto shkarkime;
 - raport verifikimi, raport mbi përmirësimin)
 - Mënyrën e përfatimit të kuotave në nivel BE-je (blerje, përfatim pa pagesë) apo kthimit të tyre

- Nisja e procesit të akreditimit dhe/ose njohja e verifikuesve të jashtëm për shkak të përmasave të tregut.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

6. Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së (Rregullorja për mekanizmat e monitorimit)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Garantimi i harmonizimit me tërësinë e legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike dhe përmbushja e kërkesave të KKKBNK-së përmes prezantimit të një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e rregullt të shkarkimeve të GES-ve dhe informacioneve të tjera lidhur me ndryshimet klimatike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Hartimi i akteve të reja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin etj., siç kërkohet nga CCL
- Një plan zbatimi për MMR-në
- Krijimi i një ekipi kryesor për inventarin e GES-ve prej të paktën 6 personash në të gjitha institucionet, plotësisht të familjarizuar me detyrat e ekipit të inventarit (ekspertë të sektorit, bashkë-koordinator, QA/QC, vlerësime mes homologëve)
- Krijimi i një ekipi kryesor për MMR-në prej të paktën 10 personash nga institucionet, plotësisht të familjarizuar me detyrat për të cilat janë trajnuar dhe të aftë për të kryer të gjitha detyrat statutorë që kërkohen nga MMR
- Ngritja e kapaciteteve për personelin e kualifikuar të MTM, AKM, MIE, MBZHR dhe për të gjitha grupet e interesit të identifikuar nga CCL
- Ngritja e kapaciteteve për verifikuesit e kualifikuar, të pavarur dhe të akredituar të raporteve të monitorimit të GES-ve
- Ngritja e kapaciteteve për personelin e kualifikuar dhe atë të institucioneve të tjera për përpunimin e të dhënave, zhvillimin e treguesve, menaxhimin dhe arkivimin
- Krijimi i grupeve të pasuruara të të dhënave dhe arkivave dhe shkëmbimi i informacionit midis të gjitha institucioneve të përfshira në MMR
- Ngritja e një sistemi elektronik për ngarkimin/shkarkimin e të dhënave të aktiviteteve nga MIE, MBZHR, MTM, AKM dhe të gjitha institucionet e tjera të përfshira në MMR
- Përmirësimi i kapaciteteve të koordinimit në MTM dhe i bashkëpunimit ndërinstitutional për zbatimin e politikave të CCL-së, MMR-së dhe pjesës tjetër të tërësisë së legjislacionit për ndryshimet klimatike
- Pajtueshmëria me kërkesat për raportim të politikave

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

7. Promovimi i bujqësisë organike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Nxitja e fermave organike, rritja e përqindjes që zënë fermat organike në sektorin e bujqësisë dhe përmirësimi i metodave të plehërimit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD)
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ në lidhje me fermat organike
- Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (PMB)
- Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së

- Mbledhja e të dhënave për feramat organike dhe për sipërfaqen e shfrytëzuar për ferma organike

Kjo PM në sektorin bujqësor është më e gjerë se objektivi për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve. Nga kjo pikëpamje, një qasje më e mirë do të ishte përcaktimi i kuadrit për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve, për të bërë të mundur që të arrihet përqindja e kësaj PM-je për objektivin në fjalë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria B).

8. Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i monitorimit kombëtar të përhershëm të aktiviteteve bujqësore lidhur me shkarkimet e CO2*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD)
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ lidhur me metodologjinë e monitorimit

Kjo PM në sektorin bujqësor është më e gjerë se objektivi për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve. Nga kjo pikëpamje, një qasje më e mirë do të ishte përcaktimi i kuadrit për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve, për të bërë të mundur që të arrihet përqindja e kësaj PM-je për objektivin në fjalë.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria B).

9. Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Ndalimi i djegies së mbetjeve bujqësore në mjedise të hapura.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Intensifikim i kontrollit mbi incinerimin e mbetjeve bujqësore
- Kontrolli i djegies së mbetjeve bujqësore me anë të marrjes së masave të sigurisë ndaj zjarrit dhe disponimi i një programi të qartë dhe i zonave të përcaktuara për incinerimin e tyre
- Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore

Për sa i përket kësaj PM-je, ajo do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasiore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Për më tepër, kjo gjë duhet të përfshihet në elementet e zbatimit të ligjit dhe në fushatën edukative

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria B).

10. Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, që bazohet në hierarkinë e mbetjeve.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Hartimi i një plani për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve dhe i një programi për parandalimin e mbetjeve, në mbështetje të zbatimit të dokumentit politik strategjik për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe planit të veprimit
- Mbyllja dhe trajtimi i të gjitha vendgrumbullimeve bashkiake (të papajtueshme) për mbetjet e trashëguara, në përputhje me udhëzimet në fuqi
- Instalimi i impianteve të thithjes së metanit në vendgrumbullime
- Zbatimi i skemave kombëtare të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet e tyre

Kjo PM i adresohet strukturave të qeverisjes vendore, që janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në zonën/rajonin e tyre administrativ PM-ja është miqësore ndaj mjedisit, megjithatë do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasiore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Më pas, duhet marrë parasysh që përpara hartimit të planeve rajonale/vendore për menaxhimin e mbetjeve, që objektivat duhet të jenë në përputhje me burimet vendore (klima, ekonomia, profili, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

11. Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Transporti i mbetjeve në impiantet e transformimit të mbetjeve në energji.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Pas ndjekjes së të gjitha proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, asgjësimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë Dokument dhe skemat teknike të përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund të dërgojnë në këto impiante të tjera mbetje të djegshme.
- Finalizimi i ndërtimit të incineratorëve në Tiranë dhe Fier.

Për sa i përket kësaj PM-je, ajo do të bëhej më mirë e matshme nga ana sasiore nëse do të përcaktonte edhe përqindjen e kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Nga pikëpamja mjedisore, duhet të paracaktohet se procesi i incinerimit paraprihet nga procesi i zbatimit të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve (3 R-të). Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

12. Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e numrit të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura në Shqipëri dhe e përqindjes së popullsisë së lidhur me impiant trajtimi të ujërave të përdorura.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Harmonizimi i plotë me Direktivën “Për trajtimin e ujërave të përdorura urbane”
- Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura dhe ndërtimi i impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të parapëlqyera nga turistët
- Financimi shtetëror për ndërhyrjet e drejtpërdrejta në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të përdorura, mbështetja nga donatorët e huaj (kryesisht IPA III dhe donatorët dypalësh), kompanitë private (përmes Partneriteteve Publike Private) dhe projekti IPA (III) 2022 për sektorin e ujit në Shqipëri
- Mbledhje e tarifave për ujërat e përdorura nga qytetarët

Masat/veprimet e parashikuara i paraprijnë komponentit të lidhur me PKEK-në, por objektivi i drejtpërdrejtë të PKEK-së duhet të jetë prodhimi i energjisë së rinovueshme nga ITUP-i. Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

13. Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Ripyllëzimi i zonave brenda fondit pyjor, me fokus në zonat e dëmtuara nga zjarri dhe shpyllëzimi masiv, zgjerimi me zona të reja të orientuara kryesisht drejt agropylltarisë, gjelbërimi urban dhe rrugor, çka do të sjellin rigjenerimin e pyjeve dhe rritjen e kapacitetit të tyre të përthithjes së karbonit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Plani kombëtar për mbjelljen në zonat e dëmtuara nga prerja e paligjshme e drurëve dhe në zonat e djegura brenda fondit pyjor
- Pyllëzimi me lloje të reja me rritje të shpejtë për produktet e drurit, duke përdorur hapësirat e lira, tokat djerrë etj. dhe duke bashkëpunuar me individë dhe sipërmarrje
- Promovimi i agropylltarisë përmes incentivave financiare, me pemë frutore, me truall apo me fidanë (drurë frutorë / Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - AZHBR), etj.
- Promovimi i gjelbërimit rrugor dhe urban në parqe, përreth burimeve ujore dhe në zonat e ndjeshme, me qëllim rritjen e sipërfaqes së mbuluar me pemë/gjelbërim dhe parandalimin e rreziqeve natyrore

Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit, por nuk ka një njësi matjeje konkrete (sipërfaqja, numri i pemëve, etj.), që e bën të pamundur përcaktimin e përqindjes së kësaj PM-je për arritjen e objektivit të synuar. Duke qenë më në kontakt me qeverisjen vendore, plani kombëtar për mbjelljen duhet të përcaktojë në mënyrë rigoroze bimësinë autoktone, sipas habitateve dhe ekosistemeve në nivel vendor.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM4 (kategoria B).

14. Menaxhimi ekologjik i pyjeve

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm*

të pyjeve me qëllim përmirësimin e përthithjes së karbonit dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetja financiare përmes buxhetit të shtetit dhe financimit ndërkombëtar
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket pylltarisë.
- Disa nga masat përfshijnë:
 - o Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe kontributit të tyre në ciklet globale të karbonit
 - o Ruajtjen e vitalitetit dhe shëndetit të ekosistemeve pyjore
 - o Ruajtjen dhe promovimin e funksioneve produktive të pyjeve (lëndë drusore dhe jodrusore).
 - o Mirëmbajtjen e duhur, ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore
 - o Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos të tokës dhe ujit)

Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit dhe e rëndësishme për rigjenerimin e sipërfaqeve pyjore natyrore por vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndryshimeve klimatike dhe masave kundër zjarrit, si dhe nevojave të trajnimit të burimeve njerëzore në nivel vendor.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM4 (kategoria A).

4.1.1.5. Nënobjektivi mjedisor "Shfrytëzimi i të gjitha përfitimeve të bioekonomisë dhe krijimi në masë të madhe i përthithësve të karbonit" OM1-NoM5

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM1-NoM5 është kryer në bazë të pritshmërisë që përthithësit e karbonit në pyje, toka dhe toka bujqësore, do të rrisë kapacitetin e tyre deri në vitin 2030.

Ndikim i	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthortë	I largët	Afatshkurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ?? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 17: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM5

- 1 Ndikimet potenciale në reduktimin e stoqeve të karbonit dhe reduktimi i biokapacitetit, për shkak të shtimit të shfrytëzimit të lëndës drusore dhe biomasës bimore për qëllime energjetike
- 2 Ndikimet potenciale në reduktimin e stoqeve të karbonit dhe shtimi i biokapacitetit për shkak të instrumenteve dhe politikave të përmirësuara, për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm pyjor

4.1.1.5.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: Ripyllëzimi i zonave brenda fondit pyjor, me fokus në zonat e dëmtuara nga zjarri dhe shpyllëzimi masiv, zgjerimi me zona të reja të orientuara

kryesisht drejt agropylltarisë, gjelbërimi urban dhe rrugor, çka do të sjellin rigjenerimin e pyjeve dhe rritjen e kapacitetit të tyre të përthithjes së karbonit.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Plani kombëtar për mbjelljen në zonat e dëmtuara nga prerja e paligjshme e drurëve dhe në zonat e djegura brenda fondit pyjor
- Pyllëzimi me lloje të reja me rritje të shpejtë për produktet e drurit, duke përdorur hapësirat e lira, tokat djerrë etj. dhe duke bashkëpunuar me individë dhe sipërmarrje
- Promovimi i agropylltarisë edhe me pemë frutore, me incentiva financiare ose për tokën, fidanë (pemë frutore / Agjencia Kombëtare për Zhvillim Bujqësor dhe Rural- AZHBR), etj.
- Promovimi i gjelbërimit rrugor dhe urban në parqe, përreth burimeve ujore dhe në zonat e ndjeshme, me qëllim rritjen e sipërfaqes së mbuluar me pemë/gjelbërim dhe parandalimin e rreziqeve natyrore

Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit por mbetet në nivelin cilësor të objektivit mjedisor. Nevojiten të dhënat sasiore për të vijuar më tej me zbatimin e masave/veprimeve të parashikuara.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM5 (kategoria B).

2. Menaxhimi ekologjik i pyjeve

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve me qëllim përmirësimin e përthithjes së karbonit dhe mbrojtjen e biodiversitetit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetja financiare përmes buxhetit të shtetit dhe financimit ndërkombëtar
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket pylltarisë.
- Disa nga masat përfshijnë:
 - Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe kontributit të tyre në ciklet globale të karbonit
 - Ruajtjen e vitalitetit dhe shëndetit të ekosistemeve pyjore
 - Ruajtjen dhe promovimin e funksioneve produktive të pyjeve (lëndë drusore dhe jodrusore).
 - Mirëmbajtjen e duhur, ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore
 - Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos të tokës dhe ujit)

Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit dhe e rëndësishme për rigjenerimin e sipërfaqeve pyjore natyrore por vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndryshimeve klimatike dhe masave kundër zjarrit, si dhe nevojave të trajnimit të burimeve njerëzore në nivel vendor.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM5 (kategoria A).

3. Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Promovimi i prodhimit dhe përdorimit të biokarburanteve, si dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, të cilat përmbushin kriterin e qëndrueshmërisë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përcaktimi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për tregtim në sektorin e transportit
- Promovimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, me anë të zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë
- Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Marrja e masave nga çdo shoqëri që zotëron një licencë për "Tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, me kodin VIII.1.A" për tregtinë me shumicë, për të garantuar vendosjen në treg të sasisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Këto sasi duhet të përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë.
- Përcaktimi i kërkesave lidhur me verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve
- Detyrimi i përzierjes
- Caktimi i tarifave për certifikatat dhe lejet e nevojshme
- Kryerja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës
- Vendosja e gjobave për shitësit me pakicë të lëndëve djegëse, nëse nuk parashikohet që biokarburantet e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, si dhe nafta ose hidrokarburet, të përzihen me bionaftë dhe bioetanol në masën 5%
- Penalitete për furnitorët e lëndëve djegëse që nuk përmbushin detyrimet e tyre
- Përcaktimi i masave mbështetëse në dispozicion të blerësve të automjeteve me lëndë djegëse alternative, si dhe i dispozitave në lidhje me përshtatshmërinë e automjeteve me llojet e ndryshme të lëndëve djegëse alternative

Kjo është një masë e përgjithshme që duhet të zbatohet në praktikë. Në rastin më të mirë, ky zbatim do të ishte për transportin publik urban.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM5 (kategoria B).

4.1.1.6. Nënobjektivi mjedisor "Rritja e lëvizshmërisë ndërkohë që reduktohet konsumi i energjisë në sektorin e transportit" OM1-NoM6

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM1-NoM6 është kryer në bazë të pritshmërive që:

- Konsumi primar i energjisë në sektorin e transportit është reduktuar ndjeshëm;
- Përqindja e kilometrave të transportit të pasagjerëve dhe mallrave në rrugë dhe me tren është shtuar ndjeshëm;
- Proporcioni i udhëtimeve të bëra me këmbë dhe biçikletë është rritur ndjeshëm.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	- / +	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	- / +	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 18: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM6

- 1 Numër më i lartë pasagjerësh që përdorin transportin rrugor dhe hekurudhor (pasagjerë/kilometër, pkm) dhe intensifikim i transportit të mallrave (ton-kilometër, tkm) me konsum të reduktuar të energjisë

4.1.1.6.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mbështetja, në sajë të kuadrit rregullator dhe mekanizmave teknike e financiare, e intensifikimit të transportit publik si rezultat i problematikave mjedisore dhe ekonomike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik në mbarë qytetin, me anë të përmirësimit të rrjetit lokal të transportit publik, me anë të korsive të dedikuara të autobusëve etj.
- Rikonstruktimi i rrugëve që ka nisur tashmë në shkallë të gjerë dhe ka filluar të përmirësojë imazhin e transportit publik nëpërmjet rritjes së numrit dhe shpeshtësisë së autobusëve elektrikë që janë pjesë e rrjetit.
- Ndërtimi i Terminalit Publik të Transportit në Tiranë dhe i sistemit të autobusëve të transportit të shpejtë (BRT) Tiranë-Rinas
- Unaza e Tiranës (2016 – 2018) (përfundimi i anës jugperëndimore - i vonuar)
- Përmirësimi i transportit publik (flotë e re (elektrike dhe me etiketim)) dhe ndërtimi i 10 km korsi të dedikuara për biçikletat)

Kjo PM do të përmirësojë infrastrukturën aktuale për biçikletat dhe ndërtimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për rrugët e biçikletave rajonale, lokale dhe në distanca të largëta, të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e numrit të përdoruesve të biçikletave dhe këmbësorëve në itinerarin e tyre të përditshëm. Megjithatë, transporti hekurudhor nuk duhet lënë pas, në zgjatim të përmirësimit të rrjetit të transportit të pasagjerëve dhe të mallrave, për të cilin po zbatohen masa konkrete (segmentet Tiranë-Durrës, Vorë-Hani i Hotit, Durrës-Rrogozhinë, Rrogozhinë-Pogradec).

Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM6 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

2. Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të makinave

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i stacioneve të karikimit për automjetet elektrike për të përmirësuar qëndrueshmërinë e Sistemit të lëvizshmërisë urbane dhe rrugore dhe reduktimi i shkarkimeve të GES-ve që vijnë nga sektori i transportit përmes instalimit të infrastrukturës së karikimit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Zhvillimi i infrastrukturës së stacioneve të karikimit të makinave elektrike
- Pasurim i flotës së taksive me modele hibride apo elektrike

Këto masa/veprime duhet të përditësohen në bazë të dispozitave të Planeve të Përgjithshme Vendore

(PPV) dhe të zbatohen së bashku me një plan masash për rrjetin rrugor shqiptar që ka potencial dhe intensitet më të madh qarkullimi (zonat turistike, parkimi në zonat urbane, akset kryesore kombëtare, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM1-NoM6 (kategoria A).

4.1.1.7. Nënobjektivi mjedisor "Reduktim i ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitet dhe përshtatshmëri më e madhe e shoqërisë" OM1-NoM7

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM1-NoM7 është kryer në bazë të pritshmërive që:

- PM-të e PKEK-së janë planifikuar duke marrë parasysh skenarët për klimën;
- Ndjeshmëria dhe cenueshmëria e sektorit të energjisë në Shqipëri ndaj ndryshimeve klimatike është tejet e ulët dhe përshtatshmëria është tejet e lartë.
- Siguria dhe sigurimi i furnizimit me energji nuk cenohet nga ndryshimet klimatike.

Ndikim i	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatshkurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 19: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM1-NoM7

1. Prodhim i shtuar i energjisë së BRE-ve (diellore dhe eolike) dhe shtimi i vetëfurnizimit me energji elektrike nga BRE-të
2. Përmirësimi i vazhdueshëm i efikasitetit të energjisë së ndërtesave
3. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave përmes zëvendësimit të pajisjeve ose lidhjes me burime të largëta

4.1.1.7.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 3% të stokut të ndërtesave të qeverisë qendrore, çdo vit.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - o Buxheti i shtetit
 - o Zbatimi i skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
 - o Institucionet financiare/donatorët ndërkombëtarë

Ndikimi i këtyre masave/veprimeve është gati i papërfillshëm për objektivin, por duhet të merret parasysh gjithsesi; do të ishte e dobishme që të përdoren si modele pilot për ngritjen e kapaciteteve

në kuadër të “Reduktimit të ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë më të madhe të shoqërisë.”

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

2. Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Arritja e pikësnyimit të përcaktuar të rinovimit të 2% të stokut të ndërtesave publike, çdo vit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Disa nga skemat financiare që mund të jenë dhe janë nën zbatim:
 - Buxheti i shtetit: Çdo vit, shteti i alokon qeverisë vendore një buxhet të caktuar për përmbushjen e objektivave të saj. Krahas kësaj, duke mbledhur një lloj të ndryshëm taksash, qeveria vendore përcakton objektivat dhe qëllimet dhe e shpërndan/investon një pjesë të buxhetit të saj total për investime lidhur me efikasitetin e energjisë në rinovimin e ndërtesave.
 - Kontributi i sektorit privat në atë publik
 - Zbatimi i skemave detyruese të efikasitetit të energjisë
 - Kombinimi i investimeve në EE dhe BRE për ndërtesat që përfitojnë nga fondet “e gjelbra” lidhur me reduktimin e konsumit të energjisë dhe GES-ve
 - Linjat e kreditit dhe grantet për ndërtesat rezidenciale
 - Zbritjet fiskale/tatimore, reduktimi i TVSH-së; taksa e karbonit dhe krijimi i një fondi të dedikuar për financimin e investimeve në EE dhe promovimi i këtyre të fundit
 - Institucionet financuese/donatorët ndërkombëtarë
 - Subvencionet publike - ato përbëjnë vetëm një pjesë të përgjigjes ndaj nevojave të zhvilluesve të projekteve, të cilat variojnë nga asistenca teknike e deri te strukturimi financiar i projektit

Ndikimi i këtyre masave/veprimeve është gati i papërfillshëm për objektivin, por duhet të merret parasysh gjithsesi; do të ishte e dobishme që të përdorehin si modele pilot për ngritjen e kapaciteteve në kuadër të “Reduktimit të ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë më të madhe të shoqërisë.” Në mënyrë që të ruhet konsistenca në zbatimin e kësaj PM-je, është me rëndësi të ngrihet një bazë të dhënash në nivel vendor.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

3. Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shpenzimi në mënyrë më efektive të fondeve publike nga ana e autoriteteve duke përfituar në këtë mënyrë rritjen e performancës energjetike të produkteve dhe shërbimeve, duke promovuar një konsum efikas të energjisë, konkurrues dhe me nivele të ulëta karboni.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i (projekt)ligjit të ndryshuar për efikasitetin e energjisë dhe

- Përgatitja e legjislacionit dytësor

Ndikimi i këtyre masave/veprimeve është gati i papërfillshëm për objektivin, por duhet të merret parasysh gjithsesi; do të ishte e dobishme që të përdreshin si modele pilot për ngritjen e kapaciteteve në kuadër të “Reduktimit të ekspozimit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë së Shqipërisë, si dhe fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë më të madhe të shoqërisë.”

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

4. Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit për etiketat e energjisë dhe/ose eko-dizajnit për produktet: Vendosja mbi produktet e fabrikuara e etiketave informuese ku tregohet performanca energjetike, e cila u siguron konsumatorëve informacionin e nevojshëm për marrjen e vendimeve të informuara të blerjes në pikën e shitjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Transpozimi dhe miratimi i etiketave të energjisë dhe/ose eko-dizajnit për produktet
- Përshtatja (dhe përditësimi) i legjislacionit mbi produktet individuale, për shembull për të siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin evropian dhe ndryshimet e tij, për prezantimin e etiketave të energjisë për kategoritë e reja të produkteve ose për të pasqyruar zhvillimet e tregut
- Kontrolli i dokumentacionit teknik të produkteve të rregulluara
- Testimi i produkteve për sa i përket pajtueshmërisë me rregulloret
- Monitorimi i përdorimit të etiketave të energjisë nëpër pikat e shitjes
- Rritja e kapaciteteve teknike të personelit të dedikuar për mbikëqyrjen e tregut lidhur me legjislacionin për etiketat e energjisë dhe eko-dizajnin
- Përgatitja e udhëzimeve lidhur me kërkesat për profesionistët ose e udhëzuesve për konsumatorët, mbështetja në përgatitjen e udhëzuesve dhe procedurave të brendshme
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet informimit lidhur me çështjet shqetësuese nga qeveria, bashkitë dhe shoqëria civile
- Nxjerrja e njoftimeve në format të shtypur, video apo audio për fushatat e konsumatorëve, duke përfshirë monitorimin e aktiviteteve lidhur me faqet e internetit të fushatave dhe rrjetet sociale

Në planin afatmesëm, kjo PM duhet të synojë procesin e auditimit dhe certifikimit të etiketës ekologjike. Do të ishte mirë që të shoqërohej me një fushatë promociionale për bizneset dhe konsumatorët e mundshëm.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

5. Etiketimi i energjisë për makinat e reja

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i një kuadri rregullator që garanton informacion transparent lidhur me kursimin e lëndës djegëse (efiçenca) dhe shkarkimet e CO2 të makinave të reja të ofruara për shitje ose qiramarrje.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Transpozimi dhe miratimi i Direktivës 1999/94/BE, Direktivës 2003/73/BE, Rekomandimit të

Komisionit 2003/217/KE dhe Rekomandimit të Komisionit (BE) 2017/948.

- Ofrimi i asistencës teknike për transpozimin e direktivave dhe rekomandimeve të sipërpërmendura.
- Do të ofrohet trajnim për autoritetet kompetente dhe grupet e interesit për zbatimin e kërkesave, për të garantuar disponueshmërinë e informacionit për konsumatorët lidhur me kursimin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂.

Krahas masave të investimeve në infrastrukturën e furnizimit me energji, do të ishte mirë që realizimi i kësaj PM-je të shoqërohej me një fushatë promovionale për bizneset dhe konsumatorët e mundshëm, por në planet afatmesme dhe afatgjata duhet të përcaktojnë dhe të jetë pjesë e objektivave sasiore.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

6. Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të lëndëve djegëse alternative/të pastra dhe automjeteve me efikasitet energjie si mënyra për gjenerimin e ndikimeve më të konsiderueshme, me anë të reduktimit të konsumit të energjisë dhe, kryesisht, me anë të reduktimit të shkarkimeve të GES-ve përmes skemave mbështetëse të automjeteve efikase dhe atyre ekologjike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Kuadri ligjor për caktimin e qëllimeve, objektivave, detyrimeve, afateve, grupeve të interesit etj.
 - o Caktimi në bazë të kuadrit ligjor i objektivave të BRE-së për biokarburantet dhe hidrogjenin që do të përdoren në sektorin e transportit, si dhe përfshirja e dispozitës për elektricitetin që përdoret posaçërisht në transport.
 - o Caktimi në bazë të kuadrit ligjor i detyrimit të prodhuesve/importuesve/shitësve me pakicë në lidhje me sasinë dhe cilësinë (certifikimin) e BRE-ve specifike për tregun e transportit, si dhe i detyrimit të importuesve/shitësve me pakicë dhe përdoruesve të automjeteve në lidhje me efikasitetin e energjisë.
 - o Përditësimi i planit të veprimit në lidhje me EE-në në sektorin e transportit, i cili përcakton objektivat, duke përfshirë mënyrat e zhvillimit të tregut të EE-së dhe automjeteve me lëndë djegëse të pastra.
 - o Adresimi i prokurimit ekologjik për sektorin publik, në favor të shtimit të flotës së automjeteve me lëndë djegëse të pastra, krahas kritereve të efikasitetit të energjisë (përcaktuar nga ligji i ndryshuar për EE-në), me synim rritjen e numrit të automjeteve ekologjike në raport me ato që përdorin lëndë djegëse konvencionale.
- Ndihmat/incentivat financiare për prodhuesit e automjeteve, shitësit me pakicë dhe konsumatorët
 - o Grantet dhe kreditë e buta për blerjen e automjeteve ekologjike
 - o Zbritje tregtare (rabate)/subvencionime të çmimit të blerjes së automjeteve: përfitim financiar që merret me blerjen e një automjeti të kualifikueshëm
 - o Programi “Feebate”: masa financiare kur një automjet i kualifikuar përfton një rabat blerjeje, ndërsa një tarifë shtesë ose taksë vendoset për disa lloje makinash, në varësi të shkarkimeve të CO₂ të automjeteve
 - o Skema e incentivave për zëvendësimin e automjeteve: një masë e cila nxit zëvendësimin e automjeteve të vjetra me modele më të reja, më efikase dhe me nivele më të ulëta ndotjeje

- Tarifat, penalitetet ose ndalimet për automjetet me nivelet më të larta të ndotjes
- Reduktimi i taksave vjetore për automjetet ose përjashtimi nga to (për disa vite)
- Reduktimi i taksave të lëndës djegëse të motorëve ose përjashtimi nga to
- Reduktimi i taksave të rrugës
- Reduktimi ose heqja e tarifës së parkimit
- Përjashtime tatimore dhe zbritje për automjetet e importit, taksën e blerjes ose të regjistrimit
- Një incentivë e planifikuar që varion nga 5% deri në 10% të kostos së blerjes për makinat e reja elektrike; mirëmbajtje dhe shërbime ndihmëse pa pagesë për pronarët e makinave elektrike; ofrim i incentivave dhe zbritjeve edhe për pronarët e makinave hibride.
- Parkim pa pagesë në të gjitha hapësirat e parkimit publik.
- Masat teknike
- Pasurim i flotës së taksive me modele hibride apo elektrike

Krahas masave të investimeve në infrastrukturën e furnizimit me energji, do të ishte mirë që realizimi i kësaj PM-je të shoqërohej me një fushatë promovionale për bizneset dhe konsumatorët e mundshëm, por në planet afatmesme dhe afatgjata duhet të përcaktojnë dhe të jetë pjesë e objektivave sasiore.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

7. Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Shtimi i kapacitetit të energjisë së rinovueshme (diellore dhe fotovoltaike) përmes organizimit të ankandeve dhe propozimit të skemave të mbështetjes të kontratave për diferencë (CfD).*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Të gjitha kapacitetet e energjisë së rinovueshme nën 2 MW (ose 3 MW për energjinë eolike) dhe projektet demonstruese dhe ato pilot mund të përfitojnë nga tarifa FiT.
- Tarifat llogariten nga ERE në mënyrë që të garantohet një normë e mjaftueshme e kthimit të investimit për të gjithë operatorët e energjisë së rinovueshme.
- Enti Rregullator i Energjisë miraton çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, sipas çmimit mesatar për vitin 2017, në përputhje me parashikimet e metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 369.
- Duke nisur nga viti 2019, çmimi i ERE i përfshirë në strategji është 100 €/MWh për energjinë e prodhuar nga dielli dhe 76 €/MWh për atë të prodhuar nga era.

Kjo PM është miqësore ndaj mjedisit, megjithatë, gjatë procesit të miratimit, duhet të bëhet kujdes që të mos cenohet përdorimi i tokës dhe peizazhi (cenimi i tokave bujqësore dhe ekosistemeve me vlerë natyrore).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM1-NoM7 (kategoria B).

4.1.2. Objektivi mjedisor "Jetesa e shëndetshme" (OM2)

4.1.2.1. Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i shkarkimeve të elementeve ndotëse të ajrit" (OM2-NoM1)

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM2-NoM1 është kryer në bazë të pritshmërive që këto politika dhe masa të parashikuara të PKEK-së nuk ndikojnë në ndryshimin e shkarkimeve të ndotësve atmosferikë ose se zbatimi i politikave dhe masave të PKEK-së do të reduktojë shkarkimet e elementeve ndotëse të ajrit nën kufirin e shkarkimeve kombëtare të vendosur për vitin 2030 (-18.7% për GES-të).

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthorë	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ?? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 20: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM2-NoM1

1. Ndikimi në shkarkimet e substancave në ajër për shkak të shtimit të qarkullimit të mallrave dhe udhëtarëve dhe ndryshimeve në strukturën e lëndëve djegëse
2. Ndikimi në shkarkimet e substancave në ajër për shkak të ndryshimeve në funksionimin e termocentraleve me gaz natyror dhe biomasë
3. Ndikimi në shkarkimet e substancave në ajër për shkak të ndryshimeve në llojin e burimit të energjisë për ngrohje në banesa
4. Ndikimi i ndërtimit të instalimeve infrastrukturore në shkarkimet e grimcave të pluhurit nga burime të shpërndara

4.1.2.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je:

- (iv) përmirësimi i infrastrukturës së terminaleve të udhëtarëve;
- (v) shtimi i efikasitetit të rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë; dhe
- (vi) reduktimi i shkarkimeve të CO₂ të lëshuara nga rrjeti i autobusëve ekstra-urbanë.

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Eliminimi i mbivendosjeve të linjave në itineraret e tyre
- Përdorimi i teknologjive të reja si "Sistemet e Transportit Inteligjent" dhe "Logjistika Inteligjente" për të ndihmuar në menaxhimin efikas të sistemeve të transportit
- Përmirësimi i cilësisë së rrugëve
- Përdorimi i automjeteve me efikasitet energjie, duke reduktuar nevojat për lëvizshmërinë dhe distancat me anë të planifikimit të integruar
- Promovimi i transportit publik të udhëtarëve
- Rritja e aksesit në përdorimin e biçikletave

- Fushatat e ndërgjegjësimit publik
- Taksa e karbonit
- Taksa e rrugës
- Caktimi i taksave të qarkullimit dhe kufizimi i përdorimit të automjeteve (përdorimi i tyre në ditë të caktuara të javës, p.sh. sipas targës së makinës)
- Përmirësimi i koeficientit të ngarkesës së automjetit në transportin e mallrave
- Përgatitja e një plani optimal parkimi dhe caktimi i tarifave optimale të parkimit, veçanërisht në nyjat kryesore të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave
- Reduktimi i përdorimit të burimeve të energjisë

Nga pikëpamja mjedisore, kjo PM është në drejtimin e duhur, por e marrë në konsideratë nga vëllimi i përgjithshëm i transportit, ndikimi është minimal; sidoqoftë, përmes fushatave promociionale mund të rrisë nivelin e ndikimit për përdoruesit e transportit urban.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM2-NoM1 (kategoria B).

2. Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je:

- (iv) një skenar të transportit aktiv që synon të reduktojë me 10% intensitetin e energjisë në sektorin e transportit
- (v) reduktimi i kostos logjistike
- (vi) reduktimi i trafikut rrugor dhe i bllokimeve të trafikut

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Integrimi i transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror në transportin e mallrave (plani afatmesëm 5-8 vite)
- Rritja e efikasitetit të transportit të mallrave
- Reduktimi i kohës së transitit dhe kostove të transportit përgjatë zinxhirit të transportit të mallrave
- Reduktimi i bllokimit të trafikut në rrjetin rrugor kombëtar
- Reduktimi i konsumit të energjisë (ton/km)
- Reduktimi i shkarkimeve të CO₂
- Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe kalimi në modalitete transporti më efikase nga pikëpamja e trafikut
- Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni, si biokarburantet e qëndrueshme ose burimet e energjisë elektrike të rinovueshme
- Rritja e investimeve në sektorin e menaxhimit të transportit të mallrave
- Reduktimi i kostos së transportit nga origjina deri në destinacionin e mallrave (gjatë zinxhirit të transportit)

Nga pikëpamja mjedisore, kjo PM është në drejtimin e duhur, por besueshmëria për arritjen e objektivave do të fitohet vetëm kur të disponohet një bazë të dhënash e qëndrueshme dhe e besueshme, dhe kur të mos mbetet thjesht në fazë diskutimesh. Kompleksiteti i kësaj mase lidhet me një sërë institucionesh që duhet të koordinojnë veprimet e tyre për arritjen e objektivit (testimi i automjeteve, cilësia e lëndës djegëse, procedurat për administrimin e mallrave, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM2-NoM1 (kategoria B).

3. Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Reduktimi i vjetërsisë mesatare të makinave dhe rritja e standardit të kërkuar. Masa është konsistente me skenarin zbutës të INDC-së. Ajo përfshin ndalimin e regjistrimit dhe rritjen e taksave për automjetet e dorës së dytë, me qëllim reduktimin në maksimum të hyrjes së tyre në tregun shqiptar.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Masat e përshkruara në seksionin e masave të marra deri më tani
- Rritja e taksave vjetore në bazë të vjetërsisë së automjetit dhe llojit të lëndës djegëse të përdorur

Këto masa/veprime duhet të rakordohen nga sektorët e veprimtarisë dhe në bazë të nivelit të varfërisë. Nga pikëpamja mjedisore, masat/veprimet janë të mirëpritura.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM2-NoM1 (kategoria A).

4.1.2.2. Nënobjektivi mjedisor "Reduktimi i mbetjeve" OM2-NoM2

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM2-NoM2 është kryer në bazë të pritshmërive që zbatimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së nuk do të ndikojë në sasinë e mbetjeve apo nuk do të reduktojë sasinë e mbetjeve. Për më tepër, politikat dhe masat e parashikuara të PKEK-së rrisin sasinë e mbetjeve, menaxhimi i të cilave, në përputhje me rregulloret ose normën e ripërdorimit apo riciklimit, është 40% ose më e lartë.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthortë	I largët	Afatshkurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ?? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 21: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM2-NoM2

1. Krijimi i sasive të mëdha të mbetjeve të ndërtimit gjatë ndërtimeve në sektorin e transportit, infrastrukturës së energjisë dhe instalimeve
2. Sasi më të mëdha të baterive të përdorura për shkak të elektrifikimit të intensifikuar të qarkullimit
3. Ndikimet e mundshme për shkak të krijimit të sasive të mëdha të llumrave nga hidrocentralet
4. Grumbullimi i sasive të mëdha të paneleve fotovoltaike që kanë dalë jashtë përdorimit

4.1.2.2.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, që bazohet në hierarkinë e mbetjeve.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Hartimi i një plani për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve dhe i një programi për parandalimin e mbetjeve, në mbështetje të zbatimit të dokumentit politik strategjik për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe planit të veprimit
- Mbyllja dhe trajtimi i të gjitha vendgrumbullimeve bashkiake (të papajtueshme) për mbetjet e trashëguara, në përputhje me udhëzimet në fuqi
- Instalimi i impianteve të thithjes së metanit në vendgrumbullime
- Zbatimi i skemave kombëtare të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet e tyre

Për shkak të faktit se zbatimi i menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe rajonal është mbrapa në krahasim me aspektet e përdorimit të burimeve të energjisë dhe ndikimeve përkatëse nga pikëpamja e PKEK-së, kjo gjë sjell një boshllëk në zbatimin e PKEK-së. Po ashtu, boshllëku në fushën e menaxhimit të strukturave të 3 R-ve, mbetjeve të rrezikshme (bateritë, etj.), disavantazhon zbatimin e PM-së së përcaktuar nga PKEK-ja

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM2-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

2. Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Transporti i mbetjeve në impiantet e transformimit të mbetjeve në energji.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Pas ndjekjes së të gjitha proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, asgjësimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë Dokument dhe skemat teknike të përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund të dërgojnë në këto impiante të tjera mbetje të djegshme.
- Finalizimi i ndërtimit të incineratorëve në Tiranë dhe Fier.

Nga pikëpamja mjedisore, duhet të paracaktohet se procesi i incinerimit paraprihet nga procesi i zbatimit të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve (3 R-të). Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM2-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4.1.3. Objektivi mjedisor "Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera" (OM3)

4.1.3.1. Nënobjektivi mjedisor "Parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu dhe kufizimi i pasojave të tyre" OM3-NoM1

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM3-NoM1 është kryer në bazë të pritshmërive që gjatë zbatimit të politikave dhe masave të PKEK-së, nuk do të ketë ndërhyrje në zonat e rrezikut për fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, krijimin e burimeve të reja të rrezikut për fatkeqësitë natyrore dhe të llojeve të tjera, si dhe ndryshimin e pasojave të tyre ose që zbatimi i tyre do të reduktojë zonat e rrezikut për fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, do të reduktojë burimet e rreziqeve për fatkeqësitë natyrore dhe të llojeve dhe tjera dhe do të reduktojë pasojat e tyre.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthortë	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	- / +	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
5	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ?? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 22: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM3-NoM1

1. Ndikimi i mundshëm i konsiderueshëm në sigurinë e rrezikut të përmytjeve për shkak të vendndodhjes së infrastrukturës së re të energjisë,
2. Rrezik i mundshëm i konsiderueshëm për aksidente për shkak të ndërtimit të HEC-eve të reja,
3. Rritje e mundshme e rrezikut për zjarr për shkak të rritjes së përqindjes së automjeteve elektrike (makina dhe kamionë),
4. Rritje e mundshme e rreziqeve të zjarrit për shkak të instalimeve intensive të impianteve diellore,
5. Rritje e mundshme e potencialit për aksidente për shkak të instalimeve intensive të impianteve eolike

4.1.3.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-ja e mëposhtme konsiderohet e rëndësishme, prandaj shpjegohet dhe analizohet me detaje në vijim

1. Plani i emergjencës për gazin natyror

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i standardeve në lidhje me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, i kritereve të detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe eficient me gaz natyror, si dhe i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin e konsumatorëve me gaz.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Ndërlidhja në gazsjellësit rajonalë dhe ndërkombëtarë
- Financimi i projekteve për depozitimin e gazit

Siç u përmend në tabelën e mësipërme, politikat dhe masat për vlerësimin e karakteristikave ende nuk janë integruar në plan, ndërsa PM-ja që trajton planin e emergjencës për gazin natyror parashikohet të zbatohet. Këto plane kanë nevojë për një bazë të dhënash të detajuar, e cila përmban të dhëna të qëndrueshme dhe të besueshme. Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të

analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM3-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4.1.4. Objektivi mjedisor "Mbrojtja e habitateve natyrore dhe llojeve" (OM4)

4.1.4.1. Nënobjektivi mjedisor "Mbrojtja e biodiversitetit" OM4-NoM1

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM4-NoM1 është kryer në bazë të pritshmërive që masat e parashikuara të PKEK-së të mos interferojnë me habitatin e kafshëve dhe llojet e bimëve ose që ato të kenë një ndikim pozitiv në statusin e llojeve, në habitatet dhe biodiversitetin e tyre.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthorët	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
5	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 23: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM4-NoM1

1. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të ndërtimit të hidrocentraleve
2. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të ndërtimit të termocentraleve
3. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të zbatimit të projekteve për depozitat e gazit
4. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të projekteve që trajtojnë menaxhimin e mbetjeve (ITUP-et, incineratorët)
5. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të projekteve të investimit në rrjetin e energjisë elektrike

4.1.4.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

1. Plani i emergjencës për gazin natyror

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i standardeve në lidhje me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, i kriterëve të detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe eficient me gaz natyror, si dhe i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin e konsumatorëve me gaz.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Ndërlidhja në gazsjellësit rajonalë dhe ndërkombëtarë
- Financimi i projekteve për depozitimin e gazit

Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.). Për më tepër, zbatimi

i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (në cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, për projektet individuale së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

2. Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rinisja e operimit të TEC-it të Vlorës me furnizimin e gazit natyror përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) dhe degës së tij në Vlorë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i koncesionit

Nga pikëpamja mjedisore, zbatimi i kësaj PM-je do të ketë ndikim në mjedis, kryesisht në atmosferë dhe përgjatë zonës bregdetare. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

3. Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Një sistem i ri, i plotë dhe funksional për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Zhvillimi i projekteve dhe investime në transmetim dhe shpërndarje. TAP, Gazsjellësi Adriatiko-Jonian – IAP etj., sipas përcaktimit në planin strategjik.

Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.). Për më tepër, zbatimi i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (në cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, për projektet individuale së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4. Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rehabilitimi i rafinerive të Ballshit dhe Fierit sipas normave dhe standardeve evropiane, duke përfshirë miratimin e normave mjedisore për produktet dhe teknologjitë e tyre, rritja e kapacitetit të përpunimit të rafinerive deri në 1,5 Mt/vit, modernizimi i terminalit të Vlorës, si dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit nga Vlora në Ballsh.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Kryerja e studimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e dy rafinerive
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po merr në konsideratë edhe opsionin e ndërtimit të

rafinerive të reja me kapacitete prej 3,2 milionë tonë.

Kjo PM do të ketë efekte të konsiderueshme në mjedis (trupat ujqorë, toka, ajri, etj.). Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse. Duhet të mbahet parasysh se përpara bërjes së investimeve të reja, duhen marrë masa për rehabilitimin e ndikimeve të rafinerive ekzistuese në tokë, trupa ujqorë, ekosisteme, etj.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

5. Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lidhja e tubacioneve të reja të transmetimit në Shqipëri me rrjetin rajonal të gazit sipas opsionit më të mirë të projektit të IAP-së dhe ALKOGAP-it.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit
- Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare
- Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara

Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.). Për më tepër, zbatimi i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (në cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, për projektet individuale së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

6. Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- HEC-i i Moglicës (182,5MW në vitin 2021)
- Impianti fotovoltaiik lundruer i Vaut të Dejës (12,9MW në vitin 2022)
- Hidrocentrali i Skavicës

Zbatimi i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (cilësia e ujit, përdorimi i tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

7. Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e numrit të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura në Shqipëri dhe e përqindjes së popullsisë së lidhur me impiant trajtimi të ujërave të përdorura.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Harmonizimi i plotë me Direktivën “Për trajtimin e ujërave të përdorura urbane”
- Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura dhe ndërtimi i impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të parapëlqyera nga turistët
- Financimi shtetëror për ndërhyrjet e drejtpërdrejta në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të përdorura, mbështetja nga donatorët e huaj (kryesisht IPA III dhe donatorët dypalësh), kompanitë private (përmes Partneriteteve Publike Private) dhe projekti IPA (III) 2022 për sektorin e ujit në Shqipëri
- Mbledhje e tarifave për ujërat e përdorura nga qytetarët

Masat/veprimet e parashikuara i paraprijnë komponentit të lidhur me PKEK-në, por objektivi i drejtpërdrejtë të PKEK-së duhet të jetë prodhimi i energjisë së rinovueshme nga ITUP-i. Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

8. Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Transporti i mbetjeve në impiantet e transformimit të mbetjeve në energji.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Pas ndjekjes së të gjitha proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, asgjësimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë Dokument dhe skemat teknike të përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund të dërgojnë në këto impiante të tjera mbetje të djegshme.
- Finalizimi i ndërtimit të incineratorëve në Tiranë dhe Fier.

Nga pikëpamja mjedisore, duhet të paracaktohet se procesi i incinerimit paraprihet nga procesi i zbatimit të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve (3 R-të). Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

9. Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Mbështetja, në sajë të kuadrit rregullator dhe mekanizmave teknike e financiare, e intensifikimit të transportit publik si rezultat i problematikave mjedisore dhe ekonomike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik në mbarë qytetin, me anë të përmirësimit të rrjetit lokal të transportit publik, me anë të korsive të dedikuara të autobusëve etj.
- Rikonstruktimi i rrugëve që ka nisur tashmë në shkallë të gjerë dhe ka filluar të përmirësojë imazhin e transportit publik nëpërmjet rritjes së numrit dhe shpeshtësisë së autobusëve elektrikë që janë pjesë e rrjetit.
- Ndërtimi i Terminalit Publik të Transportit në Tiranë dhe i sistemit të autobusëve të transportit të shpejtë (BRT) Tiranë-Rinas
- Unaza e Tiranës (2016 – 2018) (përfundimi i anës jugperëndimore - i vonuar)
- Përmirësimi i transportit publik (flotë e re (elektrike dhe me etiketim)) dhe ndërtimi i 10 km korsi të dedikuara për biçikletat)

Për sa i përket investimeve të parashikuara nga kjo PM, ato do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

10. Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FIT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Rikonstruktimi dhe rehabilitimi i nënstacioneve elektrike
- Rikonstruktimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike
- Zbatimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit përmes PMU-së (Njësi matëse fazorësh).
- Krijimi i nyjave të reja të konjeksionit
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit, kontrollit dhe matjes
- Aksesimi dhe garantimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në rrjetin e transmetimit

Kjo pikëpamje forcon qëndrueshmërinë ekonomike të vendit. Nga pikëpamja mjedisore, projektet që do të zbatohen pritet të kenë ndikime të cilat do të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, ku do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, aksesit, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM1 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4.1.4.2. Nënobjektivi mjedisor "Mbrotjtja e zonave të ruajtjes së natyrës dhe e vlerave natyrore" OM4-NoM2

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM4-NoM2 është kryer në bazë të pritshmërive që masat e parashikuara të PKEK-së të mos kenë ndikim në zonat e mbrojtura dhe në vlerat natyrore të zonave të tyre me ndikim, ose që të ndikohen pozitivisht.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthorët	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
5	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ?? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 24: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM4-NoM2

1. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të ndërtimit të hidrocentraleve
2. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të ndërtimit të termocentraleve
3. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të zbatimit të projekteve për depozitat e gazit
4. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të projekteve që trajtojnë menaxhimin e mbetjeve (ITUP-et, incineratorët)
5. Përkeqësimi i statusit të mbrojtjes së biodiversitetit për shkak të projekteve të investimit në rrjetin e energjisë elektrike

4.1.4.2.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

1. Plani i emergjencës për gazin natyror

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i standardeve në lidhje me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, i kriterëve të detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe eficient me gaz natyror, si dhe i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin e konsumatorëve me gaz.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Ndërlidhja në gazsjellësit rajonalë dhe ndërkombëtarë
- Financimi i projekteve për depozitimin e gazit

Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.). Për më tepër, zbatimi i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (në cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, për projektet individuale së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në të sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

2. Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lidhja e tubacioneve të reja të transmetimit në Shqipëri me rrjetin rajonal të gazit sipas opsionit më të mirë të projektit të IAP-së dhe ALKOGAP-it.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit

- Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare
- Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara

Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.). Për më tepër, zbatimi i kësaj PM-je parashikohet të ketë ndikime (në cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, etj.), të cilat do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së, për projektet individuale së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në të sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

3. Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FIT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Rikonstruktimi dhe rehabilitimi i nënstacioneve elektrike
- Rikonstruktimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike
- Zbatimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit përmes PMU-së (Njësi matëse fazorësh).
- Krijimi i nyjave të reja të konjeksionit
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit, kontrollit dhe matjes
- Aksesimi dhe garantimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në rrjetin e transmetimit

Kjo pikëpamje forcon qëndrueshmërinë ekonomike të vendit. Nga pikëpamja mjedisore, projektet që do të zbatohen pritet që të kenë ndikime mjedisore, që të analizohen me hollësi në raportet përkatëse të VNMS-së, në të cilat do të identifikohen ndikimet specifike në mjedis dhe masat zbutëse (përdorimi i tokës, akses, ekosistemet, peizazhi, etj.).

Bazuar në të sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

4.1.5. Objektivi mjedisor "Qëndrueshmëria e mjedisit socio-ekonomik" (OM5)

4.1.5.1. Nënobjektivi mjedisor "Qëndrueshmëria mjedisore" OM5-NoM1

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM5-NoM1 është kryer në bazë të pritshmërive që zbatimi i politikave dhe masave të PKEK-së nuk do të rezultojë në huamarrje shtesë nga shteti. Do të reduktojë rrezikun financiar të sektorit të qeverisjes së përgjithshme. Do të bëjë të mundur reduktimin e shpenzimeve publike për të shmangur kostot shtesë për shkak të efekteve të ndryshimeve klimatike ose importeve të energjisë, dhe rrjedhimisht do të reduktojë borxhin publik.

Ndikim i	Pozitiv / Negativ	I menjëhersh	I tërthort	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrue	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
----------	-------------------	--------------	------------	----------	---------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-------------

		ëm	ë				shëm			
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
4	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
5	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 25: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM1

1. Ndikimi në rritjen e borxhit publik për shkak të huamarrjes për investime në sektorin e energjisë
2. Ndikimi në rritjen e borxhit publik për shkak të huamarrjes për investime në sektorin e transportit
3. Ndikimi në rritjen e borxhit publik për shkak të fatkeqësive
4. Ndikimi në reduktimin e shpenzimeve publike dhe të huamarrjes nga shteti për masat e përshtatjes lidhur me ndryshimet klimatike dhe rehabilitimin e pasojave të "borxhit natyror" për shkak të investimeve të familjeve në efikasitetin e energjisë, BRE-të, lëvizshmërinë e qëndrueshme dhe masat e përshtatjes
5. Ndikimi në reduktimin e borxhit publik, si rezultat i investimeve të shoqërive në masat e sektorit të energjisë dhe transportit dhe përshtatjen e tyre

4.1.5.1.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Krahas të gjitha masave për efikasitetin e energjisë (EE) dhe për burimet e energjisë së rinovueshme (BRE) dhe siç paraqitet në tabelën 5, PM-të shtesë si më poshtë lidhen drejtpërsëdrejti me qëndrueshmërinë ekonomike, prandaj konsiderohen si të rëndësishme dhe shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim.

1. Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rinisja e operimit të TEC-it të Vlorës me furnizimin e gazit natyror përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) dhe degës së tij në Vlorë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i koncesionit

Vrojtuar nga pikëpamja e sistemit të energjisë elektrike në Shqipëri dhe pozicioni që kërkohet t'i jepet termocentralit (rezervë për situatat emergjente), kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, ndikimet në atmosferë dhe bregdet analizohen në OM4.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

2. Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- HEC-i i Moglicës (182,5MW në vitin 2021)
- Impianti fotovoltai kundruar i Vaut të Dejës (12,9MW në vitin 2022)
- Hidrocentrali i Skavicës

Vrojtuar nga pikëpamja e sistemit të energjisë elektrike në Shqipëri dhe pozicioni që kërkohet t'i jepet këtyre investimeve, kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, ndikimet në ujë dhe tokë analizohen në OM4.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

3. *Kuadri ligjor plotësisht funksional për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët*

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Furnizimi i sigurt dhe i qëndrueshëm i konsumatorëve me gaz natyror përmes krijimit të një tregu konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale dhe evropiane, dhe ofrimi i një shërbimi cilësor, me kosto të arsyeshme, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike, të transmetimit e të shpërndarjes.

Nga pikëpamja ekonomike, gazifikimi i Shqipërisë shton një burim të dytë të energjisë elektrike dhe kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.), ndikimet mjedisore janë të konsiderueshme. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

4. *Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit*

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Një sistem i ri, i plotë dhe funksional për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Zhvillimi i projekteve dhe investime në transmetim dhe shpërndarje. TAP, Gazsjellësi Adriatiko-Jonian – IAP etj., sipas përcaktimit në planin strategjik.

Nga pikëpamja ekonomike, gazifikimi i Shqipërisë shton një burim të dytë të energjisë elektrike dhe kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.), ndikimet mjedisore janë të konsiderueshme. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

5. *Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit*

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit sipas opsionit më të mirë (Korridori Jugor i Gazit dhe Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë, TAP, IAP, Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë "(projekti ALKOGAP)).*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit
- Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare
- Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara

Nga pikëpamja ekonomike, gazifikimi i Shqipërisë shton një burim të dytë të energjisë elektrike dhe kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.), ndikimet mjedisore janë të konsiderueshme. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

6. Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rehabilitimi i rafinerive të Ballshit dhe Fierit sipas normave dhe standardeve evropiane, duke përfshirë miratimin e normave mjedisore për produktet dhe teknologjitë e tyre, rritja e kapacitetit të përpunimit të rafinerive deri në 1,5 Mt/vit, modernizimi i terminalit të Vlorës, si dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit nga Vlora në Ballsh.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Kryerja e studimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e dy rafinerive
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po merr në konsideratë edhe opsionin e ndërtimit të rafinerive të reja me kapacitete prej 3,2 milionë tonë.

Nga pikëpamja ekonomike, vlerësimi i kësaj PM-je i përket ekspertëve përkatës. Nga pikëpamja mjedisore, ndikimet në ujë dhe tokë analizohen në OM4. Duhet të mbahet parasysh se përpara bërjes së investimeve të reja, duhen marrë masa për rehabilitimin e ndikimeve të rafinerive ekzistuese në tokë, trupa ujqorë, ekosisteme, etj.

Bazuar në të sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM4-NoM2 (kategoria C), për shkak të zbatimit të masave zbutëse.

7. Plani i emergjencës për gazin natyror

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i standardeve në lidhje me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, i kriterëve të detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe eficient me gaz natyror, si dhe i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin e konsumatorëve me gaz.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike
- Ndërlidhja në gazsjellësit rajonalë dhe ndërkombëtarë
- Financimi i projekteve për depozitimin e gazit

Nga pikëpamja ekonomike, gazifikimi i Shqipërisë shton një burim të dytë të energjisë elektrike dhe kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.), ndikimet mjedisore janë të konsiderueshme. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

8. Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Projektligji i ri përcakton procedurat e nevojshme për ndërhyrjen në rastet e mangësive të rënda të produkteve të naftës në treg. Në rast vështirësish në furnizim, vënia në përdorim e rezervave vendoset nga qeveria, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe me miratimin e komitetit të qeverisë për menaxhimin e krizave.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i ligjit të ri nga qeveria dhe parlamenti shqiptar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

9. Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lidhja e tubacioneve të reja të transmetimit në Shqipëri me rrjetin rajonal të gazit sipas opsionit më të mirë të projektit të IAP-së dhe ALKOGAP-it.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit
- Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare
- Financimi dhe zbatimi i projekteve prioritare të miratuara

Nga pikëpamja ekonomike, gazifikimi i Shqipërisë shton një burim të dytë të energjisë elektrike dhe kjo PM, nga pikëpamja ekonomike dhe qëndrueshmëria kombëtare, është pozitive. Nga pikëpamja mjedisore, gazi kontribuon në rritjen e efektit serrë dhe akoma më shumë në një vend ku burimet e energjisë së rinovueshme kanë mundësi zgjerimi (Skavica, Moglica, etj.), ndikimet mjedisore janë të konsiderueshme. Këto do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale, së bashku me masat zbutëse përkatëse.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM1 (kategoria B).

4.1.5.2. Nënobjektivi mjedisor "Zhvillimi i një qasjeje për adresimin e problemit të varfërisë energjetike" OM5-NoM2

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM5-NoM2 është kryer në bazë të pritshmërive që zbatimi i politikave dhe masave të PKEK-së do të përcaktojë kriteret për identifikimin e varfërisë energjetike dhe një plan për zhdukjen e saj përmes mekanizmave financiarë, gjë që do të garantojë një reduktim të ndjeshëm të familjeve që vuajnë nga varfëria energjetike.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?		?	?	?	?	?
3	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 26: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM2

1. Ndikimi i rritjes së numrit të familjeve që vuajnë nga varfëria energjetike si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë
2. Ndikimi në aksesin e familjeve që vuajnë nga varfëria energjetike në kapitalin për investime në efikasitetin e energjisë dhe në burime të rinovueshme,
3. Ndikimi në kostot e energjisë për familjet që vuajnë nga varfëria energjetike

4.1.5.2.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-ja e mëposhtme konsiderohet e rëndësishme, prandaj shpjegohet dhe analizohet me detaje në vijim

1. Eliminimi i varfërisë energjetike

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i varfërisë energjetike dhe krijimi i një sistemi kombëtar për monitorimin sistematik të saj dhe rekomandimi i masave për eliminimin e varfërisë energjetike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Përkufizimi i qartë i varfërisë energjetike.
- Krijimi i një sistemi kombëtar për monitorimin sistematik të saj dhe rekomandimi i masave për eliminimin e varfërisë energjetike në bazë të përvojës së vendeve të BE-së.
- Kryerja e një studimi për të përllogaritur numrin e personave që janë përballur me varfëri energjetike në vend, si dhe arsyet pas kësaj.

Rritja e nivelit të punësimit, kryesisht përmes investimeve në sektorin e energjisë dhe të ndërtimit, ka sjellë rritje të të ardhurave personale/familjare, gjë që është shoqëruar me një rritje të standardit të jetesës të shoqërisë. Ekziston një lidhje e fortë midis mirëqenies personale dhe asaj shoqërore, çka do të thotë se investimet jo vetëm që krijojnë vende pune, por kanë gjithashtu ndikim në të ardhurat e bashkive dhe ato të qeverisë që vijnë nga taksat, tarifat etj., si dhe në përdorimin e tyre në formë buxheti për t'u shpenzuar në sektorë si shëndetësia, arsimit etj. Më konkretisht, objektivat për efikasitetin e energjisë synojnë të reduktojnë konsumin e energjisë për njësi, dhe kështu që kontribuojnë në furnizimin e përbalueshëm me energji, si dhe në reduktimin e varfërisë së saj. Megjithatë, siç përmendet në PKEK, varfëria energjetike nuk është përcaktuar ende qartë dhe nuk monitorohet në mënyrë sistematike.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM2 (kategoria B).

4.1.5.3. Nënobjektivi mjedisor "Ekonomia qarkulluese si një faktor kyç në reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe në krijimin e një industrie konkurruese" OM5-NoM3

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM5-NoM3 është kryer në bazë të pritshmërive që zbatimi i politikave dhe masave të PKEK-së do të bëjë të mundur kalimin sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese dhe do të garantojë një kategorizim ndërmjet rritjes ekonomike dhe shkarkimeve të GES-ve, në atë masë Shqipëria të prezantojë praktika të mira.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthorë	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	-	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ?? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 27: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM3

1. Ndikimet në produktivitetin e shkarkimeve të vendit përmes reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë ose përdorimit të lëndëve djegëse fosile në transport përmes elektrifikimit, duke rritur përqindjen e transportit publik dhe transferimin e transportit të mallrave me tren
2. Ndikimi në ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve
3. Ndikimi në prezantimin e ekonomisë qarkulluese përmes zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të lidhura me objektivat dhe masat e PKEK-së

4.1.5.3.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, evropian dhe botëror në sektorin e energjisë. Ndër të tjera, pjesëmarrja e studiuesve dhe novatorëve shqiptarë në planin SET do të rrisë shanset e tyre në programet evropiane për organizatat kërkimore dhe NVM-të: Platformat evropiane për teknologjinë dhe novacionin (ETIPs) përbëjnë komunitetin e "industrisë/inovacionit" të planit SET, ndërsa Aleanca Evropiane për Kërkimet në Sektorin Energjetik (EERA) përbën komunitetin "kërkimor"

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetje financiare për iniciativat.
- Grante për aktorët e kërkimit dhe inovacionit për të marrë pjesë në forume të tilla si EERA dhe ETIP
- Grante për aktorët e kërkimit dhe inovacionit për përgatitjen e projekteve / paraqitjen e propozimeve
- Financimi i mjedisit mundësues (baza e të dhënave, takimet, trajnimet etj.)
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket klimës së biznesit
- Lehtësimi i krijimit të një shoqërie të re (start-up) nga një ndërmarrje kërkimore universitare
- Nxitja e kërkimit shkencor dhe inovacionit në nivel kombëtar dhe rajonal
- Publikimi i mundësive, shembujve të mirë dhe historive të suksesit në mediat sociale, si dhe në

portalet dhe faqet përkatëse të internetit

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM5-NoM3 (kategoria A).

2. Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e përvitshme e shpenzimeve publike për kërkim shkencor që i jepen Institucioneve të Arsimit të Lartë*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren, për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Mbështetje financiare për nismat e dedikuara të kërkimit dhe inovacionit në lidhje me energjinë dhe klimën:
 - o Kërkim i aplikuar (TRL 6-7)
 - o Projekte demonstruese (TRL 8-9)
 - o Aktivitetet e hedhjes në treg
 - o Fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit “Biznes-Biznes” dhe “Biznes-Klient”

Kjo PM trajton (1) mungesat në buxhet, personel dhe kushte pune (2) nevojën për fuqizimin e veprimeve të kërkimit dhe inovacionit në 5 fushat me përparësi, duke përfshirë bujqësinë, mjedisin, ujin dhe energjinë dhe teknologjinë e informacionit. Shqipëria duhet të identifikojë karakteristikat e saj specifike në kërkim dhe zhvillim, përpara se të futet në tregun ndërkombëtar.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM3 (kategoria B).

3. Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës

Siç specifikohet në PKEK, objektivi i përgjithshëm i kësaj PM-je është: *Arritja e zhvillimit dhe punësimit, duke u mundësuar qarqeve të Shqipërisë që të identifikojnë dhe zhvillojnë avantazhet e tyre konkurruese specifike në fushën e Ujit dhe Energjisë, ushqimit dhe bioteknologjisë, biodiversitetit dhe mjedisit, TIK-ut.*

Objektivi specifik është: *Demonstrimi i mënyrës sesi autoritetet vendore, universitetet, bizneset dhe shoqëria civile e një qarku të caktuar punojnë bashkërisht për të zhvilluar avantazhin e tyre konkurrues specifik në një fushë me përparësi, si dhe përfitimet që sjell kjo gjë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Sipas një qasjeje nga poshtë-lart, autoritetet vendore, universitetet, bizneset dhe shoqëria civile punojnë së bashku për të zbatuar strategji afatgjata të zhvillimit.
 - o Vlerësimi i nevojave: Identifikimi i qarkut dhe fusha kryesore e ndërhyrjes
 - o Studimi i fizibilitetit: ToR, Prokurimi, Zbatimi
 - o Zbatimi i projektit demonstrues

Shqipëria, në mënyrë që të bëhet konkurruese, duhet të bëjë lidhjen midis qendrave akademike dhe kërkimore me nevojat e tregut vendas. Këtu duhet të përfshihet kërkimi shkencor i integruar ndërmjet aspekteve mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM3 (kategoria B).

4.1.5.4. Nënobjektivi mjedisor "Zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme të interkoneksioneve dhe rrjetit inteligjent" OM5-NoM4

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së lidhur me OM5-NoM4 është kryer në bazë të pritshmërive që zbatimi i politikave dhe masave të PKEK-së do të garantojë infrastrukturën dhe interkoneksionet e përshtatshme të rrjetit inteligjent

Ndikim i	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkuftar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ?? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 28: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuar të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM4

- 1 Ndikimi në zhvillimin e rrjeteve inteligjente dhe efçente të shpërndarjes së energjisë elektrike
- 2 Ndikimi në zhvillimin e shoqërisë digjitale përmes zhvillimit të rrjeteve inteligjente

4.1.5.4.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Siç paraqitet në tabelën 5, PM-të e mëposhtme konsiderohen të rëndësishme, prandaj shpjegohen dhe analizohen me detaje në vijim

1. Ndërlidhësit elektrikë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Përcaktimi i kërkesave dhe procedurave të nevojshme për marrjen e autorizimit për ndërtimin e linjave të reja të interkoneksionit me tension të lartë (110 kV dhe më shumë) nga Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit ose nga investitorët privatë.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike dhe të efçencës së energjisë

Kjo PM është pozitive nga pikëpamja ekonomike. Nga pikëpamja mjedisore, është e nevojshme të garantohet siguria lidhur me reduktimin e rreziqeve të zjarreve dhe dëmtimeve të faunës.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM4 (kategoria B).

2. Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e kapacitetit të rrjetit të energjisë elektrike, në transmetim dhe në shpërndarje, për të shfrytëzuar më shumë burime të energjisë së rinovueshme. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FIT dhe ato të matjes së energjisë neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Rikonstruktimi dhe rehabilitimi i nënstacioneve elektrike
- Rikonstruktimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike
- Zbatimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit përmes PMU-së (Njësi matëse fazorësh).
- Krijimi i nyjave të reja të konjeksionit
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit, kontrollit dhe matjes

- Aksesimi dhe garantimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në rrjetin e transmetimit

Kjo PM forcon qëndrueshmërinë ekonomike të vendit. Nga pikëpamja mjedisore, projektet që do të zbatohen, pritet që të kenë ndikime mjedisore, të cilat analizohen në seksionin përkatës të këtij raporti.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM4 (kategoria B).

3. Lehtësimi i marrëdhënies rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Lehtësimi i shtimit të kapacitetit të ri të energjisë së rinovueshme.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Të gjitha masat rregullatore të nevojshme për arritjen e objektivit.

Nga pikëpamja ekonomike, vlerësimi i kësaj PM-je i përket ekspertëve përkatës. Nga pikëpamja sociale dhe mjedisore, fokusi duhet të jetë sa më pranë aplikimeve të EE-së, BRE-ve dhe CEC-it.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM4 (kategoria B).

4. Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Rritja e operueshmërisë së rrjetit shpërndarës për të përballuar shpërndarjen e një kapaciteti më të lartë të energjisë së rinovueshme*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Operatori i shpërndarjes, së bashku me ministrinë dhe entin rregullator, do të marrin përsipër kryerjen e studimeve për të vlerësuar potencialin real të menaxhimit të krahut të kërkesës dhe rezervave në Shqipëri. Në bazë të këtyre studimeve, duhet të ndërmerren disa masa zbatuese.

Nga pikëpamja ekonomike, vlerësimi i kësaj PM-je i përket ekspertëve përkatës. Nga pikëpamja sociale dhe mjedisore, ndikimet e mundshme ose të pritshme do të analizohen në raportet përkatëse të VNMS-së për projektet individuale.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je do të ketë një ndikim të papërfillshëm mbi OM5-NoM4 (kategoria B).

5. Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë

PKEK-ja përcakton objektivin kryesor të kësaj PM-je, që është: *Krijimi i një strategjie për matjen dhe avancimi drejt një sektori më të digjitalizuar të energjisë elektrike.*

Masat/veprimet e parashikuara që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin e kësaj PM-je janë:

- Hartimi i një strategjie matjeje
- Zbatimi i strategjisë së matjes dhe instalimi i matësve inteligjentë
- Ndërtimi i kapaciteteve të operatorëve për administrimin e matësve inteligjentë, si dhe pajisjeve dhe të dhënave përkatëse

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i kësaj PM-je nuk do të ketë ndikim mbi OM5-NoM4 (kategoria A).

4.1.5.5. Nënobjektivi mjedisor "Edukimi lidhur me energjinë dhe klimën" OM5-NoM5

Analiza dhe vlerësimi i politikave dhe masave përkatëse të PKEK-së në lidhje me OM5-NoM5 është kryer në bazë të pritshmërive që: Zbatimi i PKEK-së do të kontribuojë në mënyrë aktive në zgjerimin e njohurive të grupeve të interesit lidhur me çështjet e klimës dhe energjisë. Përmes interesit publik në rritje, do të ofrojë mbështetje në masë më të madhe për arritjen e objektivave dhe informimin lidhur me çështjen, si dhe do të garantojë pjesëmarrjen e përshtatshme në zbatimin dhe planifikimin e masave të mëtejshme.

Ndikimi	Pozitiv / Negativ	I menjëhershëm	I tërthor	I largët	Afatsh kurtër	Afatmesëm	I qëndrueshëm	Kumulativ	Sinergjik	Ndërkufitar
1	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
2	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?
3	+	?	?	?	?	?	?	?	?	?

Legjenda: + ndikimi është pozitiv, - ndikimi është negativ, ? ndikimi mbart këtë veti, ? ndikimi nuk mbart këtë veti

Tabela 29: Përcaktimi i karakteristikave të ndikimeve të konsiderueshme të identifikuara të zbatimit të PKEK-së në OM5-NoM5

- 1 Ndikimi në ndryshimet klimatike dhe ndërgjegjësimin në lidhje me energjinë
- 2 Ndikimi në njohuritë e përgjithshme në fushën e energjisë, lëvizshmërisë dhe ndryshimeve klimatike
- 3 Ndikimi në motivacionin për të bërë ndryshime në qëndrime dhe investime

4.1.5.5.1. Vlerësimi i planeve dhe masave të PKEK-së

Dokumenti i PKEK-së parashikon një sërë veprimesh/masash në fushën e trajnimit, edukimit, informimit dhe promovimit. Ato janë të renditura më poshtë. Kostoja e këtyre masave/veprimeve përfshihet në buxhetin total të PM-së përkatëse.

- Trajnimi i operatorëve industrialë lidhur me asimilimin dhe zbatimin e ETS-së në Shqipëri
- Trajnimi i fermerëve lidhur me zbatimin e kodit të PMB-ve, praktikën e djegies së mbetjeve bujqësore, monitorimin bujqësor, etj.
- Trajnimi i NVM-ve për: (i) Mbështetjen e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor; (ii) menaxhimin e energjisë
- Trajnimi dhe orientimi i autoriteteve publike për masat për EE-në, lidhur me procedurat e blerjes
- Informacioni për konsumatorin dhe masat e trajnimit lidhur me kërkesat për etiketimin e energjisë dhe dizajnin ekologjik
- Trajnimi për përmirësimin e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin energjetik
- Programe trajnimi për strategjinë e zhvillimit të biznesit dhe investimeve
- Udhëzime ose skema me bazë edukative lidhur me politikat për mbështetjen e BRE-ve në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes
- Përgatitja e kurrikulës për të gjitha nivelet arsimore, duke përfshirë fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të pakualifikuar

- Krijimi i grupeve të pasuruara të të dhënave dhe arkivave dhe shkëmbimi i informacionit midis të gjitha institucioneve të përfshira në MMR
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet informimit lidhur me çështjet shqetësuese nga qeveria, bashkitë dhe shoqëria civile
- Do të ofrohet trajnim për autoritetet kompetente dhe grupet e interesit për zbatimin e kërkesave, për të garantuar disponueshmërinë e informacionit për konsumatorët lidhur me kursimin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO2.
- Promovimi i bujqësisë organike
- Promovimi i agropylltarisë me pemë frutore, incentiva financiare ose për tokën, me fidanë, etj.
- Promovimi i gjelbërimit rrugor dhe urban në parqe, përreth burimeve ujore dhe në zonat e ndjeshme, me qëllim rritjen e sipërfaqes së mbuluar me pemë/gjelbërim dhe parandalimin e rreziqeve natyrore
- Ruajtjen dhe promovimin e funksioneve produktive të pyjeve (lëndë drusore dhe jodrusore).
- Promovimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, me anë të zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë
- Zhvillimi i platformave të pjesëmarrjes për promovimin (ndërgjegjësimin), zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël
- Promovimi i politikave më të mira të Efiçencës së Energjisë në Industri (EEI) dhe promovimi i teknologjive novatore të efiçencës së energjisë, që janë specifike për sektorin

Masat/veprimet e parashikuara do të përmirësojnë njohuritë e përgjithshme lidhur me energjinë dhe do të shtojnë aktivitetin e grupeve të interesit (NVM-ve, institucioneve publike, familjeve, etj.) përmes masave në fushën e efiçencës së energjisë dhe të burimeve të energjisë së rinovueshme.

Bazuar në sa më sipër, mund të konstatohet se zbatimi i PKEK-së do të ketë një ndikim pozitiv në OM5-NoM5 (kategoria A).

4.1.6. Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisorë

Tabela 30 paraqet një përmbledhje të vlerësimit të zbatimit të PKEK-së në lidhje me objektivat mjedisorë. Tabela është strukturuar në bazë të kategorisë së vlerësimit të ndikimit për secilën PM, lidhur me objektivin/nënobjektivin mjedisor përkatës (siç përshkruhet në Seksionin 1.4.2 Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së).

Kategori a	Përkufizimi i kategorisë
A	Zero ndikime ose ndikim pozitiv
B	Ndikim i pakonsiderueshëm
C	Ndikim i pakonsiderueshëm si rezultat i zbatimit të masave zbutëse
D	Ndikim i konsiderueshëm
E	Ndikim shkatërrues
X	Ndikim i papërcaktueshëm

Për më tepër, vlerësimi i ndikimeve të PM-ve ka vijuar më tej me përcaktimin e nivelit të pajtueshmërisë së politikave dhe masave të PKEK-së me objektivat/nënobjektivat mjedisorë. Në tabelën 31 paraqitet një krahasim i zakonshëm i PM-ve në fjalë me OM-të/NM-të. Vlerësimi paraqitet sipas ndarjes së mëposhtme:

Kodi i ngjyrave	Shpjegimi
E gjelbër	PM-ja është në pajtueshmëri të lartë me OM-të/NM-të
E verdhë	PM-ja është në pajtueshmëri të pjesshme me OM-të/NM-të
E kuqe	PM-ja pajtohet në mënyrë të kushtëzuar me OM-të/NM-të

Ekziston një korrelacion ndërmjet kategorive (A, B dhe C) në tabelën 30 dhe shkallës së vlerësimit (Pajtueshmëri e lartë, pajtueshmëri e pjesshme dhe pajtueshmëri e kushtëzuar) në tabelën 31. Korrelacioni ndërmjet dy tabelave është si më poshtë:

Tabela 30	Tabela 31
Kategoria A	Pajtueshmëri e lartë
Kategoria B	Pajtueshmëri e pjesshme
Kategoria C	Pajtueshmëri e kushtëzuar

Numri absolut i kategorive përkatëse për secilën PM, d.m.th. numri i A-ve, B-ve dhe C-ve në tabelën 30, është konvertuar në pikë përqindjeje në shkallën e vlerësimit, d.m.th. PL%, PP% dhe PK% në tabelën 31. Për shembull, **PM-ja 9 “Plani i emergjencës për gazin natyror”** në tabelën 30 është vlerësuar me **një B** dhe **tre C**, sipas OM-ve-NM-ve përkatëse. Prandaj, **PM-ja 9** në tabelën 23 **Pajtohet Pjesërisht 25%** dhe **Pajtohet në mënyrë të kushtëzuar në masën 75%**.

Tabela 30: Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PKEK-së në objektivat mjedisore

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Objektivat/nënobjektivat mjedisorë OM-NM																
		OM1- NoM1	OM1- NoM2	OM1- NoM3	OM1- NoM4	OM1- NoM5	OM1- NoM6	OM1- NoM7	OM2- NoM1	OM2- NoM2	OM3- NoM1	OM4- NoM1	OM4- NoM2	OM5- NoM1	OM5- NoM2	OM5- NoM3	OM5- NoM4	OM5- NoM5
1	Veprimet/masat në fushën e trajnimit, edukimit, informimit dhe promovimit																	A
2	Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”													B				
3	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë			B				B										
4	Menaxhimi i krahut të kërkesës dhe sistemet e rezervave të energjisë elektrike për fleksibilitet të rrjetit elektrik			A													B	
5	Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës															B		
6	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës				B				A									
7	Ndërlidhësit elektrikë																B	
8	Elektrifikimi i sektorit të transportit		B	B														
9	Plani i emergjencës për gazin natyror										C	C	C	B				
10	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet				A					C								
11	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	C	A															
12	Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	B	A					B										
13	Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	B	A															

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Objektivat/nënobjektivat mjedisorë OM-NM																
		OM1- NoM1	OM1- NoM2	OM1- NoM3	OM1- NoM4	OM1- NoM5	OM1- NoM6	OM1- NoM7	OM2- NoM1	OM2- NoM2	OM3- NoM1	OM4- NoM1	OM4- NoM2	OM5- NoM1	OM5- NoM2	OM5- NoM3	OM5- NoM4	OM5- NoM5
14	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	B						B										
15	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të	A																
16	Menaxhimi ekologjik i pyjeve				A	A												
17	Eliminimi i varfërisë energjetike														B			
18	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së				A												B	
19	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.			A														
20	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa (sektori privat)	A	A															
21	Kuadri ligjor plotësisht funksional për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët													B				
22	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës											C		B				
23	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit											C		B				
24	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri				A													
25	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	C	B															
26	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri				B													
27	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë		A		A				B									
28	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë															A		
29	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës				C							C						

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Objektivat/nënobjektivat mjedisorë OM-NM																
		OM1- NoM1	OM1- NoM2	OM1- NoM3	OM1- NoM4	OM1- NoM5	OM1- NoM6	OM1- NoM7	OM2- NoM1	OM2- NoM2	OM3- NoM1	OM4- NoM1	OM4- NoM2	OM5- NoM1	OM5- NoM2	OM5- NoM3	OM5- NoM4	OM5- NoM5
30	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të automjeteve.						A											
31	Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve											C		C				
32	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave				B	B												
33	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)						C					C						
34	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave				C				B									
35	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	A						B										
36	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë											C	C	B				
37	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit													B				
38	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)	C	B															
39	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla të rinovueshme			B														
40	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW			B														
41	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë			A													A	
42	Planet bashkiake të veprimit për efikasitetin e energjisë, zbatimimi dhe raportimi	B	A															
43	Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit															B		
44	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica											C		B		B		

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Objektivat/nënobjektivat mjedisorë OM-NM																
		OM1- NoM1	OM1- NoM2	OM1- NoM3	OM1- NoM4	OM1- NoM5	OM1- NoM6	OM1- NoM7	OM2- NoM1	OM2- NoM2	OM3- NoM1	OM4- NoM1	OM4- NoM2	OM5- NoM1	OM5- NoM2	OM5- NoM3	OM5- NoM4	OM5- NoM5
45	Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen			A	A													
46	Promovimi i bujqësisë organike				B													
47	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi				B													
48	Rikonstruktimi i ndërtesave ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)	A	A					B										
49	Rikonstruktimi i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisë qendrore)	A	A					B										
50	Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme			C								C	C				B	
51	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	B						B										
52	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor			A														
53	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara		B	A		B												
54	Zbatimi i modeleve të ESCO	A	A															
55	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri				C				C			C						

Tabela 31: Krahasimi i PM-ve specifike në varësi të pajtueshmërisë së tyre me OM-të/NM-të, përqindjet e ndikimeve të vlerësuara

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Shkalla e vlerësimit		
		PL%	PP%	PK%
1	Veprimet/masat në fushën e trajnimit, edukimit, informimit dhe promovimit	100,00	00,00	00,00
2	Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”	00,00	100,00	00,00
3	Ankandet për kapacitetet e reja të energjisë së rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë	00,00	100,00	00,00
4	Sistemet e menaxhimit të kërkesës dhe të energjisë për fleksibilitetin e rrjetit elektrik akumulimit	50,00	50,00	00,00
5	Demonstrimi i inovacionit dhe konkurrencës	00,00	100,00	00,00
6	Tarifat e makinave mbi bazën e efijencës për rinovimin e flotës dhe incentivat	50,00	50,00	00,00
7	Ndërlidhësit elektrikë	00,00	100,00	00,00
8	Elektrifikimi i sektorit të transportit	00,00	100,00	00,00
9	Plani i emergjencës për gazin natyror	00,00	25,00	75,00
10	Reduktimi i shkarkimeve nga mbetjet	50,00	00,00	50,00
11	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	50,00	00,00	50,00
12	Masat për efijencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	33,33	66,67	00,00
13	Skema detyruese e efijencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	50,00	50,00	00,00
14	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	00,00	100,00	00,00
15	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NVM-të	100,00	00,00	00,00
16	Menaxhimi ekologjik i pyjeve	100,00	00,00	00,00
17	Eliminimi i varfërisë energjetike	00,00	100,00	00,00
18	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së	50,00	50,00	00,00
19	Lehtësimi i lidhjes rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.	100,00	00,00	00,00
20	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa (sektori privat)	100,00	00,00	00,00
21	Kuadri ligjor plotësisht funksional për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët	00,00	100,00	00,00
22	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	00,00	50,00	50,00
23	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit	00,00	50,00	50,00
24	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	100,00	00,00	00,00
25	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	00,00	50,00	50,00
26	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri	00,00	100,00	00,00
27	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra-urbanë	66,67	33,33	00,00
28	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin e energjisë	100,00	00,00	00,00
29	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	00,00	00,00	100,00
30	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të automjeteve.	100,00	00,00	00,00
31	Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	00,00	00,00	100,00
32	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave	00,00	100,00	00,00
33	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)	00,00	00,00	100,00
34	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave	00,00	50,00	50,00
35	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	50,00	50,00	00,00
36	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë	00,00	33,33	66,67

Nr.	Politikat dhe Masat (PM)	Shkalla e vlerësimit		
		PL%	PP%	PK%
37	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit	00,00	100,00	00,00
38	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat dhe private) publike	00,00	50,00	50,00
39	Mekanizmi i tarifës "feed-in" për kapacitetet e vogla të rinovueshme	00,00	100,00	00,00
40	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW	00,00	100,00	00,00
41	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit të energjisë	100,00	00,00	00,00
42	Planet bashkiake të veprimit për efikasitetin e zbatimi dhe raportimi energjisë,	50,00	50,00	00,00
43	Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit	00,00	100,00	00,00
44	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica	00,00	66,67	33,33
45	Politikat për mbështetjen e BRE-ve për ngrohjen dhe ftohjen	100,00	00,00	00,00
46	Promovimi i bujqësisë organike	00,00	100,00	00,00
47	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi	00,00	100,00	00,00
48	Rikonstruksioni i godinave ekzistuese të qeverisjes qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)	66,67	33,33	00,00
49	Rikonstruksioni i stokut të (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të ndërtesave publike qeverisjes qendrore)	66,67	33,33	00,00
50	Rrjet i fuqishëm elektrik për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme	00,00	33,33	66,67
51	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	00,00	100,00	00,00
52	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor	100,00	00,00	00,00
53	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	33,33	66,67	00,00
54	Zbatimi i modeleve të ESCO	100,00	00,00	00,00
55	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri	00,00	00,00	100,00

Legjenda: PL% – përqindja e PM-ve në pajtueshmëri të lartë, PP% – përqindja e PM-ve në pajtueshmëri të pjesshme, PK% – përqindja e PM-ve në pajtueshmëri të kushtëzuar

pajtueshmëri e lartë
 pajtueshmëri e pjesshme
 pajtueshmëri e kushtëzuar

4.2. Ndikimet ndërkufitare

Bashkëpunimi ndërkufitar është çelësi për rritjen e nivelit të energjisë diellore në rrjetin e energjisë elektrike dhe për arritjen e ekonomive të shkallës për sa i përket financimit të zbatimit të masave për efikasitetin e energjisë, ndër të tjera në rinovimin e ndërtesave, si p.sh. përmes agregimit të projekteve. Në këtë drejtim, shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi për zhvillimin e strategjive është me rëndësi thelbësore për koordinimin e vendimeve me rëndësi ekonomike.

Një tjetër sektor thelbësor me rëndësi ndërkufitare është sektori i transportit. Dokumenti aktual “Strategjia Kombëtare Sektoriale për Transportin 2016- 2020” është përafëruar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila parashtrohet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj kombëtar shoqëror, demokratik dhe ekonomik gjatë periudhës 2015- 2020. Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës shqiptare të transportit ka qenë dhe mbetet një prej prioriteteve kryesore të qeverisë shqiptare.

Për sa i përket integritit në tregun evropian të energjisë, është i rëndësishëm bashkëpunimi me:

- ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike)
- ENTSO-G (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Gazit)

Për qëllimet e inovacionit, është mjaft e rëndësishme që të thellohet bashkëpunimi në fushën e kërkimit lidhur me tema janë me rëndësi të veçantë për rajonin.

Baza për bashkëpunimin rajonal, duke përfshirë edhe atë ndërkufitar, është Komuniteti i Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë organizon grupe të ndryshme pune të cilat ofrojnë një platformë për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave lidhur me çdo dimension të PKEK-së.

Gjithashtu, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë prezanton studime dhe nisma të rëndësishme për rajonin, duke përfshirë, ndër të tjera:

- Nismën e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor
- Studimin e Komunitetit të Energjisë për çmimet e karbonit (studim i nisur në janar të vitit 2020 <https://energy-community.org/news/Energy-Community-News/2020/02/03.html>)

Në mënyrë më specifike, për sa i përket PKEK-së për Shqipërinë, mund të cilësohet se PM-të lidhur me nënobjektivin mjedisor "Reduktimi i shkarkimeve të elementeve ndotëse të ajrit" mund të pritët të kenë edhe ndikime të drejtpërdrejta, afatshkurtra dhe ndërkufitare për shkak të shkarkimeve në ajër të substancave si rezultat i trafikut përgjatë kufirit me vendet fqinje apo në zonat e kalimit kufitar, në masën e bllokimit të trafikut në atë zonë.

Sipas parashikimeve për reduktimin e shkarkimeve në nivel kombëtar të elementeve ndotëse individuale, reduktimi i ndotësve ndërkufitarë me rreze të gjatë dhe asgjësimi i tyre në vendet fqinje dhe e anasjella mund të pritët që të vazhdojë në të ardhmen. Një gjë e tillë do të reduktojë gjithashtu ndikimin në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Parashikohet që zbatimi i PKEK-së të sjellë modernizimin e rrjetit të transportit (me fokus te transporti hekurudhor), gjë që do të ketë një ndikim pozitiv në kapacitetet rajonale lidhur me transportin e mallrave, do të mundësojë një kuotë më të lartë të transportit të mallrave dhe ndikimeve shoqëruese pozitive në aspektin mjedisor (reduktimi i gazeve serrë dhe shkarkimeve të ndotësve në ajër).

Për sa i përket nënobjektivit "Zhvillimi i infrastrukturës dhe interkoneksioneve të përshtatshme të rrjetit inteligjent", aktualisht Shqipëria ka pesë linja interkoneksioni me një kapacitet nominal total prej 4096 MVA me të gjitha subjektet politike fqinje, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë 2021), si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 32: Interkonektorët ekzistues ndërkufitarë

Niveli i tensionit (kV)	Zbarra 1 (kombëtare)	Zbarra 2 (jo-kombëtare)	Nga Shqipëria në	Fuqia maksimale aktive (MW)
400	Zemblak	Kardia	Greqi	1215
400	Tiranë 2	Podgoricë	Mal i Zi	1197
400	Koman	Kosova B	Kosovë	1185
220	Koplik	Podgoricë	Mal i Zi	270
220	Fierzë	Prizren 2	Kosovë	270

Burimi: PKEK

Në figurën e mëposhtme Figura 16 paraqitet shpërndarja gjeografike e linjave kryesore të transmetimit dhe interkonektorëve.




Figura 16: Harta e linjave kryesore të transmetimit dhe e interkonektorëve

Burimi: PKEK

Figura e mëposhtme tregon një skemë e interkonektorëve ndërkufitarë, duke përfshirë kapacitetin nominal të transmetimit të interkonektorëve (fuqia maksimale aktive në MW) dhe kapacitetin maksimal ndërkufitar që u është dhënë pjesëmarrësve të tregut për përdorim tregtar (NTC). Duhet theksuar se

vënia në punë e linjës 400 kV Tiranë 2 - Koman - Kosovë B në dhjetor të vitit 2020 bëri të mundur rritjen e kapaciteteve nominale të transmetimit në kufirin me Kosovën dhe Greqinë, nga 250 MW që ishte më parë në 400MW.




Figura 17: Kapacitetet e interkonektorëve

Burimi: PKEK

Parashikohet që zbatimi i PKEK-së të përmbushë kërkesat për sa i përket lidhshmërisë në nivel evropian të rrjetit energjetik, ndikimi pozitiv i së cilës është një rrjet solid shpërndarjeje në Shqipëri që nuk sjell çrregullime në vendet fqinje. Nga ana tjetër, zbatimi i PM-ve përkatëse kërkon një rregullim të interkonektorëve ndërkufitarë. Kësisoj, përmirësimet e efijencës së energjisë duhet të përfshihen në planifikimin e furnizimit me energji elektrike.

Në përgjithësi, përgatitja e politikave dhe masave të PKEK-së bëhet në nivel strategjik dhe përshkrimet e detajuara të ndërhyrjeve nuk janë të disponueshme në këtë fazë. Duke marrë në konsideratë masat zbutëse, vlerësohet se nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme ndërkufitare. Për plane/projekte specifike që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis në vendet fqinje, në fazat e mëtejshme të përgatitjes së dokumentacionit të projektit duhet të kryhet një procedurë për vlerësimin e ndikimit

në mjedis në nivel ndërkufitar.

5. GJENDJA DHE MASAT ZBUTËSE

5.1. Gjendja

Vlerësimi i ndikimit të PM-ve individuale të PKEK-së në mjedis tregoi se pjesa më e madhe e tyre bëjnë pjesë në kategorinë A ose B (zero ndikim/ndikim pozitiv ose ndikim i konsiderueshëm).

Gjithashtu, ka edhe PM që bëjnë pjesë në kategorinë e vlerësimit C (ndikim i pakonsiderueshëm si rezultat i zbatimit të masave zbutëse), si ato më poshtë:

1. Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës
2. Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit
3. Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës
4. Rritja e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve
5. Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (në rrugë tokësore, ujore dhe hekurudhore)
6. Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë
7. Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica
8. Rrjet elektrik i fuqishëm për të përballuar rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme
9. Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri

Duke qenë se këto PM përfshijnë investime/ndërrhyrje fizike, pritet që ato të sjellin ndikime në mjedis. Për sa i përket lidhjes së ndërsjellë midis zbatimit të këtyre PM-ve dhe ndikimeve të parashikuara në arritjen e objektivave mjedisore, vlerësimi doli në konkluzionin se PM-të e renditura pritet të kenë efekte dhe të ndikojnë në arritjen e OM-ve në vijim:

- OM1: Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj tyre
- OM2: Jetesa e shëndetshme
- OM4: Mbrojtja e habitateve natyrore dhe llojeve

Për rrjedhojë, është e nevojshme të sigurohen e më pas të zbatohen masa zbutëse të detajuara e specifike për secilin nga projektet/ndërrhyrjet specifike, duke bërë kështu që pikët e vlerësimit të përkojnë me kategorinë C.

Për sa i përket OM5, (qëndrueshmëria e mjedisit socio-ekonomik) këto PM konsiderohen pozitive nga pikëpamja ekonomike dhe vlerësohet të kenë ndikim të konsiderueshëm.

5.2. Masa zbutëse

Ky seksion identifikon masat zbutëse (MZ) që duhet të merren në konsideratë gjatë finalizimit të dokumentit të PKEK-së dhe, veçanërisht, gjatë fazës së zbatimit të politikave dhe masave të përshkruara në të.

Në momentin e zbatimit të masave zbutëse, ndikimet e zbatimit të PKEK-së, të cilat janë vlerësuar si të konsiderueshme, do të bëhen të papërfillshme. Duhet të theksohet se ky është vlerësim i një dokumenti strategjik dhe se nuk përcaktohen vendndodhjet individuale për zbatimin e masave. Ato do të cilësohen gjatë procesit të zbatimit të PKEK-së (PPV, PPK, PVZh), si dhe në VNMS-të individuale për secilin prej projekteve.

5.2.1. Masat zbutëse në aspektin organizativ/administrativ

Masat zbutëse në aspektin organizativ/administrativ synojnë të mbështesin zbatimin efektiv të dokumentit të PKEK-së dhe, për rrjedhojë, të fuqizojnë efektet pozitive derivative. Më poshtë paraqitet një listë e masave përkatëse.

- Çështja e energjisë komplikohet për shkak të përmbajtjes dhe fushës së saj të zbatimit dhe vënia në zbatim e planit nuk do të jetë e lehtë. Për këtë do të nevojitet një bashkëpunim i koordinuar dhe efektiv ndërmjet institucioneve dhe ministrive të ndryshme, të cilat janë gjithashtu të ngarkuara me detyrën e përgatitjes/përditësimit dhe zbatimit të strategjive të tyre sektoriale.
- Nevojitet gjithashtu një bashkëpunim midis institucioneve shtetërore dhe autoriteteve të qeverisjes vendore, përfaqësuesve të unioneve e shoqatave profesionale apo të llojeve të tjera dhe sektorëve të tretë.
- Sektori privat do duhet të jetë një partner thelbësor.
- Do të jetë i nevojshëm garantimi i një bashkëpunimi efektiv dhe të koordinuar ndërmjet të gjitha grupeve të interesit që në nisje të procesit të planifikimit dhe zbatimit, gjatë vlerësimit dhe analizës së progresit dhe, kur është e nevojshme, gjatë propozimit të ndryshimeve në rast se objektivat dhe PM-të fillestare nuk pasqyrojnë nevojat aktuale. Me kalimin e kohës ato mund të jenë objekt i ndryshimeve, me gjasë edhe rrënjësore.
- Fleksibiliteti në strukturimin e marrëveshjeve administrative dhe të bashkëpunimit të koordinuar do të jetë thelbësor.

5.2.2. Masat zbutëse për marrjen në konsideratë të shpërndarjes hapësinore të objekteve dhe infrastrukturës

- PM-të në dokumentin e PKEK-së duhet të jenë praktike në raport me regjimet e mbrojtjes dhe zonat e mbrojtura apo me legjislacionin në fushën e mbrojtjes mjedisore, i cili përcakton: zonat e Natura 2000, vlerat natyrore, zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi ekologjike, tokat bujqësore, zonat e mbrojtjes së burimeve ujore, zonat e përmytjeve, rezervatet pyjore, trashëgiminë kulturore dhe peizazhet unike.
- Të gjitha ndërhyrjet në hapësirë (ndërtimi i objekteve dhe instalimi i infrastrukturës energjetike brenda tyre) do të kryhen jashtë zonave të sipërpërmendura; në rast se një gjë e tillë është e pamundur, do të përcaktohen zgjidhje alternative zbatimi, të cilat koordinohen më tej me institucionet dhe/ose ministrinë kompetente.
- PM-të duhet të jenë gjithashtu praktike në raport me legjislacionin sektorial lidhur me shkarkimet në ajër, ujin dhe tokën, zhurmat dhe menaxhimin e mbetjeve. Shtimi i ngarkesave në një mjedis që është tashmë i mbingarkuar është i papranueshëm.
- Me qëllim arritjen e përdorimit racional të tokës, në ndërtimin e objekteve duhet t'u jepet përparësi zonave të degraduara dhe atyre industriale, duke vendosur kërkesa për instalimin e impianteve diellore mbi tarraca, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur. Vendosja e impianteve diellore të mëvetësishme në zona të degraduara dhe pika industriale duhet të bëhet vetëm nëse ndërtimi i objekteve është i paarsyeshëm ose i pamundur. Gjithashtu, vendosja e impianteve diellore pranë objekteve infrastrukturore të transportit në linjë (autostrada dhe superstrada) duhet të bëhet në rastet kur një gjë e tillë është ekologjike dhe e pranueshme nga pikëpamja e infrastrukturës energjetike.
- Sipas parimit të përdorimit racional të tokës, kjo e fundit duhet të shfrytëzohet në mënyrë të tillë që ndikimi tek tokat bujqësore dhe pyjet të jetë sa i vogël që të jetë e mundur. Rrjedhimisht, në rastin e tokave të degraduara, ato duhet të përdoren në mënyrë racionale. Nëse janë të përshtatshme për ndërtim, ato kanë avantazh absolut në raport me tokat bujqësore apo pyjet, duke përdorur për energji diellore tarracat e objekteve.

- Gjatë planifikimit hapësinor të një HEC-i (procedura VNMS), duhet të merret një opinion ekspert lidhur me ndikimin e tij në rrezikun ekzistues për përmbajtje në zonën përkatëse të ndikimit, si dhe të kryhet një analizë e rrezikut për përmbajtje si rezultat i mundësisë së operimit të papërshtatshëm të HEC-it, si p.sh. zbrazja e njëkohshme e prurjeve të mëdha në vijën ujore apo përmbajtjet për shkak të shembjes së digës.
- Me qëllim shmangien e rritjes së mundshme të presioneve në vendndodhjen e objekteve dhe në vendndodhjen e zbatimit të ndërhyrjeve në zonat me regjime mbrojtjeje (duke përfshirë zonat e mbrojtura), këto regjime duhet të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së planeve të detajuara të zbatimit për PM-të përkatëse.
- Për sa i përket vendndodhjes së objekteve më të mëdha, është e nevojshme të përcaktohen zonat e përshtatshme të cilat më pas do të shërbejnë si bazë për planifikimin hapësinor. Me anë të kësaj MZ-je do të reduktohen presionet në zonat ku organizimi i objekteve është i papërshtatshëm. Efektiviteti i MZ-së do të matet me anë të efikasitetit dhe shpejtësisë së procedurave të zbatimit të PKEK-së për objekte specifike (PM).
- Me qëllim shmangien e rritjes së mundshme të presioneve për shkak të zbatimit të PM-ve të PKEK-së të cilat parashikojnë shpërndarjen në hapësirë të objekteve, gjatë fazës së planifikimit do të merren në konsideratë regjimet e mbrojtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe rrënojave të mundshme. Ndërhyrjet dhe aktivitetet në zonë do të planifikohen dhe do të kryhen në mënyrë të tillë që rrënojat arkeologjike në sit (trashëgimia arkeologjike dhe rrënojat e mundshme) të ruhen.
- Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, kërkohet modelimi i përhapjes së zhurmave (diapazoni i infratingujve, tingujve me frekuenca të ulëta dhe tingujve të dëgjueshëm) në mjedis, sipas ndryshueshmërisë lokale të terrenit dhe specifikave të faktorëve meteorologjikë, me qëllim vlerësimin e tyre në mënyrë që të garantohej që të mos shkaktojnë shqetësim për popullsinë.

5.2.3. MZ-të për parandalimin, eliminimin, minimizimin dhe kompensimin e ndikimeve mjedisore dhe shëndetësore

- Propozimi i vetë PKEK-së përfaqëson një seri politikash dhe masash të cilat synojnë parandalimin, zbutjen ose eliminimin e ndikimeve negative mjedisore dhe shëndetësore, duke përforcuar ndikimet pozitive dhe duke parandaluar, eliminuar, minimizuar dhe kompensuar ndikimet mjedisore dhe shëndetësore në tërësi.
- Drafti i këtij dokumenti planifikimi, për nga natyra, synon arritjen e ndryshimeve pozitive, veçanërisht në fushën e ndryshimeve klimatike për sa i përket aspektit të cilësisë së ajrit dhe atij socio-ekonomik, por ai ka një ndikim pozitiv të konsiderueshëm edhe në aspekte të tjera mjedisore të mjedisit natyror dhe në faktorët mjedisorë të cilësisë së jetës dhe shëndetit.
- Rrjedhimisht, PM-të e hartuara me qëllim arritjen e objektivave mund të konsiderohen si masa për parandalimin, eliminimin, minimizimin dhe kompensimin e ndikimeve mjedisore dhe shëndetësore. Nëse këto masa nuk arrijnë të adresojnë plotësisht efektet negative aktuale në mjedis dhe shëndet, përkatësisht, tendencat e tyre në zhvillim do të vazhdonin dhe nuk përjashtohet as përkeqësimi i tyre.
- Rrjedhimisht, konsiderohet me rëndësi marrja e masave të mëtejshme të një natyre organizative dhe administrative të cilat do të kontribuonin në zbatimin efektiv të këtij dokumenti.
- Masat e mëtejshme e më të detajuara mund të konsiderohen si masa të rëndësishme në drejtim të:
 - ✓ ndikimeve të ndërhyrjeve infrastrukturore në mjedis, në cilësinë e ajrit dhe në shëndet

- ✓ ndikimeve të PM-ve lidhur me transportin në cilësinë e ajrit dhe në shëndet
- ✓ ndikimeve në cilësinë e jetës në fushën e varfërisë energjetike
- Rekomandohet që kësaj çështjeje t'i kushtohet vëmendje maksimale në planet e zbatimit të PM-ve specifike.

5.2.4. Masat zbutëse për plotësimin e PM-ve të PKEK-së

- Identifikimi i instrumenteve dhe politikave për reduktimin e përdorimit të energjisë dhe për përdorimin më eficient të saj, të tilla si incentivat tatimore për riinvestimin e fitimeve në masat lidhur me reduktimin e përdorimit të energjisë dhe efikasitetin e energjisë, si dhe në prezantimin e BRE-ve në sektorët ETS dhe jo ETS. Kjo do të mundësojë reduktimin e konsumit specifik të energjisë elektrike, duke rritur përdorimin e BRE-ve nga sektorët individualë
- Gjatë planifikimit të zbatimit të ndërhyrjeve/investimeve fizike, duke përfshirë HEC-et, duhet të kërkohej që vendndodhja e tyre në hapësirë të marrë në konsideratë efektet e pritshme të ndryshimeve klimatike në kapacitetin e tyre prodhues dhe në sigurinë nga përmbajtjet.
- Për të gjitha ndërhyrjet fizike të planifikuara, duhet të parashikohen masa efikase për reduktimin e ngarkesave hidromorfologjike, dhe rrjedhimisht për të reduktuar ndikimin në biodiversitet, në kuadër të studimeve të ekspertëve për qëllime të zbatimit të përjashtimeve ose në kuadër të vlerësimeve të ndikimit, në nivele më të ulëta planifikimi. Masat duhet të bazohen në një listë masash hidromorfologjike. Sipas kësaj liste, masat zbutëse përgatiten në dy kategori, përkatësisht:
 - një sërë masash zbutëse për ndryshimet hidromorfologjike të parashikuara, dhe
 - një sërë masash zbutëse të rëndësishme për të reduktuar përkeqësimin e statusit ekologjik të ujërave, në lidhje me elementet e cilësisë hidromorfologjike, kimiko-fizike dhe biologjike, si rezultat i ndryshimeve hidromorfologjike të parashikuara.
- Duhet të krijohet një inventar paraprak i përshtatshëm për biodiversitetin e secilës zonë përkatëse.
- Duhet të përgatiten masa efikase zbutëse dhe kompensuese për llojet e klasifikimit të “Natura 2000”, për llojet e habitateve, si dhe për biodiversitetin. Nevojiten masa kompensuese të suksesshme dhe proporcionale për zbatimin e suksesshëm të procedurës së mbizotërimit të një interesi tjetër publik mbi interesin publik të mbrojtjes së natyrës.
- Duhet të krijohet një sistem për menaxhimin e mbetjeve të baterive dhe paneleve të përdorura fotovoltaike. Kjo gjë përfshin ngritjen e një sistemi për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve, si dhe monitorimin e sasive të grumbulluara të mbetjeve.
- Për sa i përket efikasitetit të energjisë në ndërtesa dhe përdorimit të BRE-ve në ndërtesa, të gjitha PM-të duhet të përfshijnë një kërkesë për të marrë në konsideratë efektet e parashikuara të ndryshimeve klimatike, në veçanti për sa i përket reduktimit të nevojës për ngrohje dhe shtimit të nevojës për ftohje.
- Krahas efikasitetit të energjisë, duhet marrë në konsideratë edhe efikasiteti i materialeve gjatë projektimit, ndërtimit dhe rinovimit të infrastrukturës:
 - gjatë planifikimit të infrastrukturës, duhet të vlerësohet konsumi i substancave sipas nevojave dhe funksionalitetit të infrastrukturës, duke marrë në konsideratë skenarët për nxjerrjen përfundimisht nga përdorimi të saj,
 - nxitet përdorimi i materialeve të ricikluara dhe ripërdorimi i materialeve dhe produkteve; Duhet t'i jepet përparësi përdorimit të materialeve vendase me vetitë e përshtatshme teknike, që nuk janë të dëmshme ndaj mjedisit apo shëndetit të njeriut,
 - materialet me nivele të ulëta shkarkimi duhet të integrohen siç duhet në sistemin e

- ndërtimit të qëndrueshëm dhe të treguesit,
 - përdorimi i këtyre materialeve duhet të nxitet sa më shumë të jetë e mundur gjatë rinovimit energjetik të ndërtesave (p.sh. në rastin e sipërmarrjeve të përbashkëta).
- Për të garantuar përfshirjen e familjeve me të ardhura të ulëta, masat zbutëse duhet të përfshijnë së paku masat për luftimin e varfërisë energjetike (p.sh. zëvendësimi me bojlerë me teknologji të bazuar në biomasë, instalimi i paneleve diellore në çatitë e ndërtesave, etj.) dhe, mbi këtë bazë, të parashikojë në mënyrë më specifike hartimin e tyre për sa i përket ofrimit të fondeve dhe projektimit të mbështetjes së investimeve dhe masave mbështetëse të kostove për familjet që vuajnë nga varfëria energjetike.
- Duhet të organizohen aktivitete të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin publik lidhur me efektet e parashikuara të ndryshimeve klimatike dhe për të reduktuar ekspozimin ndaj efekteve të këtyre ndryshimeve, ndjeshmërinë dhe cenueshmërinë e Shqipërisë, si dhe për të ofruar fleksibilitet dhe përshtatshmëri më të madhe e shoqërisë.
- Autoritetet përkatëse, së bashku me institucionet kërkimore, duhet të hartojnë një listë të fushave kyç të zhvillimit (BRE-të, EE-ja dhe teknologjitë e tjera me karbon të ulët, ruajtja e energjisë, rrjetet inteligjente, riciklimi, efica e materialeve, etj.), për të cilat do të nevojiten më shumë fonde për të mbështetur kalimin në një shoqëri me shkarkime të ulëta karboni. Financimet më të mëdha për kërkim dhe zhvillim nënkuptojnë një zhvillim më të shpejtë të teknologjive të reja dhe konkurrueshmëri më të lartë.
- Instalimi i pajisjeve të reja nga kontraktorë të kualifikuar dhe demonstrimi i detyrueshëm i përdorimit të saktë të pajisjes së blerë rishtazi, garanton mbrojtjen e përdoruesve ndaj blerjes dhe instalimi të një pajisjeje të papërshtatshme. Masa ka për qëllim përmirësimin e efica së instalimeve, teksa redukton shkarkimet.
- Intensifikimi i PM-ve në lidhje me sektorin e transportit, me qëllim reduktimin e trafikut të udhëtarëve në mënyrë më ambicioze, përmes:
 - nxitjes së unitetit,
 - nxitjes së mëtejshme të zhvillimit të sipërmarrjeve lokale dhe artizanatit, me qëllim reduktimin e transportit në distanca të largëta për në punë,
 - përforsimit të konceptit P + R,
 - implementimit të konceptit P + R në nyjat lidhëse të autostradave dhe lidhja me linjat e shpejta të autobusëve,
 - shtimit të transportit përmes autobusëve qytetas në raport me transportin hekurudhor,
 - përmirësimit të planifikimit hapësinor,
 - rritjes së ndërgjegjësimin lidhur me mënyrat e qëndrueshme të transportit,
 - promovimit të mëtejshëm të ecjes dhe çiklizmit, si dhe përmes krijimit të kushteve më të mira të sigurisë për këto mënyra transporti,
 - ofrimit të incentivave fiskale për përdoruesit e transportit publik dhe mënyrave të pamotorizuara të transportit.
- Intensifikimi i PM-ve në lidhje me sektorin e transportit, me qëllim reduktimin e transportit rrugor të mallrave, përmes:
 - intensifikimit të promovimit dhe fuqizimit të ekonomisë qarkulluese, dixhitalizimit dhe përmirësimit të logjistikës,
 - aplikimit më të shpejtë dhe rrjeteve të përmirësuara hekurudhore, që do të bëjnë të mundur kalimin në masë më të madhe të transportit rrugor të mallrave në atë hekurudhor,
 - promovimit të kalimit të transportit të mallrave në rrugë hekurudhore.
- Duhet të shtohet një PM e re për rinatyrizimin e lumenjve dhe rrjedhave ujore për t'i rikthyer

në gjendjen e tyre natyrore, aty ku ndërhyrjet aktuale në lumenj dhe zona bregore janë të vjetra, të panevojshme ose që sjellin shkatërrim të mëtejshëm. Ajo duhet të parashikojë edhe një mekanizëm për blerjen e zonave bregore në nivel kombëtar, për të mundësuar lugina natyrore të përmblytjeve për lumenjtë dhe për të ndryshuar politikën lidhur me mbrojtjen e zonave bregore, duke bërë kështu të mundur që lumenjtë të transportojnë sedimentet në mënyrë natyrore.

5.2.5. Masat zbutëse lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Qasjet e mëposhtme mund të përdoren për përshtatjen, duke përfshirë edhe kombinimin e tyre, kur është e nevojshme dhe/ose e mundshme:

- koncepte të infrastrukturës “*gri*”, d.m.th. ndërhyrje fizike ose masa ndërtimore kundrejt ngjarjeve të jashtëzakonshme, përmes përdorimit të shërbimeve inxhinierike, për të rritur fleksibilitetin e ndërtesave dhe të infrastrukturës,
- qasjet strukturore “*të gjelbra*” dhe “*blu*”, që kontribuojnë në fleksibilitet më të madh të ekosistemeve, në mënyrë që të parandalohet humbja e biodiversitetit dhe degradimi i ekosistemit dhe që të rikthehen ciklet e ujit, ndërkohë që shfrytëzohen funksionet dhe shërbimet e ofruara nga ekosistemet;
- konceptet jostrukturore “*të moderuara*”, sipas të cilave, strategjitë për përdorimin e tokës, shpërndarjen e informacionit dhe incentivat ekonomike për reduktimin ose parandalimin e riskut të fatkeqësive janë projektuar dhe zbatuar.

Preferohen qasjet e “*gjelbra*” dhe “*të moderuara*”, dhe është i volitshëm një kombinim i tyre në cilësinë e masave zbutëse.

- Aktualisht, një sërë propozimesh për masat e përshtatjes disponohen në disa dokumente, por duke marrë parasysh dyshimet e shumta lidhur me parashikimet e zhvillimit të ndryshimeve klimatike dhe informacionet e kufizuara aktuale për këtë dukuri, monitorimi i zhvillimeve dhe reagimi në mënyrë fleksibël ndaj informacioneve të reja do të jetë i nevojshëm. Në bazë të informacioneve dhe njohurive të reja, informacionet aktuale duhet të korrigjohen/përditësohen, ose duhet të merren masa të reja për përshtatjen.

5.2.6. Masat zbutëse lidhur me përdorimin e BRE-ve

- Përcaktimi dhe përdorimi i kriterëve për BRE-të, për përdorimin e qëndrueshëm të të gjithë burimeve të rinovueshme të energjisë.
- Vendosja e kriterëve për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të rinovueshme duhet të jetë pjesë e planit të zbatimit për çdo PM përkatëse, si dhe duhet të ndërmerren masa në lidhje me to.
- Për ndërhyrjet/projektet që përdorin BRE-të, duhet të merret në konsideratë kriteri aktual i vlefshëm (i nxjerrë së fundmi ose i përditësuar) për përdorimin e qëndrueshëm të të gjitha burimeve të rinovueshme.
- Identifikimi i instrumenteve dhe politikave për të promovuar vetëplotësimin lidhur me BRE-të, si një kusht për përfitimin e incentivave financiare (p.sh. shfrytëzimi i plotë i potencialit të energjisë diellore në ndërtesa, si kusht për të rritur shanset e përfitimit të incentivave) Kjo masë kontribuon në shfrytëzimin e potencialit të BRE-ve në ndërtesat dhe zonat industriale dhe tregtare.
- Për sa i përket promovimit të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të, planifikimi eficient i infrastrukturës në zona të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, që kanë kapacitet të

përshtatshëm të rrjetit lokal, garanton ndjeshmëri më të ulët dhe rrit fleksibilitetin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe garanton furnizim më të sigurt me energji elektrike. I është dhënë prioritet ambienteve që janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore dhe nga rrjeti i energjisë.

- Duhet të nxitet fleksibiliteti i prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të, në rast ndërprerjeje të rrjetit të transmetimit ose të shpërndarjes.
- PKEK-ja duhet të marrë në konsideratë ofrimin e fondeve të përshtatshme të investimeve për ndërtimin e një rrjeti shpërndarjeje inteligjent dhe të fuqishëm, që do të bëjë të mundur përdorimin e impianteve diellore, pompave të nxehtësisë dhe karikimin e automjeteve elektrike në të gjithë vendin.

6. MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT

Sistemi i monitorimit i ndikimeve të konsiderueshme në mjedis, që vijnë si rezultat i zbatimit të planit, është një mjet i thjeshtë i monitorimit efikas.

Monitorimi i ndikimit është tejet i rëndësishëm për zbatimin e planit, dhe si sipas ligjit 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, zbatimi i një plani ose programi duhet të monitorohet, në mënyrë që të identifikohen efektet e konsiderueshme ose efektet negative të paparashikuara, të cilat bëjnë të mundur neutralizimin e tyre në kohën e duhur dhe përshtatjen për atë që është e mundur.

Për këtë qëllim, u krijua një sistem i përshtatshëm monitorimi për ndikimet madhore në mjedis që rrjedhin nga plani, si rezultat i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe përlogaritjes së tij. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë treguesit mjedisorë përkatës për sektorin mjedisor (p.sh. shëndeti, natyra/biodiversiteti, ndryshimet klimatike, toka, uji, cilësia e ajrit, etj.) dhe identifikon kompetencat dhe përgjegjësitë për matjen e secilit tregues mjedisor të sugjeruar.

Mbledhja e të dhënave sugjerohet që të bazohet në dy burime:

- (a) në të dhënat primare të gjeneruara nga matja e parametrevë mjedisorë; dhe
- (b) në vlerësimin e treguesve mjedisorë.

Në procesin e gjetjes së të dhënave përmes matjes mund të përfshihen autoritetet rajonale (qarqet), por edhe autoritetet kombëtare (p.sh. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), autoritetet vendore, organet shkencore dhe profesionale, si dhe organet e shërbimeve publike (p.sh. organet menaxhuese të venddepozitimeve, ARMZ-ja, drejtoritë e shëndetit publik, etj.). Matja e treguesve mjedisorë është një proces kompleks; d.m.th. është një proces i rregullt ose një proces i vazhdueshëm.

Për këtë qëllim, duhet të bazohemi në përvojën dhe sistemet e monitorimit të organeve të tjera, duke u fokusuar, nga njëra anë, në monitorimin e zbatimit të standardeve të nevojshme të matjes nga organet e tjera dhe kryesisht nga operatorët e projekteve (përmes përfshirjes së tyre në procesin e lejeve mjedisore) dhe, nga ana tjetër, në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave.

Drejtoritë Rajonale duhet të luajnë një rol kyç për sa i përket menaxhimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kuadër, departamentet përkatëse duhet të planifikojnë dhe veprojnë si një qendër për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit. Në veçanti, roli i departamenteve rajonale duhet të përfshijë:

- Mbledhjen e të dhënave si rezultat i masave marra nga shërbimet rajonale, të cilat janë të përhershme ose të përkohshme.
- Mbledhjen e të dhënave primare nga organet rajonale të shërbimeve publike (p.sh. organet menaxhuese të venddepozitimeve, impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura, sipërmarrjet për menaxhimin e mbetjeve, korporata e energjisë, organi menaxhues i zonave të mbrojtura).
- Mbledhjen e të dhënave primare nga administrata publike (p.sh. sistemi kombëtar/rajonat i monitorimit për cilësinë e ujërave sipërfaqësore, cilësia e ajrit, etj.).
- Mbledhjen e të dhënave primare nga organet shkencore dhe organet e tjera.
- Analizimin dhe sintetizimin e të dhënave për të nxjerrë përfundime mbi gjendjen në mjedis brenda qarkut.
- Ruajtjen e të dhënave dhe zhvillimin e serive kronologjike për të monitoruar statusin mjedisor me kalimin e kohës.

- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve të përshtatshme, sipas legjislacionit aktual dhe/ose vendimeve në nivel qarku. Këto raporte kanë për qëllim të:
 - (a) përmbushin kërkesat përkatëse të legjislacionit,
 - (b) informojnë pjesëmarrësit lidhur me procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të planit (vendimmarrësit) dhe
 - (c) informojnë publikun e prekur nga zbatimi i planit.

Synimi i programit të monitorimit në kuadër të këtij raporti është që të disponojë një grup të dhënash në lidhje me planet dhe masat e PKEK-së, si dhe veprimet në lidhje me to, mbi të cilat mund të identifikohen ndikimet e mundshme negative në mjedis.

Nënseksionet e mëposhtme dhe tabela paraqesin një model të programit të monitorimit të PKEK-së. Tabela është ndarë sipas sektorëve mjedisorë të përshkruar në raport.

Për çdo sektor mjedisor, jepen treguesit mjedisorë përkatës, organi i monitorimit, parametrat mjedisorë dhe shpeshtësia e monitorimit. Duhet të theksohet se treguesit e përshkruar janë objekt rishikimi sipas nevojës, dhe sipas këtij arsyetimi, tabela duhet të konsiderohet më shumë si një model për programin e monitorimit dhe të trajtohet si një dokument në përditësim të vazhdueshëm, që përshtatet sipas nevojës.

Si përfundim, duhet të theksohet se të dhënat mjedisore të gjeneruara nga programi i monitorimit duhet të raportohen, publikohen dhe të bëhen të disponueshme për publikun.

Popullsia dhe shëndeti i njeriut

Një tjetër aspekt që kërkon monitorim është popullsia dhe shëndeti i njeriut. Ky aspekt përfshin mbrojtjen e përgjithshme të shëndetit publik dhe mirëqenien në komunitet, që duhet të mbrohet dhe monitorohet. Kjo gjë mund të monitorohet përmes matjes së aksidenteve në punë, përqindjen e njerëzve që jetojnë nën kufirin minimal të jetesës, etj.

Krahas kësaj, matja e rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së publikut në skemat për EE-në dhe BRE-të kryhet përmes vlerësimit të interesit për krijimin e grupeve të CEC-it.

Ndryshimet klimatike

Planifikimi për ndryshim dhe marrja e hershme në konsideratë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike bën të mundur që autoritetet vendore të reduktojnë ekspozimin ndaj riskut të përgjithshëm.

Për të reduktuar cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, kriteret duhen vendosur në mënyrë të tillë që të ruajnë energjinë dhe të promovojnë burimet e rinovueshme, si p.sh. përdorimi i mbetjeve për të prodhuar energji.

Bashkitë duhet të ndërmarrin një proces për Profilin e Ndikimit Klimatik në nivel Lokal (LCIP). Një LCIP është një proces që thekson pikat e dobëta të bashkive lidhur me përballimin e kushteve të këqija të motit dhe mënyrën se si ato ndikojnë në komunitetet lokale, në asetet e autoriteteve vendore, në infrastrukturë dhe në kapacitetin për ofrimin e shërbimeve. Ndër të tjera, LCIP-i përfshin informacione lidhur me ndikimet e motit në shërbimet publike (p.sh. grumbullimi i mbetjeve dhe shërbimet e riciklimit).

Është me rëndësi të sigurohet se çdo ndërprerje për shkak të kushteve të këqija të motit në shërbimet publike të regjistrohet dhe të rishikohet rregullisht për të parë nëse janë përmbushur standardet për një shërbim të pranueshëm.

Informacioni për mbledhjen/matjen dhe analizimin për secilën ngjarje që lidhet me kushtet e këqija të motit duhet të përmbajë:

1. **Ngjarja:** Viti dhe moti
2. **Ndikimi:** Si dhe në çfarë mënyre ndikoi kjo ngjarje te shërbimet?
3. **Pragjet kritike:** A kishte pragje kritike, p.sh. temperatura, kohëzgjatja e thatësirës ose nivelet e përmbajtjeve, të cilat përshpejtuan ndërprerjen? Nëse po, cilat ishin ato?
4. **Përgjigja e menjëhershme dhe kostoja:** Çfarë masash korrigjuese janë ndërmarrë gjatë kushteve të këqija të motit? Sa është kostoja e këtyre masave?
5. **Përgjigja afatgjatë dhe kostoja:** Çfarë lloj riparimesh afatgjata ose masa të tjera janë të nevojshme dhe sa është kostoja në lidhje me to?
6. **Efikasiteti i përgjigjes:** Sa efikase duhet të jetë përgjigja e menjëhershme dhe ajo afatgjatë?

Në bazë të informacioneve të mbledhura dhe të analizuara, bashkia duhet të identifikojë, vlerësojë dhe të zbatojë opsionet e përshtatjes.

Biodiversiteti

Kriteret për biodiversitetin garantojnë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura. Kjo gjë mund të matet përmes studimit të ndikimeve në zonat e mbrojtura, si rezultat i zhvillimit të infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve.

Biodiversiteti përfshin edhe ruajtjen e biodiversitetit të ujërave të ëmbla. Kjo gjë është e mundur përmes matjes së popullsisë dhe shpërndarjes gjeografike të llojeve treguese.

Një sërë parametrash monitorohen përmes kushteve të lejeve mjedisore dhe përmes programeve të monitorimit në nivel kombëtar/qarku/vendor; këto të dhëna mund të jenë të dobishme.

Toka

Një nga mënyrat e mbrojtjes së burimeve nga veprimtari/shërbime të ndryshme (p.sh. menaxhimi i mbetjeve) është vlerësimi i ndotjes së tokës, duke monitoruar kështu instalimet e menaxhimit të mbetjeve për të vërtetuar që është i nevojshëm shkarkimi i lëngjeve kulluese dhe i nënprodukteve të tjera.

Krahas kësaj, për të përmirësuar cilësinë e tokës, komposti që do të përdoret për qëllime bujqësore dhe ruajtjes së peizazhit duhet të monitorohet për cilësinë dhe sasinë e saj.

Një sërë parametrash monitorohen përmes kushteve të lejeve mjedisore dhe përmes programeve të monitorimit në nivel kombëtar/qarku/vendor; këto të dhëna mund të jenë të dobishme.

Uji

Burimet ujore meritojnë të mbrohen, ndërsa vlerat e cilësisë së ujit duhet të përmbushin standardet dhe rregulloret.

Për të monitoruar efektet në burimet e ujësive nëntokësore dhe sipërfaqësore, duhet të monitorohen shkarkimet, si dhe numri i rasteve të ndotjes së ujit.

Cilësia e ujërave bregdetare duhet të monitorohet gjithashtu për burime ndotjeje përmes vlerësimit të shkarkimeve në mjedisin ujor, dhe ky burim duhet të lokalizohet.

Një sërë parametrash monitorohen përmes kushteve të lejeve mjedisore dhe përmes programeve të monitorimit në nivel kombëtar/qarku/vendor; këto të dhëna mund të jenë të dobishme.

Ajri

Monitorimi i cilësisë së ajrit është i nevojshëm për të reduktuar efektet negative në atmosferë. Shkarkimet në ajër duhet të monitorohen dhe kontrollohen në lidhje me objektivat kombëtare për cilësinë e ajrit dhe vlerat kufi të shkarkimeve. Ky monitorim do të garantojë përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe arritjen e standardit të kërkuar nga legjislacioni përkatës shqiptar, si dhe nga direktivat e BE-së.

Një sërë parametrash monitorohen përmes kushteve të lejeve mjedisore dhe përmes programeve të monitorimit në nivel kombëtar/qarku/vendor; këto të dhëna mund të jenë të dobishme.

Burimet e rinovueshme të energjisë

Në teori, përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë matet përmes vlerësimit të prodhimit të energjisë neto nga këto burime dhe përmes shkarkimit të gazeve me efekt sërë.

Çelësi i suksesit në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë është promovimi i ruajtjes së energjisë, përdorimi në masë më të madhe i energjisë së rinovueshme dhe reduktimi i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë. Këto grupe të dhënash duhet të jenë gjithnjë të disponueshme edhe nga procesi i monitorimit, i kryer nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Raporti i gjendjes në mjedis).

Tabela 33: Modeli i programit të monitorimit të ndikimeve të konsiderueshme në mjedis nga PKEK-ja

Nr	Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti i monitorimit	Parametrat mjedisorë	Shpeshtësia e monitorimit	Komente
1	Popullsia – shëndeti i njeriut	- Vitet e jetëgjatësisë në shëndet të mirë - Aksidentet në punë - Përqindja e njerëzve që jetojnë nën kufirin minimal të jetesës	Drejtoritë kompetente të qarqeve	- Vitet e jetëgjatësisë në shëndet të mirë - Numri i aksidenteve në punë - Përqindja e njerëzve që jetojnë nën kufirin minimal të jetesës	Çdo vit	
2	Faktorët klimatikë	- Shkarkimet e gazeve me efekt serrë ✓ shkarkimet sipas burimit (%) - Zhvillimi i kërkesës për energji ✓ Alokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit - Përqindja e BRE-ve (%) - Evoluimi i numrit të automjeteve për transportin e udhëtarëve	MTM MTM Drejtoritë kompetente të qarqeve	SOx, NOx, PM₁₀, gazet me efekt serrë, Pb, CO Përqindja e energjisë nga BRE-të (%) Numri automjeteve për transportin e udhëtarëve	Çdo vit	Rrjetet e ndotjes së ajrit Monitorimi i cilësisë
3	Natyra (Biodiversiteti - fauna- flora	- Numri i habitateve të rëndësishme që janë në kushte të kënaqshme - Numri dhe/ose sipërfaqja e zonave të mbrojtura - Madhësia e biodiversitetit, në krahasim me BE-në (numri i llojeve endemike dhe të	Organet menaxhuese të zonave të mbrojtura Drejtoritë kompetente të qarqeve	- Habitatet - Numri dhe/ose sipërfaqja e zonave të mbrojtura - Numri i llojeve endemike dhe të rralla - Sipërfaqja e mbuluar nga pyjet - Numri dhe madhësia e sipërfaqes natyrore	Sipas Planit të menaxhimit Çdo vit	

Nr	Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti i monitorimit	Parametrat mjedisorë	Shpeshtësia e monitorimit	Komente
		rralla - Sipërfaqja e mbuluar nga pyjet - Numri dhe madhësia e sipërfaqes natyrore				
4	Tokat	- Përqindja e tokës së degraduar - Sasitë e mbetjeve të asgjësuara në venddepozitime - Zhvillimi i prodhimit të mbetjeve të prodhuara për frymë dhe në total % e riciklimit (letër, qelq, MBB, alumin)	Autoritetet kompetente të qarqeve Organet menaxhuese të venddepozitimeve	- Përqindja e tokës së degraduar - Sasitë e mbetjeve të asgjësuara në venddepozitime - Zhvillimi i prodhimit të mbetjeve të prodhuara për frymë dhe në total % e riciklimit (letër, qelq, mbetjet bashkiake të biodegradueshme, alumin)	Çdo vit	
5	Ujërat	- Cilësia e ujërave sipërfaqësore - Cilësia e ujërave nëntokësore - Përdorimi i ujit sipas sektorit - Përqindja e riciklimit të ujit - Përqindja e popullsisë së lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura - Ujërat detare: Cilësia e ujërave të larjes	Drejtoritë kompetente të qarqeve Organet menaxhuese të ITUP-eve MTM	- N total, P total, BOD-et, COD, SS, TDS, pH, përçueshmëria, etj. - pH, përçueshmëria, fortësia, kloruret, sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitriti, P total, metalet, detergjentet, agjentët toksikë, parametrat mikrobiologjikë, etj. - Parametrat mikrobiologjikë për ujërat e larjes	Kampionimi dhe matjet në përputhje me kushtet mjedisore të çdo ITUP-i. Sistemi kombëtar i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore Sipas programit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes në plazhe	Sipas ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Sipas ligjit nr. 9915, datë 12.5.2008 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes" Direktiva 76/160/KEE
6	Ajri	Ditët kur janë tejkaluar kufijtë e	MTM	SOx, NOx, PM ₁₀ , gazet me efekt serrë, Pb, CO	Çdo vit	Rrjetet e ndotjes së ajrit Monitorimi i cilësisë

Nr	Aspekti mjedisor	Treguesi mjedisor	Autoriteti i monitorimit	Parametrat mjedisorë	Shpeshtësia e monitorimit	Komente
		cilësisë së ajrit Shkarkimet sipas burimit				

Monitorimi i ndikimeve në mjedis për çdo veprim/masë të parashikuara në PKEK do të bëhet sipas programit të monitorimit dhe mund të përfshijë informacione të shprehura në formë tabelore, sipas modelit në tabelën e mëposhtme.

Veprimi/masa e zbatuar sipas PKEK-së në Shqipëri	Treguesit mjedisorë	Parashikim i ndikimeve kumulative (sipas rastit)	Ndikimi total i planit
Veprimi/masa 001			
Veprimi/masa 002			
Veprimi/masa 003			
Veprimi/masa ...			

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- ✚ Zhvillimi dhe zbatimi i politikave kombëtare të energjisë dhe hartimi i PKEK-së do të ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Shumë prej investimeve që janë parashikuar të realizohen në mbarë sektorin e energjisë do të kenë një ndikim të madh në rritjen e PPB-ve sektoriale, gjenerimin e të ardhurave dhe shtimin e forcave punëtore në fusha të ndryshme.
- ✚ Politikat dhe masat që lidhen me ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave, si dhe me ndërtimin e sistemeve fotovoltaike, do të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e punëve ekologjike. Reduktimi i varësisë nga energjia e importuar do të kontribuojë jo vetëm në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, por edhe në rritjen e sigurisë makroekonomike dhe politike të vendit në sajë të zvogëlimit të deficitit në buxhetin e brendshëm.
- ✚ Vlerësimi i ndikimeve në mjedis do të bëhet rast pas rasti, në një nivel më të ulët planifikimi (PPV, PKK), si dhe në kuadër të VNMS-ve përkatëse. Në disa raste, PM-të e renditura në PKEK i janë nënshtruar ndërkohë procedurës ose janë ende në proces zbatimi (p.sh. incineratorët e mbetjeve). Në nivel PKEK-je, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se disa masa, për shkak të kufizimeve që mbartin regjimet aktuale të mbrojtjes dhe sipas legjislacionit sektorial ose për zonat e mbrojtura, mund të mos zbatohen deri në masën e parashikuar. Nga ana tjetër, në kuadër të PKEK-së, duhet të parashihet qartë që, përdoruesit e planit janë gjithnjë të informuar lidhur me kufizimet hapësinore që duhet t'ju kushtojnë rëndësi, gjatë zbatimit të masave.
- ✚ Në nivel strategjik, është e nevojshme të përcaktohet se cilat burime të rinovueshme të energjisë kenë përparësi, cilat do të jenë fazat për përcaktimin e përqindjes së BRE-ve dhe koha e zbatimit. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të përcaktohen vendet me përparësi, si dhe vendet e përshtatshme e të papërshtatshme sipas kushteve.
- ✚ Duke marrë parasysh problemet ekzistuese dhe grumbullimet e mbetjeve që nuk janë të përshtatshme për ripërdorim ose rikuperim, dhe në bazë të nevojave të paraqitura për energji, është e arsyeshme që të përshpejtohet vendimmarrja e organeve qeveritare lidhur me rikuperimin e energjisë. Për përdorimin e energjisë, është e arsyeshme që të nxitet dhe t'i jepet përparësi përdorimit të energjisë nga mbetjet e biodegradueshme për prodhimin e biogazit dhe biokarburanteve të avancuara. Hapi pasardhës duhet të jetë korrigjimi i dokumentacionit të nevojshëm për infrastrukturën e energjisë dhe ndërtimin e saj. Kjo gjë do të zgjidhë problemin e menaxhimit të mbetjeve në planin afatgjatë.
- ✚ Ndryshimet klimatike ndikojnë në ndryshimet e regjimeve të lumenjve (prurje më të pakta në verë, prurje maksimale më të larta). Infrastruktura e re që parashikohet që instalohet duhet të marrë parasysh regjimet e ndryshuara të parashikuara.
- ✚ Janë të mundshme edhe ndikimet e tjera të zbatimit të HEC-eve, hidrocentraleve të vogla, të cilat duhet të adresohen siç duhet në kuadër të PKEK-së dhe VNMS-ve përkatëse, në nivel zbatimi.
- ✚ Për sa i përket, menaxhimit të mbetjeve, rekomandohet që të merret në konsideratë ndërmarrja e masave të mëposhtme:

- Krijimi i një baze profesionale për regjistrimin e llojeve të mundshme dhe sasive të mbetjeve që janë të përshtatshme për përdorim të energjisë, për vendndodhjen hapësinore të infrastrukturës dhe për garantimin e pranueshmërisë mjedisore të zgjidhjes së përzgjedhur.
 - Vlerësimi i potencialit të energjisë dhe promovimi i përdorimit të energjisë nga mbetjet e biodegradueshme për biogazin dhe biokarburantet e avancuara.
 - Përdorim më i madh energjisë nga mbetjet që nuk mund të ripërdoren apo riciklohen, dhe që janë të përshtatshme për përdorimin e energjisë.
- ✚ Mbështetja e shoqërive për kalimin në një ekonomi qarkulluese me karbon të ulët. Kjo mbështetje duhet të rritet në mënyrë intensive për një kalim efikas dhe konkurrues në një ekonomi qarkulluese me karbon të ulët, të dixhitalizuar dhe me logjistikë të përmirësuar.
- ✚ Efienca e energjisë në sektorin industrial duhet të respektojë kërkesat e Teknikave më të mira në dispozicion (BAT), të cilat përveç përcaktimit të kufijve të shkarkimeve, përcaktojnë edhe eficientë e energjisë dhe të materialeve.
- ✚ Është e nevojshme të verifikohet nëse sistemi ekzistues për menaxhimin e Mbetjeve nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (MPEE) dhe mbetjet e baterive ose akumulatorëve mund të përballojë një rritje të kështillë të këtyre mbetjeve; pra, nëse kapaciteti i përshtatshëm do të ofrohet për grumbullimin, rikuperimin dhe asgjësimin e këtyre mbetjeve: bateritë e automjeteve dhe bateritë industriale, të parashikuara ekskluzivisht për përdorim industrial ose profesional, ose që përdoren në të gjitha llojet e automjeteve elektrike.
- ✚ Rinovimi i planifikuar në shkallë të gjerë i ndërtesave mund të ketë një ndikim negativ në eficientë e materialeve, për shkak të përdorimit të shtuar të materialeve. Prandaj, është e arsyeshme që të përfshihen kriteret e eficientës së materialeve gjatë përpilimit të kriterëve të qëndrueshmërisë. Ato kanë një ndikim të konsiderueshëm në shtimin e kapacitetit biologjik.
- ✚ Duke iu referuar planit të veprimit dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke të përgatiten studime nga ekspertët (studime lidhur me cenueshmërinë sipas sektorëve dhe bashkive).
- ✚ Si plan veprimi fillestar, rekomandohet marrja e masave të përcaktuara në Komunikimin e katërt kombëtar të Shqipërisë për KKKBNK-në, veçanërisht masat në ato sektorë që përbëjnë një pjesë integrale të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë sektorin e energjisë, si dhe sektorët që përfaqësojnë komponentë të rëndësishëm mjedisorë, të tillë si bujqësia, pylltaria, menaxhimi i ujërave, mbetjet, etj.
- ✚ Rekomandohet hartimi i masave në planet e veprimit në fushën e eficientës së energjisë së ndërtesave, të cilat njihen si ndërtesa ekologjike dhe janë në zhvillim të vazhdueshëm, dhe krahas elementeve të izolimit termik, rekomandohet fokusimi në masa të tjera (p.sh. materialet mbrojtës) për të rritur eficientë e energjisë së ndërtesave.
- ✚ PKEK-ja duhet të parashikojë një politikë dhe masa më ambicioze për zhvillimin e transportit hekurudhor, si një element kyç për rritjen e eficientës së energjisë dhe shkarkimeve të ekonomisë dhe mallrave konsumatore. Për të garantuar ndarjen midis zhvillimit ekonomik dhe shkarkimeve nga sektori i transportit, duhet të garantohet një rritje pothuajse zero në shkarkimet e transportit, deri në vitin 2030. Kjo gjë mund të arrihet përmes shtimit të investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet hekurudhore, duke elektrifikuar sektorin e transportit të udhëtarëve dhe duke rritur

kapacitetin dhe cilësinë e transportit rrugor publik në raport me transportin hekurudhor.

- ✚ BRE kyç që do të përdoret në mënyrë intensive në vitet e ardhshme është energjia diellore. Nëse Shqipëria dëshiron ta përdorë këtë energji në mënyrë eficiente, kjo gjë duhet të pasohet nga ndërtimi i një rrjeti shpërndarjeje inteligjent.
- ✚ Pas rindërtimit ose përmirësimit, duhet t'i kushtohet vëmendje pranueshmërisë së teknologjisë në lidhje me ndikimet në organizmat ujorë. Jo të gjitha teknologjitë janë njësoj të pranueshme nga këto organizma, prandaj, gjatë përzgjedhjes së teknologjive, përdoren ato me ndikimin më të vogël. Në disa HECv që janë ndërtuar vite më parë, rrugëkalimet e peshqve nuk janë të mirëmbajtura, edhe pse kjo gjë është e nevojshme dhe e arsyeshme. Në këto raste, rinovimi i rrugëkalimeve të peshqve është një kusht për rindërtimin. Gjatë procesit të përmirësimit, është gjithashtu e nevojshme të ofrohet mundësia e monitorimit të drejtpërdrejtë të prurjeve ekologjike.

8. PROCESET E KONSULTIMEVE

9. BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT

- Shqipëria - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
- Shqipëria - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
- Shqipëria, MIE - Draft Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën, korrik 2021
- Komunikimi i Tretë Kombëtar në kuadër të KKKBNK-së. Programi për Ndryshimet Klimatike, UNDP.
- Energy Poverty in South East Europe – Surviving the Cold. Programi Politik i Evropës Juglindore për Energjinë e Qëndrueshme (SEE SEP), 2016
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
- Gjeografia e Shqipërisë, Botim i Akademisë së Shkencave
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës
- Jiri Dusik, Shqipëri - Metodologjia e përgjithshme për VSM-në - Drafti i 1-rë, qershor 2012
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015-2030
- Raporti për Gjendjen e Mjedisit, 2017
- Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Kuadri legjislativ

- Ligji nr. 111, i vitit 2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr.73 / 2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- Ligji nr.8906, datë: 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr.9734, datë: 14.05.2007 "Për turizmin"
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor"
- Ligji nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
- VKM nr. 598, datë 01.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar"
- VKM nr. 620, datë 07.07.2015 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësive dhe proceduarve të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar"
- VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"
- VKM nr. 507, datë 10.06.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- Ligji nr. 11/2015 "Për aderimin e republikës së shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e konventës "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar"
- VKM nr. 219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

Direktivat e BE-së

- Vendimi i Komisionit nr. 2010/2/BE "Për përcaktimin e një liste të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit";
- Vendimi i Këshillit 2002/358/KE "Për miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to";
- Direktiva e Këshillit 85/337/KE "Për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis";
- Direktiva 1999/94/KE "Për disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve";
- Direktiva 2000/53/KE "Për automjetet në fund të jetës"
- Direktiva 2000/60/KE "Për ngritjen e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave";
- Direktiva 2001/42/KE "Për vlerësimin e pasojave mjedisore të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva 2001/81/KE "Për tavanet kombëtare të shkarkimeve për disa ndotës atmosferikë";
- Direktiva 2002/96/KE dhe Direktiva 2012/19/BE "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";
- Direktiva 2003/35/KE "Për garantimin e pjesëmarrjes së publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin dhe që ndryshon direktivat 85/337/KEE dhe 96/61/KE për sa i përket pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi";
- Direktiva 2003/4/KE "Për aksesin e publikut në informacionin mjedisor";
- Direktiva 2003/87/KE "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/KE";
- Direktiva 2004/101/KE "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit në zbatim të mekanizmave të Protokollit të Kiotos";
- Direktiva 2004/35/KE "Për përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2005/55/KE "Për përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete".
- Direktiva 2006/118/KE "Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi";
- Direktiva 2006/21/KE "Për menaxhimin e mbetjeve nga industria e nxjerrjes";
- Direktiva 2006/66/KE "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";
- Direktiva 2006/7/KE "Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes";
- Direktiva 2007/60/KE "Për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet";
- Direktiva 2008/50/KE "Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Evropë";
- Direktiva 2008/98/KE "Për mbetjet";
- Direktiva 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egra";
- Direktiva 2009/29/KE "Për ndryshimin e Direktivës 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njërive të lejuara të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit";
- Direktiva 92/43/KE "Për ruajtjen e habitateve natyrore, të florës dhe faunës së egër";
- Direktiva 98/83/KE "Për cilësinë e ujit të pijshëm";

Konventat ndërkombëtare:

- Konventa CITES (1975): Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër

- Konventa e Aarhusit (Konventa mbi të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe të Drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore) (1998)
- Konventa e Barcelonës (1976); Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe
- Konventa e Bernës (1976): Ruajtja e Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror Evropian
- Konventa për Diversitetin Biologjik (1992)
- Konventa e Bonit (1979); Konventa për Ruajtjen e Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra
- Konventa e ESPOOS (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar së bashku me Amendimet dhe Protokollet
- Konventa e Ramsarit për Ligatinat (1971)
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

10. SHTOJCAT

- Shtojca 1 – Kuadri ligjor gjithëpërfshirës
- Shtojca 2 – Konsultimet me publikun
- Shtojca 3 – Përmbledhje e institucioneve të përfshira në sektorin e energjisë

10.1. Shtojca 1 – Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Në këtë shtojcë paraqiten aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me dimensionet përkatëse sipas PKEK-së.

➤ *Dimensioni i dekarbonizimit*

1. Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”
2. Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”
3. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
4. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
5. Ligji nr. 9957, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar
6. Kontributet Kombëtare të Pikësnuara për Shqipërinë (INDC)
7. VKM nr. 418, datë 20.5.2020, “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Shqipëri, 2020–2035”
8. VKM Nr. 580, datë 28.8.2019 “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”
9. VKM nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”
10. VKM nr. 814, datë 31.12.2018, “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”
11. VKM nr. 633, datë 26.10.2018, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, e ndryshuar
12. VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”
13. VKM Nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit, 2016-2020” (SSTPV)
14. VKM Nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e SNZHRB - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020”, e ndryshuar
15. Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”
16. Studim sektorial lidhur me kërkesën e investimeve për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri (2018)
17. Kontributet Kombëtare të Përcaktuara (versioni draft 2021)
18. Projektligji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”
19. Plani i Transportit të Qëndrueshëm (versioni draft)

➤ *Dimensioni i efijencës së energjisë*

1. Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”
2. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
3. Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”
4. Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për efijencën e energjisë”
5. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar

6. Ligji nr. 9463, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar
7. VKM Nr. 580, datë 28.8.2019 "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020"
8. VKM nr. 466, datë 3.7.2019, "Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike"
9. VKM nr. 407, datë 19.6.2019, "Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik"
10. VKM nr. 342, datë 22.5.2019, "Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë"
11. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030"
12. VKM nr. 709, datë 1.12.2017, "Për miratimin e planit të dytë dhe të tretë kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë, 2017 – 2020"
13. VKM nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"
14. VKM Nr. 811, datë 16.11.2016 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020" (SSTPV)
15. VKM nr. 619, datë 7.9.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë, 2011 – 2018"
16. Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli"
17. Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020 (Raporti i monitorimit, 2019)
18. Projektligji "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"
19. Plani i Transportit të Qëndrueshëm (versioni draft)

➤ ***Siguria energjetike***

1. Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar
2. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar
3. Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet", i ndryshuar
4. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030"
5. VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"
6. VKM nr. 417, datë 10.5.2017, "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror"
7. Projektligji "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"

➤ ***Tregu i brendshëm i energjisë elektrike***

1. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"
2. Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave"
3. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar
4. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030"
5. VKM nr.16, datë 11.01.2017 "Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e interkonektorëve të rinj"

6. VKM nr. 718, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”
7. Vendimi i bordit të ERE nr. 186, datë 10.11.2017, “Për miratimin e kodit të transmetimit”
8. Vendimi i bordit të ERE nr. 180, datë 8.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”
9. Vendimi i ERE nr. 135, datë 6.9.2017 “Rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit (OSSH, OST)”
10. Urdhri i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, Nr 27, datë 18.1.2021 “Për miratimin e strategjisë së transformimit të mbështetjes feed-in-tariff në kontratë për diferencë”

➤ ***Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca***

1. Ligji Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
2. VKM Nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (SKShTI), për periudhën 2017-2022”
3. VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit” (AKKSHI)

10.2. Shtojca 2 – Konsultimet me publikun

Për t'u plotësuar në raportin përfundimtar

10.3. Shtojca 3 – Përmbledhje e institucioneve të përfshira në sektorin e energjisë

Institucionet më të rëndësishme në përcaktimin e kuadrit politik dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”) dhe Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”).

Krahas MIE dhe ERE, janë gjithashtu edhe disa ministri që luajnë një rol më të vogël në sektor, si dhe një sërë agjencish qeveritare të cilave ministratë u kanë deleguar përgjegjësi në lidhje me sektorin e energjisë elektrike. Ministri të tjera të rëndësishme janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“MFE”); Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Organet rregullatore dhe agjencitë e tjera qeveritare të përfshira në sektorin e energjisë

Enti Rregullator i Energjisë (ERE): Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) është një organ shtetëror i pavarur, përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike dhe në sektorin e gazit natyror. ERE është gjithashtu përgjegjëse për zhvillimin e pjesës më të madhe të legjislacionit dytësor në sektor, si dhe për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike. ERE është organi kompetent për:

- dhënien e licencave për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike
- miratimin e kodeve të rrjetit, të cilat rregullojnë lidhjen me dhe aksesin në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike.
- miratimin e tarifave në sektorin në fjalë, duke përfshirë tarifat “feed-in” për prodhuesit e BRE-ve, tarifat për aksesin në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe tarifat për klientët fundorë që furnizohen nga Shërbimi Universal i Furnizimit.
- miratimin e dokumenteve standarde të industrisë, si p.sh. kontratat tip të shit-blerjes së energjisë, që do të përdoren nga prodhuesit me përparësi të BRE-ve.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë: është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për EE-në përcaktohen me detaje në nenin 8 dhe 25 të ligjit “Për eficiencën e energjisë” dhe përfshijnë:

- Përgatitjen e legjislacionit dytësor dhe të programeve për promovimin e eficiencës së energjisë.
- Përgatitjen dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (“PKVEE”) dhe përgatitjen e një progres-raporti vjetor lidhur me PKVEE.
- Bashkëpunimin me pjesëmarrësit e tregut dhe grupet e interesit për krijimin e një baze të dhënash për të monitoruar progresin e bërë në përmirësimin e eficiencës së energjisë.
- Përgatitjen e standardeve dhe rregulloreve teknike për të përmirësuar eficiencën e energjisë së produkteve.
- Vlerësimin e projekteve për përmirësimin e eficiencës së energjisë për financim potencial nga fondi i EE-së.
- Mbështetjen e eficiencës së energjisë përmes ofrimit të konsulencës, trajnimeve dhe hartimit të kontratave standarde për shërbimet energjetike.
- Verifikimin e saktësisë së të dhënave nga auditimet energjetike, në rast se e çmon të nevojshme.

Fondi për Eficiencën e Energjisë: Ligji për eficiencën e energjisë autorizon krijimin e Fondit për Eficiencën e Energjisë, i cili do të menaxhohet nga një Këshill Drejtues, që përbëhet nga përfaqësues të institucioneve publike të ndryshme. Aktualisht po zhvillohet një proces konsultimi mbi variantin e

rishikuar të ligjit për efikasitetin e energjisë, në vijim të të cilit do të merret vendimi nëse do të krijohet Fondi për Efikasitetin e Energjisë apo nëse është e nevojshme të krijohen mekanizma të tjerë financiarë për investimet në fushën e efikasitetit të energjisë. Aktualisht, sipas vlerësimeve paraprake, gjykohet se kushtet janë të pafavorshme për krijimin e Fondit për Efikasitetin e Energjisë për Shqipërinë, për shkak të pengesave të shfaqura që në nisje të këtij procesi (2017). Prandaj, nënet përkatëse mund të përjashtohen nga ligji.

AKBN – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (“AKBN”) raporton pranë MIE-së. Misioni i AKBN-së është zhvillimi, mbikëqyrja dhe përdorimi racional i burimeve natyrore, sipas politikës së qeverisë, dhe monitorimi i shfrytëzimit të tyre në sektorin minerar, të hidrokarbureve dhe të energjisë.

AKPT – Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Territorit: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (“AKPT”) është një institucion publik në varësi të MIE-së, e cila është përgjegjëse për përgatitjen dhe koordinimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është përgjegjëse për koordinimin e planifikimit të territorit, dhe prandaj ka një rol të rëndësishëm në lidhje me shfrytëzimin e potencialit të energjisë së rinovueshme, që përcaktohet nga dispozitat në të drejtën agrare. Planifikimi hapësinor për energjinë (i quajtur gjithashtu zonimi energjetik ose përgatitja e master planit për energjinë) luan një rol thelbësor në arritjen e objektivave të PKEK-së. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe funksionet e saj bazohen në Ligjin nr. 28/2017 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

AZHT - Agjencia e Zhvillimit të Territorit: AZHT është organi vendimmarrës për projekte specifike me rëndësi kombëtare. Këtu përfshihet, për shembull, miratimi i lejeve të ndërtimit për projektet në sektorin e energjisë, si p.sh. për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, si dhe projektet për naftën dhe gazin.

AKM – Agjencia Kombëtare e Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit (“AKM”) është një institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e cila është përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e vlerësimeve të ndikimit në mjedis për projektet e mëdha të zhvillimit, si p.sh. ato në sektorin e energjisë. Agjencia është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin e pajtueshmërisë me standardet mjedisore.

Shoqëritë Publike të Energjisë

Krahas departamenteve shtetërore dhe të agjencive të përmendura më lart, në Shqipëri ekzistojnë edhe disa shoqëri të mëdha publike të energjisë, të cilat janë në thelb organe të shërbimeve publike në pronësi të shtetit.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH: KESH mbetet prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri, duke gjeneruar ~75% të energjisë së prodhuar në vitin 2015. Fillimisht, KESH u krijua si një shoqëri shtetërore vertikalisht e integruar, që mbulonte të gjitha funksionet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. KESH është gjithashtu përgjegjës për administrimin, mirëfunksionimin dhe garantimin e sigurisë teknike dhe operacionale të hidrocentraleve që ai operon.

Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST: OST është Operatori i Sistemit të Transmetimit (“OST”) në Shqipëri, që menaxhon rrjetin në nivelin e tensionit 110 kV e lart. OST-ja është një shoqëri aksionare e pavarur, aksionet e së cilës janë në pronësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përgjegjësitë kryesore të OST-së janë:

- Menaxhimi i flukseve të energjisë në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike;
- Shërbimet e balancimit të sistemit;
- Zhvillimi i rrjetit të transmetimit për të garantuar sigurinë e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- Mbulimi i humbjeve në rrjet dhe ofrimi i shërbimeve ndihmëse;
- Alokimi i kapacitetit ndërkufitar;
- Lidhja e përdoruesve me rrjetin e sistemit të transmetimit.

Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE: OSHEE zotëron sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike nën 110 kV. OSHEE është shoqëria mëmë në cilësinë e aksionarit themelues, e cila ka nën kontroll tri shoqëri bija midis të cilave synon të bëjë ndarjen e aktiviteteve të shpërndarjes, shërbimeve universale të furnizimit dhe shitjeve për tregun e lirë të energjisë elektrike, si më poshtë:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A. (FSHU) për "Furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që operojnë në tregun e rregulluar, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi".
- "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A (FTL) për "Blerjen dhe menaxhimin e energjisë elektrike dhe operimin në tregun e lirë, etj".
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A (OSSH) për "Shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike të klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, shërbimet e instalimit dhe matjes së energjisë elektrike, etj.".

OSHEE Sh.A., përmes Entit Rregullator të Energjisë, i ka transferuar licencat e tij te shoqëritë e krijuara rishtazi.

Operatori i Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë) është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar, përmes platformës së tregut, e cila do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, e cila është e pavarur financiarisht dhe ligjërisht nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është përgjegjës për sigurinë publike të aspekteve të pajisjeve të përdorura për prodhimin, transportimin dhe shpërndarjen e energjisë, si dhe për ruajtjen e sigurisë së infrastrukturës së gazit. ISHTI mban gjithashtu përgjegjësi për monitorimin dhe kontrollimin e respektimit të kushteve dhe standardeve teknike të impianteve dhe instalimeve në fushën e hidrokarbureve, që varion nga kërkimi dhe prodhimi i naftës bruto e deri te shitja e produkteve përfundimtare nga konsumatori fundor. Kontrolli i cilësisë së të gjitha produkteve të lëndëve djegëse që tregtohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë përfshihet në kompetencat e Inspektoratit.


ALBPETROL është një shoqëri në fushën e naftës, 100% në pronësi të shtetit dhe vertikalisht e integruar, që zotëron të drejtat ekskluzive për zhvillimin e të gjitha veprimtarive në fushën e naftës dhe të gazit. Pjesa më e madhe e prodhimit të naftës mbi të cilin ALBPETROL ka të drejta prodhimi është kontraktuar te shoqëri të huaja dhe 60% e tij eksportohet jashtë vendin për rafinim në nënprodukte.

ALBGAS është një shoqëri 100% në pronësi të shtetit, e themeluar për të funksionuar si një operator i kombinuar i sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes së gazit.

Përmbledhje e institucioneve qeveritare

Institucionet më të rëndësishme në përcaktimin e politikave dhe rregullimin e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”) dhe Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”). Krahas MIE dhe ERE, janë gjithashtu edhe disa ministri që luajnë një rol më të vogël në sektor, si dhe një sërë agjencish qeveritare të cilave ministritë u kanë deleguar përgjegjësi në lidhje me sektorin e energjisë elektrike. Këto janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë qeveritare e shoqëritë e përfshira në furnizimin me energji, siç tregohen në figurën më poshtë.

Figura 18: Organigrama e institucioneve qeveritare të përfshira në hartimin dhe zbatimin e PKEK-së



Burimi: PKEK